



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**DISERTACION**

**SHQYRTIME KONTRASTIVE PËR FORMËN E BRENDSHME TË GJUHËS NË  
SHQIPE, PËRQASUR ME GJUHË TË TJERA INDOEVROPIANE**

**Punoi  
Ma. ALDA JASHARI-CICKO**

**Udhëheqës shkencor  
Prof. dr. SHEZAI RROKAJ**

**TIRANË, 2014**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**DISERTACION**

**Përgatitur nga: Alda JASHARI-CICKO**

**Për marrjen e gradës shkencore: “DOKTOR”**

**SHQYRTIME KONTRASTIVE PËR FORMËN E BRENDSHME TË GJUHËS NË  
SHQIPE, PËRQASUR ME GJUHË TË TJERA INDOEVROPIANE**

**Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Shezai RROKAJ**

**Mbrohet në dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2014 përpara jurisë së përbërë nga:**

1. \_\_\_\_\_ Kryetar
2. \_\_\_\_\_ Anëtar
3. \_\_\_\_\_ Anëtar (oponent)
4. \_\_\_\_\_ Anëtar (oponent)
5. \_\_\_\_\_ Anëtar

**TIRANË, 2014**

## **Falënderime**

Qysh në krye, dua të shpreh mirënjohjen për udhëheqësin e këtij disertacioni, prof. dr. Shezai Rrokaj, i cili, me këshillat dhe sugjerimet e tij me shumë vlerë, bëri që ky punim të përsosej cilësisht. Dëshiroj të përmend dhe të falënderoj profesorët e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës që më dhanë mësim gjatë shkollës doktorale.

Kolegët dhe miqtë e mi, pedagogë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin e Korçës, i falënderoj për dashamirësinë dhe ndihmën e pakursyer, për mbështetjen dhe përkrahjen gjatë gjithë punës sime. Një falënderim të veçantë kam për kolegët Olgër Brame dhe Dhori Beta, të cilët u përkujdesën për anën teknike dhe përpunimin kompjuterik të materialit.

Gjithashtu, vlerësoj edhe ndihmën e çmuar të prof. as. dr. Pavllo Cicko dhe Prof. dr. Dhimitri Bello, të cilët më ofruan konsulencën për gjuhët e huaja.

Familjes dhe, veçanërisht vajzave të mia, u shpreh mirënjohje pafund për përkujdesjen, qetësinë dhe mirëkuptimin e dhuruar.

Në fund, dua të përmend babain tim, Ali Jashari, që me këmbëngulje dhe përkushtim më nisi në këtë hulli të vështirë të shkencës, më ndoqi hap pas hapi dhe me durim, duke bërë që ëndrra e tij dhe imja të realizohej.

ALDA JASHARI-CICKO

Korçë, shtator 2014

## **Tabela e përmbajtjes**

Falënderime.....	1
Tabela e përmbajtjes.....	2
<b>HYRJE.....</b>	<b>7</b>
0.1. Përligjja e punimit.....	7
0.2. Objekti i punimit dhe hipotezat e tij.....	10
0.3. Metodologjia e kërkimit dhe literatura shkencore .....	16
<b>KAPITULLI I .....</b>	<b>19</b>
<b>VËSHTRIM HISTORIKO-TEORIK MBI FORMËN E BRENDSHME NË GJUHË.....</b>	<b>19</b>
1.1. Rreth termit “formë e brendshme” dhe përkufizimet për të.....	19
1. 2. Qasje ndaj formës së brendshme të gjuhës deri në shekullin XIX.....	21
1.2.1. Teoria e korrigjimit ose e përmirësimit të emrave .....	22
1.2.2. Kuptimi si raport ndërmjet fjalëve dhe sendeve .....	23
1.2.3. Debati “natyrë”-“konvencion” .....	23
1.2.4. Teoria e lektionit .....	25
1.2.5. Kratili, Hermogjeni dhe Sokrati.....	26
1.2.6. De natura rerum .....	28
1.2.7. Fjalët parake varroniane.....	29
1.2.8. Realistë dhe nonimalistë .....	30
1.2.9. Traktati “De vulgari eloquentia” i Dante Alighierit.....	31
1.2.10. Teoria individualiste dhe e marrëveshjes shoqërore .....	32
1.3. Rreth ideve të Humboldt për formën e brendshme të gjuhës.....	33
1.3.1. Antinomitë gjuhësore.....	34
1.3.2. Gjuha është “shpirti i popullit” (botëkuptim).....	34
1.3.3. Format e gjuhës.....	35
1.4. Probleme të formës së brendshme të gjuhës në teoritë psikologjike individualiste .....	37
1.5. Fjalët dhe sendet (veçanësitë dhe afritë gjuhësore).....	38

1.6. Gustav Shpet-i për tezat e Humboldt-it.....	38
1.7. Hipoteza e relativizmit lingistik .....	41
1.8. Forma e brendshme sipas Anton Marty-it.....	43
1.9. L. Weisgerber-i si dishepull i Humboldt-it .....	45
1.10. Potebnja dhe Zvegincev për formën e brendshme .....	46
1.11. “Summa summarum” e Roland Barthes-it për formën e brendshme .....	47
1.12. Përsiatje të I. Kadaresë për formën e brendshme të gjuhës.....	49
KAPITULLI II.....	51
RRETH FORMËS SË BRENDSHME TË FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE.....	51
2.1. Analiza etimologjike dhe forma e brendshme e fjalës: lidhje e dallime .....	51
2.2. Forma e brendshme të fjalët e prejardhura.....	52
2.3. Forma e brendshme të homonimet.....	57
2.4. Forma e brendshme si motivim semantik të emrat e përveçëm .....	63
2.5. Forma e brendshme të emrat-terma që përdoren vetëm në numrin shumës.....	66
2.6. Nofkat si shprehje e formës së brendshme.....	67
2.7. Sinonimia leksikore dialektore si shprehje e realizimit të formës së brendshme.....	72
KAPITULLI III.....	76
ANALIZA E KOMPOZITAVE NGA PIKËPAMJA E FORMËS SË BRENDSHME .....	76
3.1. Motivimi semantik si mjet për të zbuluar formën e brendshme.....	76
3.2. Motivimi i brendshëm i kompozitave mbiemra sipas tipareve të referentit.....	78
3.3. Tipet e formës së brendshme sipas strukturave semantike .....	81
3.4. Motivimi i formës së brendshme të kompozitave mbiemra mbi bazën e ngjyritimit emocionues... 93	
3.5. Organizimi kompozitave sipas fushave konceptore dhe leksikore në funksion të formës së brendshme .....	95
3.6. Kompozitat dëshirore dhe forma e brendshme .....	100
3.7. Forma e brendshme e kompozitave terma .....	102
3.8. Analizë përjasëse e formës së brendshme të kompozitave me anglishten dhe gjuhë të tjera indoevropiane.....	106
KAPITULLI IV .....	116
RRETH FORMËS SË BRENDSHME TEK EMËRTIMET E PËRBËRA.....	116
4.1. Trajtesat teorike për emërtimet e përbëra në gjuhën shqipe .....	116
4.2. Analizë leksiko-semantike e togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë .....	117

4.2.1. Motivimi mbi bazën e funksionit të referentit.....	119
4.2.2. Motivimet mbi bazën e ngjyrës së referentit.....	120
4.2.3. Motivimi mbi bazën e disa cilësive të referentit .....	121
4.2.4. Motivimi mbi bazën e një emërtimi tjetër të referentit .....	122
4.2.5. Motivimi mbi bazën e formës së referentit .....	122
4.2.6. Motivimi mbi bazën e treguesit të kohës .....	123
4.2.7. Motivimi mbi bazën e treguesit të lëndës .....	124
4.2.8. Motivimi mbi bazën e treguesit të vendit.....	124
4.3. Shqyrtim përqsasës i emërtimeve të përbëra të shqipes me gjuhë të tjera.....	124
KAPITULLI V.....	128
ANALIZË STRUKTURORE-SEMANTIKE E NJËSIVE EUFEMISTIKE TË SHQIPES MBI BAZËN E KONCEPTIT TË FORMËS SË BRENDSHME.....	128
5.1. Përkufizimi i eufemizmave dhe studimi i tyre .....	128
5.2. Eufemizmat në kontekstin historiko-shoqëror si sendërtim i formës së brendshme .....	131
5.3. Eufemizmat në këndvështrimin pragmatik .....	134
5.4. Analiza e formës së brendshme të disa eufemizmave të shqipes .....	136
5.4.1. “Gjarpri” si tabu dhe eufemizmat për të .....	137
5.4.2. Një analizë e formës së brendshme për eufemizmat e tabusë “ujk” .....	139
5.4.3. Bukla, nuselala etj. dhe forma e tyre e brendshme.....	142
5.4.4. Rreth formës së brendshme të njësive eufemistike për tabu nga demonologjia .....	144
5.4.5. Rreth formës së brendshme të njësive eufemistike për sëmundjet: epilepsia .....	146
5.4.6. Rreth formës së brendshme të njësive eufemistike për sëmundje të tjera.....	147
5.4.7. Vdekja dhe forma e brendshme e njësive eufemistike për të.....	150
5.5. Një përqsasje e formës së brendshme të eufemizmave të shqipes me anglishten .....	153
5.5.1. Eufemizmat e lidhura me profesionet .....	155
5.5.2. Eufemizmat e lidhura me sëmundjet.....	156
5.5.3. Eufemizmat e lidhura me marrëdhëniet seksuale.....	156
5.5.4. Eufemizmat e lidhura me fjalën-tabu <i>krim</i> .....	156
5.5.5. Eufemizmat e lidhura me fjalën-tabu <i>vdekje</i> .....	156
5.5.6. Eufemizmat e lidhura me shtatzaninë .....	157
5.5.7. Eufemizma me fjalët “gomar” dhe “ari” .....	158
5.6. Një klasifikim tematik i eufemizmave të shqipes .....	158

KAPITULLI VI .....	163
RRETH FORMËS SË BRENDSHME TË IDIOMAVE .....	163
6.1. Trajtime teorike dhe përkufizime për formën e brendshme të idiomave në gjuhësinë shqiptare	163
6.2. Trajtime teorike dhe përkufizime për formën e brendshme të idiomave në gjuhësinë botërore	168
6.3. Mënyrat dhe mjetet e motivimit të idiomave për nga forma e brendshme .....	174
6.3.1. Njësi frazeologjike të motivuara mbi bazën e krahasimit .....	176
6.3.2. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e metaforës.....	178
6.3.3. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e metonimisë.....	178
6.3.4. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e sinekdokës.....	178
6.3.5. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e hiperbolës dhe litotës .....	178
6.4. Idiomat në teorinë konvencionale të gjuhës së figurshme .....	179
6.4.1. Inati/zemërimi .....	179
6.4.2. Ngjashmëria, tiparet e përbashkëta, afërsia.....	180
6.4.3. Probleme, shqetësime, vështirësi, gjendje e rëndë ekonomike .....	181
6.4.4. Lehtësi.....	182
6.4.5. Dallime të sjelljes dhe karakterit.....	182
6.4.6. Padituria, moskokëçarja, papjekuria, nxitimi .....	182
6.4.7. Vdekja.....	184
6.4.8. Tipare të karakterit, pabesia, gënjeshtria, mosmirënjohja.....	184
6.5. Përqsje për nga forma e brendshme e idiomave të shqipes me bullgarishten .....	185
6.6. Forma e brendshme e vargjeve sinonimike idiomatike që shprehin të njëjtin koncept .....	187
6.7. Çështje të formës së brendshme të kalkeve frazeologjike .....	200
6.7.1. Klasifikimi i kalkeve me burim nga togfjalëshat e lirë .....	201
6.7.1.1. Kalke frazeologjike me vlerë foljore.....	201
6.7.1.2. Kalke frazeologjike me vlerë emërore .....	203
6.7.1.3. Kalke frazeologjike me vlerë ndajfoljore.....	205
6.7.2. Klasifikimi i kalkeve frazeologjike sipas burimit .....	205
6.7.2.1. Kalke frazeologjike me prejardhje biblike:.....	205
6.7.2.2. Kalke frazeologjike me prejardhje nga mitologjia:.....	207
6.7.2.3. Kalke frazeologjike me burim nga historia, gjeografia, politika.....	208
6.7.2.4. Kalke frazeologjike me burimin nga filozofia .....	209

6.7.2.5. Kalke frazeologjike me burim nga letërsia, folklori dhe besimi popullor .....	210
6.7.2.6. Kalke frazeologjike me burim nga matematika, fizika, astronomia dhe shkenca të tjera.....	213
6.8. Një analizë e formës së brendshme të njësive frazeologjike mbështetur në veprën e D. Agollit	214
6.8.1. Analiza sipas gjymtyrëve të njësive frazeologjike.....	215
6.8.2. Analiza sipas mendësisë popullore dhe botës shpirtërore.....	217
6.8.3. Analiza sipas kulturës materiale .....	217
VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	220
VIII. REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA.....	232
ABSTRACT/PËRMBLEDHJE.....	239



## HYRJE

*“Zakonet e një kombi lënë gjurmë në gjuhë, dhe, nga ana tjetër, në një masë të gjerë, gjuha formon kombin”*

**Saussure**

### 0.1. Përligjja e punimit

Hyrjen e këtij punimi po e nisim me thënien e Humboldt-it (Humbold) se “*Gjuha është rrjedhë e pavullnetshme e shpirtit të popullit*”<sup>1</sup>. Nëse kjo është aq bindëse, siç besohet nga shumëkush, atëherë natyrshëm lindin pyetje të tilla: si arrijnë popuj dhe kultura të ndryshme ta perceptojnë atë çka i rrethon në mënyra të veçanta, qoftë edhe në mënyra të njëjta; si arrijnë folës të ndryshëm të gjuhës t’i sendërtojnë valët zanore jo vetëm në sekuenca të caktuara tingujsh materialë, por në një zinxhir njësisish të kuptimshme, të konvencionalizuara, që përmbajnë një lloj informacioni njëlloj të shkodueshëm nga folësit e kësaj gjuhe? Deri ku shkon universaliteti i parimit të arbitraritetit të Saussure-it (Sosyri); a janë përzgjedhur veshjet gjuhësore në mënyrë kaq të pamenduar dhe instiktive; a është gjuha e çdo kombi një bashkim rastësor tingujsh të nyjëtuar që kanë shënuar nxitimthi realie të caktuara apo vetë gjuha është pasqyra në të cilën më qartë dhe më mirë shohim botën tonë materiale, shpirtërore, ndërgegjen, besimin dhe shpresën tonë? A është babelizmi realiteti gjuhësor në të cilin ne jetojmë, mallkimi për mëkatin e paraardhësve tanë apo është një univers më vete që të bën të kuptosh se gjuha nuk është gjë tjetër vetëm se fytyra e çdo kombi dhe se të njohësh gjuhën “e tjetrit” do të thotë të dalësh përtej botës që të rrethon?

Sigurisht, jemi të vetëdijshëm se me fqinjën e afërt apo të largët na ndan një hendek njësisish gjuhësore të papercptueshme dhe të pakonceptueshme mendërisht dhe se, që t’i kuptosh e të merresh vesh me ta, duhet të ndash të njëjtat tipare universale që lindin nga

---

<sup>1</sup> Humboldt W., *On the differences of the Human Sprachbaues and its influence on the mental development of the human race*, Stuttgart, 1963, f. 27.

parimet e brendshme të logjikës së përbashket të të gjithë gjuhëfolësve. Por a jemi plotësisht të bindur se e njohim mjaftueshëm karakterin individual kombëtar të gjuhës sonë; a jemi të bindur se tërësia e imazheve dhe shëmbëlltyrave “të depozituara” në mendjen tonë në formën e veshjeve tingullore nuk është gjë tjetër veçse sendërtimi dhe animimi i veçorive dalluese tërësore të mendjes, shpirtit dhe gjithçkaje konkrete dhe abstrakte që na bashkëshoqëron, të cilat janë asociuar njëherë e përgjithmonë në formën e modeleve identike në trurin e çdo bashkëfolësi të gjuhës sonë? A ndodh rëndom që në këtë turravrap masiv të jetës që po jetojmë, në kushtet e “konsumatorizmit” tipik që na karakterizon, ku gjuha, si rrallëherë tjetër, është një vegël më shumë për t’u instrumentalizuar në favorin tonë, të mendojmë se mos ndoshta jemi me më pak fat se paradhësit tanë, të cilët kishin “luksin” ta perceptonin realitetin objektiv ashtu si ata mendonin, madje, jo vetëm njëherë dhe me të njëjtin mënyrë, por me një shumësi mjetesh dhe mekanizmash, duke na bërë të mendojmë se si përdorues dhe jo krijues të gjuhës, neve na ka rënë për pjesë ta shohim botën, as më shumë dhe as më pak, por ashtu siç ata do të dëshironin? Sa herë na shkon në mendje të analizojmë dhe ta drejtojmë ndërgjegjen tonë drejt lidhjeve të sendit me konceptin dhe formën materiale që ne jemi mësuar ta përdorim? Rrallë, për të mos thënë kurrë. Sigurisht, që teksa gjuhën e marrim si një fakt konkret dhe të mirëqenë, nuk na shkon ndër mend aspak se, ndërsa presim *fluturimin* e radhës për diku, të mendojmë se në shqip *fluturoj* dhe *flutur* apo në anglisht *fly*<sub>I</sub> - *fluturoj* dhe *fly*<sub>II</sub> - *mizë* kanë të njëjtën bazë sendore-logjike të perceptuar njëlloj, se në të njëjtat kushte mendore-psikike është prodhuar *dritare* “vend nga hyn drita”, në anglisht *window* “realie për të penguar erën”, në rusisht *okno* (nga mund të shohësh), në italisht *finestra* (diçka e hollë, fine) etj., se *syze* është perceptuar pashmangshmërisht mbi bazën e realies *sy*, se entiteti ynë mendor e ka krijuar fjalën *shkrepëse* vetëm sepse me të mund të ndezësh (të shkrepësh) shkëndijën (në analogji me *shkrepëtij* apo me onomatopenë përkatëse), se *qeleshe* nuk mund të motivohet veçse me “që është bërë prej leshi” etj.; apo kur themi *humbet rrugën në oborr* “është i mefshtë”; *e dogji shaminë e beqarit* “u martua”; *është me një këmbë në yzengji* dikush “është gati për të ikur a për të bërë shpejt diçka” etj.

Mënyra se si shqipja e ka përpunuar formën e shprehjes në funksion të tërësisë përmbajtësore, qëmtimet e hollësishme që folësit kanë përdorur për të konkretizuar njësi të veçanta leksikore, nxjerrja në pah e treguesve të ndryshëm të realieve në funksion të realizimit të finalizimit aktual të shprehjes etj., janë në një masë të madhe të motivueshme

me kushtet psikike-mendore të folësve, duke bërë që të besohet se dallimet nuk qëndrojnë te veshjet tingullore, por te imazhet psikike që folësit perceptojnë dhe shkodojnë materialisht, me aftësinë për ta njohur dhe zbërthyer realien deri në gjërat më të imëta, me përvojat jetësore dhe vetëdijen kolektive, me kujtesën gjenetike dhe gjurmët historike.

Teoria e formës së brendshme, pra procesi i gjuhësimit a i shenjzimit, është plotësisht e përligjur në rastin e analizës sonë dhe na çoi në përfundimin se mënyrat se si folësit e gjuhëve të marra në analizë e perceptojnë realitetin, lidhja dhe materializimi i veshjes tingullore me konceptin që shprehet me anë të saj, përzgjedhja e elementeve gjuhësore origjinale që bashkësitë e ndryshme gjuhëfolëse krijojnë për të shenjuar një realie, për të shprehur një përmbajtje të caktuar etj., nuk mund të shpjegohen tjetër veçse me traditën, kulturën, botën materiale, mendësinë, shkallën e njohjes së realitetit objektiv, kushtet natyrore, mënyrën e jetesës etj. Veç të tjerash, dallimet e dukshme në fushën e leksikut përcaktohen nga ndasitë e parimeve të brendshme të logjikës dhe të perceptimit. Koncepti që Humboldt-i kishte për gjuhën, duke u shprehur se forma e brendshme e gjuhës është shpirti i popullit, se gjuha vetë gjen vend dhe përligjet edhe me faktin se qasjet dhe bashkëpërkimet që folësit e këtyre gjuhëve gjejnë midis elementeve të realies dhe tërësisë së veshjeve gjuhësore, dëshmojnë shpirtin origjinal dhe natyrën e pakrahasueshme të këtyre gjuhëve.

Humboldt-i, ndër të tjera, vëren se “*Ndryshimet ndërmjet gjuhëve nuk janë çështje të tingujve dhe të shenjave, por të konceptit të ndryshëm mbi botën*”<sup>2</sup>. Ky këndvështrim duket interesant dhe plotësisht i përligjur edhe në rrafshin e studimeve kontrastive të gjuhëve. Paraqitja dhe konkretizimi i dallimeve brenda strukturës së brendshme kuptimore është bazuar në përjasjen e elementëve të sistemit leksikor aktiv të disa gjuhëve të familjes indoevropiane, sidomos të anglishtes, italishtes, frëngjishtes etj.

Në mënyrë më të veçantë, kjo analizë kontrastive mëton të nxjerrë në pah dallimet dhe bashkëpërkimet midis shqipes dhe anglishtes, si një prej gjuhëve me një visar të çmuar të fjalëve dhe shprehjeve dhe me veçori të spikatura të karakterit idiomatik. Pikërisht, kjo lëndë gjuhësore e pashtershme na dha mundësinë që ta zgjerohim nivelin e analizës dhe të nxirrim përfundime me vlerë pothuajse në të gjithë e nënsistemit leksikor (fjalët e

---

<sup>2</sup> Humboldt W., *On the differences...* vep. cit., f. 47.

prejardhura, homonimet, emrat e përveçëm, emrat-terma, nofkat, sinonimet leksikore dialektore, kompozitat, emërtimet e përbëra, eufemizmat, idiomat etj.

## **0.2. Objekti i punimit dhe hipotezat e tij**

Ky punim është konceptuar, organizuar dhe sistemuar në gjashtë kapituj. Argumentimi teorik i problemeve të parashtruara është gërshetuar natyrshëm me analizën konkrete dhe praktike të shembujve të grupuar në kategori të veçanta sipas tipareve dhe veçorive strukturore dhe kuptimore. Në funksion të hipotezës së hedhur që në fillim se gjuha pasqyrohet dhe përditësohet nga shpirti, i cili bën të mundur që tingujt e nyjëtuar të bëhen mjet për shprehjen e mendimit, forma e brendshme, kaq e ndryshme dhe lehtësisht e dallueshme jo vetëm nga gjuha në gjuhë, por edhe nga dialekti në dialekt, na dha mundësi të mjaftueshme për të hedhur dritë mbi natyrën e vërtetë të gjuhëve, si produkt i drejtpërdrejtë i tërësisë së përvojave individuale dhe shoqërore të bashkësisë. Përpos të gjithave, bindja dhe besimi i kahershëm i studiuesve të gjuhës se ndërveprimi i gjuhës dhe kulturës mund të gjendet jo vetëm në fushën e leksikut, e motivoi më tej tezën tonë dhe i hapi shteg kundrimin të kësaj dukurie në një pjesë të madhe të kategorive potenciale të këtij sistemi, kategori të gatuar sipas lidhjeve të natyrshme sistemore semantike të gjuhës dhe ligjësisive të brendshme, të diktuar prej faktorëve brenda dhe jashtëgjuhësorë dhe të mbujtura me shpirtin kombëtar, me ngjyresat e kulturës, botëkuptimit, psikologjisë dhe mendësisë së bashkësisë gjuhëfolëse.

Organizimi dhe renditja e kapitujve është bërë në funksion të shprehjes së idesë tërësore të punimit, që motivimi i brendshëm semantik dhe forma e brendshme, mund të jenë gjithëpërfshirës dhe mund të shtrihen paralelisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha realizimet e pafundme dhe të larmishme konkrete ligjërimore. Një këndvështrim shumëplanësh i këtij punimi na dha mundësi që ta vëzhgonim dukurinë nën një drejtim tjetër, në të cilin ngërthehet rrafshi diakronik me atë sinkronik.

Kapitulli i parë i këtij punimi me titull “Trajtesa teorike për formën e brendshme e gjuhës” është konceptuar në formën e një sinteze të gjerë të ndihmesave teorike dhe këndvështrimeve të ndryshme të problematikës së këtij argumenti përgjatë zhvillimit të mendimit gjuhësor. Dilema e kahershme e njerëzimit dhe thelbi i debatit filozofik dhe gjuhësor nëse ka apo jo një lidhje të brendshme a shkakësore ndërmjet natyrës së sendit dhe

emrit që e shënon atë, është shtjelluar me argumente pro dhe kundër, me debate idesh dhe qëndrimesh të ndryshme të karakterit filozofik, teologjik, ekzistencialist, me përballje teorish dhe ballafaqime tezash gjuhësore, me pranëvënie hipotezash dhe argumentim kundërshtish. Duket se tharmi i debatit të lashtë, sa dhe vetë gjuha, i ka kapërcyer kufijtë kohorë dhe truallsorë nga Kina e vjetër dhe Greqia e lashtë te Mesjeta dhe Rilindja shpresëndjellëse, e deri te teoritë më të spikatura të shekullit XIX, prej nga mori jetë edhe teza e Humboldt-it, e cila qëndron në themel të trajtesës teorike të këtij disertacioni. Ndhimesat teorike të shkollave, teoricienëve, përfaqësuesve të epokave përkatëse etj., janë renditur në sythe të veçantë, duke i shtjelluar dhe dokumentuar ato, siç janë: “teoria e korigjimit ose e përmirësimit të emrave”, “kuptimi si raport ndërmjet fjalëve dhe sendeve”, “debati natyrë-konvencion”, “teoria e lektonit”, “argumentet e Demokritit”, “Kratili, Hermogjeni dhe Sokrati”, “De natura rerum”, “fjalët parake varroniane”, “universalet përkundër formës së brendshme”, “fjalët dhe sendet (veçanësitë dhe afritë gjuhësore)”, “hipoteza e relativizmit lingvistik” etj., duke nxjerrë në pah ndihmesat teorike të studiuesve të ndryshëm për formën e brendshme të gjuhës, edhe pse ky term ende nuk ishte krijuar si i tillë. Një pjesë e këtyre sytheve u kushtohet trajtesave teorike për formën e brendshme nga pasardhësit e Humboldt-it dhe filozofë të tjerë të gjuhës, si: “rreth termit “formë e brendshme dhe përkufizimet për të”, “Gustav Shpet-i dhe Humboldt-i”, “hipoteza e relativizmit lingvistik”, “forma e brendshme sipas Anton Marty-it”, “L. Weisgerber-i si dishepull i Humboldt-it”, “Potebnja dhe Zvegincev për formën e brendshme”, “Summa summarum” e Roland Barthes-it për formën e brendshme” etj.

Në kapitullin e dytë “Rreth formës së brendshme të fjalës në gjuhën shqipe” synohet që, nëpërmjet analizës etimologjike dhe kundërimit të disa dukurive që vihen re si rezultat i ndryshimeve semantike që ndodhin përgjatë zhvillimit të gjuhës, të qëmtohet forma e brendshme e fjalëve. Rast pas rasti është analizuar shkalla e motivimit dhe qartësia e lidhjeve kuptimore ndërmjet temës fjalëformuese dhe fjalës së prejardhur. Në kuadër të këtij punimi homonimet janë analizuar nga pikëpamja e motivimit së formës së brendshme të fjalës, që përmbahet në kuptimin e fjalës homonime, e cila përputhet plotësisht me të sipas veshjes tingullore. Lënda gjuhësore e përdorur në këtë kapitull është pasuruar me shembuj të vjelë nga fusha e onomastikës dhe kryesisht antroponimet, toponimet, nofkat dhe patronimet, çka e zgjeroi spektrin e analizës sonë. Materiali i lartpërmendur është klasifikuar sipas fushave

leksikore dhe konceptuale, sipas lidhjeve semantike të krijuara brenda çerdheve të fjalëve. Në këtë kontekst janë shfrytëzuar disa prej burimeve potenciale të sferave të veçanta të leksikut popullor. Sinonimisë leksikore si shprehje e realizimit të formës së brendshme i është kushtuar një vend i veçantë në këtë kapitull. Sinonimet dialektore, të cilat në rastin e gjuhës shqipe paraqiten jo vetëm të shumta në numër, por edhe të shumëllojshme, origjinale e të veçanta, na krijojnë hapësirat e duhura për t'i studiuar. Kjo shumëllojshmëri nuk ka si të mos shihet e lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë e këtyre rajoneve, me kulturën materiale me përvojën e këtyre njerëzve, me veçoritë e jetës shpirtërore, elementë, të cilët, së bashku, përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të një bashkësie gjuhëfolëse. Nofkat, një pjesë e të cilave, të kthyer në emra familjarë, në këndvështrimin e tezës sonë, janë mjete leksikore të përimituara me shumë kujdes, të motivueshme dhe të kushtëzuara kryesisht nga rrethana apo faktorë etnogjuhësorë, rajonalë, fetarë, shoqërorë etj. Gjeografia e shpërndarjes dhe e përdorimit të mjeteve të tilla gjuhësore është e njëtrajtshme për të gjitha hapësirat shqiptare dhe dukuria është pothuajse e barasvlershme në të dyja dialektet dhe në tërësinë e korpusit të të folmeve. Shembujt e analizuar mund të përbëjnë argument mbështetës për idenë se prirja për të etiketuar apo karakterizuar individët mbi bazën e një stereotipie të caktuar është produkt i mendësisë dhe psikologjisë popullore.

Përbërja (kompozimi) si një prej gjedheve më prodhuese të fjalëformimit të gjuhës shqipe, për vetë larminë, shumëllojshmërinë dhe vendin e rëndësishëm që zënë në korpusin e mjeteve gjuhësore të leksikut të shqipes, na krijoi hapësirën e duhur për të shqyrtuar motivimin semantik ose thënë ndryshe “formën e brendshme” të tyre në kapitullin e tretë të punimit. Analiza jonë për këta mbiemra parashtron disa prej teknikave më të rëndësishme që ka përdorur bashkësia shqipfolëse gjatë procesit të emërtimit dhe të sintetizojë disa prej gjedheve më të përdorura të këtij procesi. Gjatë vjeljes së materialit ne kemi skeduar 977 kompozita mbiemra dhe i kemi klasifikuar ato sipas disa kriterëve, të cilat lidhen me mënyrën se si është shenjuar tipari, duke u bazuar në cilësitë që zotëron vetë realia e cilësuar nga mbiemri apo nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të tij.

Në këtë mënyrë është bërë e mundur zbërthimi i përbërësve semantikë dhe kundrimi i dukurive gjuhësore në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit. Interpretimi i

lidhjeve dhe raporteve të cilësimit dhe shkallëzimi i tyre është parë gjithmonë në raport me qëndrimin subjektiv të folësit përkundrejt vlerësimit të tiparit që do të nxjerrë në pah dhe referentit të cilit ky tipar i vishet, çka bën që këto shenja gjuhësore të jenë të ngarkuara me nuanca kuptimore dhe ngjyrimë emocionuese. Përveç klasifikimeve të ndërtuara mbi bazën e tipareve të referentit apo shkallës së ndërmjetimit të cilësisë së krahasuar, kompozitat janë organizuar sipas fushave konceptore dhe leksikore. Analiza e kompozitave nga ky këndvështrim, tregon se dukuritë gjuhësore janë të lidhuara njëkohësisht me rrafshin e realitetit dhe të mendimit, me mënyrën se si një bashkësi gjuhësore e abstragon realitetin duke nxjerrë në pah tipare të veçanta të realieve, me mjetet që kjo bashkësi përzgjedh për të përpunuar formën e shprehjes, imazhet psikike që folësit sendërtojnë gjatë procesit të pëshfaqjes së koncepteve, me përfytyrimin që kanë këta të fundit për botën që i rrethon duke “prodhuar” një shumësi shenjash të ndryshme, origjinale dhe lehtësisht të dallueshme nga njëra-tjetra. Dhe, në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se këto shenja gjuhësore formojnë një varg të zgjeruar sinonimik. Të njëjtat njësi formojnë një tërësi fushash konceptore dhe leksikore, të bazuara te treguesit themelorë të realies, të përzgjedhur dhe të sintetizuar mendërisht në bazë të perceptimeve të ndryshme që folësit zgjedhin për të asociuar simbolikën tingullore me një përkatësi “natyrore” të përmbajtjes së fjalës. Në rastin e kompozitave, “substancë kuptimore”, e lidhur me tërësinë e perceptimeve, qëndrimeve subjektive të folësve, ndjenjave dhe abstragimeve mendore, është e ndryshme. Në funksion të idesë themelore të këtij kapitulli, nuk mund të lireshin pa u shtjelluar kompozitat terma. Përmes kësaj analize kemi arritur të zbërthejmë strukturalisht dhe semantikisht një varg emërtimeve të përbëra-terma të përdorura kryesisht në fushën e botanikës dhe zoologjisë. Kapitulli i tretë përmbillet me një analizë përfaqëse të formës së brendshme të kompozitave mes shqipes, anglishtes, frëngjishtes dhe italishtes. Në funksion të realizimit të objektivit kryesor të temës sonë, kompozitat që kemi përzgjedhur për analizë u përkasin të njëjtave fusha leksiko-semantike. Mënyra se si folësit e gjuhëve të krahasuara e konkretizojnë realitetin objektiv në njësi gjuhësore është pashmangshmërisht e lidhur me natyrën e gjuhës, me traditën, mendësinë, veçoritë psikologjike, me shkallën dhe nivelin e abstragimit, me situatat konkrete të ligjërit aktual dhe, mbi të gjitha, me qasjen dhe bashkëpërkimet që folësit e këtyre gjuhëve gjejnë midis elementeve të realies dhe tërësisë së veshjeve gjuhësore për ta konkretizuar këtë realie.

Kapitulli i katërt ka për qëllim analizën leksiko-semantike të togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë. Në togfjalëshat terminologjikë, si emërtime të përbëra, pasqyrohet më së miri botëkuptimi i një kombi, një bashkëjetesë midis formimit kulturor dhe rrjedhës së historisë, si shprehje e pastër e lëndës shpirtërore dhe mendësisë gjithnjë e në zhvillim. Mbledhja, skedimi dhe klasifikimi i emërtimeve të përbëra sipas treguesit tematik të fushës së përdorimit dhe, mbi të gjitha, analiza semantike dhe strukturore e tyre, na lejon të bëjmë një pasqyrë të plotë të këtyre mjeteve të rëndësishme autoktone të shqipes. Materiali i vjelë nga FGJSSH (1980), me rreth 370 njësi, u klasifikua në dy fusha të gjera semantike: fusha e botanikës dhe ajo e zoologjisë. Motivimi i strukturimit të përbërësve leksikorë është bërë mbi bazën e funksionit, përdorimit, dobisë, ngjyrës apo cilësive të tjera, si: forma, lënda, treguesve të vendit apo të kohës.

Analiza strukturore-semantike e njësive eufemistike të shqipes mbi bazën e konceptit të formës së brendshme është objekti i studimit në kapitullin e pestë. Këtu shqyrtohen qasjet teorike dhe studimet e bëra në lidhje me konceptin dhe karakteristikat e eufemizmave, duke i grupuar ato në kategori sipas veçorive kuptimore dhe strukturore. Eufemizmat janë kundruar në kontekstin historiko-shoqëror dhe atë pragmatik. Njësitë eufemistike janë një pasuri e madhe dhe e pazëvendësueshme gjuhësore. Ato na japin mundësi që mendimi të shprehet gjuhësisht sa më i thukët dhe e bëjnë gjuhën më të larmishme, më të shkathët dhe më të fuqishme. Pikërisht, forma e brendshme e gjuhës realizohet përmes njësive konkrete që dallohen për karakterin popullor dhe lidhjet me gjuhën e folur të popullit që eufemizmat i shpërfaqin përmes zhvillimit, pasurimit dhe diferencimit të vlerave kuptimore e funksionale. Baza lëndore-konceptore e përzgjedhjes së njësive të tilla merret drejtpërsëdrejti nga elemente të jetës së përditshme, që lidhen me frikën nga kafshët grabitqare, nga sëmundjet, me besimet fetare etj. Masa, gjerësia, gjallëria, larmia dhe origjinaliteti i eufemizmave të shqipes na jep mundësi që, krahas vendit që zë zgjerimi i vëllimit kuptimor të fjalëve të gjuhës shqipe, krahas analizës së proceseve të prejardhjes dhe strukturës kuptimore të saj, të analizojmë edhe kushtet historike, socialkulturore dhe rajonale që kanë diktuar zhvillimin kaq të madh nga pikëpamja sasiore dhe cilësore të kësaj dukurie të njohur gjuhësore.

Analiza e eufemizmave është parakusht për njohjen e mendësisë së një populli, i cili në gjuhë, në akte të tilla të mirëfillta krijimi të vullnetshme, e ka shkrirë gjithë vetëdijen dhe



ndërgjegjen e tij kolektive. Tipologjia e emërimit të strukturave me vlerë eufemistike është shoqëruar edhe më një përqsasje të eufemizmeve të shqipes me anglishten.

Kapitulli përmbyllës i punimit “Rreth formës së brendshme të idiomave” merr përsipër, së pari, të bëjë një përmbledhje të trajtimeve teorike dhe përkufizimeve për formën e brendshme të idiomave në gjuhësinë shqiptare dhe atë botërore, duke qenë se studimi i njësive frazeologjike për nga motivimi i brendshëm është një fushë interesante që ka tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve. Zbërthimi i formës së brendshme të idiomave është një ndërmarrje e vështirë që kërkon detyrimisht rrokjen e të dy rrafsheve të studimit të gjuhës, atij diakronik dhe sinkronik, pasi për të gjetur burimin strukturor dhe semantik të këtyre njësive duhet njohur së pari trualli gjuhësor i formimit të tyre, pa harruar faktin se për të zbërthyer formën e brendshme të idiomave mund të shërbejë edhe “etimologjia popullore”. Teorive tradicionale dhe bashkëkohore të klasifikimit të njësive të tilla u është bashkëngjitur edhe tipizimi i këtyre strukturave, duke u bazuar në shkallën e motivimit dhe lidhjen midis kuptimit të së tërës dhe kuptimit të pjesëve të veçanta. Mënyrat dhe mjetet e motivimit të idiomave janë zgjeruar dhe përqsar me shembuj në disa gjuhë kryesisht nga anglishtja, italishtja, frëngjishtja, bullgarishtja, si dhe është bërë klasifikimi i këtyre njësive sipas fushave konceptore. Të gjithë shembujt e përqsar janë pajisur me përkthime fjalë për fjalë për të qartësuar edhe një herë se dallimet në rrafshin gjuhësor shpjegohen me ndasitë konceptore e mendësore të përceptimeve kolektive të dallueshme, të lidhura pashmangshmërisht edhe me faktorët jashtëgjuhësore, sidomos me ato etnokulturorë.

Në fund të këtij kapitulli është parë me vend që të bëhen objekt studimi kalket frazeologjike. Siç dihet, kalket frazeologjike janë përkthime fjalë për fjalë nga gjuha burimore dhe gjenden si të tilla në të gjitha gjuhët. Ato janë njësi gjuhësore që bashkojnë përvojën historike, kulturore, psikologjike etj. Forma e brendshme e kalkeve frazeologjike është këqyruar sipas ndërtimit mbi bazën e togfjalëshave të lirë dhe sipas burimit.

Në pjesën e fundit të punimit janë dhënë edhe përfundimet përkatëse për çështjet kryesore që janë shtjelluar.

### **0.3. Metodologjia e kërkimit dhe literatura shkencore**

Lënda konkrete gjuhësore e përzgjedhur dhe e studiuar është “pronë” e korpusit leksikor dhe frazeologjik burimor të shqipes dhe njësitë leksikore të skedua dhe analizuara u përkasin të gjitha mjeteve dhe mekanizmave të veçanta të përdorura gjatë procesit gjuhësor, duke filluar që nga fjalët e parme (antroponimet, patronimet, homonimet, nofkat, emërtimet terma) për të kaluar te klasa leksikore dhe semantike me strukturë më të zgjeruar fjalë dhe kuptimformuese të tipit të fjaëve të prejardhura, kompozitive dhe emërtimeve të përbëra, për t’u përmbyllur me një analizë të plotë të karakterit idiomatik të njësive frazeologjike.

Për pjesën e analizës kuptimore të elementëve gjuhësorë të gjuhës shqipe, materiali i skeduar është vjelë nga tekste burimore të folklorit dhe letërsisë artistike, ligjërimit të shkruar popullor, fjalorëve dhe doracakëve dialektorë, krahinorë, etimologjikë, sinonimikë, antonimikë, frazeologjikë, terminologjikë, si dhe disa fjalorëve shpjegues të gjuhës së sotme shqipe.

Tradita e pasur leksikografike e gjuhëve të marra në shqyrtim bëri të mundur shfrytëzimin e plotë të materialit burimor, i cili u skedua kryesisht nga fjalorët shpjegues të gjuhëve përkatëse, fjalorët dy apo trigjuhësh, sikundër dhe nga fjalorët frazeologjikë njëgjuhësh dhe dygjuhësh.

Kundrimi i dukurisë së formës së brendshme të njësive leksikore dhe përpjekja për ta rrokur strukturën kuptimore të gjuhëve të veçanta përmes motivimit të brendshëm, ka kaluar përmes metodave të analizës, krahasimit dhe sintezës, ndër të cilat do të përmendnim metodën përshkruese dhe analizën e përbërësve dhe treguesve kuptimorë. Ky punim ka karakter sistemor dhe procesi krijues ka ndjekur disa etapa, si: qëmtimi i elementëve të veçantë gjuhësorë që mbartnin vlera të dallueshme në funksion të dokumentimit dhe konkretizimit të tezës sonë, mbledhja, skedimi i këtij materiali dhe më pas përpunimi, sistemimi, ndarja dhe klasifikimi sipas treguesve të ndryshëm të realies, analiza etimologjike, përcaktimi i shkallës apo mënyrës së motivimit semantik, hartimi dhe skematizimi i fushave konceptore dhe leksikore, për t’u përmbyllur me shqyrtimet përqsëse dhe krahasuese midis gjuhëve të ndryshme, sipas tematikës së përzgjedhur për secilin kapitull.

Punimi ynë është mbështetur në një bazë të gjerë teorike nga gjuhësia botërore dhe ajo shqiptare, çka del në pah edhe nga citimet e dhëna gjatë hartimit të kapitujve përkatës, si dhe në kapitullin VIII për bibliografinë dhe referencat. Duke patur në qendër të këtyre shtjellimeve teorike veprën dhe tezat e Humboldt-it, kemi sjellë në vështrim ndihmesat teorike të drejtpërdrejta apo të tërthorta të një sërë studiuesish të njohur (gjuhëtarë, filozofë, etnologë etj.), si: Herder, Vaisgerber, Shpet, Saussure, Sapir, Worf, Marty, Lyons, Robert, Zvegincev, Potebnja, Barthes, Eco etj., si dhe trajtimet teorike dhe zbatimet praktike në gjuhësinë shqiptare nga Çabej, Thomai, Rrokaj, Jashari, Memishaj, Toska etj.

Në mënyrë të veçantë, punimi ynë është mbështetur në trajtesat teorike që ka bërë prof. Shezai Rrokaj në lëminë e filozofisë së gjuhës, si në librat e botuar (shih referencat në punim), ashtu edhe në leksionet e zhvilluara me studentët doktorantë për këtë lëndë. Në këtë rast, na duhet të përmendim disa prej koncepteve të tij teorike.

*Së pari*, zhvillimi i gjuhës ka kaluar në katër faza: gjuha pasthirrmaike, gjuha onomatopeike, gjuha simbolike dhe gjuha konvencionale. Një ndarje e tillë vlen për trajtimin e problemit të formës së brendshme përgjatë zhvillimit të mendimit gjuhësor botëror.

*Së dyti*, duke shtjelluar konceptin e formës së brendshme, ai e lidh këtë me universalet gjuhësore, të cilat krijojnë një çift antinomik. Universalet janë tipare të përbashkëta për të gjitha gjuhët, që gjenden kryesisht në sistemin fonetik dhe gramatikor të tyre. Prof. Rrokaj e ka trajtuar këtë problem duke përmendur idetë e autorëve të ndryshëm që nga Antikiteti deri në ditët tona, si: Aristoteli, Platoni, Okhama (Okama) “universalet nuk janë gjë tjetër veçse emra dhe ekzistojnë vetëm individualet”, Anselm dhe Champeaux (Shampo) “ideja universale u ka paraprirë ekzistencës së sendeve”, Roscellino (Roshelino) “universalet janë vetëm “flatus vocis” e thjesht njësi gjuhësore, të krijuara sipas parimit konvencionalist dhe, si të tilla, ato duhen menduar si “post-rem”, T. Aquini (Akuini) “Sipas tij në mendjen e Zotit universalja ka një funksion arketipik platonik dhe është *ante-rem* dhe natyrisht *in-re*, përderisa bota materiale e ka të mishëruar vetë këtë ide, duke qenë projeksioni i saj. Por universalja është edhe *post-rem*, nëse e shohim si një produkt të abstragimit të mendimit të botës materiale”, Guglielmo di Salisbury (Salsbëri) “gjuha në tërësi dhe gramatika në veçanti nuk janë gjë tjetër veçse pasqyrë e botës. Strukturat gramatikore pasqyrojnë strukturat e botës reale” etj. Sh. Rrokaj shkruan se *një analizë gjuhësore e thelluar nxjerr në pah veçoritë e përgjithshme të të folurit si një tërësi kategorish dhe rregullash të përbashkëta për gjuhët.*

*Këto tipare të përbashkëta burojnë nga universaliteti i mendimit a i vetë natyrës njerëzore. Është e vërtetë se i njëjti realitet semantik organizohet ndryshe në gjuhë të ndryshme, se kuptimet e fjalëve nga njëra gjuhë te tjetra nuk mbulojnë plotësisht njëri-tjetrin. Sidoqoftë, në tërësi kuptimi shprehet nga tërësi elementesh semantike minimale të quajtura sema, mjaft prej të cilave janë universale. Të gjitha gjuhët, sipas mbështetësve të këtij mendimi, janë ndërtuar mbi të njëjtin model. Në këtë mënyrë, ekzistojnë mekanizma të nevojshëm dhe të përbashkët për të gjitha gjuhët siç janë universalet gjuhësore, universalet kategorizuese, si kategoritë gramatikore, universale formale, si prirja për të emërtuar objekte etj.<sup>3</sup>*

Së treti, gjatë punimit janë përdorur shpesh termat “formë e brendshme” dhe “motivim semantik (kuptimor)”, ndonjëherë edhe duke i përmendur ato në vend të njëra tjetrës. Prof. Rrokaj mendon se ndërmjet tyre ka dallim, pavarësisht se janë në funksion të njëra-tjetrës. Motivimi semantik, sipas tij, është proces i brendshëm i gjuhës për nevoja jashtëgjuhësore, pra shpreh marrëdhëniet mes individit dhe gjuhës, ndërsa “forma e brendshme” shpreh marrëdhëniet midis referentit (objektit) që shenjohet dhe individit.

---

<sup>3</sup> Rrokaj Sh, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 65.

## KAPITULLI I

### VËSHTRIM HISTORIKO-TEORIK MBI FORMËN E BRENDSHME NË GJUHË

*“Çdo gjuhë është një univers holistik, i aftë për shprehur një  
përfytyrim të botës, të ndryshëm nga përfytyrimet e  
shprehura me gjuhë të tjera”*

**B. Worf**

#### 1.1. Rreth termit “formë e brendshme” dhe përkufizimet për të

Në gjuhësinë e sotme botërore janë dhënë mjaft përkufizime për termin “formë e brendshme”<sup>4</sup>, që, në të shumtën e rasteve, u referohen përcaktimeve të Humboldt-it, duke përmendur dy ndarje: “formë e brendshme e fjalës” dhe “formë e brendshme e gjuhës”<sup>5</sup>.

1.1.1. *Forma e brendshme e fjalës* zakonisht përkufizohet si ideja e tipareve thelbësore që nënkuptohen nga koncepti që qëndron në brendësi të kësaj fjale. Në mënyrë më të saktë, forma e brendshme përcaktohet si lidhja semantike dhe strukturore e morfemës leksikore ose gramatikore të një fjale me morfema të tjera të një gjuhe të caktuar, të cilat gjenden në mendjen e folësit në momentin kur analizohet struktura e asaj fjale. Kjo lidhje mund të shkaktohet objektivisht nga ruajtja e etimonit origjinal në strukturën e fjalës (rus. *snegir*, angl. *bullfinch*, shqip. *gushëkuq*). Në mjaft raste mund të jetë rezultat i së ashtuquajturës etimologji folklorike, popullore (rus. *blizorukii*, angl. *nearsighted*, shqip. *dritëshkurtër*) nga forma *blizo* (afër) dhe *zorkii* (pamje) të ndikuara nga fjala *ruka* (dorë). Forma e brendshme interpretohet ndryshe në semantikë dhe stilistikë, duke qenë se në këto disiplina termi shoqërohet me nocionin e figurshmërisë së brendshme të fjalës (kombinimet midis fjalëve), që do të thotë ndryshe: kuptimet e figurshme të fjalës (konotacionet), të cilat lindin kur kjo fjalë përdoret në kontekste të caktuara për shkak të lidhjeve të ndryshme

---

<sup>4</sup> angl. *Inner form*, frëngj. *forme intérieure*, gjerm. *Innere Form*, ital. *forma interna*; rus. *vnutrenniaia forma* etj.

<sup>5</sup> Në këtë syth të kapitullit po japim vetëm disa nga përcaktimet a përkufizimet që janë bërë për termin “formë e brendshme”, sepse më gjerë ato jepen përgjatë çështjeve që janë shtjelluar në punim.

denotative sisteme të fjalës, fillimisht si një e tërë e, më pas, sipas elementeve përbërës të saj<sup>6</sup>.

**1.1.2. Forma e brendshme e gjuhës.** W. Humboldt-i dallonte në gjuhë formën e jashtme (shprehja që gjuha gjen për të dhënë mendimin) dhe formën e brendshme që pasqyron tiparet e veçanta të *Weltanschauung* të folësve të një gjuhe të dhënë, e cila përforcohet nga struktura (forma) e jashtme e gjuhës. Të marra së bashku, forma e brendshme dhe ajo e jashtme përbëjnë formën e gjuhës, të cilën Humboldt-i e përballte me përmbajtjen (thelbin) e gjuhës<sup>7</sup>.

**1.1.3.** Edhe A. S. Ahmanova<sup>8</sup>, nën artikullin e fjalorit *vnutrennij* ( i brendshëm), veç të tjerash, jep edhe përkufizimin për termat *formë e brendshme e fjalës* (vlerë simbolike, strukturë kuptimore), duke e quajtur struktura semantike e fjalës, pra ajo cilësi morfonologjike, e cila simbolizon lidhjen ndërmjet një tingëllimi (kompleksi tingullor) dhe një kuptimi të dhënë, ose me konotacione stilistike të caktuara. Ndërsa konceptin për formën e brendshme të gjuhës (rus. *vnutrenniaia jaziikovaja forma*; angl. *inner form of a language*; frëngj. *forme intérieure d'une langue*; gjerm. *Innere Sprachform*; spanj. *forma interior del lenguaje*) e jep si organizim të brendshëm origjinal të gjuhës, që përmban specifikën e lidhjes së një përmbajtjeje të caktuar me një shprehje të caktuar<sup>9</sup>.

**1.1.4.** P. H. Mathews termin *inner form* (formë e brendshme), e lidh me tezën e Humboldt-it “e cila haset më rrallë në veprat e tij. Forma e brendshme interpretohet si parimi ose parimet bazë të krijimit të gramatikës dhe të leksikut vetjak të gjuhëve të veçanta. Kjo teori ndikoi mjaft edhe te gjuhëtarët e shekullit XX, të quajtur neohumboldtianë, veçanërisht në veprën e Leo Weisgerber-it”<sup>10</sup>.

**1.1.5.** G. L. Baccaria në fjalorin e tij, nën artikullin *forma interna* (formë e brendshme), shkruan se ky term është përkthyer nga gjermanishtja *innere Sprachform*. Sipas filozofit gjerman Humboldt, forma e brendshme nënkupton karakteristikat e thelluara, të nënkuptuara, të cilat i japin mundësi çdo gjuhe të ketë një strukturë të veçantë dhe të

---

<sup>6</sup> *The Great Soviet Encyclopedia*, 3<sup>rd</sup> Edition (1970-1979).

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Ahmanova A. S., *Silovar lingvističeskih terminov*, Moskva, 1969, f. 81.

<sup>9</sup> Po aty, f. 500.

<sup>10</sup> Mathews P. H., *Concise Oxford Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 1997, f. 165, 180.

pakrahasueshme me gjuhët e tjera. Forma e brendshme është ajo veçori semantike, e cila nuk mund të përkthehet dhe që e bën të pamundur krahasimin midis sistemeve të ndryshme gjuhësore. Forma e brendshme qëndron në themel të tezës së relativitetit gjuhësor<sup>11</sup>.

**1.1.6.** Në Fjalorin e termave të gjuhësisë<sup>12</sup>, jepet termi në rusisht: *vnutrenniaia forma* “formë e brendshme”; në anglisht: *inner form* “trajtë e brendshme”, në frëngjisht: *forme intérieure* “trajtë e brendshme, formë e brendshme”; gjermanisht: *innere Form* “trajtë e brendshme” dhe italisht: *forma interna* “trajtë e brendshme”. Kurse në Fjalorin krahasues të termave të gjuhësisë<sup>13</sup>, nën artikullin e fjalorit *formë* ose *trajtë*, jepen përgjegjëset e termit në tri gjuhë: *forma interna* (it.), *forme intérieure* (frëngj.), *inner form* (angl.).

**1.1.7.** G.V. Ramishvili shkruan se teoria bazë për formën e brendshme duhet të përmbushë tri kushte: 1. forma e brendshme duket të jetë saktësisht e tillë, çka do të thotë se zbërthimi i saj duhet të bëhet në përputhje me parametrat e përmbajtjes dhe jo sipas parimeve që vijnë si rezultat i studimit të formës së jashtme; 2. megjithëse quhet e brendshme ajo nuk mund dhe nuk duhet të ndahet nga struktura pra, në thelb, ngelet formë; 3. është forma e brendshme e gjuhës dhe jo e përmbajtjes jashtëgjuhësore<sup>14</sup>.

## **1. 2. Qasje ndaj formës së brendshme të gjuhës deri në shekullin XIX**

Para Humboldt-it, në historinë e mendimit gjuhësor, ka patur shkolla dhe teori që e trajtuan “formën e brendshme” të gjuhës (në kuptimin e gjerë të termit) në teza e pozicione të ndryshme teorike, çka do të shtjellohet më tej në këtë kapitull. Pavarësisht nga termat që u përdorën dhe qëndrimet teorike, shkollat filozofiko-gjuhësore dhe autorët e tyre mund të ndahen në dy grupime të mëdha, që dalloheshin prerazi në pikëpamjet e tyre për një çështje thelbësore të filozofisë së gjuhës: *cila është lidhja që ekziston midis emrit dhe sendit të emërtuar prej tij, pra, a ka lidhje të brendshme a shkakësore ndërmjet natyrës (thelbit) të sendit dhe emrit që e shënon atë?* Sipas grupit të parë, çdo gjë është e emërtuar sipas natyrës

---

<sup>11</sup> Baccaria G. L., *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Einaudi, Torino, 2004, f. 336.

<sup>12</sup> *Fjalor i termave të gjuhësisë (shqip, rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1975, f. 282, 385, 450, 508, 562.

<sup>13</sup> Belluscio G & Rrokaj Sh., *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)*, Arbëria, Tiranë, 2011, f. 108.

<sup>14</sup> Po aty.

(perëndisë) dhe, sipas grupit të dytë, çdo gjë emërtohet sipas konventës (marrëveshjes). Ndërkaq, në historinë e gjuhësisë botërore dhe filozofisë së gjuhës ka edhe qëndrime të ndërmjetme. Prof. Shezai Rrokaj, duke shkruar për raportin e gjuhës me përvojën e bashkësisë folëse, si dhe përfaqësimi i kësaj përvoje në gjuhë, thekson se ky problem u shtrua për të zbuluar lidhjen midis shenjës dhe objektit që emërton, çka solli dallimin midis *natyralistëve* (sipas të cilëve midis sendit dhe emërimit të tij ka një lidhje natyrore) dhe *konvencionalistëve*, që mendonin se kjo lidhje është arbitrare.<sup>15</sup>

### **1.2.1. Teoria e korigjimit ose e përmirësimit të emrave**

Në filozofinë e lashtë kineze lindi *teoria e korigjimit ose teoria e përmirësimit të emrave*. Sipas kësaj teorie, përmbajtja e objektit duhet të jetë në përputhshmëri dialektike me përmbajtjen e mendimit; emri me të vërtetë duhet t'i përgjigjet thelbit të emrave, pra thelbi real është thelbi nominal, sepse vetëm në atë mënyrë mund të ndahet e vërteta nga jo e vërteta, e drejta nga jo e drejta, e dobishmja nga jo e dobishmja. “Çdo gjë duhet të quhet me emrin e saj të vërtetë. - thoshte Konfuci. - Nëse qeveritari, ministri, prindi, djali mendojnë dhe veprojnë sipas thelbit të detyrës së tyre, atëherë ata do të jenë të njëmendtë në realitet, sipas realitetit dhe emrit do të paraqesin thelbin e gjërave të tyre të vërteta”<sup>16</sup>. Kung Su Lung, një filozof tjetër kinez, thoshte se nocionet janë abstrakte, ideale, absolute. Emërtimi i gjërave bëhet në mënyrë ideale, sepse ato janë të përjetshme dhe absolute. Këto shprehen më së miri në punimin e tij që njihet me titullin “*Traktat mbi kalin e bardhë*”. Kundër teorisë së emërimit të Kung Su Lungut ishte Huj Siu, i cili shprehet se gjërat ekzistuese janë relative, prandaj edhe janë të ndryshueshme. Përfaqësuesit e shkollës së emërimit bënë dallimin ndërmjet “asaj që fillon brenda formës dhe vetisë” dhe “asaj që qëndron jashtë formës dhe vetisë”. Në fillim të shekullit II të erës sonë doli libri “*Chi min*” (Sqarimi i emrave), që merret me studimin dhe analizën etimologjike të disa fjalëve, të cilat vështrohen të lidhura me përbërjen tingullore dhe kuptimin e tyre.

---

<sup>15</sup> Rrokaj Sh., *Filozofia e gjuhës*, Arbëria, Tiranë, 2010, f. 33-34

<sup>16</sup> Presheva A., *Filozofia e gjuhës*, Prishtinë, 1998, f. 21



### **1.2.2. Kuptimi si raport ndërmjet fjalëve dhe sendeve**

Dijetarët indianë u morën dhe me probleme të filozofisë së gjuhës. Sikurse dhe në tradita të tjera gjuhësore (greke, romake etj.), edhe në mendimin filozofiko-gjuhësor indian midis studiuesve në qendër të polemikave ishte ajo mbi karakterin “natyror” dhe “konvencional” të gjuhës<sup>17</sup>.

Të gjitha drejtimit e filozofisë indiane (induse), si *mimansa*, *vedantra*, *nyaya*, *vaisesika*, *samkhya*, *yoga*, kanë në thelb problemin e kuptimit si raport ndërmjet fjalëve dhe objekteve, pra, të studiosh problemin e kuptimit do të thotë të shqyrtosh njëmendësinë ekzistenciale, sepse problemet e kuptimit janë probleme të ekzistencës<sup>18</sup>. Kjo teori lidhet me botëkuptimin se kush e ka krijuar botën, kush i ka emërtuar gjërat, sendet, pra Perëndia i gjithëfuqishëm apo njerëzit në marrëveshje me njëri-tjetrin. Filozofi *Jaimin* (themelues i drejtimit *mimansa*) thoshte se njeriu i parë në tokë nuk e krijoi gjuhën, por ka ndjekur gjurmët e gjuhës, e cila është vepër e Perëndisë. Pra, Perëndia ka emërtuar çdo gjë, çdo send, çdo fjalë me kuptimin dhe emrin e vet. Nga ana tjetër, filozofi *Jaska* (shek. V-IV p.e.s) pohonte se ajo që qëndron ndërmjet emrit dhe objektit, ajo që është e përgjithshme, është kuptimi i tyre, çka u ngulit thellë në mendimin filozofik-gjuhësor indian: çdo gjë e merr emrin e vet sipas marrëveshjes që bëhet midis njerëzve të parë që kanë ardhur në tokë<sup>19</sup>.

Robins vë në dukje se në gjirin e dijetarëve indianë diskutohej nëse kuptimet mund të kundroheshin si një tipar i natyrshëm i fjalëve, apo nëse onomatopeja mund të merrej si model për të përshkruar marrëdhëniet ndërmjet fjalës dhe sendit. “Ashtu si në kundërshtinë perëndimore natyrë-marrëveshje, shkruan Robins, edhe këtu shpejt u bë i qartë funksioni i kufizuar që ky faktor kishte në gjuhë dhe që marrëdhënia konvencionale dhe arbitrare ndërmjet një forme dhe kuptimit të saj ishte më e natyrshme për gjuhën”<sup>20</sup>

### **1.2.3. Debati “natyrë”-“konvencion”**

Në Greqinë e lashtë problemi themelor i filozofisë ishte lidhja e sendit me emërtimin e tij, pra *a ka lidhje emri me natyrën e sendeve apo jo*. Filozofët grekë nuk ishin në një

---

<sup>17</sup> Lyons J., *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 35

<sup>18</sup> Presheva A., *vep. cit*, f. 52.

<sup>19</sup> Presheva A., *po aty*, f. 55.

<sup>20</sup> Robins R., *Historia e gjuhësisë*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 232.

mendje nëse gjuha rridhte nga “natyra” apo nga “konvencioni”. Kjo kundërshti midis natyrës dhe konvencionit është ndeshur shumë shpesh në mendimin filozofik të grekëve. Kur një realie emërtohej si “e natyrshme”, atëherë mendohej se ajo buronte nga parime të përjetshme, të pandryshueshme dhe jashtënjerezore, prandaj dhe ishte i paprekshëm; nëse, përkundrazi, emërtohej si konvencionale, atëherë ai ishte vetëm rezultat i zakonit dhe i traditës, domethënë, buronte nga një marrëveshje e pashprehur, nga një “kontratë shoqërore”, që vendosej ndërmjet anëtarëve të një shoqërie; pra, nga një “kontratë”, e cila, meqë ishte lidhur nga njerëzit, po nga njerëzit mund të zgjidhej<sup>21</sup>. Në debatin *natyrë/ konvencion* çështja themelore ishte: *a ka ndonjë lidhje të domosdoshme midis formës dhe përmbajtjes së fjalës*. Përkrahësit e shkollës natyraliste mëtonin se të gjitha fjalët dhe sendet që ato emërtojnë, përputhen “natyrshëm” midis tyre. Sipas tyre, të zbulosh burimin e një fjale dhe bashkë me të kuptimin “e vërtetë” të saj, do të thotë të gjurmosh një nga të vërtetat e natyrës. Kështu janë dalluar mundësi të ndryshme të përkatësisë “natyrore” të formës së një fjale dhe përmbajtjes së saj. Së pari, ka pasur një grup relativisht të vogël fjalësh, si: *cicëron; mjaullin* etj., të cilat në një mënyrë ose në një tjetër, “imitojnë” tingujt që lidhen me to. Një kategori e ngjashme fjalësh (p.sh. *kuku, uhu* etj.), që imitojnë cilësi të caktuara tingullore, tregonin burimin e tingullit, por jo vetë tingullin. Në të vërtetë, në të dy rastet ka një lidhje “të natyrshme” dhe bindëse ndërmjet kompleksit tingullor të fjalës dhe asaj që emërton. Termi që ende sot përdoret me këtë kuptim, ishte fjala greke “onomatope” (krijim emrash). Sipas stoikëve, këto fjalë janë rrënjët e emrave, nga të cilët u zhvillua pastaj gjuha. Por, siç dihet, në gjuhë ka pak fjalë onomatopeike. Gjithashtu, “prejardhja natyrore” shpjegohej duke marrë parasysh një ose më shumë prej tingujve përbërës të fjalës përkatëse dhe besohej se tingujt të caktuar të kujtonin cilësi të caktuara fizike ose veprimtari etj. Sipas kësaj pikëpamjeje del se *L* ishte një tingull *i lëngët*, p.sh., fjala latine *liquid* (rrjedhshëm), përmban kështu një tingull të lëngët, i cili i përshtatet natyrshëm kuptimit të saj<sup>22</sup>. Ishin filozofët, si: Hrisipi, Herakliti, Diogjeni etj., që thoshin se midis emrit dhe sendit ka një lidhje të domosdoshme: *emri i vihet sendit sipas natyrës së këtij të fundit*. Epikuri mendon se format e fjalëve kanë lindur në mënyrë të natyrshme, por më pas janë ndryshuar me marrëveshje<sup>23</sup>. Është e njohur letra e Epikutit për Herodotin, ku thuhet se edhe emrat e sendeve në krye të erës nuk u krijuan me marrëveshje,

---

<sup>21</sup> Lyons J., *Hyrje...*, vep. cit, f. 22

<sup>22</sup> Po aty, f. 23

<sup>23</sup> Robins R., vep. cit, f. 42.

por nga vetë natyra e njerëzve, të cilët, sipas racave, duke provuar ndjesi të ndryshme dhe duke patur perceptime të ndryshme, në po aq mënyra të ndryshme e nxirrnin frymën të formësuar sipas gjendjes shpirtërore dhe perceptimit të veçantë<sup>24</sup>.

Për Herodotin çdo emër shpreh thelbin e sendit. Kjo u quajt teoria *fysei* (nga natyra). Hrisipi thoshte se për çdo send natyra cakton emër të veçantë, ashtu si për çdo objekt të perceptuar është caktuar një perceptim i veçantë. Herakliti pohonte identitetin e arsyes njerëzore me tërësinë e strukturës gjuhësore. Platoni theksonte se fjala është forma materiale e idesë. Të tjerë filozofë e kundërshtonin këtë, duke u shprehur se emrat e sendeve vendosen nga njerëzit sipas disa rregullave të caktuara. Kjo u quajt teoria *nomo* (emër). Për disa filozofë emrat e sendeve vendosen sipas një marrëveshjeje konvencionale (kjo u quajt teoria *syntheke*), kurse për disa të tjerë emrat e sendeve vihen sipas zakonit (teoria *ethei*) dhe grupin e katërt e përbënin filozofët që thoshin se emrat u vihen sendeve sipas vendimit të njerëzve (teoria *thesei*). Të katër këto teori të ndryshme i bashkon një koncept themelor: *lindjen e gjuhës e kërkojnë nga shoqëria, pra njohin shoqërinë si krijuese të gjuhës*.

#### **1.2.4. Teoria e lektonit**

Sh. Rrokaj shkruan për një ndihmesë origjinale të stoikëve me atë që quhet teori e “lektonit”: *sipas këtij koncepti, fjalët janë terma, të cilët nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me sendet, por me “kuptimin” që u jepet sendeve. Lektoni (kuptimi a i shenjuari) është një njësi e ndërmjetme që vihet midis “shprehjes (shenjuesit) dhe “sendit”<sup>25</sup>*. Pikëpamjet e stoikëve për gjuhën mund të përmbliidhen në tri teza: në fillim lind përshtypja; pastaj mendja, me anë të gjuhës, shpreh me fjalë atë që ndien për përshtypjen; çdo gjë kuptohet përmes studimit të fjalëve. Një nga çështjet kryesore që trajtuan stoikët ishte dallimi midis formës dhe kuptimit, midis asaj që “shenjon” dhe asaj që “shenjohet”. Ata këmbëngulnin fort në idenë se gjuha është pasqyrim i drejtpërdrejtë i natyrës, pra, gjuha lind në mënyrë të natyrshme duke u mbështetur mbi onomatopenë dhe simbolizmin e tingujve por, nga ana tjetër, ngaqë shumica e tyre ishin “anomalistë”, e kundërshtonin përputhjen e fjalëve me sendet<sup>26</sup>.

---

<sup>24</sup> Eco U., *Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën europiane*, Dituria, Tiranë, 2008, f. 94.

<sup>25</sup> Rrokaj Sh., *Filozofia...* vep. cit., f. 32-33.

<sup>26</sup> Lyons J., vep. cit., f. 28.

### 1.2.5. Kratili, Hermogjeni dhe Sokrati

Në këtë debat filozofik Platoni zuri një pozitë të ndërmjetme, duke mos pranuar as teorinë *fyesi*, as teorinë *nomo*. Këtij problemi ai i kushtoi dialogun “*Kratilos*”. Ky dialog është një debat mbi prejardhjen e gjuhës dhe marrëdhëniet ndërmjet fjalëve dhe kuptimeve të tyre, pra këto lidhje kanë një afri të natyrshme apo janë fryt i marrëveshjes ndërmjet njerëzve?<sup>27</sup>. Në dialogun midis Kratilit, Sokratit dhe Hermogjenit shtjellohen me hollësi argumentet e të dyja teorive dhe jepet një zgjidhje e shtëmëngët (asnjanëse): as njëra dhe as tjetra pikëpamje nuk ka të drejtë. Dialogu i Platonit është interesant se bëhen përpjekje për klasifikimin e fjalëve në bazë të logjikës. Duke kundërshtuar dy teoritë, për Platonin kishte rëndësi fakti se gjuha ka një qëllim, aty gjejmë një synim të brendshëm. Midis tingujve, sipas tij, ka ekzistuar një lidhje e brendshme, natyrore. Ai thotë se fjalët e para u krijuan në bazë të një lidhjeje të brendshme midis tingullit dhe nocionit dhe, më vonë, në bazë të këtyre, njerëzit krijuan fjalë të reja, që nuk kishin lidhje me natyrën e sendit, por, prapëseprapë, fjala mbetet e lidhur me sendin, sepse këtë lidhje e vendos tradita gjuhësore, shoqëria (p.sh. *fjalët onomatopeike*). Përmes fjalëve të Hermogjenit gjatë dialogut, Platoni shpërfaq pikëpamjen se emërtimi i gjërave nuk rrjedh nga natyra, nga thelbi i gjërave, por nga marrëveshja mes njerëzve. “*Mua më duket se emri i vërtetë i disa gjërave është ai të cilin dikush emërton, por nëse atë përsëri e ndërron dhe i pari përdoret më pak, emërtimi i dytë nuk është më pak i përshatshëm se i pari*”, shprehet Hermogjeni [përkthimi ynë. A. C]. Ndërsa Kratili thotë: “*Çdo emër, çdo gjë që ekziston e shpreh natyrën e emrit dhe të gjërave, sepse fjalët paraqesin natyrën përkatëse të tërë asaj që është emërtuar. Kjo do të thotë se emërtimi, fjalët nuk paraqesin kurrfarë marrëveshje ndërmjet individëve, të cilët e emërtojnë ndonjë gjë me ndonjë emër. Përkatësia e fjalës sipas natyrës është veti e tërë asaj që ekziston dhe se fjala nuk është ajo mbi të cilën disa njerëz bëjnë marrëveshje se si të emërtojnë ndonjë gjë*” [përkthimi ynë A. C]. Sokrati shpreh pikëpamjen e vetë autorit, duke u pajtuar herë me mendimet e Hermogjenit, dhe herë me mendimet e Kratilit. Pikëpamjet e Platonit përputhen me ato të sofistëve. Lindjen e fjalëve të reja dhe mënyrën se si lidhet fjala me objektin të cilin

---

<sup>27</sup> Robins R., vep. cit., f. 41.

ajo cilëson, Sokrati e krahason me procesin krijues të një artisti. Ashtu si piktori përdor ngjyrat për të shprehur thelbin e përmbajtjes së veprës së tij, ashtu dhe krijuesi i fjalëve përdor shkronjat që përmbajnë tinguj të caktuar për të shprehur përmbajtjen e një fjale. Ka shkronja të veçanta që shprehin sende apo materiale të buta, të tjera përdoren për lëngjet e kështu me radhë. Sokrati shprehet se “*mënyra më e mirë për t’u shprehur është të përdorësh fjalë (emra), të cilët ngjasojnë me objektet që emërtojnë, ndërsa mënyra më e gabuar është të përdorësh fjalët që shprehin të kundërtën*”.

Në kundërshim me tezën e Sokratit, Hermogjeni mendon se emërtimi i sendeve është bërë mbi bazën e traditës dhe konvencionit. Ato nuk shprehin thelbin e referentit të tyre, por mund të ndryshojnë sipas vullnetit të individit apo bashkësisë që i përdor ato. Dallimi midis këtyre qëndrimeve është i paqartë. Në gjysmën e dialogut, Sokrati hamendëson në lidhje me hipotezën e hedhur nga Hermogjeni për prejardhjen e fjalëve. Në grupin e këtyre emrave përfshihen “Perënditë e Olimpit”, hyjnitë e personifikuara dhe emrat e lidhur me shumë koncepte abstrakte. Ai thotë se emërtimi i lumenjve si *Kroni* dhe *Rea* është krejtësisht rastësor. Shumë nga fjalët që Sokrati i ka përdorur si shembuj, janë krijuar mbi bazën e një ideje të lidhur natyrshëm me sendin, por kanë ndryshuar në rrjedhën e kohës. Për fjalët, të cilave nuk mund t’u gjendet një lidhje e tillë, shpjegimi i vetëm është se ose janë fjalë të huazuara ose janë ndryshuar, sa e kanë humbur ngjashmërinë me fjalën origjinale. Emrat kanë ndryshuar kaq shumë dhe në kaq shumë mënyra sa, nëse e krahasojmë gjuhën e sotme me atë të përdorur kohë më parë, ka shumë mundësi të na duket si gjuhë barbare (e huaj). Kratili, një ndjekës shpirtëror i Heraklitit, ka hedhur tezën e fundit në lidhje me marrëdhënien midis fjalës dhe objektit. Sipas tij, emrat kanë origjinë hyjnore. Sokrati e qorton këtë teori duke i kujtuar Kratilit se disa emra nuk lidhen aspak me idenë dhe sendin që ata emërtojnë. Në këtë këndvështrim, Sokrati përfundimisht e mohon mundësinë e studimit të gjuhës, duke menduar se nga pikëpamja filozofike nuk mund të krahasohet me nivelin e studimit dhe analizës së vetë sendit. Sipas teorisë së Platonit për formën, nuk ka rëndësi se prej çfarë materiali përbëhet një *çekiç*, ai gjithsesi do të quhet kështu dhe është pikërisht fjala *çekiç* forma e këtij objekti. Sokrati: “*A nuk duhet që një njeri që përcakton (vendos) rregullat të përfshijë brenda fjalës tinguj apo rrokje të cilat të përshtaten natyrisht me secilin prej sendeve (objekteve)? Dhe nëse atij do t’i lihej si detyrë të përcaktonte emrat a nuk duhet që, së pari, të kuptojë se çfarë është një emër në vetvete? Dhe, nëse krijues të ndryshëm emrash*

*nuk përdorin rrokje të ndryshme për të krijuar fjalë, atëhere nuk duhet të harrojmë se farkëtarë të ndryshëm, që prodhojnë të njëjtën vegël për të njëjtin lloj pune, nuk përdorin hekur të njëjtë. Por, për sa kohë ata i japin veglës të njëjtën formë, atëhere nuk ka rëndësi nëse është prodhuar në Greqi apo gjetkë. Apo jo?”*

Është me shumë interes të përmendet këtu komenti i Umberto Eco-s (Eko) se “megjithatë, kultura e lashtë greke, me *Kratilin e Platonin*, i bëri vetes një pyetje gjuhësore, të cilën e has lexuesi i rrëfimit biblik<sup>28</sup>: a kishte zgjedhur Emërdhënësi fjalë që i emërtojnë sendet sipas natyrës së tyre (*physis*), dhe kjo ishte teza e *Kratilit*, apo i kishte emërtuar sendet sipas një ligji apo marrëveshjeje njerëzore (*nomos*) dhe kjo është teza e *Hermogjenit*”<sup>29</sup>. Eco-ja ka arritur me të drejtë në përfundimin se edhe në kulturat që e kanë shpërfillur *Kratilin*, çdo rrahje mendimesh mbi natyrën e një gjuhe të përkryer ka ndjekur njërën prej tri udhëve të përvijuara nga teksti platonik<sup>30</sup>.

### **1.2.6. De natura rerum**

Për problemet e origjinës së gjuhës ndihmesë më të madhe dha Lukreci në veprën “*Mbi natyrën e sendeve*” (*De natyra rerum*). Ai u bashkua me përkrahësit e teorisë *nomo* lidhur me çështjen e origjinës së gjuhës. Sipas tij, po të mendojmë se dikush i pajisi sendet me emra dhe njerëzit për herë të parë i mësuan fjalët nga dikush, kjo është marrëzi, sepse të gjithë njerëzit, së bashku, mund ta bëjnë këtë punë vetë. Për Lukrecin, nevoja shprehu emrat e njerëzve. Në fillim gjuha lindi nga tingujt që shprehin ndjenjat e njeriut dhe më vonë u kalua nga ndjenja te mendimi. Po citojmë disa copëza nga vepra e Lukrecit: *Përsa u takon, pastaj, tingujve t’ndryshëm.../ të gjuhës, vetë natyra i shtyu njerëzit/ t’i nxirrnin goje, pra që vetë nevoja/ që nxori emrat për t’shënuar objektet, / gati njësoj ashtu si u ndodh fëmijëve, / të cilët, meqë s’shprehen dot me gojë, /tregojnë më gisht objektet që kanë pranë.../Pra, të mendosh se vetëm një njeri/ u vuri emrin sendeve të ndryshme/ e se të tjerët nxunë fjalët e para/ nga goja e tij, do t’ishite marrëzi./ Kur vetëm ky me zë paska shënuar/ dhe paska*

---

<sup>28</sup> Shumëkush, që e ka lexuar Dhjatën e Vjetër (Zanafilla), e di se në kreun 2 (19-20) thuhet “*Dhe Zoti Perëndi formoi nga dheu tërë kafshët e fushës dhe tërë zogjtë e qiellit dhe i çoi te njeriu për të parë si do t’i quante; dhe sido që njeriu t’i quante qeniet e gjalla, ai do të ishte emri i tyre. Dhe njeri u vuri emra tërë bagëtisë, zogjve të qiellit dhe çdo kafshe të fushave*” (Bibla, 1995).

<sup>29</sup> Eco, U., vep. cit, f. 25.

<sup>30</sup> Po aty, f. 25.

*nxjerrë prej goje tinguj të ndryshëm, / po pse të nënkuptohet se të tjerët/ nuk paskan qenë në gjendje po n'atë kohë/ të bënin të njëjtën gjë? Përveç kësaj, / nëse të tjerët njerëz ndër ato kohë/ nuk i përdorën fjalët midis tyre, / si vallë e kuptoi ky njeri/ dobin'e gjuhës, si, pra, qe në gjendje/ të dinte dhe të ndiente ç'desh të bënte? / Pastaj një i vetëm nuk mund të nënshtronte,/ as mund të detyronte një shumicë/ t'mësonte mu prej tij me ëndje t'plotë/ emrin e sendeve, e n'asnjë mënyrë/ s'është kollaj t'mësosh edhe të bindësh/ të shurdhët se qysh duhet të veprojnë;/ pa le pastaj që kurrë s'do t'ishin bindur, / durim s'do kishin pasur kurrsesi/ t'ua çante dikush veshët me ca fjalë/ që tingëllonin bosh, pa farë kuptimi./ Po, fundi, pse t'na vijë çudi e madhe/ që njerëzit, me gjuh'e zë pajisur, / t'u venë sendeve emra të ndryshëm/ sipas përshtypjes s'tyre, krejt të ndryshme? / Ti ke bagëtinë e ke bishat e egra, / që s'flasin dot, mirëpo, kur i kap frika, / kur ndiejnë dhembje ose kënaqësi,/ gërthasin dhe të nxjerrin gjithfarë zërash.../ Prandaj, derisa ka sensacione t'ndryshme,/ që i bëjnë frymorët, ndonëse të pagojë, / të nxjerrin gjithfarë zërash, aq më tepër/ është e natyrshme që ndër kohë të para, /dhe njerëzit t'kenë arritur të shënonin/ me gjithfarë zërash sende të çdo lloji<sup>31</sup>. Elementet thelbësore të teorisë së tij Lukreci i mori nga Epikuri, i cili, megjithëse ishte për teorinë fysei, pranonte zhvillimin e gjuhës në bazë të marrëveshjes: “Popuj të ndryshëm kishin gjetur një marrëveshje për t'u dhënë nga një emër gjërave dhe për të mënjeluar dykuptimësinë”. Nga ana tjetër, Lukreci rimori idenë e Epikurit se edhe emrat e sendeve në krye të erës nuk u krijuan me marrëveshje, por nga vetë natyra e njerëzve, të cilët, sipas racave, duke provuar ndjesi të ndryshme dhe duke patur perceptime të ndryshme, në po aq mënyra të ndryshme e nxirrnin frymën të formësuar sipas gjendjes shpirtërore dhe perceptimit të veçantë<sup>32</sup>, duke u shprehur se është natyra ajo që i ka shtyrë njerëzit të prodhojnë tingujt e gjuhës dhe nevoja ka bërë që lindin emrat e sendeve.<sup>33</sup>*

### **1.2.7. Fjalët parake varroniane**

Mark Terenc Varro është dijetari më i njohur i Romës së vjetër në fushën e gjuhësisë dhe ka lënë një trashëgim të madh. Vepra e tij “Gjuha latine”(De lingua latine) me 25 vëllime (nga të cilat kanë mbetur vetëm 6) ishte ndihmesa kryesore. Varroni ndihmoi edhe

<sup>31</sup> Lukreci., *Mbi natyrën e sendeve*, Tiranë, 1961, f. 98-101.

<sup>32</sup> Eco, U., vep. cit, f. 94.

<sup>33</sup> Po aty, f. 95.

për gjuhën letrare, duke dhënë rregullat themelore: -të mbështetemi në natyrën e gjuhës; të mbështetemi në analogjitë (në rregullsitë); në përdorimin e përgjithshëm të fjalës; në autoritetin e atyre që shkruajnë. Ai thotë, gjithashtu, se për origjinën e fjalëve të para duhet të njohim historinë. Ideja kryesore e Varronit është se fillimisht lidhja midis sendeve dhe fjalëve ka qenë natyrore, pastaj kjo lidhje është deformuar në atë masë sa lidhjet midis tyre duket se janë arbitrare<sup>34</sup>. Sipas Varronit, gjuha zhvillohet mbi bazën e një numri fjalësh parake (ai besonte se janë katër emra që u vihen sendeve për t'i emërtuar), e më pas krijon një numër të madh fjalësh përmes ndryshimeve të njëpasnjëshme të shkronjave ose formës fonetike, duke ndjekur hap pas hapi përparimin e qytetërimit dhe pasurimit të jetës njerëzore<sup>35</sup>.

### **1.2.8. Realistë dhe nominalistë**

Në periudhën e Mesjetës u bënë përpjekje për të trajtuar disa probleme filozofike të gjuhës, si origjina e gjuhës, marrëdhëniet midis sendit dhe fjalës etj. Origjina e gjuhës u zgjidh shumë thjesht: gjuha e njeriut të parë ka qenë hebraishtja, meqë Bibla ishte në gjuhën ebraike. Sipas tyre, gjuhën e krijoi një fuqi e mbinatyrshme ose zoti krijoi njeriun dhe njeriu krijoi gjuhën. Diskutimi për lidhjen e fjalës me sendin u bë nga dy grupe, që u quajtën *realistë* dhe *nominalistë*. Realizmi në Mesjetë ishte rryma themelore filozofike. Bazë e saj ishin konceptet se ideja ekzistonte para materies, prandaj, sipas tyre, nocionet e përgjithshme, që emërtohen nga fjalët e ndryshme, janë të vetmit që ekzistojnë realisht dhe objektivisht. “*Nocionet universale janë reale*”, këmbëngulnin realistët. Këto nocione ekzistojnë para sendeve. Përfaqësuesi kryesor i realizmit ishte Shën Anselmi. Me realizmin u bashkua edhe filozofi Thomas Aquin-i (Thoma Akuinasi), që ishte më i moderuar dhe më i matur. Sipas tij, nocionet e përgjithshme ekzistojnë përpara sendeve, edhe në vetë sendet, edhe pas sendeve. Realistët e kulluar nuk e pranonin këtë. Kundër realizmit u ngritën *nominalistët*, të cilët bënë një polemikë të ashpër në shekujt XI-XIV. Kjo ishte polemikë me karakter filozofik dhe idologjik. Ata e morën emrin nga fjala latine *nomo* (emër). Sipas tyre sendet ekzistojnë përpara nocioneve të përgjithshme dhe nocionet e përgjithshme të krijuara nga mendimi ynë për sendet nuk ekzistojnë pavarësisht nga sendet. Nocionet (idetë) e përgjithshme janë vetëm

---

<sup>34</sup> Rrokaj Sh., *Filozofia...*, vep. cit, f. 34-35.

<sup>35</sup> Robins R., vep. cit., f. 87.



fjalë, të cilave nuk i përgjigjet asnjë realitet në mendje. Nominalizmi mori një zhvillim shumë të madh me Johan Rosselin, i cili pati guxim ta zbatojë atë edhe në teologji. Nominalistët pranojnë karakterin parësor të sendit dhe karakterin sekondar të nocionit të përgjithshëm, por ata shkëpusnin sendin konkret nga emri i tij. Ata thoshin se nocionet e përgjithshme nuk ekzistojnë realisht dhe nuk pasqyrojnë vetitë reale të sendeve të veçanta. Nominalizmi u çua më tej nga dietari anglez Gijon Okkama që krijoi teorinë e termave, si shenja të sendeve. Sipas tij, termi është vetëm shenjë e sendit. Termi përbëhet nga shenja dhe përmbajtja (ana tingullore dhe përmbajtja e nocionit). Ai thotë se ka *terma primarë* dhe *sekondarë*. Termat primarë përbëhen nga shenja dhe përmbajtja e saj, ndërsa termat sekondare janë shenja e shenjës, p.sh., nocioni *kafshë*-sekondar, kurse *pulë, lopë, dele* etj. - primare. Me nominalistët u bashkuan *konceptualistët*, sipas të cilëve nocionet e përgjithshme nuk ekzistojnë realisht, por pranonin se në mendjen e njerëzve ekzistojnë konceptet e përgjithshme të shprehura në emra, si një formë e veçantë e njohjes së realitetit. Themelues i konceptualizmit ishte Pjer Abelar. Sipas tij, konceptet e përgjithshme janë thelbi i sendeve, domethënë, emërtimi është koncept i përgjithshëm për sendet. E përgjithshmja lind pas sendeve si koncept i saj (*conceptus*). Megjithatë, kuptimi nuk pasqyron sendin, por vetëm shenjën e tij. Në njëfarë mënyre, realizmi mund të quhet vazhdues i teorisë *fyesi*, kurse nominalizmi si vazhdues i teorisë *nomo*.

### **1.2.9. Traktati “De vulgari eloquentia” i Dante Alighierit**

Dante Alighierin disa studiues e kanë quajtur si profetin e Rilindjes.<sup>36</sup> Në kuadrin e punimit tonë, po marrin në vështrim tezat e tij nga traktati “De vulgari eloquentia” (Mbi gjuhën popullore)<sup>37</sup>. Ai thoshte se gjuha ka karakter të dyfishtë: nga njëra anë është materiale, sepse përbëhet nga tingujt, nga ana tjetër është racionale, se shënon diçka sipas vullnetit të njeriut. Gjuha varet nga njeriu dhe ky njeri që përdor gjuhën është qenie krejt e paqëndrueshme, pra ndryshon vazhdimisht e, për pasojë, edhe gjuha ndryshon “*sepse asgja, që asht e arsyetueshme/ mbasi ndryshon i njerëzve dëshiri/ për ndikim t’yjeve, s’asht kurrë e qëndrueshme. /Me u shprehë me gojë njeriu e ka për piri/ porse natyra atij ia len në dorë/*

---

<sup>36</sup> Robins R., vep. cit, f. 156.

<sup>37</sup> Fragmente nga ky traktat janë përkthyer nga A. Kasimati, *Mbi të folurin e popullit*, botuar në revistën “Nëntori”, nr. 5, 1965, f. 202-209.

*kështu o ashtu, si t'i pëlqejë ma s'miri*<sup>38</sup>. Te *gjuha popullore* Dante-ja gjen afrinë e parë lindur me sendet, çka është veti e gjuhës adamike<sup>39</sup>. Në konceptet e tij për lidhjen midis emrit dhe sendit ai bashkohet me Aristotelin, sepse pranon që marrëdhënia ndërmjet të shenjuarit dhe shenjuesit, rrjedhojë e aftësisë së gjuhës, përcaktohet me marrëveshje, pra *ad placitum* (latinisht: sipas dëshirës)<sup>40</sup>.

### **1.2.10. Teoria individualiste dhe e marrëveshjes shoqërore**

Teoria sociale më e rëndësishme është ajo e marrëveshjes shoqërore mbi krijimin e gjuhës. Përfaqësues i kësaj teorie ishte J. J. Rousseau (Zhan Zhak Ruso). Më 1762 ai botoi traktatin e famshëm politik me titull "*Mbi kontratën shoqërore*", ku çdo gjë e zgjidh me anën e kontratës shoqërore, prandaj dhe gjuha nuk është krijim i një njeriu. Njerëzit primitivë u mblodhën në kolektiv dhe vendosën të emërtojnë sendet e dukuritë. Në fillim ka pasur britma të natyrshme dhe pastaj leksik të plotë. Në fakt, teoria e marrëveshjes shoqërore origjinën e gjuhës e sheh brenda shoqërisë njerëzore, sepse lindjen e gjuhës e vë në varësi të kërkesave shoqërore dhe hedh tezën për zhvillimin e njëjtë të gjuhës dhe të mendimit nga britmat e natyrshme deri te gramatikat e gjuhëve të rregullta.

Teorisë së kontratës apo marrëveshjes shoqërore iu kundërvu teoria individualiste, përfaqësues i së cilës ishte Herder-i. Ai nënvizon lidhjen mes lindjes dhe zhvillimit të gjuhës me lindjen dhe zhvillimin e mendimit, por e veçon gjuhën nga shoqëria dhe e lidh krijimin e gjuhës me aktin krijues individual. Pra, individi, nga bota e tij e brendshme, ndien nevojën ta shprehë këtë botë. Ky individ, duke qenë i pajisur me arsye e përdor këtë për të mbledhur tinguj. Kështu lindi gjuha tek njeriu. Sipas tij gjuha ka pasur dy etapa zhvillimi: *etapa e parë*, kur gjuha ka karakter primitiv, sepse është gjuhë e një shoqërie primitive, por njëkohësisht gjuha ka një fuqi shprehëse shumë të madhe dhe fuqi emocionuese të drejtpërdrejtë. Tipike për këtë është gjuha e folklorit; *etapa e dytë*, kur gjuha humbet karakterin muzikal dhe fuqinë shprehëse të ndjenjave dhe emocioneve. Tani gjuha bazohet mbi arsyen. Kjo është gjuha e nocioneve abstrakte dhe e gjykimeve racionale, pra gjuha e qytetërimit të sotëm. Model tipik për këtë është gjuha e librave. Robins-i thekson se "*Herder-i solli një risi të madhe, duke*

---

<sup>38</sup> Alighieri D., *Komedia Hyjnore, Parajsja*, Tiranë, 1966, f. 150.

<sup>39</sup> Eco U., vep. cit., f. 46.

<sup>40</sup> Po aty, f. 48.

hamendësuar prejardhjen e përbashkët dhe zhvillimin paralel të gjuhës dhe mendimit, përmes shkallëve të njëpasnjëshme të rritjes dhe pjekurisë; më tej pohoi se, për shkak të ndërvarësisë ndërmjet gjuhës dhe mendimit, format e mendimit dhe të letërsisë popullore të popujve të ndryshëm mund të kuptoheshin ose studioheshin vetëm përmes gjuhëve të tyre<sup>41</sup>. Herder-i e vështronte gjuhën dhe mendimin jashtë shoqërisë njerëzore. Ai thoshte se duhet studiuar gjuha e individit dhe jo e shoqërisë. Në gjuhë gjen shprehje edhe “shpirti i popullit”, si një shumë individësh. Tezat e Herder-it u zhvilluan më vonë nga Vilhelm Humboldt-i, i cili hodhi bazat e filozofisë së gjuhës. Vepra e Herder-it “*Studime për origjinën e gjuhës*” (1772) dhe përpunimi që u bëri Humboldt-i teorive të tij, patën përkrahje dhe nga teoricienë të tjerë gjermanë të shekullit XX, si: Trir, Weisgerber (Vajsergerber), Cassirer (Kasirer) etj., të cilët, në themel të veprave të tyre kanë konceptin se gjuha është një akt krijues i individit dhe shprehje e nevojës së shpirtit të individit.

### **1.3. Rreth ideve të Humboldt-it për formën e brendshme të gjuhës**

Siç e vumë në dukje dhe më lart, Wilhem von Humboldt-i ishte ndër ata filozofë të gjuhës që studioi në mënyrë të plotë konceptin “e formës së brendshme” në gjuhë nga pozitave e romantizmit dhe filozofisë idealiste. Zhvillimi i gjuhësisë historiko-krahasuese krijoi mundësi që në shekullin XIX të bëheshin përpjekje për një sintezë filozofike edhe më të gjerë për kuptimin e natyrës së gjuhës, të lindjes dhe të zhvillimit të saj, të lidhjes së gjuhës me mendimin etj. Të gjitha këto lidhen me emrin e filozofit të madh gjerman Wilhelm von Humboldt. Ai ishte njohës i shumë gjuhëve (njihte gjithë gjuhët indoevropiane dhe familjen gjuhësore semite), çka i dha mundësi që të merrej me këto probleme. Ai hodhi bazat e gjuhësisë së përgjithshme si filozofi e gjuhës dhe e vuri filozofinë e gjuhës të asaj kohe mbi baza shkencore, duke ndërtuar një teori gjuhësore krejt origjinale, ku u mbështetën pothuajse gjithë rrymat gjuhësore të mëpastajme. Vepra e tij kryesore është “*Mbi gjuhën Kavi në ishullin Java*”<sup>42</sup> (1836-1839), e botuar në tre vëllime pas vdekjes së Humboldt-it. Në hyrjen e veprës, prej 400 faqesh, që mban titullin “*Mbi shumëllojshmërinë e ndërtimit të gjuhëve*” dhe përbën pjesën teorike, për herë të parë jepen konceptet themelore për filozofinë e gjuhës.

---

<sup>41</sup> Robins R., vep. cit., f. 206.

<sup>42</sup> Humboldt W., *Über die Verschiedenheit des menschlichen Sprachbaues*, Darmstadt, 1949.

### **1.3.1. Antinomitë<sup>43</sup> gjuhësore**

Sipas Humboldt-i, gjuha është në thelb e ndërlikuar dhe thelbin e këtij ndërlikimi e zbërthen në një varg antinomish<sup>44</sup>, pra si ligje që bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, por veçmas janë të vërtetë. Nën ndikimin e Hegelit ai u përpoq të zbulonte antinomitë në jetën e gjuhës:

- gjuha është krijim i shumë popujve dhe krijim i individit; pra gjuha është krijuar nga populli për shekuj të tërë, por edhe individual se edhe individi shton diçka;
- gjuha njerëzore përbëhet nga një numër i madh gjuhësh të veçanta dhe kjo përbën unitetin e gjuhës njerëzore, pra është larmi dhe njësi;
- gjuha është kategori e lëvizshme, por edhe e qëndrueshme (lëvizje dhe qëndrueshmëri relative);
- gjuha është ajo që kanë thënë njerëzit më parë, por është edhe ajo që thuhet. Pra ajo është produkt i shumë brezave të kaluar, por edhe krijohet nga individi në një çast të caktuar;
- gjuha është edhe objektive edhe subjektive. Për atë që e flet është edhe amtare, edhe huaj, se çdo individ e merr gjuhën ashtu si e kanë lënë të tjerët (tradita), por edhe individi detyrohet ta mësojë këtë gjuhë dhe të krijojë më tej


### **1.3.2. Gjuha është “shpirti i popullit” (botëkuptim)**

Sipas Humboldt-it, në gjuhë ngulitet një botëkuptim i caktuar, i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që flet. Kjo ndodh se gjuha ka një funksion ndërmjetës: ajo qëndron mes njeriut dhe botës së jashtme. Njeriu e rrethon veten me botën e tingujve, me qëllim që të perceptojë botën e jashtme. Qëndrimi i njeriut ndaj realieve kushtëzohet tërësisht nga gjuha. Pra, njeriu e sheh botën e jashtme me sytë e gjuhës e, si rrjedhim, edhe qëndrimi i njeriut ndaj botës varet nga gjuha. Për të koncepti *gjuhë* krijon *një rreth të mbyllur* për njeriun dhe ky varet nga gjuha për t’u lidhur me botën e jashtme. Për të dalë nga ky rreth, njeriu duhet të mësojë një gjuhë tjetër, e, për rrjedhim, do të krijojë një botëkuptim të ri.

---

<sup>43</sup> Ky term është përdorur për herë të parë në filozofi. Antinomitë janë dy teza, dy gjykime, dy parime të kundërta që përjashtojnë njëra-tjetrën, por të marra në vetvete janë të pranueshme, të vërteta. P.sh. njeriu si genie e gjallë dhe genie e vdekshme.

<sup>44</sup> Dhima Th., *Histori e gjuhësisë*, Infbotues, Tiranë, 2014, f. 98.



### 1.3.3. Format e gjuhës

Humboldt-i e quante gjuhën si shprehje të shpirtit të popullit dhe mjet për shprehjen e mendimit. Në përgjigje të pyetjes pse është krijuar kjo larmi e gjuhës, ai thotë se duhet rishikuar koncepti i formës në gjuhë. Ai i njeh gjuhës dy forma: *të jashtme dhe të brendshme*. Forma e brendshme e gjuhës pasqyron veçoritë dalluese tërësore të botës shpirtërore dhe botëkuptimin e një populli, si dhe veçoritë e lidhjeve të formës tingullore me nocionin që shënohet nga këta tinguj. Në çdo gjuhë duket kjo lidhje. Para Humboldt-it me konceptin formë kuptohej vetëm forma gramatikore, pra sistemi i lakimit dhe i zgjedhimit. Gjuhët që nuk kishin fleksion i quanin *pa formë (amorfe)*, pra njëjtësonin mbaresat me formën, si Schlegel-i (Shlegeli) etj. Këtij koncepti iu kundërvu Humboldt-i, duke thënë se gjuha ka formë të jashtme dhe formë të brendshme. Në formën e jashtme të fjalës përfshihen këta përbërës kryesorë: a) kompleksi tingullor i fjalës (i gjuhës në tërësi); b) struktura morfologjike (tipat e rrënjëve dhe të temave); c) kuptimi i përgjithshëm që ka fjala (pra aftësia e saj për të shënuar diçka nga realiteti). Kësaj ai i kundërvë formën e brendshme, e cila është mënyra se si nocioni bashkohet me kompleksin tingullor, mënyra e objektivizimit të mendimit ose të nocionit në gjuhë, që nuk është gjë tjetër veçse procesi i shenjëzimit ose i gjuhësimit, mënyra si përfaqësohet perceptimi i referentit në gjuhë. P.sh., shqip. *misërok* (që ha misër; Çabej e lidh me prejardhjen nga Misiri-Egjip<sup>45</sup>; rus. *indjuk* (me prejardhje nga india); angl. *turkey* (me prejardhje nga turqia); ose, po të marrin fjalën *dritare* (shqip), lidhet me dritën; *finestra* (italisht), lidhet me dukje, *window* (anglisht), lidhet me ajrin, erën etj. Pra, mënyra e lidhjes së kompleksit tingullor me nocionin e caktuar është e ndryshme. Forma e

---

<sup>45</sup> Çabej E., *Studime etimologjike të gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1982, f. 99.

brendshme përcaktohet nga kushtet në të cilat jeton dhe zhvillohet një gjuhë, dhe, pikërisht, forma e brendshme jep dallimet midis gjuhëve të ndryshme. Pra, veçanësia e gjuhëve nuk lidhet aq me formën e jashtme, sesa me formën e brendshme, e cila shpreh mënyrën se si bashkësia njerëzore i qaset gjuhësisht përvojës së vet. Forma e brendshme përfshin këto elemente: a) mënyra se si kategoritë e ndërgjegjes realizohen në gjuhë, pra forma e brendshme është hallkë mes ndërgjegjes së njeriut dhe gjuhës, vizioni i bashkësisë mbi botën dhe vetveten; b) shprehje e shpirtit të një populli të caktuar; c) është tërësia e të gjitha kategorive gjuhësore, pra është vetë gjuha. Humboldt-i, mbi të gjitha, vlerëson formën e brendshme, sepse ajo realizon lidhjen e mendimit me gjuhën. Nocioni në gjuhë ekziston bashkë me nocionin formë dhe gjuha është formë e asgjë tjetër veç formës. Humboldt-i trajton edhe anën materiale të formës, e cila i kundërvihet formës. Por përmbajtjen e formës nuk mund ta gjejmë brenda gjuhës. Ajo ekziston, sipas Humboldt-it, por ne nuk e gjejmë dot. Pra, ai brenda sistemit të gjuhës dallon formën e jashtme (shprehjen/ idenë që gjuha krijon për mendimin) dhe formën e brendshme (sistemin e koncepteve që pasqyrojnë tiparet e veçanta të botës së brendshme të folësve të një gjuhe të caktuar, tipare të cilat përforcohen përmes formës së jashtme. Të dyja së bashku këto forma përcaktojnë formën e gjuhës, të cilën Humboldt-i e krahasonte (e vinte përballë) me përmbajtjen. Sipas tij, gjuha është një *energji* e përjetshme, e cila zhvillohet dhe ripërtërihet vazhdimisht. “*Gjuha nuk është produkt i veprimtarisë (ergon), pra diçka statike, por është veprimtari (energia)*”. Një pikëpamje e tillë e shtyu Humboldt-in drejt konceptit të formës së brendshme, *innere Sprachform*<sup>46</sup>. Duke vlerësuar studimet e bëra në planin sinkronik në gjuhësinë e shekullit XIX, Sh. Rokaj vë në dukje se: “Në mënyrë të veçantë duhet përmendur vepra e pasur e Humboldt-it. Disa koncepte të tij, si: raporti midis gjuhës dhe mendimit, antinomitë, klasifikimi tipologjik i gjuhëve, *forma e brendshme dhe e jashtme e gjuhës* (nënvizimi ynë), gjuha dhe procesi i të folurit apo karakteri sistematik i saj, u rimorën dhe u zhvilluan më tej nga disa drejtime të tjera, si: drejtimi psikologjik, drejtimi i idealizmit, shkolla sociologjike etj<sup>47</sup> .

Teoria e tij për formën e brendshme dhe të jashtme e shpuri përpara mendimin gjuhësor, sidomos ligjet semantike, duke dhënë mundësi të depërtohet në anët e veçanta të çdo gjuhe kombëtare dhe të popujve të fiseve të ndryshëm.

---

<sup>46</sup> Robert R., vep. cit., f. 219.

<sup>47</sup> Rrokaj Sh., *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Arbëria, Tiranë, 2005, f. 28.

#### **1.4. Probleme të formës së brendshme të gjuhës në teoritë psikologjike individualiste**

Teorinë individualiste-psilokogjike për gjuhën e përpunoi nxënësi i Humboldt-it, H. Steinthal-i (Shtejntal), duke u mbështetur në filozofinë e Herder-it, sipas të cilit, shpirti i individit është i vetmi realitet që ekziston. Shpirti i individit pjell elemente të veçanta psikike që ndeshen dhe gërshetohen midis tyre, e zhvendosin njëri-tjetrin nga vetëdija e njeriut. Shpirti i individit është krijuar i gjithçkaje, pra edhe i gjuhës. Shtejntal-i thoshte se vetëm bota shpirtërore e individit është faktori që krijon dhe kushtëzon zhvillimin e gjuhës.

Steinthal-i dhe gjithë pasuesit e tjerë e barazonin nocionin e shpirtit individual me atë të gjithë proceseve psikofizike që zhvillohen në vetëdijen e njeriut. I ashtuquajtur "shpirti i popullit" ekziston, sipas tyre, vetëm te individë të veçantë. Edhe në gjuhë nuk ndikon shija e individit, por "shpirti i popullit", ai vendos për përdorimin e një fjale ose jo. Sipas Steinthal-it forma e brendshme është një mënyrë e shprehjes së përmbajtjes psikike të gjuhës, ajo i kundërvihet materialit fonetik (formës së jashtme fonetike) dhe përmbajtjes psikike. Nga kjo pikëpamje, duket se koncepti i Steinthal-it përkon më tepër me konceptin që Humboldt-i ka për gjuhën në përgjithësi dhe jo për formën e brendshme. Tezën e Humboldt-it mbi kuptimin e fjalës ai e shpuri më tej, duke theksuar se fjalët nuk kanë kuptim të caktuar, se çdo individ duke shqiptuar fjalët, shpreh përjetimet vetjake, psikologjinë e vet <sup>48</sup>.

Më vonë bëhen ndryshime në tezat e psikologjisë. Pas sistemit të Herder-it, del sistemi voluntarist i Wilhelm Wundt-it (Vilhelm Vundi) në fillim të shekullit XX. Ai hodhi idenë se baza e të gjithë proceseve psikike është vullneti i njeriut. Çdo gjë në zhvillimin e shoqërisë varet nga vullneti ynë. Kjo teori u zbatua edhe në gjuhë: p.sh., pasuria apo varfëria e një gjuhe varet nga vullneti i individit. Megjithëse Wundt-i nuk besonte në idenë e Humboldt-it se gjuha është shpirti i popullit, ai thoshte se për të njohur psikologjinë e popullit duhen njohur mirë të gjitha shfaqjet konkrete të asaj jete të përbashkët të një populli, që janë gjuha, zakonet, ideologjia, pra gjithë kultura e tij <sup>49</sup>. Nga ana tjetër, Wilhelm Wundt-i i referohet konceptit të Humboldt-it duke i njohur gjuhës dy aspekte: "formën e jashtme gjuhësore" që e quan "struktura e gjuhës" dhe "formën e brendshme", që e përcakton si

---

<sup>48</sup> Dhima, Th., vep. cit., f. 114.

<sup>49</sup> Po aty, f. 115.

“procese psikike të fshehura dhe të ndërlukuara, të cilat shfaqen (manifestohen) përmes formës së jashtme gjuhësore”<sup>50</sup>.

### **1.5. Fjalët dhe sendet (veçanësitë dhe afritë gjuhësore)**

Shkolla gjuhësore “Fjalët dhe e sendet” (nga revista me të njëjtin emër) mori përsipër që të studiojë historinë e fjalëve jo vetëm në bazë të analizës gjuhësore, por edhe në lidhje me historinë e sendeve (fjalët ekzistojnë në varësi nga sendet). Prof. Çabej shkruan se *teza kryesore e kësaj shkolle është që t’i shikojmë fjalët jo të shkëputura, po lidhur me kulturën materiale. Kjo rrymë u zhvillua më vonë në atë që quhet sot etnolinguistika*<sup>51</sup>. Gjithashtu, ata u morën dhe me një sërë problemesh të etimologjisë, të leksikologjisë dhe të semasiologjisë. Sipas Schuchardt-it në veprën “Brevier”, gjuha është produkt i individit folës; gjendja e tij individuale, edukata, karakteri etj., ndikojnë drejtpërdrejt mbi gjuhën, duke krijuar stilin individual; ky stil merret nga të tjerët dhe përgjithësohet. Ai krijoi dhe një teori të re, e cila u quajt *teoria e afritë elementare të gjuhëve*, e cila lidhet me invariantet sendore të përbashkëta për të gjitha bashkësitë gjuhësore. Këto invariante janë pasojë e invarianteve perceptive. -Pse gjuhët janë të afërta? - pyet ai. Dhe përgjigjet: natyra psikike e njerëzve është e afërt, e përbashkët dhe prandaj kjo është bazë mbi të cilën ngrihet një afri elementare e vetë gjuhëve<sup>52</sup>.

### **1.6. Gustav Shpet-i për tezat e Humboldt-it**

G. Shpet-i zgjodhi veprën e Humboldt-it për t’i bërë një shqyrtim kritik dhe e shtjellon “formën e brendshme të fjalës” qysh vitin 1927, në kuadrin e një studimi të veçantë, më filozofik, duke materializuar të njëjtën ide në mënyra të ndryshme sipas fushave të dijes (pra dhe materialet e përdorura dhe mjetet e kërkuara)<sup>53</sup>. Për të nxjerrë idenë për të cilën Shpet-i jep mjaft formulime, mund t’i referohemi një fragmenti të shkurtër nga vepra “Forma e brendshme e fjalës”, ku ai saktëson metodën që duhet përdorur në studimin e mendimit të

---

<sup>50</sup> *The Great Soviet Encyclopedia*, 3<sup>rd</sup> Edition (1970-1979).

<sup>51</sup> Çabej, E., *Hyrje në indoevropianistikë*, Çabej, Tiranë, 2008, f. 57.

<sup>52</sup> Gosturani, Xh., *Historia e gjuhësisë botërore gjatë shekujve*, Erik, Tiranë, 1993, f.

<sup>53</sup> Shpet G. G., *The inner form of the words-Essays and variation on the theme Humboldt/Vnutrennyaya forma slova-Etyudu i variatsii nga temy Gumbolta*, M. 2009, f. 10.



Humboldt-it. Ai shkruan: “Vështirësitë e hasurura nga studiuesit që janë përpjekur të qartësojnë konceptin e “formës së brendshme” te Humboldt-i do të mbeten gjithnjë të pakalueshme, nëse i ndjekim pikë për pikë formulimet dhe shembujt e Humboldt-it dhe nuk marrin parasysh kuptimin e përgjithshëm të analizës së tij”<sup>54</sup>. Shpet-i thekson vështirësinë kryesore të punës së njëkohshme, nga njëra anë, për dallimin që ka Humboldt-i midis formës dhe përmbajtjes dhe, nga ana tjetër, mbi nocionin e “formës së brendshme”. Pastaj ai shton: “Për të kuptuar Humboldt-in duhet të vendosim para vetes objektin që qëndronte para tij, duke e parë këtë objekt dhe duke përcaktuar terminologjinë që te Humboldti mbetet ende e përafërt”. Së pari, Shpet-i përcakton atë që kupton me *gjuhë*, duke pasur kujdes që të çlirohet nga çdo këndvështrim ose element që mund të vijë nga jashtë kësaj fushe. Ajo që ne konstatojmë përnjëherë rreth nesh, kur e shkëpusim gjuhën nga mjedisi rrethues dhe përpiqemi të zgjidhim enigmën e tij, është sigurisht përvoja jonë dhe aspak “tinguj” bosh, “shprehje”, “reflekte”, por përjetime të orientuara drejt gjërave reale, objekteve, proceseve dhe marrëdhëniet midis tyre. Ne mund të përdorim çdo gjë që na rrethon si shenjë të diçkaje tjetër- dhe atëherë ne nuk kemi të bëjmë me dy lloje gjërash, por me një nga mjetet e shumta që ne zotërojmë për të përdorur realitet. Ne mund të shkëpusim një sistem të veçantë “gjërash” që e përdorim gjithnjë në këtë kuptim. Një sistem i tillë është gjuha.

Shpet-i ndahet nga Humboldt-i, duke treguar veçanërisht se ajo çka ai propozon e lejon të zgjidhë paradokset (vështirësitë) që ka zbuluar në procedurën e gjuhëtarit gjerman dhe të shmangë që në fillim kundërvëniet që nuk duhet të ekzistojnë (kundërvëniet formë/përmbajtje ose formë e brendshme/ formë e jashtme). Ai shkruan: “Humboldt-i i përcakton format gjuhësore nga të dy anët dhe na shpie në një lëndë të mundshme të gjuhës. ... Nga njëra anë është tingulli në përgjithësi, nga ana tjetër, tonaliteti i shprehjeve të ndjeshme dhe i lëvizjeve të pavarura të mendjes, që i paraprin formimit të konceptit me anën e gjuhës.” Humboldt-i ka kërkuar një njësi superiore në veprimtarinë sintetike të arsyes, pa vlerësuar faktin se koncepti i “formës së brendshme”, që ai e kishte futur, e zgjidhte tashmë problemin. Ky koncept ka krijuar pikërisht në gjuhë një raport ndërtues midis formës së jashtme fonetike dhe kuptimit objektiv të veçantë, përmbajtjes semantike të gjërave. Njëkohësisht, Shpet-i këmbëngul mbi faktin se “ajo që në një farë raporti është forma, në tjetrin është përmbajtja” dhe ai vazhdon: “Për të gjetur përmbajtjen në kuptimin që del këtu, gjuha duhet marrë si një

---

<sup>54</sup> Të gjitha citimet e dhëna më poshtë në këtë syth janë marrë nga kjo vepër.

e tërë “organike”. “Forma e brendshme” do të na japë mundësi të zgjidhim problemet që janë realisht në çështjen e ngritur. Forma e brendshme, si formë e formave, nuk është ligji i një abstraksioni të zhveshur, por i ndryshimit të asaj që është plot jetë e kuptim, të fjalës-koncept, në imanencën e saj ndaj ligjit të përbërjes dhe zhvillimit dialektik.”

Në lidhje me këtë ai shkruan se dallimi midis formës së brendshme dhe asaj të jashtme, është vetëm dytësor dhe se ai lidhet me disa pikëpamje mbi gjuhën: “Format e jashtme dhe të brendshme nuk janë kontradiktore dhe nuk kërkojnë, njëra në raport me tjetrën, tejkalim ose mënjanim. Ato janë të ndashme vetëm me abstraksion dhe nuk është e nevojshme një sintezë e fundit, por duhet njohur që në zanafillë një strukturë bazë.”

Shpet-i bën trajtime dhe përkufizime vetjake të “formës së brendshme të fjalës”. “Nëse, shkruan ai, ashtu siç e shpreh vendosmërisht Humboldt-i, gjuha ose, po flasim në mënyrë empirike, tingulli, është i domosdoshëm për të formuar konceptin (por tingulli, nga ana e vet, si dukuri gjuhësore nuk është asgjë veçse “mishërimi i vullnetit për ta prodhuar atë”, dhe, për më tepër, me dëshirën e saktë për të shprehur një mendim), atëherë është e qartë se në këtë vullnet gjendet ky synim i fjalës, si çdo synim që bashkon, në kuptimin konkret të fjalës, aspektet e saj që mund të ndahen vetëm në mënyrë abstrakte: aspekti i ndjeshëm dhe ai logjik.

Edhe kjo hermeneutikë e tekstit shpetian mund të vazhdohej në mënyrë permanente. Kjo duket edhe në përkufizimin e “formës së brendshme”, e cila, në perspektivën e hermeneutikës së shkrimeve të Shpet-it, bëhet domosdoshmërisht forma e brendshme e fjalës. Shpet-i shkruan: “Një përkufizim negativ: forma e brendshme nuk është një formë fonetike e ndjeshme, as nuk është më tepër vetë forma e mendimit, e përfshirë në mënyrë abstrakte, meqë nuk është forma e një objekti- që përbën përmbajtjen e menduar të çfarëdo ndryshimi të qenies- (dhe pra) të një objekti të kuptuar në mënyrë abstrakte. Një përkufizim pozitiv: por forma e brendshme përdor formën fonetike për të shenjuar objekte dhe lidhjet midis ideve, sipas kërkesave të mendimit konkret. Për këtë, ajo përdor formën e jashtme për të shprehur çfarëdo ndryshimi të përmbajtjes objektive mbi të cilën mbështetet mendimi- përmbajtje që, në këtë rast quhet *kuptim* (sens), në masën që është e domosdoshme që shprehja dhe tingujt, në realitetin konkret të qenies së tyre gjuhësore, përbëjnë jo vetëm një njësi strukturore të pandashme, por në vetvete të njëjtën *sui generis* të qenies ( të tipit social dhe kulturor).”

Metoda e praktikuar këtu, që mund të cilësohej si metodë krahasuese në filozofi, është në përshtatje me një kërkesë metodologjike që rrjedh nga kërkimet që synojnë të vënë në dukje specifikat e disa veprave, në fushën e filozofisë, të shkencave humane dhe të letërsisë. Konceptet e Shpet-it për formën e brendshme të fjalës janë të lidhura me konceptet e formës së brendshme të gjuhës. Natyra e gjuhës duhet të kërkohet në format e tingujve dhe idesë dhe të ndërthurjes së duhur dhe të saktë të të dyjave.

### **1.7. Hipoteza e relativizmit linguishtik**

Sh. Rrokaj shkruan se “që nga Humboldi, një grup gjuhëtarësh (Vartburgu, Trieja, Kasireri, Sepiri e Uorfi) kanë mbështetur tezën sipas së cilës çdo sistem gjuhësor vepron me një analizë specifike ndaj përvojës së bashkësisë. Ky proces kushtëzon mënyrën tonë të të konceptuarit të botës. Çdo gjuhë përfaqëson përvojën e bashkësisë sipas një mënyre të vetën, të dallueshme nga një gjuhë tjetër”<sup>55</sup>. Sipas autorit, kjo ide themelore shpuri, së pari, në krijimin e tezës së “relativizmit linguishtik” të Sapir-it (Sepir) dhe Worf-it (Uorfi), e cila mund të perifrazohet si më poshtë: Sepiri mendon se lidhja midis gjuhës dhe kulturës mund të vihet re vetëm në fushën e leksikut. Qeniet njerëzore nuk jetojnë vetëm në një botë objektive, por janë të varura në “mëshirën” e një gjuhe të veçantë, e cila më pas bëhet një mjet shprehjeje për kulturën dhe shoqërinë në përgjithësi. Ne e njohim natyrën përmes kufijve që përcakton gjuha. Qeniet njerëzore e perceptojnë natyrën përmes kategorive të veçanta dhe secila kulturë e pret realitetin në mënyra të ndryshme. Njerëzit i krijojnë fjalët dhe konceptet në mënyrë që të flasin për botën apo universin kulturor. Parimi i relativitetit gjuhësor nënkupton vlerësime të ndryshme të vëzhgimeve, të shfaqjeve (veprimeve) të ngjashme në dukje, por ende të diskutueshme, sepse vëzhguesit duhet të nxjerrin përfundime për këndvështrime të ndryshme të botës. Në themel të teorisë së Sapir-Worf-it qëndron teza që përcakton se kufijtë që gjuha amtare vë për folësit e saj janë në të vërtetë kufijtë e botës së tyre. Në teorinë e relativitetit gjuhësor fjalori dhe strukturat gramatikore të një gjuhe amtare kufizojnë dhe ndikojnë perceptimin për botën. Gjuha është një udhërrëfyes drejt realitetit gjuhësor, ajo kushtëzon fuqimisht të gjithë mendimin tonë për problemet dhe proceset shoqërore. Çdo gjuhë vulos një

---

<sup>55</sup> Rrokaj Sh., *Strukturalizmi ...vep. cit.*, f. 170-171.

formë të veçantë të substancës së botës në të cilën flitet<sup>56</sup>. Teoria e Sapir-it dhe nxënësit të tij Worf-it mbështetet mbi konceptet e dy prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të romantizmit: Herder-it dhe Humboldt-it. Kjo teori në vetvete thekson, veç të tjerash, vlerat pozitive të ndrysheshmërisë (diversitetit) dhe, në mënyrë më të përgjithshme, është një shtojcë e parimeve të idealizmit romantik. Sapir-i mund të ketë të drejtë kur ia njeh frymëzimit herderian pjesën më të madhe të mendimit të Humboldt-it mbi gjuhën dhe, nëse është kështu, si ndjekësit e teorive të Worf-it, ashtu edhe edhe teoricienët e sotëm të gramatikës gjeneruese, mund të zbulojnë lidhje ndërmjet tyre dhe Herder-it<sup>57</sup>.

Humboldt-i i sheh njëlloj të rëndësishme vlerat universale dhe të veçanta të gjuhës. Ai e sheh shumëllojshmërinë strukturore të gjuhëve (formën e tyre të brendshme) si një produkt të aftësisë mendore, funksionale dhe universale, karakteristike vetëm për qeniet njerëzore. Kjo është arsyeja pse Chomsky (Comski) sheh te teza e Humboldt-it fillesat e gjenerativizmit dhe veçanërisht të aftësisë krijuese të gjuhës (kreativitetit). Megjithatë, versioni Herder-Humboldt për lidhjen midis mendimit dhe gjuhës u shtjellua më tepër nga gjuhëtarët, antropologët dhe psikologët amerikanë të viteve '50 të shekullit XX dhe u përmblodhën në parimet e një teorie të quajtur *relativizëm gjuhësor*. Duke folur për ndërveprimin dhe kushtëzimin e ndërsjellë të gjuhës me mendimin, Humboldt-i i afrohet shumë vizionit që kishin gjuhëtarët amerikanë për relativitetin. Në fakt hipoteza e Sapir-Worf-it në vetvete ka të ndërthurur determinizmin gjuhësor (gjuha përcakton/ kushtëzon mendimin) me relativitetin gjuhësor (nuk ka kufij të përcaktuar qartë për shumëllojshmërinë dhe ndryshueshmërinë e strukturave gjuhësore)<sup>58</sup>. Qëndrimi themelor i Boas-it, Worf-it etj., ndaj gjuhës në lidhjet e brendshme me jetën dhe mënyrën e të menduarit të folësve të saj, është rrjedhë e ideve të Humboldt-it. Sh. Rrokaj arrin në dy përfundime të rëndësishme:

Së pari, strukturat e universit tonë linguistik i imponojnë rregullat e tyre specifike universit tonë mendor. Çdo gjuhe i përket një organizim i veçantë i fakteve të përvojës, sistemi i saj i interpreton me besnikëri këto fakte. Gjuhë të ndryshme e bëjnë atë që u quajjt “prejje e realitetit” në mënyra të ndryshme dhe se, në raportin që ekziston midis gjuhës dhe

---

<sup>56</sup> Champan S & Routledge, S. *Key ideas in linguistic and philosophy of language*, Edinburgh University Press, 2009, f. 30.

<sup>57</sup> Robins R., vep. cit., f. 207.

<sup>58</sup> Lyons J., *Language and linguistics*, Cambridge University Press, 1981, f. 304.

mendimit, e para përcakton të dytin<sup>59</sup>. Por, nga ana tjetër, nuk janë gjuhët shkak i prerjeve të ndryshme të realitetit, por janë grupet shoqërore, të cilat, duke jetuar në bashkësi etnokulturore, psikike dhe ekonomiko-shoqërore të caktuara, rrjedhimisht kanë edhe qëndrime perceptive dhe konceptuale të ndryshme. Ndërsa gjuha nuk bën gjë tjetër veçse i përcjell këto dallime, sepse i tillë është funksioni i saj. I njëjti problem shtrohet në një formë tjetër për njerëzit që jetojnë brenda një bashkësie gjuhësore, ku niveli i njohjes nuk është i njëjtë për të gjithë. Edhe vetë këta nuk e kanë të njëjtin perceptim të realitetit, pa folur këtu për këndvështrimin nga i cili ata nisen në përcaktimin e tipareve të qenësishme të një objekti. Në bazë të këtij këndvështrimi dalin edhe tiparet e qenësishme të realitetit, i cili, objektivisht, mund të jetë i njëjtë për të gjithë. Me një fjalë, prerjet e ndryshme të realitetit kanë si burim nivelet e ndryshme të përvojës dhe dallimet gjuhësore, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër veçse përfaqësojnë këto dallime. Çdo bashkësi i jep gjallesës së vet jo vetëm trashëgiminë gjenetike, por edhe atë kulturore, që në thelb shpreh mënyrën se si ajo ka ndërtuar nga brezi në brez tërë përbërjen e saj shpirtërore<sup>60</sup>.

### **1.8. Forma e brendshme sipas Anton Marty-it**

Anton Marty (Marti), në teorinë e tij semasiologjike, lëndën gjuhësore e klasifikoi si kuptim e formë, ndërsa formën e ndau në të brendshme dhe të jashtme. Me formë të

brendshme kupton lidhjen midis kuptimit dhe shprehjes dhe këtë e lidh me veprimtarinë psikologjike. Fjalët i grupoi në autosemantike (që kanë kuptim të pavarur) dhe sinsemantike (që marrin kuptim kur lidhen me fjalë të tjera në kontekst). Në shekullin XIX termi “semasiologji” përdoret shpesh në analizat gjuhësore të lidhura veçanërisht me kuptimin. Marty e përdori termin “semasiologji” për të përcaktuar trajtesat e tij filozofike në lidhje me gjuhën në përgjithësi dhe me kuptimin në veçanti. Terma të tjerë pak a shumë sinonimikë janë “semantikë” dhe “gramatikë universale”, të përdorura në mënyrë të veçantë për ta analizuar gjuhën nga aspekti sinkronik.

Është me shumë interes edhe koncepti i Marty-it për formën e brendshme gjuhësore. Sikurse e shtjelluam më lart, ky koncept ishte trajtuar më parë nga Humboldt-i, i cili

---

<sup>59</sup> Rrokaj Sh., *Strukturalizmi ...* vep. cit., f. 171.

<sup>60</sup> Po aty, f.175.

mendonte se kjo formë ishte e lidhur me botëkuptimin dhe shpirtin e popullit (e njerëzve) që flet një gjuhë të dhënë. Edhe pse nocionet “botëkuptimi” dhe “shpirti i popullit” nuk luajtën aspak rol në trajtesat teorike të Marty-it në fushën e semasiologjisë deskriptive, ai e sheh me vend ta përcaktojë “formën e brendshme gjuhësore” apo “etimoinin”<sup>61</sup> si një përshfaqje që shërben si një e bashkëlidhjes (asosacionit) midis shenjës të perceptuar nga ana e jashtme dhe kuptimit<sup>62</sup>. Forma e brendshme e gjuhës e gjen shprehjen tek idetë “e fshehura” pas shprehjeve të ndryshme figurative të tipit “i jap dorën” dikujt apo “heq dorë”. Në këto raste imazhet lindin brenda mendjes njerëzore si rezultat i perceptimeve të brendshme dhe shërbejnë për të shprehur kuptimin pa patur nevojën e shprehjeve të tjera më të ndërlikuara.

Megjithëse Marty nuk ishte i vetmi në rrethin e gjuhëtarëve dhe filozofëve të gjuhës që e përdori konceptin e “formës së brendshme” ai doli kundër parimeve të disa bashkëkohësve të tij, veçanërisht nativistëve<sup>63</sup>.

Sipas Marty-it, koncepti i integruar i Humboldt-it për botëkuptimin e popullit që flet një gjuhë të caktuar, më saktësisht mund të identifikohet me kuptimet e përçuara përmes zbatimeve konkrete të gjuhës e jo me imazhe apo forma të tjera të brendshme që i lidhin këto shprehje me kupimin. Për më tepër, sipas Marty-it, disa nga bashkëkohësit e tij, ndër të cilët përmend B. Delbruck (Delbruk), nuk kishin ide të qarta për dallimin midis formës së brendshme dhe asaj të jashtme. Ndër të tjera, Marty u përpoq të argumentonte se ka një dallim të qartë midis shprehjes gjuhësore dhe kuptimit të saj. Sipas tij, semasiologjia studion njësinë e përbërë (komplekse) të shprehjes gjuhësore-formës së brendshme gjuhësore-kuptimit”.

Filozofia e gjuhës së Marty-it meriton vëmendjen e studiuesve të gjuhës për dy arsye. Së pari, krahasuar me bashkëkohësit e tij, të cilët ishin më të interesuar për zhvillimin e gjuhës nga pikëpamja diakronike (ndryshimin fonologjik dhe semantik), Marty i kushtoi më tepër vëmendje gjendjes aktuale të gjuhës. Nga kjo pikëpamje, analizat e tij dhe trajtesat teorike ishin më tepër përshkruese (sinkronike), sesa gjenetike (diakronike). Së dyti,

---

<sup>61</sup> Nga greq. *etimon*-rrënja ose fjala kryesore nga e cila e ka burimin një fjalë tjetër; forma e parë e fjalës nga e cila dalin fjalët e prejardhure.

<sup>62</sup> Marty, A., *Untersuchungen zur Grundlegung der allgemeinen Grammatik und Sprachphilosophie*. Vol. I. Halle a. S.: Max Niemeyer, 1908.

<sup>63</sup> Prej frëngjishtes *nativisme*, nga lat. *natives-i lindur*. Nativizmi është teori psikologjiciste, sipas së cilës, përfytyrimi i hapësirës na jepet menjëherë me çdo ndijim dhe nuk fitohet nga përvoja apo puna mendore. I krijuar nga Kanti, nativizmi u zhvillua nga Stumpfi, Panumi, Heringu, Myleri, Uliam Xhejmsi. Xhejmsi thoshte se ndijimet tona janë pak a shumë “vëllimore” për nga vetë natyra e tyre.

krahasuar me filozofët e tjerë të gjuhës, ai e trajtonte gjuhën si produkt të një inteligjence të supozuar mbinjerëzore apo të mekanizmave psikologjike dhe filozofike, si asosacioni apo refleksi. Ai e studion gjuhën si diçka që rrjedh nga mendja njerëzore individuale dhe drejtohet në mënyrë të qëllimshme drejt objekteve. Para së gjithash, koncepti i Marty-it për gjuhën lidhet me “manifestimet e qëllimshme të botës së brendshme përmes shenjave të caktuara, veçanërisht përmes tingujve që lidhen drejtpërdrejt me fjalë të gjuhës të folur, të cilat nuk janë lehtësisht dhe instiktivisht të kuptueshme, por kuptimim i tyre i veçantë lidhet me zakonet dhe traditat.

### **1.9. L. Weisgerber-i si dishepull i Humboldt-it**

Një prej vazhduesve të ideve të Humboldt-it (të cilët u quajtën neohumboltianë) ishte dhe Leo Weisgerber (Vaisgerber), i cili në veprat e tij ka trajtuar disa çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis gjuhës në veçanti dhe kulturës, gjuhës dhe të menduarit në raport me letërsinë etj. Neve na intereson interpretimi që ai i ka bërë tezës së Humboldt-it lidhur me formën e brendshme të gjuhës (innere Sprachform). Sipas Weisberger-it, Humboldt-i, duke iu përmbajtur konceptit të tij për botën, e sheh anën shpirtërore si komponent qëndror në çdo gjuhë. Humboldt-i ka shkruar se “*gjuha nuk është thjesht një mjet shkëmbimi i një mirëkuptimi reciprok, por një botë e tërë, në të cilën mendja duhet të përdorë gjithë forcën e brendshme mes vetes dhe objekteve që e rrethojnë*”<sup>64</sup>. Te ky citim Weisgerber-i veçon termat “forcë” dhe “mendje” dhe parashtron konceptin e tij “forca e mendjes”, duke e lidhur këtë me “konceptimin për botën” dhe “formën e brendshme të gjuhës” në kontekstin e ideve të Humboldt-it, që e sheh gjuhën jo si “ergon”, por si “energia”. Në interpretimin e Weisgerber-it del edhe këndvështrimi i gjuhës për nga forma dhe përmbajtja midis rrethit të dytë dhe të tretë humoldtian për gjuhën si botë e ndërmjetme (shih sythin 1.2.3 të këtij kapitulli).

Humboldt-i gjuhën nuk e sheh si diçka të dhënë njëherë e përgjithmonë, duke iu kundërvënë pikëpamjes që e vështronte gjuhën si shprehje të drejtpëdrejtë të logjikës, që edhe ligjet e gjuhës i quan të përbashkëta për gjithë njerëzimin. “*Gjuha, - thotë ai, - duhet parë jo si produkt i vdekur, por edhe si proces krijues*”. Sipas tij, gjuha është një *energji* e

---

<sup>64</sup> Losener H., *Zweimal Sprache: Weisgerber und Humboldt*, Munster: Nodus Publikationen, 2000, f. 197-212.

përjetshme, e cila zhvillohet dhe ripërtërihet vazhdimisht. “Gjuha nuk është produkt i veprimtarisë (*ergon*), pra diçka statike, por është veprimtari (*energia*)”<sup>65</sup>. Në veprën e fundit me titull “Dy herë gjuhë” Weisgerber-i fjala “*ergon*” interpretohet në këndvështrimin formal gramatikor të gjuhës, ndërsa “*energia*” i referohet përceptimit të gjuhës lidhur me përmbajtjen. Te Weisgerber-i ngatërrohen domethëniet e termave humboldtiane *ergon* dhe *energia*. Kur ai flet për *energia*, ka në mendje pikërisht atë që Humboldt-i mblaton në termin *ergon*, anën e “fjalëve dhe të rregullave”.

Në veprën “Gjuha amtare në formimin e kulturës sonë” Weisgerber-i e shtjellon përsëri konceptin e formës së brendshme nga një këndvështrim tjetër. Ai thotë se poeti së pari duhet të përpunojë pa u lodhur format e brendshme të konceptimit të gjuhës amtare. Veprimtaria poetike ka për detyrë ta kthejë gjuhën në art me gjithë konceptimin e saj në mënyrën e të krijuarit, të vlerësuarit, në kuptimin e botës shpirtërore dhe atë të mendjes <sup>66</sup>.

L. Weisgerber-i përpiqet që me anën e formës së brendshme të gjuhës të ndërtojë tablonë e botëkuptimit gjerman. Deviza e tij ishte se forma e brendshme është një forcë enigmatike që drejton zhvillimin kuptimor të fjalëve, madje gjithë strukturën kuptimore të fjalës.

## **1.10. Potebnja dhe Zvegincev për formën e brendshme**

**1.10.1.** Aleksandër Potebnja, një gjuhëtar që ndoqi gjurmët e Humboldt-it, mendonte se një nga detyrat me të rëndësishme të psikologjisë ishte studimi i gjuhës. Sipas tij, gjuha dhe ligjërimi nuk shërbejnë vetëm si mjet komunikimi, por, në të njëjtën, kohë formësojnë mënyrën tonë të përgjithshme të të menduarit. Në këtë kontekst, gjuha që ne flasim është pjesë e trashëgimisë biologjike dhe kulturore. Një nga tezat themelore të Potebnja-së ishte ajo e lidhjes midis fjalëve ose koncepteve, nga njëra anë, dhe ideve apo mendimeve, nga ana tjetër. Në librin e tij “Gjuha dhe mendimi”, Potebnja argumentonte se idetë nuk shprehen thjesht me fjalë (sikur idetë të ishin të gatshme dhe të artikuloreshin sa herë të paraqitej nevoja), por lindin bashkë me fjalën. Gjuha apo ligjërimi i shton diçka idesë, është një instrument që krijon apo formëson idetë tona, apo siç shprehej Humboldt-i është “organi

---

<sup>65</sup> Të gjitha citimet janë dhënë sipas botimit të mësipërm.

<sup>66</sup> Weisgerber. L., *Broad content-based grammar*, German Language I, Dusseldorf, 1962.



krijues i mendimit”<sup>67</sup>. Fjalët kanë aftësinë për të përgjithësuar, çka do të thotë se ato i referohen një klase të tërë objkesh apo veprimesh (ngjarjesh) të ngjashme dhe një folës i përshkruan idetë e tij individuale duke përdorur fjalët ekzistuese. Në këtë mënyrë, detyrimisht i përshtat idetë personale me idetë ekzistuese të kulturës përkatëse duke i sendëzuar ato.

**1.10.2.** V. A. Zvegincev-i, në kapitullin VII (f. 186-214) të veprës së tij “Semasiologjia” i e shtjellon në mënyrë kritike teorinë Humboldt-it për “formën e brendshme” dhe e lidh atë me “analogjinë e brendshme”. Në literaturën gjuhësore për formën e brendshme jepen përkufizime të ndryshme, por, në përgjithësi, kuptohet përfytyrimi që ruhet në fjalë për shenjën e parë, e cila shtrihet në bazën e nocionit. Pra, quajmë formë të brendshme: ose kuptimin original që qëndron në bazë të kuptimit etimologjik të fjalës, po që ka humbur prej kohësh (p.sh. animal “kafshë” dhe anima “shpirt, frymë”, në fillim përfshihej dhe njeriu si frymor); ose çdo nuancë figurative që “krijon hallkën ndërmjet tingujve dhe kuptimeve”<sup>68</sup>. Zvegincev-i nuk e mohon origjinalitetin kombëtar të gjuhëve në dukuritë semasiologjike, duke pohuar se në kuptimet leksikore të fjalëve gjen shprehjen e vet origjinaliteti kombëtar, i cili, sipas tij, s’ka të bëjë me shpirtin e popullit në gjuhë e në sendet reale, po me historinë e raporteve të gjuhës me sendet e realitetit. Forma e brendshme lidhet: 1. me dukuritë e formimit të fjalëve të reja; 2. me formimin e kuptimeve të reja të fjalëve ekzistuese. Në rastin e parë, krahason fjalë të gjuhëve të ndryshme, p. sh. shqip-*dritare*; rus.-*okno*; angl. *window*; ital. *finestra* etj. Në shembuj të tillë forma e brendshme, e cila qëndron në bazën e krijimit të këtyre fjalëve, është ajo anë e kuptimit që mbështetet në diçka reale dhe që na lejon një motivim të brendshëm gjuhësor.

### **1.11. “Summa summarum” e Roland Barthes-it për formën e brendshme**

Këtë “summa summarum” të Roland Barthesit po e japim siç e ka shkruan vetë autori: U pa se për shenjuesin mund të thuhej që ai është ndërmjetës (material) i të shenjuarit. Çfarë natyre ka ky ndërmjetësim? Në gjuhësi ky problem ka ngritur diskutime: diskutime sidomos terminologjike, sepse në thelb gjërat janë mjaft të qarta (ato ndoshta nuk do të jenë të tilla në atë shkallë në semiologji). Duke

---

<sup>67</sup> Potebnja A., *Thought and language*. Oxford, 1926, f. 30.

<sup>68</sup> Zvegincev V. A., *Semasiologjia*, M. 1957 (përkthim nga rusishtja prej Akad. Jani Thomai, kopje e daktilografuar).

u nisur nga fakti se në ligjërimin njerëzor zgjedhja e tingujve nuk na imponohet nga vetë kuptimi (kau nuk i detyron asgjë tingullit ka, pasi që ky tingull është i ndryshëm në gjuhë të ndryshme), Saussure (Sosyri) fliste për raport arbitrar midis shenjuesit dhe të shenjuarit, Benveniste (Benvënisti) e kontestoi: ajo që është arbitrare është raporti midis shenjuesit dhe “gjësë” së shenjuar (midis tingullit ka dhe shtazës ka); por, siç u pa, as për vetë Saussure-in, i shenjuari nuk është “gjëja”, por përfytyrimi psikik i gjësë (koncept); shoqërimi i tingullit me përfytyrimin është rezultat i një dresimi kolektiv (për shembull i nxënies së gjuhës frënge)-dresim (të mësuarit pa kushte, verbërisht); ky shoqërim-që është domethënia, nuk është assesi arbitrar (asnjë francez nuk është i lirë ta modifikojë), por përkundrazi, i domosdoshëm. U propozua, pra, të thuhet se në gjuhësi domethënia është e pamotivuar; është imotivim, pos tjerash, i pjesërishtëm (Saussure flet për analogji relative): midis të shenjuarit dhe shenjuesit ekziston një lloj motivimi në rastin (të rrallë) e onomatopeve, siç do të shihet tani, dhe gjithherë kur në gjuhë vendoset përmes imitimit të një prototipi të caktuar të kompozitave apo derivative: i tillë është rasti i shenjave të quajtura proporcionale: pommier, porier, abricotier etj. (dru molle, pomme+ier, dru dardhe-poire+ier, dru kajsie-abricot+ier); pasi të jetë vendosur njëherë imotivimi i rrënjorit dhe i sufiksit të tyre, ato paraqesin analogji të komponimit. Do të themi, pra, në një mënyrë të përgjithshme, se në gjuhë lidhja e shenjuesit dhe të shenjuarit është në parim kontraktuale, porse kjo kontratë është kolektive, e regjistruar në një kohësi të gjatë. (Saussure thotë se “gjuha është gjithmonë trashëgimi”), dhe, për pasojë, në njëfarë dore e natyralizuar. Në të njëjtën mënyrë, K. Levi-Stross-i (Stros) saktëson se shenja gjuhësore është arbitrare apriori, por parashihen dy terma të ndryshëm, të dobishëm për zhvillimin e semiologjisë; do të themi se një sistem është arbitrar kur shenjat e tij themelohen jo me kontratë, por me vendim të njëanshëm: në gjuhë shenja nuk është arbitrare, por e tillë është në modë; dhe se shenja është e motivuar kur relacioni midis të shenjuarit dhe shenjuesit të saj është analogjik (për shenjat e motivuara Buysens-i ka propozuar emërtimin semë intrinseke, ndërsa për shenjat e pamotivuara: semë ekstrinseke); mund të kemi, pra, sisteme arbitrare dhe sisteme të motivuara; të tjera, joarbitrare dhe të pamotivuara.

Në gjuhësi motivimi kufizohet në rrafshin e veçuar të derivacionit dhe të kompozicionit; në të kundërtën, në semiologji ai do të shtrojë probleme të përgjithshme. Nga njëra anë, është e mundshme që jashtë gjuhës të gjenden sisteme gjerësisht të motivuara dhe do të duhej atëherë të gjendet mënyra se si pajtohet analogjia me diskontinuitetin, që deri tash duket i domosdoshëm për domethënie; dhe pastaj mund të vendosen seritë paradigmatiche (pra, seri me terma të paktë në numër dhe të mbaruar), kur shenjuesit janë analogë: i tillë do të jetë, pa dyshim, rasti i “imazheve”, semiologjia e të cilave, për

këto arsye, është larg së qeni e themeluar; nga ana tjetër, është fare e besueshme që inventari semiologjik do të nxjerrë në shesh eksistencën e sistemeve të papastra, që përmbajnë ose motivime shumë të labërguara ose motivime të përshkuara, nëse mund të thuhet kështu, nga imotivime dytësore, po sikur shenja të ketë qenë shpesh vend konflikti midis të motivuarës dhe të pamotivuarës; i tillë është nga pak rasti i zonës “të motivuar” të gjuhës, i zonës së onomatopeve; Martineja ka shënuar se motivimi onomatopeik shoqërohet nga një humbje e nyjëtimit të dyfishtë (aie “of”, që del vetëm nga nyjëtimi i dytë, zëvendëson sintagmën e nyjëtuar dyfish: më dhemb); megjithatë, onomatopeja e dhembjes nuk është e njëjtë në frëngjishten (aie), në danishten (au) dhe në shqipen (of), për shembull, kjo ndodh për shkak se motivimi këtu u shtrohet në njëfarë dore gjedheve fonologjike, që s’ka dyshim se ndryshojnë sipas gjuhëve: kemi këtu shkrirje të analogjikes me digjitalen. Jashtë gjuhës, sistemet problematike, si “ligjërimi” i bletëve, na ofrojnë të njëjtën dysi: rrathët e gjetjes së ushqimit kanë vlerë të paqartë analogjike; loja në hyrje të kosheres është gjerësisht e motivuar (tregon drejtimin e kullotës), por vallëzimi në formën e 8-shes është plotësisht i pamotivuar (tregon një distance)<sup>69</sup>.

### **1.12. Përsiatje të I. Kadaresë për formën e brendshme të gjuhës**

Por për ta kuptuar edhe më mirë formën e brendshme të gjuhëve, po japim pa koment përsiatjet e Ismail Kadaresë:

Një ditë e gjetëm shefin tonë të zhytur në librin “Gjuha shqipe, njohuri për turistët”. Kishte thënë disa herë se në gjuhën e një populli mund të gjesh kyçet për të zbërthyer misterin e tij, por ngaqë një mendim të tillë e kishte shfaqur në Shën Petërsburg, madje edhe në Budapest, pa e njohur as rusishten e aq më pak hungarishten, kurrsesi nuk na shkonte mendja se do të guxonte të përzihej me gjuhën e vështirë të shqiptarëve.

Shefi hynte ndër ata njerëz që, për shkak të mungesës së flokëve, ngjajnë edhe më kokëfortë. Mezi ç’priste ardhjen e vendasve për t’i munduar edhe ata me ca pyetje të vështira. Një Zot e dinte se ku i kishte gjetur ca shprehje të papërkthyeshme, si: “dita e moskurrit”. “ngjarje e mosqoftshme”, e, sidomos, një trajtë të foljes me të cilat ato lidheshin, në një trajtë që quhej “dëshirore”, e që qenkësh vetëm në gjuhën shqipe e, ndoshta, disi në greqishten e vjetër. Sipas tij, kjo trajtë ishte vegla që gjithë

---

<sup>69</sup> Barthes R., *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 255-258.

foljeve të shqipes mund t'u jepje kahun e mbarë ose të prapë, me fjalë të tjera, një frymë të mirë ose të keqe.

Jo vetëm ne, por edhe vendasit mbetën disi të hutuar, ngaqë, siç e pohuan edhe vetë, e dinin pa dyshim këtë trajtë, madje edhe e përdornin në të folurën e përditshme, por mendja u shkonte kaq larg.

Shefi ynë i zhbironte me ca sy që herë ngjanin shpotitës e herë bëheshin të ligj, thua se fryma e mirë ose e keqe e gjuhës shqipe e kishte molepsur ndërkaq. Natyrisht që s'u ka shkuar mendja, thoshte ai, sepse mendjes suaj aq ia pret. E përdorni atë trajtë e nuk e dini se ajo është makina që prodhon të gjitha mallkimet e bekimet që janë te ju si askund. M'i gaculloni sytë si të bufit, sepse nuk ju shkon mendja që, sipas mendësisë së të parëve tuaj, hyjnitë e vogla, Orët, s'bëjnë gjë tjetër, veçse enden e përenden gjithkund për të mbledhur e për të çuar pastaj atje ku duhet qoftë mallkimet, qoftë bekimet që dëgjojnë andej-këtej.

E kuptoni tani se ato hyjni i shërbejnë pikërisht kësaj makine? Dhe e kapni dot tani se, kur poetët tuaj të vjetër e quanin gjuhën shqipe hyjnore, këtë e bënin jo se besonin në dokrra të tilla, por thjesht ngaqë e dinin se trajta dëshirore e foljes, ky thesar që e dallon atë nga gjuhë të tjera të botës, ka lidhje me orët? (Vepra 15, SPIRITUS, Onufri, 2009, f. 22-23).

## KAPITULLI II

### RRETH FORMËS SË BRENDSHME TË FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE

*“Credē mibi sacra populi lingua est.”*

**Seneka**

#### 2.1. Analiza etimologjike dhe forma e brendshme e fjalës: lidhje e dallime

E. Çabej, në studimet e tij etimologjike, e shtjellon edhe konceptin e formës së brendshme të fjalës. Etimologjia, si fushë studimi, nuk është një me hetimin e gurrës së fjalës, ajo përfshin diçka më tërësore, atë që mund të quhet jeta e fjalëve në një kuptim të përgjithshëm. Objektin e saj e përbëjnë kështu zona e përhapjes sot e dikur e fjalës, mjedisi ku u formua, historia e saj dhe zhvillimi i brendshëm i saj etj.<sup>70</sup>. Po kështu, për të gjetur kuptimin e kryehershëm, gjenetikisht më të moçmin, përmes analizës semantike, p.sh.: *hime* “krunde të imëta” ka si kuptim bazë, pra formë të brendshme “i imtë, bluar hollë” etj. Autori shkruan se në ndonjë rasë, ashtu si te format e fjalëve, edhe këtu ndihmon paralelizmi onomasiologjik me gjuhët fqinje, “forma e brendshme” e njëllojtë me të shqipes<sup>71</sup>, duke sjellë si shembuj fjalët *morth (morr)*, *murriz*, *sysk* etj., përqsar me rumanishten. Konceptin e formës së brendshme të fjalës E. Çabej e sheh në lidhje me ndryshimet semantike që ndodhin përgjatë zhvillimit të gjuhës. “Kështu, shkruan autori, ka emra konkretë që, duke zgjeruar një përdorim metaforik e shpeshherë vetëm okazional të tyre në kuptim të mirëfilltë, me rrugë metonimie bëhen emra abstraktë; dhe ky karakter i ri nganjëherë vjen e mbulon krejt të parin”<sup>72</sup>. Në këtë përfundim të profesor Çabejt del qartë se si formohet një “karakter” i ri që ka si formë të brendshme kuptimin e fjalës bazë. Si shembuj sillen raste të tilla, si: *brengë* “vuajtje” nga *brengë* “mëllëri që u del kafshëve dhe bagëtisë”; nga *ball/ë,-i* janë formuar edhe kuptimet e tjera: “anë e përparme”, “fillim”, “pjesa me e zgjedhur” (balli i shtëpisë; në

---

<sup>70</sup> Çabej E., *Studime etimologjike të gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 1982, f. 46.

<sup>71</sup> Po aty, f. 55.

<sup>72</sup> Po aty, f. 56.

ballë të dimrit; balli i grurit); nga *krah*, -u kanë dalë edhe kuptimi “mbrotje, përkrahje” (i dal krah) etj. (shih më gjerë në vijim çështjen e formës së brendshme te homonimet etj.).

Për prof. Çabejn ka rëndësi që, për të gjetur “formën e brendshme” të fjalëve duhet të merret parasysh zbatimi i parimit “fjalët dhe sendet” dhe përfillja e mjeteve të etnografisë, “i realieve”, që të arrijmë të kuptojmë historinë e një fjale në gjenezën dhe zhdrivillimin e saj<sup>73</sup>. Si shembull të njëmendtë autori sjell fjalën *brisk* “thikë çeliku me dorëz” nga *bri*, -ri, krijuar me sinekdokë si (pjesa për të tërën), sipas traditës së shqiptarëve që bishtin e thikës së xhepit e bënin pre briri.

## **2.2. Forma e brendshme te fjalët e prejardhura**

Siç dihet, prejardhja është mënyra kryesore fjalëformuese për pasurimin e leksikut të shqipes dhe të gjuhëve të tjera. Në këtë lëmë, analiza e temës fjalëformuese bën që të motivohet kuptimisht fjala e prejardhur, pra që të gjendet forma e brendshme e saj, pra, mënyra se si përbërësit japin kuptimin. Shkalla e motivimit, shkruan J. Thomai, varet edhe nga qartësia e lidhjeve kuptimore ndërmjet temës fjalëformuese dhe fjalës së prejardhur<sup>74</sup>. Në këtë rast, forma e brendshme e fjalës përfshihet në kuptimin e temës fjalëformuese, që mund të jetë fjalë rrënjë (kuptimi i parmë) ose një fjalë tjetër e prejardhur, për shembull: *besë* “fjala e dhënë me sigurinë se do të mbahet”- *besnik* “që e mban deri në fund fjalën e dhënë”- *besnikëri* “të qenët besnik ndaj dikujt a diçkaje” etj. Forma e brendshme, pra motivimi, mund të gjendet edhe te një kuptim i prejardhur i temës fjalëformuese, si për shembull: *dhelpër* “1. kafshë gjitare grabitqare. 2. fig. njeri shumë dinak”- *dhelpëri* “dinakëri, dredhi”- *dhelpërisht* “me dhelpëri”- *dhelpëroj* “veproj a sillem me dhelpëri”- *dhelpëror* “dinak, dhelparak”. Forma e brendshme, pra motivimi i fjalëve të prejardhura bëhet ndonjëherë edhe i vështirë në gjendjen e sotme të gjuhës: *lajthit* “gaboje padashur, ngatërrohem për diçka” nga *lajthi* “shkurre me degë të holla, që bën kokrra të vogla me guackë të fortë”; *tkurr* “rregjoj, e zvogëloj vëllimin, e bëj më të mbledhur” nga *korr* “shkurtoj”; *shtrungë* “vend i thurur, ku përbujnë e ku mjelin bagëtinë; vend pranë derës së vathës ku mjelin bagëtinë” vjen nga folja *shtrëngoje*. Me këtë kuptim përdoret edhe në një varg gjuhësh të tjera (greqisht, bullgarisht,

---

<sup>73</sup> Po aty, f. 64.

<sup>74</sup> Thomai J., *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989, f. 273.

rumanisht etj.)<sup>75</sup>: *shkues, shkes* “ndërmjetës në një fejesë” nga folja *shkoj* “largohem për diku, iki, kaloj, vete”. Sinonime të kësaj fjale *lajmës* nga *lajm* “njoftim i shkurtër”; *shkrepës* “që nxjerr shkëndija, që bën shkrepjen” dhe *shkrepëse* “kunja të vegjël druri që nxjerrin shkëndija” nga *shkrep* “përpyjek dy sende për të nxjerrë shkëndija”; *shterpë* “që nuk pjell ose nuk lind dot, që nuk është i aftë për mbarsje” nga *shteroj /shter* “ia heq krejt diçkaje, nuk i lë gjë”; *shtijë* “tel i hollë me majë a me grep që përdoret për të thurur çorape, triko etj ” nga *shtie* “hedh a vë diçka brenda diçkaje tjetër, shtoj diçka”.

Sikurse shihet, për shumicën e fjalëve të prejardhura motivimi i brendshëm është i kapshëm dhe gjendet lehtë.

**2.2.1. Fjalë të prejardhura emra:** *brymak* “lloj duhani që rritet deri sa bie brymë, vjeshtuk” nga *brymë* “rreshje që formohet si shtresë shumë e hollë bore”; *dredhanik* “embëlsirë me petë të mbledhura rrrumbullak” nga *dredh* “rrotulloj, i jap formë të lakuar diçkaje”; *elbth* “puçërr me qelb sa një kokërr elbi” nga *elb* “kokërr e vogël e një bime njëvjeçare si kokrrat e grurit”; *shapkë* (lat. Scolopax) “zog i murrmë, me sqep të gjatë e të hollë, që rron nëpër ligata dhe që e gjuajnë për mishin e shijshëm që ka”, Majeri e lidh me *shapkë* “kësulë me strehë përpara” në ngjashmëri me mbrapakreun vara-vara të zogut, që të lë përshtypjen e një kësule. Kristoforidhi jep për të njëjtin zog fjalën *sqeptore* (Shkodër), *skjepça* (Zadrimë) nga sqepi i gjatë; ital. *beccaccia* (becco-sqep); gjerm. *Schnepfe* (schnabel-sqep)<sup>76</sup>; *këndes* “shpend shtëpiak me lafshë të kuqe, gjel” nga *këndo* “nxjerr tinguj muzikorë”; *balluk* “kaptell i samarit të kafshës” nga *ballë* “pjesa e përparme e një ndërtese, pjesa e fytyrës së njeriut midis syve dhe flokëve”; *çifteli* “vegël muzikore me dy tela” dhe “që ka dy kurora ose dy dredhëza në flokë” dhe *çifte* “armë gjahu me dy tyta” nga *çift* “dyshe, dy frymorë sende a dukuri që merren si një njësi”; *gishtje/ gishtëz* “kësulës metali që e vëmë në gisht kur qepim”, “këmbëza e shkrepjes” nga *gisht* “secili nga pesë zgjarimet në fund të dorës”; *shofkë*-“pasqyrë” nga një trajtë dialektore (*shof*) e foljes *shikoj* “i hedh sytë dikujt, dalloj me sy diçka”; *shpatore* “barishte shumëvjeçare me gjethe si shpatë” nga *shpatë* “armë e fortë e gjatë prej çeliku”; *shtjekëz* “kllapë e vogël në shënjestrën e disa armëve të zjarrit që shërben për të marrë vijën e shënimit” nga *shtie* “hedh, fut ose vë diçka brenda në një vend të mbyllur a të rrethuar”; *thyesë* “numër që shpreh pjesë të barabarta në të cilat është ndarë një

---

<sup>75</sup> Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VII, Tiranë, 2005, f. 83.

<sup>76</sup> Çabej E., *vep. cit.*, VII, f. 41.

njësi” nga *thyej* “e ndaj një gjë në dysh apo në disa copa”; *ulok* “ai që nuk ngrihet a nuk ecën dot për shkak të një sëmundjeje” nga *ul/ulem* “e zbres nga lart poshtë; zbres nga një vend më i lartë në një vend më të ulët”; *veshkë* “organ i përbërë nga dy pjesë në trajtën e një fasuleje të madhe, të cilat ndodhen afër mesit” nga *vesh* “organi i dëgjimit, secila prej llapave të këtij organi që gjenden në të dyja anët e kokës” emërtimi është bërë përmes metaforës, mbi bazën e ngjashmërisë së formës; *mëkresë* “gur varri” nga *krye (kre)* “koka e trupit apo e kafshës”; *nënkresë/përkresë* “jastëk” përsëri nga *krye*; *ngjelkë* “grua llafazane” nga “gjel”; *plasje* “sëmundjeje e rëndë ngjitëse e bagëtive” nga *plas* “çaj me shpërthim diçka të fryrë tepër”; *qelbës, qelbak* “gjitari i egër që ha minj, pula dhe që lëshon një erë të keqe për t’u mbrojtur nga egërsirat e tjera” nga *qelb* “lëshoj erë të keqe, ndot ajrin”

**2.2.2. Fjalë të prejardhura mbiemra:** *barrsë* “që ka mbetur me barrë” nga *barrë* “ngarkesë që mbartet nga një kafshë a një njeri”; *shtegtar* “që shtegton nga një vend të një vend tjetër, udhëtar, endacak” nga *shteg* “udhë e vështirë dhe e panjohur për të gjetur diçka”; *tutkun* “i trashë nga mendja, që nuk është në gjendje t’i dalë zot vetes” nga *tutkë* “mendje, kokë” etj.

Në shembujt e sjellë më poshtë, nisemi nga fakti se fjalët që kanë të njëjtën rrënjë, si formë të brendshme kanë kuptimin leksikor të temës fjalëformuese, që në këtë rast është rrënja e fjalës.

### **2.2.3. Nga rrënja *larë* formohen:**

**a. mbiemrat** *laracik* “i larmë, me pika, pikalosh; zog laracik”; *laragan* “i larmë, laraman”, *larak* “i larmë”; *laran* “i larmë; kafshë me lara (viç, ka etj.); shalqin, misër me lara”; *laraquk* “që ka quka në fytyrë”; *larashan* “që është me lara, laraman”; *larc* “qimezi ose qimekuq me ndonjë larë të bardhë”; *i larmuar* “i zbukuruar me lara, lule”; *larun* “lara-lara” etj.

**b. foljet:** *laracit* “bëj lara-lara”, *laracoj* “e spërkat, e bëj lara-lara diçka”; *laramanoj* “bëj lara-lara”; *laravit* “bëj lara-lara”; *larëztoj* “zbukuroj me letra e vizatime”; *laroj* “bëj punëdore, qëndis” etj.

**c. emrat:** *laraç* “shalqi i larmë, me lara”; *laraman* “lloj gjarpri helmues me lara”; *laramane* “lloj rose e egër, me trup të vogël e me pendë të larmë”; *laraskë* “shpend i madh sa sorra me pendë të përziera të bardha dhe të zeza”, *laras* “lloj fajkoi me trup të larmë”; *laravi* “të qenit me dy faqe a me dy fytyra”; *lare* “dele e larme”; *larec* “zog bjeshke me pendla të



ndryshme (edhe si emërvend)”; *lareshë* “lopë lara-lara”; *larë* “emër lope me lara”; *larës* “pe, tojë prej fijesh shumëngjyrëshe”; *laricë* “lopë e larme”; *larick* “që ka dy fytyra”; *lariçkë* “femër që ndërron fytyrë, laramane”; *larikë* “lareshë”; *larishë* “dhi e larme, dagroshë”; *lark* “shenjë e parë e pjekjes së fikut”; *larmim* “zbukurim, hijeshim”; *laroç* “cjav, dhi me lara”; *laroji* “emër viçi ose kau me lara”; *larok* “qen i zi me pulla të bardha”; *larosh* “qen me lara; gjarpër”; *larujë* “groshë e larme; lopë e larme”; *larukë* “lareshë”; *larush* “ka me lara të zeza”; *larushk* “kulpër që s’i bien fletët në dimër dhe që përdoret për zbukurime”; *larushkë* “dhi që e ka trupin me një ngjyrë dhe këmbët me ngjyrë tjetër” etj.

**ç. ndajfoljet:** *larançe* “si laran” etj.

#### **2.2.4. Nga rrënja *lesh* formohen:**

**a. mbiemra:** *lashtak* “me qime të gjata, leshtor”; *leshatuk* “leshtor”; *leshtak* “që ka shumë push, që ka fiye të holla dhe të gjata”, *i leshtë* “i ngadalshëm, i pazhvilluar”; “; *i leshtuar* “që është lështuar, i kërleshur”; *i leshtur* “që i kanë dalë pendët”; *leshurak* “që ka shumë lesh, leshatuk”; *leshuran* “lesharuk, katalesh”; *leshuriq* “leshurak, katalesh” etj.

**b. emra:** *leshajkë* “dhi leshgjatë”; *leshan* “ka me qime të gjata, njeri leshurak, leshtor”; *leshatak* “cjav, dhi leshgjatë”; *leshëz* “thupërz e përshkuar me penj leshi që shërben për të pastruar fyellin nga brenda”; *leshje* <sub>I</sub> “lloj dardhe me push”, *leshje* <sub>II</sub> “copë e vogël lëkure delesh, që e përdor mullisi për të mbledhur miellin”; *leshka* “flokë, leshëra”; *leshnajë* “masë e madhe leshi, hapësirë me lesh”; *leshnik* “veshje popullore burrash e punuar me lesh deleje ose dhie”, *leshotë* “njeri që e kanë mbuluar leshrat (i paqethur), katalesh”; *leshterik* “algë”;

**c. folje:** *leshatohet* “bëhet leshtor, i rritet leshi”; *leshet* “fillojnë t’i dalin puplat; *leshtohet* “i ngrihen qimet përpjetë, kërleshet” etj.

#### **2.2.5. Nga rrënja *lule* formohen:**

**a. mbiemra:** *i lulëm* “që është me lule”; *i lulës* “i verdhë, i shndritshëm; lulës “në gjendje të zverdhur”; *i lulët* “që është me lule, prej lulesh”; *lulëzues* “që lulëzon”; *lulor* “që ka të bëjë me lulen”; *lulsan* “i verdhë, verdhacuk”; *i lulsavët* “i zverdhur”; *i lulsuar* “që është lulësuar”; “ *lulushan* “që është i zbukuruar me lule (veshjet, copat)” etj.

**b. emra:** *lulak* “kungull që ende s’i ka rënë lulja”; *lularashkë* “modhull”; *lule* “ *euf. lia*”; *lulës* “ai që e merr jetën gëzueshëm e plot besim, ndjellmirë”; *lulëzore* “bimë barishtore me gjethe të mëdha dhe lule të verdha”; *lulikë* “emër lope me balushë si lule në ballë”;

*lulishtar* “ai që punon në lulishte”; *lulishtari* “puna që bën lulishtari”; *lulnajë* “vend me bar e me shumë lule”; *luloji* “emër kau me një balushë si lule në ballë”; *lulosh* “cjav balash” etj.

**c. folje:** *lulëz* “çel, nxjerr lule”; *luloj* “çel lule; zbardhet floku”; *lulsav* “zverdh shumë, lulsoj”; *lulsohem* “zverdhem” etj.

**ç. ndajfolje:** *lulëz* “plot vezullim, plot pastërti” etj.

#### **2.2.6. Nga rrënja *lig* formohen:**

**a. mbiemra:** *i lig* “i keq, i dobët; *i lig* “*euf.* i një cilësie të keqe”; *ligaç* “i dobët nga trupi”; *i ligatur* “i dobësuar; i lagur, i qullur”; *i ligavtë* “që është ligavur”; *i ligavur* “që është ligavur”; *i ligësuar* “i dobësuar; i pakuar”; *ligështues* “që ligshton”; *i ligshtë* “i pafuqi, i dobët”; *ligtar* “i lig, i keq” etj.

**b. emra:** *ligajkë* “ligan”; *ligan* “dash, cjav etj. jo i majmë”; *ligavec* “kërmill, jargës”; *ligcinë* “sëmundje, dergjë, lëngatë”; *ligesë* “cen, mangësi morale”; *ligë* “gjendje e rëndë e me mundime; jargë”; *ligësi* “të qenët i lig; ndjenjë të përzieri si në të vjellë”; *ligështajkë* “ai që ligështohet, tutet, trembës”; *ligështan* “ai që ligështohet, tutet, trembës”; *ligështi* “të qenët i dobët, i vuajtur, brengë, e keqe”; *ligështinë* “punë e keqe, e fëlliqët”; *ligështujë* “vajzë a grua e ligshtë në trup, e lodhur dhe e dërrmuar; shpirtkeqe”; *të ligështit* “ligështi”; *të ligtë* “*euf.* sëmundje e tokës” etj.

**c. folje:** *lig* “e tret nga trupi dikë, e dobëson”; *ligat* “i sëmur bagëtitë me ligatë, i këlbaz”; *ligatet* “sëmuret nga ligata”; *ligav* “dobësoj shumë, lodh shumë”; *ligem* “dobësohem, tretim nga trupi”; “*ligësohem* “ligem, dobësohem, keqësohet, prishet”; *ligësoj* “pakësoj, mangoj”; *ligoj* “gaboj”;

**ç. ndajfolje:** *ligsht* “në gjendje të keqe shëndetësore; varfërisht” etj.

#### **2.2.7. Nga rrënja *sy* formohen:**

**a. folje:** *syj* “mësyj”; *syjoj* “ballafaqoj”; *sykav* “lyej sytë me tepri”; *syllit* “e shikoj dikë vëngër”; *synoj* “kam për qëllim të bëj diçka”; *syzohem* “takohem me dikë ballë për ballë”, *syzoj* “e nxjerr para syve, e ballafaqoj” etj.

**b. mbiemra:** *syjor* “që ka parë diçka me sy”; *syll* “i vëngër, syçakërr”; *sysk* “që ka rrathë të zinj rrotull syve”; *sytar* “shenjëtar, sydrejtë”;

**c. emra:** *sykan* “dash i bardhë me rrathë të zinj rrotull syve”; *sykë* “dele e bardhë me rrathë të zinj ose njolla të zeza në fytyrë”; *sykoi* “ka i sykëm”; *sylyke* “syze”; *synim* “ajo që i vëmë vetës si detyrë, si qëllim”; *syn* “lloj peshku”; *syprinë* “faqja e sipërme e diçkaje”; *syrëz*

“fluska të vogla si rreth, varg ose grumbull sumbullash që formohen në sipërfaqen e një lëngu”; *syze* “dy xhama të posaçëm që vihen para syve për të parë më mirë”; *syz* “syth”;

ç. ndajfolje: *symbyllas* “me sy të mbyllur ose të lidhur”; *synazi* “hapur, përballë”; *syrazi* “ballazi, hapur”;

### **2.2.8. Nga rrënja *shalë* formohen:**

**a. emra:** *shalamak* “ai që ecën ngadalë, i ngathët”; *shalanike* “pjesë e barrës që i ngarkohet kalit mbi shalë”; *shalëz* “vendi ku shtypen liri, këрпи etj.”; *shalës* “mëngër liri, melicë”; *shalim* “veprim sipas shaloj”; *shalok* “vegël si kompas me hapje të këmbëve dy metra që përdoret për të matur tokat”; *shaloke* “mbathje grash të gjata deri në gju”; *shalor* “ai që e nget mirë kalin”; *shalore* “dru me bigë për të vënë këmbën” etj.

**b. mbiemra:** *shalaman* “shalëgjatë”; *shalavrak* “shalëgjatë”; *shaluq* “shalaman” etj.;

**c. folje:** *shalit* “pëlkej (dorën, këmbën etj.)”; *shaloj* “i vë shalën kalit a mushkës” etj.

ç. ndajfolje: *shalas* “ mënyra se si veprohet në një lojë popullore”; *shaluar* “ndenjur me këmbët e varura anës shalës” etj.

### **2.2.9. Nga rrënja *dredh* formohen:**

**a. mbiemra:** *dredha-dredha* “që ka shumë kthesa, gjarpërues”; *dredhak* “i lakuar, i përdredhur”; *dredharak* “që ka dredha a kthesa, që i bën dredha fjalës); *dredhan* “dredharak”; *dredhor* “që ka shumë dredha” etj.

**b. emra:** *dredhajë* “vorbull ere”; *dredhajkë* “dhi me bri të thyer”; *dredhanik* “pite të mbështjella me djathë”; *dredhël* “bimë kacavirëse”; *dredhë* “kthesë harkore, gjarpërim”; *dredhës* “punëtor që punon në makinën e dredhjes së fillit”; *dredhës* “dre mashkull me brirë të degëzuar”; *dredhës* “rotullues”, *dredhi* “veprim tinëzar që bëhet për t’i bërë bisht diçkaje”; *dredhje* “veprim sipas *dredh/dridhem*”; *drethkë* “bimë barishtore që kacavaret pas një bime tjetër”; *dredhore* “familje bimësh që kacavaren pas drurëve”; *dredhule* “zë i dredhur” etj.

**c. folje:** *dredhoj* “lë rrugën që kam nisur”; *përdredh* etj.


ç. ndajfolje: *dredhas* “me trajtën e një dredhe” etj.

## **2.3. Forma e brendshme te homonimet**

Në gjuhësinë shqiptare çështja e homonimeve është trajtuar mjaft gjerë nga autorë të

ndryshëm<sup>77 78 79 80</sup> dhe janë dhënë përkufizime ndër fjalorë shpjegues, si: *Fjalët që ngjajnë në shqiptim, por ndryshojnë shumë nga kuptimi quhen homonime*<sup>81</sup>; *Fjalë që tingëllon njësoj me një tjetër, por nga kuptimi ndryshon prej saj (p.sh. verë<sub>I</sub> dhe verë<sub>II</sub>); secila nga njësitë e ndryshme gjuhësore që përputhen nga ana tingullore*<sup>82</sup>

Në kuadrin e temës sonë, analiza e homonimeve bëhet për nga motivimi i formës së brendshme të fjalës, që përmbahet në kuptimin e fjalës homonime parake, e cila përputhet plotësisht me të sipas veshjes së saj tingullore. J. Thomai shkruan se në çdo rast, kur duam të dallojmë homoniminë nga polisemia, do të bëjmë etimologji, qoftë për të zbuluar rrënjët e ndryshme të fjalëve të dikurshme, qoftë kuptimet fillestare a temat semantike prej nga kanë dalë homonimet<sup>83</sup>. Kur kuptimi i fundit i fjalës polisemike krijon shkëputje nga kuptimi a kuptimet e fjalës, atëherë krijohet një njësi leksikore e veçantë, pra homonim me prejardhje semantike. Këtu kemi të bëjmë me procesin e prejardhjes semantike nga polisemia në homonimi, i cili sjell kalimin nga rrafshi i brendshëm (struktura kuptimore e fjalës së parë, etimonit homonimik) në rrafshin e jashtëm, pra krijimin e një fjale të re homonimike, e cila ka si formë të brendshme (motivim) kuptimet ose një nga kuptimet e fjalës së parë homonimike, që shërbejnë si *temë themelore fillestare*. Ky proces, grafikisht mund të paraqitet kështu:



Këto quhen dhe *homonime semantike*, domethënë, fjalë me prejardhje të përbashkët, te të cilat këputja, thyerja e lidhjeve semantike midis kuptimeve, ndarja e boshtit semantik shkon aq larg, saqë shoqërohet edhe me vendosjen e veçorive të reja strukturore-gramatikore

<sup>77</sup> Thomai J., *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989.

<sup>78</sup> Lloshi Xh., *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve, I, Tiranë, 1972.

<sup>79</sup> Kostallari A., *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972.

<sup>80</sup> Kryeziu B. & Jashari A., *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008.

<sup>81</sup> *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.

<sup>82</sup> *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.

<sup>83</sup> Thomai J., *Prejardhja ...vep. cit., f. 172.*

e fjalëformuese<sup>84</sup>. Për shembull, *fletë*<sub>I</sub> “gjethe”, *fletë*<sub>II</sub> “krah, flatër”, *fletë*<sub>III</sub> “një fije letër”, por kjo e fundit shërben si temë fjalëformuese për një sërë fjalësh të reja, si: *fletore*, *fletushkë*, *shfletoj*, *i shfletuar* etj., aftësi që nuk e kanë dy homonimet e para.

Homonimet semantike, përftesa të shpërbërjes së polisemisë, krijohen mbi bazën e tropeve të ndryshme gjuhësore, si metafora, metonimia, sinekdoka etj., mund të konkretizohen në analizën e shembujve të mëposhtëm.

**áht,~i**<sub>I</sub> “psherëtimë, rënkim, mallkim”; - **áht,~i**<sub>II</sub> “afsh. *ahti i detit*”.

**akrép,~i**<sub>I</sub> “kafshë e vogël helmuese; sfurk; cukth; përçollak; grepsh; shkrap. *helmi i akrepit. e pickoi akrepi*”; - **akrép,~i**<sub>II</sub> “secila nga shigjetëzat e orës ose e aparateve matëse; shigjetëz, gjilpërë. *akrepat e orës. akrepi i vogël (i madh)*”.

**ám/ë, -a**<sub>I</sub> “nënë”; - **ám/ë, -a**<sub>II</sub> “vendi ku nis një rrjedhë uji, burim. *ama e lumit. rrjedh nga ama*”; - **ám/ë, -a**<sub>III</sub> “1. erë tjetër e lehtë që merr një ushqim; kundërmim, amëz. *ama e luleve. amë e këndshme*. 2. afshi i tokës, i zjarrit etj.”; - **ám/ë, -a**<sub>IV</sub> “kafshë mëmë; mbretëresha e bletës. *ama e bletës*”.

**án,~i**<sub>I</sub> “organ i femrës ku zihet e zhvillohet pjella; mitër, shtrat. *ani i fëmijës. i ra ani*”; - **án,~i**<sub>II</sub> “kyçi i eshtrave. *ani i dorës (i këmbës)*”.

**án/ë,~a**<sub>I</sub> “1. pjesa e diçkaje larg mesit të tij, skaj; krah; drejtim. *ana e djathtë (e majtë). anët e lakrorit. ana e mushkës*”; - **án/ë,~a**<sub>II</sub> “fill mëndafshi a pambuku që përdoret në endje zakonisht për pjesët anësore të pëlhurave dhe për vijat e zbukurimeve. *anë e bardhë (e kuqe). anë mëndafshi*” (të dy homonimet formohen mbi bazën e lidhjes metonimike).

**árrëz,~a**<sub>I</sub> “1. rruaza e parë e qafës, ngjitur me kokën. *arrëz e qafës. thefsh arrëzën! mallk*. 2. fikthi i fytit, arçi. *arrëz e fytit (e gushës)*”; - **árrëz,~a**<sub>II</sub> “arrishtë, pyll me arra”; - **árrëz,~a**<sub>III</sub> “barishte e fushave bregdetare, me gjethe si të tërfilit e të dendura”(me burim fillestar nga arrëz “arrë e vogël”)<sup>85</sup>.

**bál/ë,~a**<sub>I</sub> “pullë e bardhë në kokë a në trup të kafshëve, balishë, baliskë; kafshë me pulla të tilla”; - **bál/ë,~a**<sub>II</sub> “*zool.* baldosë, dosëbalë, mjedull, kafshë gjitare mishngrënëse, me trup të vogël e me turi të zgjatur, me qime të murrme në bark e më të çelura në kurriz” (vihet re menjëherë që këtu kemi ngjashmëri në ngjyrë).

---

<sup>84</sup> Kostallari A., *Parimet ...vep. cit.*, f. 52.

<sup>85</sup> Thomai J., *Prejardhja...*, vep. cit. f. 185.

**báll/ë,~i I** “1. pjesa e fytyrës së njeriut midis syve dhe flokëve; pjesa e sipërme e turirit të shtazëve. *Ballë i lartë (i gjerë, i ngushtë). Ballë i dalë (i futur). Me ballë të ngrysur (të vrenjtur). Shtegu (mesi) i ballit. Lulja e ballit. Damari (nervi) i ballit.* 2. pjesa e përparme e kryesore e një ndërtese, e një galerie, e një sendi etj.; pjesa e fillimit, kreu, radhët e para; vendi më i rëndësishëm. *Balli i samarit (i djepit). Balli i tunelit (i pusit)*”; - **báll/ë, ~i II** “krehër pushke me pesë a gjashtë fishekë. *Tre ballë fishekë*”. (si temë semantike, pra formë e brendshme e homonimit të dytë ka shërbyer kuptimi 2 i homonimit të parë “diçka e rëndësishme”, por nuk kanë lidhje semantike me ballë III “njësi për të matur shkallën ose forcën e tërmetit: tërmet me shtatë ballë”, që është formuar me ngushtim kuptimi).

**bár,~i I** “bimë me kërcell të hollë që nuk drunjëzohet, me gjethe të gjata e të blerta, që shërben kryesisht si ushqim për kafshët; bimë barishtore. *Bar i njomë (i thatë). Bar i helmët (i kripur)*”; - **bár,~i II** “lëndë e përgatitur për parandalimin ose për mjekimin e sëmundjeve a të plagëve, ilaç. *Bar qetësues. Pi barnat. 2. fig. mjet a mënyrë për të dalë nga një e keqe, për të zbutur hidhërimin etj., rrugëdalje. Ia gjeti barin*”. (të cilat nuk kanë lidhje etimologjike me dy njësitë e tjera homonimike); **bár,~i III** “lokal i vogël, ku pinë zakonisht më këmbë. *Bar veror*” dhe **bár,~i IV** “njësi e matjes së shtypjes atmosferike” (me ngushtim kuptimi).

**bathór/e,~ja I** “1. tokë e mbjellë më bathë, bathishtë. 2. kërcell i thatë i bimës së bathës, i bimës së pambukut etj. *Bathore pambuku. Djeg bathoret.* 3. fasule kokërrmadhe”- **bathór/e,~ja II** *bot*. “presh i egër, badër; shpatore. *Kokat e bathoreve.* (që lidhet me kuptimin 3 të homonimit të parë mbi bazën e ngjashmërisë (metaforës), përmes procesit të ngushtimit të kuptimit).

**bisbíq,-i I** “kulaç me miell misri, me qumësht dhe gjalpë”; - **bisbíq,-i II** “dele ose dash me trup të imët e të dobët. (sipas elementit semantik “diçka e vogël: kulaçi-delja”.

**bót/ë,~a I** “rruzulli i Tokës; dheu, gjithçka që është në të; edhe *sh.* trup qiellor, planet. *Botët e gjithësisë. Lëmshi i botës. Harta e botës. Shtetet e botës. Udhëtim rreth botës*”; - **bót/ë,~a II** “baltë e përhime në të bardhë; deltinë; baltë, dhé. *Botë e bardhë (e kuqe)*”.

**bréng/ë,~a I** “1. pjesë e ënjtur në trup të njeriut a të kafshës ose në trup të drurit. 2. bullungë; shenjë plage; xhungë, gungë, bungë, brokë, mëllë”; - **bréng/ë,~a II** “gjendje e rëndë shpirtërore, hidhërim; trishtim i thellë; merak i madh, peng, keqardhje, pikëllim. *Jetë me*

*brenga. Pa halle e pa brenga. Ka një brengë*” (ka si temë semantike kuptimin e dytë të homonimit brengë<sub>I</sub>, me anë të metonimisë).

**brét/k,~ku**<sub>I</sub> *zool.* “mashkulli i bretkosës; zhaban”; - **brétk,~u**<sub>II</sub> *anat.* “kryqet, kërbishtja. *I ra bretku. Ngre bretkun*” (këtu lidhja është për nga ngjashmëria në formë, metaforë).

**brók/ë,~a**<sub>I</sub> “enë druri, qelqi etj., me grykë të gjerë e me një vesh, që përdoret për ujë, për verë; kanë, poç, kabash, çini etj. *Piu me brokë.*; - **brók/ë,~a**<sub>II</sub> “masë drithi prej druri, që nxë rreth njëzet e pesë kilogramë, brokatore, buçuk, mashtër, sheke, shinik. *Një brokë misër (grurë). E ka kokën sa një brokë.* (ngushtim kuptimi me anë të metonimisë).

**búb/ë,~a**<sub>I</sub> “1. vemje e rritur, krimbalesh. 2. rre, glistër. *Bar bubash. Ka buba.* 3. rrëshqanor që të ha (gjarpër, zhapi etj.). 4. morr i vogël. 5. *krahin.* pushi i një rrobe të leshtë. *Buba e shajakut (e velenxës)*; - **búb/ë,~a**<sub>II</sub> *mit.* “qenie fantastike, që përfytyrohej si përbindësh a si gjarpër i madh; gogol, vovë. *E fryftë buba! mallk.*”(nga struktura kuptimore e **búb/ë,~a**<sub>I</sub> është marrë kuptimi i tretë, që me anë të sinekdokës ka shërbyer si formë e brendshme për **búb/ë,~a**<sub>II</sub>).

**búrth,~i**<sub>I</sub> *bot.* “barishte me kërcell të shkurtër, me gjethe si zemër e me lule të trëndafilta; ciklamin i egër”; - **búrth,~i**<sub>II</sub> *veter.* “sëmundje e njëthundrakëve, që shfaqet në qiellzën e gojës me filluska të mbushura me gjak. *I ra burthi*” (lëvizje kuptimore mbi bazën e metonimisë).

**çák/ë,~a**<sub>I</sub> “trastë e vogël prej pëlhure të hollë ose prej leshi; qese. *Cakë me miell. Caka e bukës*”; - **çak/ë,~a**<sub>II</sub> “pjesë e caktuar e një pagese, kuotë. *Caka e kamatës. Derdhnin cakat*” (mbi bazën e sinekdotës).

**cép,~i**<sub>I</sub> “1. pjesa e fundit e këndit të një sendi, maja e këndit ose e vendit ku bashkohen dy vijat a dy faqet e brendshme të një sendi; skaj, kënd; qoshe; pjesa e zgjatur dhe e mprehtë e diçkaje, maja; pjesa e ngushtë, rrip i ngushtë në skaj të një sendi. *Cep i ngushtë. Cep i tryezës. Cipi i dhomës. Cepat e shamisë. Cipi i jorganit. Cipi i jakës. Cepat e shallit.* 2. vendi i largët ose i mënjanuar dhe jo shumë i rrahur. *Cipi i largët. Cep kufitar. Cipi më verior (më jugor).* 3. *fig.* pjesë anësore e diçkaje, skaj, skutë. *Në një cep të mendjes. Në një cep të zemrës*”; - **cép,~i**<sub>II</sub> “vesh i vogël rrushi, bistak. *Këput një cep*” (përbërësi “pjesa e zgjatur e diçkaje” e kuptimit të parë të **cép,~i**<sub>I</sub> ka shërbyer si temë semantike për **cép,~i**<sub>II</sub>).

**címb/ël,~la** **I** “1. copë e vogël dhe e hollë e një sendi, cifël, çikë, grimcë. *Bëhet cimbla*. 2. bisku i hollë i një degëze, që sapo ka filluar të rritet”; - **címb/ël,~la** **II** *bot.* “barishte e brigjeve shkëmbore, me gjethe të vogla e të mbledhura tufë, që hahet e zier si sallatë. (është formuar me ngushtim kuptimi, mbi bazën e metaforës, ndoshta nga trajta e gjetheve të holla si cifla);

**cím/ë,~a** **I** *det.* “litar i trashë për të lidhur anijen në breg; litar. *Lidh me cima. Tërheq cima*”; - **cím/ë,~a** **II** *bot.* “tufë lulësh nga e njëjta nyjë e kërcellit të bimës” (megjithëse janë terma nga fusha të ndryshme, kanë të përbashkët ngjashmërinë në formë dhe mund të jenë rrjedhoja të njëra-tjetrës).

**cingërim/ë,~a** **I** “1. të ftohtë i madh e i thatë, acar; ngrica e dimrit. *Cingërimë e madhe. Cingërima e dimrit. Ditë me cingërimë. Në mes të cingërimës*. 2. *vet. sh.* Dridhje e trupit nga të ftohtët, mornica. *Më shkojnë cingërima*”; - **cingërim/ë,~a** **II** “1. zë i hollë, i zgjatur dhe si i çjerrë; të qarët e një kafshe, kuitje, pingërimë, cijatje. *Cingërima e qenit. Cingërima e gjinkallave*. 2. kumbim i hollë e i zgjatur në veshë, tringëllimë” (të dyja lidhen me një komponente semantike “që të pret, therëse”).

**cípu/ll,~lli** **I** *etnogr.* “vel i hollë që i hidhej nuses në kokë; napë”; - **cípu/ll,~lli** **II** “fik që bën kokrra gjatoshe cipëholla në ngjyrë të kuqërreme; patëllxhanës. (me element kuptimor të përbashkët “i hollë”).

**çáfk/ë,~a** **I** “kaçul pendësh, çallmë në majë të kokës së pulave ose disa zogjve”; - **çáfk/ë,~a** **II** “shpend uji me kaçul të zi, me qafë e këmbë të gjata, sqep të hollë; gatë, çajme, agjëronjë. *Çafka e bardhë. Çafkë deti.* (i cili quhet kështu sipas çafkës që ka në kokë, mbi bazën e metaforës).

**dóç/e,~ja** **I** “koçan misri ose copë e vogël druri e rumbullakosur, afërsisht sa grushti, që përdoret në një lojë fëmijësh; lojë me disa veta, njëri prej të cilëve përpigjet të hedhë një copë në një gropë që ruhet me shkopinj nga lojtarët e tjerë; topgropti. *Doçja luhet me shkopinj të gjatë*”; - **dóç/e,~ja** **II** “shtambë e vogël, zakonisht me një vesh. *Pinë me doçe*” (sipas formës e madhësisë).

**legén,~i** **I** “1. enë e madhe, e rumbullakët dhe mjaft e thellë, që shërben për të larë. *Legen alumini (bakri, plastike). Laj duart (fytyrën, këmbët, fëmijën, rrobat) në legen*. 2. *fig. bised., mospërf.* njeri, të cilit i ka dalë boja fare, që është bërë qesharak dhe e shpërfillin të gjithë. *Është bërë legen ai*. 3. pjesa e gjerë e pak e përkulur e plugut mbi plorin, që shërben



për të kthyer plisat. *Legeni i plugut*"; - **legén,~i** I anat. "pjesë e skeletit të njeriut, e cila përbëhet nga brezi i harkuar i eshtrave të kryqeve e nga kërdhokullat; brezi i harkuar i eshtrave të kafshëve gjitarë në pjesën e prapme të trupit. *Eshtrat e legenit*" (me ngushtim kuptimi mbi bazën e ngjashmërisë për nga forma dhe funksioni).

**lér/ë,~a** I "1. baltë e hollë, llucë; vend a gropë me baltë të hollë e me ujë të ndenjtur; moçalishte; pellig me ujë kur shkrin bora në kullotat malore; gropë e madhe me ujë ku pinë bagëtitë në kohën e thatësirës. *Lerat e kullotave. I çoi bagëtitë në lerë. Gropë me lerë. U bë lerë. Ngeci në lerë. I futi buajt në lerë.* 2. zhul nga të palarat në trup a në rroba; llum, zdralë; llum vaji; papastërti të ndryshme në diçka. *Lera e kokës (e flokëve, e trupit). Lera e rrobave (e jakës). Ka zënë lerë. Lera e pushkës. Pastroi lerën e tytës.* 3. fig. diçka e turpshme dhe e fëlliqur; njollë turpi; fjalë të ndyra e të turpshme. *I vuri lerë dikujt e njollosi, e turpëroi. Nxori lerë nga goja.* 4. përd. ndajf. tërë, krejt (kur fëlliqet shumë dikush a diçka). *U bë lerë me gjak*"; - **lér/ë,~a** II "vend i pjerrët dhe i sheshtë, i mbuluar me gurë të rënë nga mali; pjesë zalli a përrua me shumë gurë (formuar mbi bazën e metonimisë). **skllóp,~i** I "baltë e përzier me borë të shkrirë; llum. *Rrugë tërë skllop. E bëri skllop*"; - **skllóp,~i** II zool. "shpend uji i murrmë, i madh sa një pulë e me sqep të gjatë" (me ngushtim kuptimi mbi bazën e ngjashmërisë në gjyrë) etj.

Nga shembujt e sjellë, del se shumica e homonimeve që vijnë nga njëri-tjetri si pasojë e shpërbërjes së polisemisë janë emra, me përjashtim të ndonjë foljeje, si:

**cërit** I "nxeh a djeg vajin, tret gjalpin a dhjamin ose skuq diçka në tigan; shkrij. *Cërit vajin. Cërit gjalpin*"; - **cërit** II "1. thumboj; shpoj, nguc, ngas. *Cërit mushkën (gomarin).* 2. edhe jokal. *Vet. veta III fig.* e pikëlloj dikë, e përvëloj; më djeg, më përvëlon, më ther. *I cërit zemrën. I cërit zemra (në zemër).* (cërit I është formuar mbi bazën e onomatopesë (cër-cër), kurse kuptimi i parë i cërit II ka si temë semantike kuptimin e homonimit të parë).

#### **2.4. Forma e brendshme si motivim semantik te emrat e përveçëm**

E. Çabej ka vënë në dukje se "si nga krahasimi me bimë, ashtu dhe me anë të një krahasimi me shtazë janë formuar jo vetëm shumë emra vetjakë individësh e familjesh, po

edhe mjaft apelativa<sup>86</sup>. Ndërsa P. Daka, arrin në përfundimin se “Populli ynë, si gjithë popujt e tjerë, ka krijuar dhe krijon gjithnjë me brumë të shqipes emra njerëzish, duke shfrytëzuar në mënyrë origjinale sfera të ndryshme të jetës materiale e shpirtërore të botës shqiptare, të cilat kanë qenë dhe janë burim i pashtershëm për pasurimin e emrave vetjakë kombëtarë<sup>87</sup>. Ndërkaq, me të drejtë theskohet se “Emrat e përveçëm, si rregull, zhvishen nga kuptimi i tyre që shpreh emri i përgjithshëm apo fjala nga vijnë...prandaj emrat nuk përdoren në kuptimin gjuhësor që ata kanë fillimisht”<sup>88</sup>. Duke u nisur nga materiali i vjelë për emrat e përveçëm, mund të bëjmë një klasifikim të tyre mbi bazën e fushave leksikore, si më poshtë:

**2.4.1. Emra të përveçëm që vijnë nga emra abstraktë:** *Bashkim, Begator, Behar, Besa, Burim, Dije, Besnik, Betim, Bujar, Bukuri, Çlirim, Ardhmri, Dashnor, Dashuri, Dituri, Bres, Festim, Fitim, Flamur, Freskim, Gëzim, Guxim, Kujtim, Kushtim, Kushtrim, Lavdërim, Lavdi, Liri, Lumturi, Mbresa, Mira, Nderim, Ngadhnjim, Përparim, Jeta* etj.

**2.4.2. Emra të përveçëm që vijnë nga emërtime të botës bimore:** *Begonja, Boronisa, Burbuqe, Dafina, Jargavan, Karafil, Lule, Bredhi, Fidan, Filize, Pjeshka, Qershiza* etj.

**2.4.3. Emra të përveçëm me bazë emërtime të botës shtazore:** *Bilbil, Bubreza, Dallëndyshe, Flutura, Gugushe, Gjeraqinë, Kumrije, Lauresha, Mjelma, Pelikan, Pëllumb, Petrit* etj.

**2.4.4. Emra të përveçëm të formuar përmes prejardhjes:** *Bardhok, Detar, Lavdosh, Luftim, Lulzim, Mbarësim, Ndriçim* etj.

**2.4.5. Emra të përveçëm që vijnë nga emërtime të natyrës në përgjithësi:** *Agim, Bjeshka, Blerim, Blerina, Blerta, Bletar, Bora, Borana, Drita, Diella, Argjend, Ar, Hëna, Mjalta, Mjedis* etj.

**2.4.6. Antroponime nga emra të përveçëm, si male, fusha, lumenj etj.:** *Morava, Morina, Gramoz, Tomorr, Vjosa, Orenja, Prishtina, Rozafa, Kelmend, Ivan, Jon, Adriatik, Korab, Ksamil, Labinot* etj.

---

<sup>86</sup> Çabej E., *Studime ...I*, vep. cit., f. 60.

<sup>87</sup> Daka P., *Mbi disa dukuri të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, III, Tiranë, 1969, f. 278.

<sup>88</sup> Zoto V., *Fjalor emrash*. Desara. Tiranë, 2005, f. 4.

**2.4.7. Emra të përveçëm kompozita (që përbëjnë pjesën më të madhe) të formuar mbi bazën e krahasimit të një cilësie të dallueshme dhe të dëshirueshme të referentit:**

*Aibardh, Aidiell, Aidrin, Ajobora, Ajodita, Ajodrita, Ajolinda, Ajovesa, Ajoylla, Ajozana, Albadrita, Albadita, Albamira, Albavesa, Albavjosa, Amvjosa, Arbdiell, Arbdri, Arbdrita, Arbjeta, Bludrita, Borarta, Bordiell, Bordita, Bormira, Borvesa, Arsjell, Bardh dita, Bardh drin, Bardh mira, Besbardha, Besdita, Besfort, Besgur, Besjeta, Beslind, Besmir, Bresbardh, Bresbor, Bresdet, Bresdrin, Bresdrit, Breslind, Bresmir, Bresnur, Brevjen, Brezart, Briarta, Bridet, Bridiell, Bridrita, Biyll, Brizan, Çeldiell, Çeldita, Çeljeta, Dashamir, Dashatare, Deldiell, Deldita, Detmir, Diellart, Diellbardh, Dielldit, Diellmir, Diellndrit, Dita, Ditarta, Ditbardha, Ditdrita, Ditmir, Dodiell, Dodit, Dodrit, Dolidiell, Dorarta, Dorëzonja, Dormira, Dorzana, Dritarta, Dritmadh, Drityll, Ejabora, Ejadita, Ejazana, Ejamal, Emirbesa, Emirjeta, Emirjona, Emirzana, Ëndërrjeta, Erbardha, Erbjeshka, Erblin, Erbora, Erdiell, Erdet, Erlehta, Ermira, Ermjalt, Ermoza, Fillbor, Filldit, Fillmir, Gazmir, Gazmend, Gazlind, Farëmir, Ftabardh, Fatdit, Fatdrit, Fatlind, Fatlum, Fatmadh, Fatmbar, Fatmir, Fatmjel, Fatvjen, Fatzana, Fisbor, Fisbardh, Fisdet, Fisdiell, Fislart, Fislind, Fislir, Fismal, Fismbar, Fismir, Fismjal, Fisnik, Fistrim, Jetarta, Jetbardh, Jetdet, Jetdiell, Jetdit, Jetdrin, Jetdrit, Jetëmbël, Jetgjat, Jetjon, Jetjona, Jetlind, Jetlira, Jetlis, Jetlum, Jetmal, Jetmir, Jetndri, Jetnis, Jetvjen, Majlinda, Malbardha, Maldie, Maldita, Marsdiell, Marsdita, Marsivjen, Marsindrin, Mbidiell, Mesart, Mesdiell, Mesdit, Mirdash, Mirndrin, Mirprit, Mirsjell, Ndeshmira, Ndriart, Ndribesa, Ndrinur, Nisjeta, Nurbardhë, Nurdita, Nusmira, Rezart etj.*

Në botëkuptimin e një mjedisi patriarkal emri identifikohet krejtësisht me njeriun, me pamjen fizike të tij, duke besuar se emri është pjesë përbërëse e njeriut si pjesë e trupit të tij. Në frazeologjinë popullore emri shpeshherë tregon tërësinë e tipareve të njeriut, karakterin e punën e tij, qoftë në kuptimin pozitiv, qoftë në kuptimin negativ: *i ka dalë emni; ia la namën/ famën emnit të vet; mos iu përmend të emni kurrë; i kjoftë i zi emni etj*<sup>89</sup>.

Në përfundim të këtij sythi, sa për ta përshenjor çështjen, ia vlen të përmenden dhe emërvendet të formuar mbi bazën e emrave të përgjithshëm, si: *Shpat* i Elbasanit- nga *shpat* “faqe e pjerrët e një mali a e një kodre, pyll në mal”<sup>90</sup>; *Therapel*-emri i një fshati në Skrapar

---

<sup>89</sup> Krasniqi M., *Gjurmë e gjurmime*, Tiranë, 1982, f. 101-102.

<sup>90</sup> Çabej E., *Studime ...VII*, vep. cit, f. 68.

nga *therepelë*-emër bime; *Lëkurëz* (Sarandë) nga “lëkurë”; *Shkozë* nga “shkozë”; *Drizë* “vend me shkurre”; *Laç* “vend me ujë”; *Lajthizë* “vend me lajthi” etj.

## **2.5. Forma e brendshme te emrat-terma që përdoren vetëm në numrin shumës**

Gjatë hulumtimit të materialeve leksikore na ra në sy edhe një dukuri tjetër, që mendojmë se është me interes për formën e brendshme, pra motivimin e formimit të emrave-terma nga fusha e botanikës dhe e biologjisë, të përdorur zakonisht vetëm në numrin shumës.

**2.5.1. Nga fusha e botanikës:** *bishtajoret* “familje bimësh që e kanë frutin bishtajë”; *petalendarë* “bimë që i kanë petlat e ndara”; *petalengjitur* “bimë që i kanë petalet e ngjitura”; *umbrellorët* “familja e bimëve që e kanë mbulesën në formë umbrelle”; *njëthelbore/dythelbore* “klasë e bimëve që kanë një/dy gjethëz embrionale”; *trëndafilorët* “familje bimësh që kanë lule të rregullt me pesë petale si trëndafili”; *fluturorët* “bimë barishtore e familjes bishtajore ku kurora ngjan me një flutur”; *kryqore* “bimë barishtore që i kanë petlat dhe nënpetlat në formë kryqi”; *buzore* “bimë barishtore me petale të kthyera nga poshtë (në formë buze)”; *papetalorët* “nënklasë e bimëve dythelbore te të cilat mungojnë petlat (kurora)”; *pendoret* “bimë që kanë gjethë me llapë të ndarë (me nerva në formë pende)”; *halorët* “drurë si bredhi, pisha etj., që i kanë gjethet të holla e të gjata si gjilpëra e përherë të blerta”.

**2.5.2. Nga fusha e biologjisë:** *lëkurëtrashët* “kandrra që e kanë trupin të fortë dhe lëkurën të fortë”; *kërcorët* “klasa e peshqve që e kanë skeletin kërcor”; *kockorët* “klasa e peshqve që e kanë skeletin kockor”; *gjakftohët/gjakngrohtët* “kafshë që e ndryshojnë temperaturën e trupit në varësi të mjedisit”; *këmbënyjëtuarit* “insekte që i kanë këmbët të nyjëzuara (me nyje)”; *butakët* “tip molusqesh që e kanë trupin të butë”; *unazorët* “tip krimbash që e kanë trupin me unaza”; *trupshypurit* “krimba që e kanë trupin të shtypur”; *rrumbullakorët* “tip krimbash që e kanë trupin e rrumbullakët”; *barngrënësit* “kafshë që ushqehen me bimë, me bar”; *mishngrënësit* “kafshë që ushqehen me mish”; *gjithçkangrënësit* “gjallesa që hanë gjithçka (jetushqyes dhe vetushqyese)”; *qerpikorët* “tipi i protozoarëve që e kryejnë lëvizjen me anë të qerpikëve”; *kamxhikorët* “tipi i protozoarëve që e kryejnë lëvizjen me anë të kamxhikut”; *ripërtypës* “gjitarë bimëngrënës që e përtypin disa herë ushqimin”; *zhabinorët* “familje e bimëve barishtore që kanë shumë thekë dhe pistila si të zhabinës”; *dykapakorë* “klasë kafshësh që bën pjesë te butakët, të cilët kanë dy kapakë”; *shumëkëmbësh*

“insekt që ka në trupin e tij një numër shumë të madh këmbësh”; *dyflatorë* “insekte të cilat kanë dy flatra”; *gjysmëflatrafortë* “rend insektesh që i ka flatrat e përparme në bazë të kalcifikuara, kurse majat i ka cipore”; *flatradrejtët* “rend insektesh që i kanë flatrat e përparme gjysmë të forta (që u qëndrojnë drejt)”; *flatralëkurorë* “rend insektesh që i kanë flatrat e përparme lëkurorë”; *ditëshkurtër* “rend insektesh të cilat faza e rritur nuk zgjat më shumë se disa orë”; *këmbërremët* “protozoarë të cilët e kryejnë lëvizjen me anë të zgjatimeve (jo me këmbë të mirëfillta)”; *jorruazorët* “kafshë të cilave u mungojnë rruazat (vertebrat); *plaçentarët* “gjitare që e zhvillojnë embrionin në një plaçentë (qeskë)” etj.

## **2.6. Nofkat si shprehje e formës së brendshme**

Nofkat janë emra familjarë ose humoristikë që u vihen personave ose dhe sendeve në vend të emrave të tyre të vërtetë. Nofkat mund të jenë *hipokoristike* (nofka përkëdhelie për të shprehur afërsinë ose lidhjet me personin që po cilësojmë). Nofkat e ashtuquajtura zvogëluese përdoren edhe këto për të shprehur afërsi apo familjaritet. Një pjesë e madhe e nofkave janë fyese dhe ofenduese. Nofkat nuk zgjidhen, ato u adresohen personave pa miratimin e tyre dhe nuk përdoren gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë si emër përcaktues për folësin. Si koncept, nofkat duhet të dallohen nga pseudonimet apo titujt.

Përdorimi i nofkave është një dukuri e hershme e shumë kulturave evropiane dhe më gjerë. Te popujt vikingë pjesa më e madhe e njerëzve kishin emra të dytë, që përdreshin bashkë ose në vend të emrave të vendosur nga familja. Në disa rrethana, vënia e një nofke fitonte një status të veçantë, duke krijuar një lidhje të ngushtë midis krijuesit të nofkës dhe personit të cilit ky emërtim i drejtohej, deri në atë masë sa nofkat viheshin gjatë një ceremonie zyrtare duke shkëmbyer edhe dhurata me këtë rast. Skllevërit përdornin nofka për njëri-tjetrin në mënyrë që pronarët të mos kishin mundësi t'i identifikonin. Në Indonezi nofkat përdoren në shenjë mirësjellje dhe respekti, veçanërisht kur emri i vërtetë është më i gjatë se dy rrokje. Në shoqërinë indiane zakonisht njerëzit kanë të paktën një nofkë, të cilat i quajnë emra afërsie, përkëdhelie dhe që janë krejt të dallueshme nga emrat e tyre të vërtetë. Në Australi burrave shpesh u vihen emra ironikë, të cilët nënkuptojnë të kundërtën e cilësive që ata mbartin në të vërtetë, p.sh., një burrë flokëkuq thirret qëllimisht *flokëbluja* apo *flokëbojëqielli* dhe një njeri shtatlartë quhet *i shkurtri*. Në Angli nofkat tradicionalisht

shoqërohen me mbiemrin e personit. Në kulturën kineze nofkat përdoren shpesh brenda bashkësisë midis të afërmeve, miqve apo fqinjëve.

Sipas FGJSSH (1980) “nofka është emër i dytë që i vihen dikujt për tallje, për shaka apo përkëdheli duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar dallues”, ndërsa sipas Q. Muratit “Turlitava gjuhësore ballkanike përmes ofiqeve dhe nofkave na flet qartë për psikologjinë dhe etnografinë e të folurit të popujve përkatës. Si shprehje e një arkaizmi provincial ata kanë krijuar një mal nofkash në gjuhët e tyre”<sup>91</sup>.

Nofkat apo llagapet janë krijime të formësuara gjuhësisht në çastin e ligjërimit, kryesisht arkaizma provinciale dhe rajonale, mbi bazën e perceptimeve individuale apo grupe të cilësive të dallueshme të individëve, tipare të cilat me pas bëhen përcaktuese, diferencuese dhe identifikuese fillimisht për individin, i cili “pagëzohet” me këtë nofkë e, më pas, duke u bërë emra përgjithësues për grupe apo bashkësi individësh me të njëjtën përkatësi shoqërore apo territoriale. Përzgjedhje leksikore e këtyre mjeteve leksikore është plotësisht e motivueshme dhe e kushtëzuar kryesisht nga rrethana apo faktorë etnogjuhësorë, rajonalë, fetarë, shoqërorë etj. Gjeografia e shpërndarjes dhe e përdorimit të mjeteve të tilla gjuhësore është e njëtrajtshme për të gjitha hapësirat shqiptare dhe dukuria është pothuajse e barasvlershme në të dyja dialektet dhe në tërësinë e korpusit të të folmeve. Uniformiteti i vërejtur mund të përbëjë argument mbështetës për idenë se prirja për të etiketuar apo karakterizuar individët mbi bazën e një stereotipie të caktuar është produkt i mendësisë dhe psikologjisë popullore. Tipizimi i individëve është i qëllimshëm: herë ka karakter të mirëfilltë identifikimi, herë zgjidhet qëllimisht ngjyrimi emocionues keqësues për të shprehur përbuzjen, ironinë, përçmimin, nënshtrimin, përjashtimin etj., e herë nofkat janë përkëdhelëse, mikluese, zvogëluese.

Përpos të gjithave, trajtat e pafundme dhe reflektimet e ndryshme, pasojë e qasjeve ndaj realitetit kanë bërë “pronë” dhe “pasuri” të leksikut popullor një mori përzgjedhjesh të tilla. Tipologjia e përzgjedhjeve leksikore është shumë e ndryshme, por ndër gjedhet kuptimore më të spikatura mund të përmendim:

**2.6.1. Nofka që shprehin tipare dalluese identifikuese të përmasave apo ndërtimit të trupit të njeriut:** *xhuxh* (i shkurtër), *zdap* (i hollë dhe i gjatë), *lloko* (me trup të madh dhe

---

<sup>91</sup> Murati Q., *Hetime dhe vjelje për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2012, f. 351.

të shëndoshë), *këmbëgjati* (që i ka këmbët e gjata), *goxhomani* (i bëshëm, trupmadh), *kamburi* (kurrizdalë), *kyçyku* ( i vogël, me shtat të shkurtër), *olli* ( i hollë), *shishmani* (i shëndoshë), *çyreku* ( i shëndoshë dhe i shkurtër), *vogli* ( i shkurtër, me trup të vogël), *gjatovina* (me trup të gjatë), *gjyryku* ( njeri shumë i shëndoshë), *shulliçi* (i gjatë dhe i hollë), *gjato* ( i hollë dhe i gjatë) .

Brenda të njëjtit klasifikim të shenjimit të tipareve të jashtme trupore, por bazuar në tjetër tipologji emërtimi, përfshihen nofkat e ndërtuara sipas transformimeve metaforike me bazë treguesin e ngjashmërisë midis tiparit dominues të referentit që do të shënohet dhe një realieje (zakonisht jofrymor) që e mbart këtë karakteristikë identifikuese. Sipas këtij modeli tipari dallues identifikues për trupin e vogël, të pakët dhe të shkurtër është shprehur përmes metaforave *karanxha* (milingonë), *buba* (krimb mëndafshi, morr i vogël), *kukumi* (vorbë me bark), *gazheli* (gomar plak), e kështu me radhë *çyreku*, *brumbulli*, *miza/mico*, *pleshti*, *qofte*, *pluskë*, *qypi*, *foka*, *cmingo*, *buti*, *duckë*, *mushtulluk*, *pisuskë*, *cironkë*, *llomkë* etj. Krahasimi për gjatësinë, shkathtësinë apo mënyrës së lëvizjes është shprehur me anë të nofkave *fuga* (lodër në një copë dërrasë që rrotullohet në ajër), *dhoga* (dërrasë e gjatë), *karaxhai* (kaproll), *suta* (drenushë), *guska* (patë) etj.; krahasimi për përmasat e mëdha trupore është shprehur me anë të transformime metaforike *deveja*, *mullari*, *halldupi*, *kokorroçi*, *bualli*, *zullapi*, *xhirafë*, *gërdallë*, *gallofi*, *foka*, *pela* etj.

**2.6.2. Nofka të krijuara mbi bazën e treguesve të dallueshëm të njeriut**, si: defekte, cene, paftësi fizike. Krahasimi në rastin e këtyre përzgjedhjeve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë *cungu* (me një gjymtyrë të prerë), *çalamani/çali/çalo/çala* (me defekt në ecje), *uloku* (pamundësia për të lëvizur), *qosja* (burrë që nuk ka qime në faqe dhe mjekër), *sakati* (që nuk mund të lëvizë), *kaceli* ( i çalë), *gagaçi*, *shurdho/a*, *xhumba/xhunga* (që ka gunga në kokë apo në trup) dhe shembuj të tjerë si *topalli*, *doraci*, *qorri*, *çakërri*, *kurrizoja*, *docka*.

**2.6.3. Nofka të krijuara mbi bazën e ndonjë tipari fizik të veçantë dhe të dallueshëm të referentit** (kryesisht në pjesën e fytyrës) që ka shërbyer si apelativ që individi të diferencohet pikërisht për shkak të kësaj veçorie. Sipas këtij modeli janë formuar nofkat: *qerpja* (tufë flokësh, balluke), *veshi*, *xhufka* (tufë flokësh), *kaçuli* (balluke, xhufkë që vendoset mbi kokë), *nishani*, *noçka* (turiri i zgjatur), *daci* (tullac, i shogët), *buzo/a* (pjesa e tultë që mbyll gojën), *bukla* (tufë flokësh të mbledhura kaçurrel), *sollaku* (që përdor dorën e

majtë) dhe me radhë *llapa, qafa/qafka, qafoku, nofulla, dhëmboja, kataroshi, qimja, llapushi, kaçurrelsi, tullaci, balashi, quksi, kinezi, kalessi, syni*, etj.

**2.6.4. Nofka të lidhura me personalitetin, karakterin e individëve.** Brenda kësaj fushe leksikore janë përfshirë kryesisht lema që përcaktojnë cilësi negative dhe janë të ndërtuara mbi bazën e metaforës të tipit: *grifshë* (llafazane), *grenxa* (që bën zhurmë), *gjalma* (fill i gjatë është përdorur me kuptimin ngatërrestar), *matrapazi* (njeri pa parime që bën gjithfarë pazarllëqesh për t'ia arritur një qëllimi të caktuar), *ngjala* (njeri që bën dredhi), *pelivani* (dredharak), *doksani* (njeri i hurit dhe i litarit), *çapraz* (flet në mënyrë të parregullt e të pamatur mirë, flet mbrapsht), *birbo* (njeri i shturur), *cubi* (hajdut), *rrodhe* (i bezditshëm), *xhambaz* (dinak, hileqar), *shamata* (rrëmujaxhi), *cingun* (dorështërnguar), *zullumxhi, teveqeli, tombeta* (që e ka zërin e lartë), *zallëmi* (mizor, barbar), *gojëçorapja* (llafazane), *piperkë, kacidhja* (dorështërnguar), *farmaku* (ironik, i pakëndshëm), *kokosh* (mendjemadh), *kaçani* (cingun, dorështërnguar), *qelepiri* (që do të përfitojë, që i do gjërat falas), e të tjera si *manari, masha, pepellashka, lubi, jarani, gojëmasha, kodoshi qelepiri, karagjozi, xanxari, shushunja, donzhuani, noprani, fasharuku, kodoshi, kakami, bëllciku, kopuku*, etj.

**2.6.5. Nofka që identifikojnë mungesën e zgjuarsisë, mprehtësisë,** si: *kopani* (njeri i trashë), *loloja* (i marrë, sylesh), *qypi* (i trashë, që nuk i nxë radakja), *qytyku* (që nuk di nga shkon, i dehur), *rabushi* (i trashë), *duduku/dudmi* (budalla), *hardalli* (budalla, i trashë), *pyka, eksiqi, kokëkungull, bufi/bufja, kokëpacja, fyell, kokëbostani, leshko, shushkë, aguridhe, fyckë, tuafi, mollopupi, humbameno, tekayti, matufi, faqorka, tyryfyckë, teveqeli* etj.

**2.6.6. Spektri i ngjyrave ka shërbyer për krijimin e një fushe të gjerë leksikore,** të cilat shfaqin shumëllojshmëri dhe variacione: *ziu, ziko, zeza, zezo, kuqo, bardho, verdho, leshkuqi, leshbardhi, qafëzezi, kuqaj, verdhacuk, arapi, lesharapi* etj.

**2.6.7. Profesionet e zgjedhura si emërtim identifikues** për personin me anë të metonimisë përbëjnë një fushë shumë të gjerë dhe të shumëllojshme. Ndër nofkat më të përdoruara mund të përmendim: *jatro* (mjek), *jorganxhi* (ai që bën jorganë), *kapxhiu* (person që rrinte te dyert në administratën turke), *kokalari* (tregtar shëtitës që shiste parfume nëpër fshatra), *kondakçiu* (që prodhon kondakë armësh), *kujunxhiu* (argjend, arpunues), *kundraxhiu* (këpucari), *saraçi* (lëkurëpunues), *tavanxhi* (ai që punon tavanë), *teneqexhi* (ai që punon/prodhon teneqe), *topçiu* (ai që shtie me top, emërtim i drejtpërdrejtë me emra vepruesish), *samarxhiu* (ai që bën dhe vë samarë), *ekonomi* (prift i thjeshtë), *millona*



(mullixhi), *myderizi* (teolog, profesor medreseje), *nallbani* (ai që mbath patkonjtë), *odaxhiu* (ai që shërben si roje, shërbyes, portier), *vegshari* ( ai që bën poçe/poçar), *xherahu* (mjek popullor), *qehajai* (shërbëtor i beut), *qeramixhi* ( ai që rregullon tjegullat), *qerraxhia* (mjeshtër që ndreq apo bën qerre), *qyrkxhiu* (ai që bën qyrqe), *sahatçiu* (ai që rregullon sahatë) etj., si *mullixhiu*, *kalemxhi*, *bojaxhiu*, *bozaxhiu*, *daullxhiu*, *djepaxhiu*, *dhaskali*, *kazanxhiu*, *kafexhiu*, *kallajxhiu* etj.

**2.6.8. Nofka të krijuara mbi origjinën, prejardhjen, përkatësi etnike:** *toska*, *turku*, *vllahu*, *muhaxhiri*, *çobani*, *maloku*, *jevgu*, *labi* etj.

Në përmbyllje të këtij sythi, po sjellim një shembull nga gazetari italian Roberto Saviano, ku bëhet një shtjellim i hollësishëm për nofkat:

Paolo Di Lauro njihet si *Çiruzo milioneri*, një nofkë qesharake kjo, por nofkat dhe pseudonimet ndjekin njëfarë logjike dhe kanë një domethënie të caktuar. Gjithmonë kam dëgjuar t'iu drejtohen anëtarëve të Sistemit me nofkën e tyre, aq sa emri e mbiemri shpesh u shuhet, u harrohet. Askush nuk e zgjedh atë, ajo lind papritur nga ndonjë gjë, për ndonjë arsye, e pastaj dikush nis ta përdorë atë. Kështu, krejt rastësisht, lindin pseudonimet e Kamorrës. Paolo Di Lauron e quajti për herë të parë *Çiruzo milioneri* bosi Luigi Giugliano kur, një mbrëmje, pa t'i binin dhjetëra kartmonedha njëqindmijëlitëshe nga xhepat, teksa i afrohej tryezës së pokerit. E kështu, Giuglianoja tha me zë të lartë: "Ja kush na erdhi, Çiruzo milioneri!". Një emër i lindur gjatë një mbrëmjeje dalldisëse, në çast, është një gjetje që të përket vërtet.

Por antologjia e nofkave është e pafundme. Carmine Alfieri, *I nevrikosuri*, bosi i Familjes së re, është quajtur kështu për shkak të ngërdheshjes plot pakënaqësi dhe inat, gjithnjë të pranishme në fytyrën e tij.

Ka edhe nofka që trashëgohen nga të parët e familjes, si ajo e bosit Mario Fabbrocino, i quajtur *Qymyrxhiu*; të parët e tij shisnin qymyr e kjo kishte mjaftuar për ta emërtuar kështu bosin që kolonizoi Argentinën me kapitalet e Kamorrës së Vezuivit.

Disa nofka iu referohen pasioneve të vetë kamorristëve, siç është rasti i Nicola Luongos, i quajtur *Vrangler*, nga që ishte i fiksuar pas tipit të makinës *Jeep Vrangler*, që ishte bërë modeli i parapëlqyer i njerëzve të Sistemit.

Disa të tjera janë të lidhura me tipare të veçanta fizike: Giovanni Birra, *Shkopi*, për arsye të trupit të tij të gjatë dhe të thatë; Costantino Iacomino, *Kokëbardhi*, për shkak të thinjave që i kishin dalë shumë shpejt; Ciro Mazzarella, *Skilipeci*, ngaqë ka klavikula të dala; Nicola Pienese, i quajtur

*Bakalaroja*, ngaqë e kishte lëkurën shumë të bardhë; Rosario Privato, *Gishti i Vogël*; Dario De Simone, *Xhuxhi* etj.

Ka edhe nofka misterioze, si ajo e Antonio De Fraias, i mbiquajtur “u urpacciello”, që do të thotë *kamxhik*, por nga ato që bëhen duke tharë penisin e gomarit. Si edhe Carmine Di Girolamo, ndryshe *Polici*, për shkak të aftësisë që kishte për të përfshirë në operacionet e tij policët dhe karabinierët. E pastaj kemi Ciro Monterison, *Magjistari*, kushedi se për ç’arsye. Pasuqal Gallon prej Torre Annunziatës, me tipare të hirshme, e quanin *Bukuroshi*.....

Gjithsesi, ka edhe nofka të kalibruara, që mund t’i sjellin sukses apo dështim mediatik një bos, si ajo e Francesco Schiavones, i quajtur *Sandokan*, një nofkë mizore, e zgjedhur për arsye të ngjashmërisë së tij me Kabir Bedin, aktorin që ka interpretuar heroin e Salgarit...

Gati të gjithë bosët kanë një nofkë: ky është padyshim një tipar i veçantë, identifikues. Nofkat janë për bosët si vrajat e pashpjegueshme e për këtë arsye janë të shenjta për të shenjtin. Një tregues i përkatësisë në Sistem. Të gjithë mund të jenë Francesco Schiavone, por vetëm njërin e quajnë *Sandokan*; të gjithë mund të kenë emrin Carmine Alfieri, por vetëm njëri e kthen kokën kur e thërrasin / *nevrikosuri*; gjithkush mund të regjistrohet në gjendjen civile si Paolo Di Lauro, por vetëm njëri do të jetë *Çiruzo milioneri*<sup>92</sup>.

## **2.7. Sinonimia leksikore dialektore si shprehje e realizimit të formës së brendshme**

Spektri i gjerë i variacioneve dialektore, të cilat në rastin e gjuhës shqipe paraqiten jo vetëm të shumta në numër, por edhe të shumëllojshme, origjinale e të veçanta, rrjedhimisht, na krijojnë hapësirat e duhura për t’i studiuar. Kjo shumëllojshmëri nuk ka si të mos shihet e lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë e këtyre rajoneve, me kulturën materiale, me përvojën e njerëzve, me veçoritë e jetës shpirtërore, elemente, të cilat, së bashku, përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të një bashkësie gjuhëfolëse. Veshja gjuhësore apo përzgjedhja e elementëve gjuhësorë për të shenjuar të njëjtën realie nuk është gjithmonë e njëjtë dhe të ashtuquajturat sinonime dialektore janë lehtësisht të dallueshme, çka na bën të mendojmë se dhe brenda të njëjtit komunitet gjuhësor, folësit e një gjuhe e perceptojnë, e kuptojnë apo e interpretojnë realitetin objektiv në mënyra të ndryshme dhe se mjetet e përzgjedhura për të shenjuar një realie, për

---

<sup>92</sup> Saviano R., *Gomorra*, Dudaj, Tiranë, 2008, f. 64-67.

të komunikuar një ide apo një përmbajtje të caktuar, ndryshojnë jo vetëm nga dialekti në dialekt, por edhe nga e folmja në të folme.

Dallimet jo të pakta dialektore në fushën e leksikut na bëjnë të mendojmë se faktorët ekstralinguistikë (jashtëgjuhësorë), ndër të cilët do të përmendnim faktorët shoqërorë, kulturorë, ekonomikë, etnografikë, gjeografikë, të kulturës materiale, të lidhur ngushtë me mënyrën e jetesës, me parapëlqimet dhe shijet, qëndrimet ndaj zhvillimeve shoqërore, paragjykimet, kushtet mjedisore, normat dhe zakonet, traditat, doket krahinore, marrëdhëniet me fqinjët etj., janë faktorët më domethënës dhe elementët më përcaktues në formimin e leksikut krahinor, sikurse, në të njëjtën kohë, mund të renditen ndër shkaqet kryesore të veçorive dialektore edhe për nga forma e brendshme e fjalëve. E. Çabej me të drejtë shkruante se “te leksiku i shqipes ... ne shohim të shprehur në gjuhë si në një pasqyrë të gjallë karakterin e veçantë të kulturës popullore, të materiales dhe mendores”<sup>93</sup>. J. Thomaj e lidh këtë çështje me veçoritë historike, psikologjike e të jetesës së popullsisë së këtyre territoreve (faktorët sociologjikë), si edhe veçoritë natyrore (faktorët gjeografikë) që kanë ndikimin e tyre, si faktorë jashtëgjuhësorë, kryesisht për izolimin e elementeve e të dukurive gjuhësore (pra edhe leksikore), si edhe për krijimtarinë gjuhësore specifike<sup>94</sup>. Nga shumë shembuj që kemi vjelë për këtë qëllim<sup>95</sup>, por përmendim vetëm disa syresh, që gjallojnë në leksikun dialektor e krahinor, të lidhur ngushtë me jetën e përditshme, me kulturën materiale dhe shpirtërore, si:

**buburiskë-mollëkuqe-** *buzëkuqe, mizë pashke, nuse pashke, parashkëndi, buburezë, pikaloshja e bostanit;*

**ylber-** *vijakuqe, ylyver, bukë e verës, shok i kumbarës, brez i qiellit, vaj e verë e uthull, brezi i zonjës (i Perëndisë), shoka e zonjës;*

**kazmë-** *qylyk, çapë, lavare, tharakac, firikac;*

**kosh-kashun,** *koshare, koshariqe, koshiq, koshiqe, arkë, thark, garravel, kofin etj.;*

**sëpatë-** *sakicë, naxhake, cakorre, çokë, kepore, nagaçe, sakë, latë, latore, latoshkë, latoshe, latushë, sakavicë, balltje etj.;*

---

<sup>93</sup> Çabej E., *Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime gjuhësore, 1, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 12.

<sup>94</sup> Thomaj J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2001, f. 14.

<sup>95</sup> Shembujt janë marrë kryesisht nga fjalorë dialektorë dhe fjalorë sinonimikë të gjuhës shqipe. Shih bibliografinë dhe referencat në fund të punimit.

**tundës-** mëti, pëti, dybek, tundaç, tundje, shkërdheç etj.;

**pirun-** cimbi, furkulicë, grep, sfurk, gjemb;

**kanistër-** sepet, sepetkë, shportë;

**kusi-** kushane, rrethje, poçe, kamane, valë, bakraç, veshje, kusiçkë,

**lugë-** luçkë, lugashkë, çape, luhare;

**poçe-poçkë,** shtambë, vorbë, baltore, poçok;

**qyp** - qypkë, baltore, pille, bamë, qype, balgëtore, magrip, meçe, kapasë, gërzhare, garraç, garbe;

**tigan-** tigankë, fultere, curufujkë;

**astragaç-** qehën, qer, tajer, palare etj.;

**misërishte:** misërore, hamullore, kashtë (misri), lëpushkë (misri), koçan, bokël, bloçkë, boçe, kacarrum, bërçuk, macurr, masur, boçë, kaçë, rrome, rrumb, kallamidhe, sharrë, shkokël, shtupë, shushallë, tallë, tapë etj.;

**bisk:** filiz, ngallë, degëz, rejë, rremb, skallua, smag, smat, qepore, rrembth, bifkë, bilashnjo, gem, bitonjë, bitme, biskonjë, bilonjë, fillak, mënjollë, lastar, llaskonjë, mitë, noshtër, vllastar, njomëz, pinok, pinjoll, pip, shpatull, trikë, triskull, fiskajë, çicër, grep, kopil, thupër, kalem, korthitë, nënsqetull, bythanë, çatall etj.;

**gomar-** veshgjatë, magjar, gazhel; kërrkë, kërriq;

**dem-** mëzat, mëzator, meshk, taroç, borrokoç, ter, terak, termëzat;

**qen-** zagar, lingua, çap, qenush, kone, llangos, kuç, lush, gjahtor, bardho, murro, murrash, korbec, bic, gucë, mënik etj.;

**rrëmujë:** zallahi, zallamahi, potere, zhurmë, gurgule, gjullurdi, gallamardë, burbujë, ngatërresë, mishmash, rrungajë, gramshalesh, pështjellim, pështjellas, lëmsh, çrregullim, katrapilas, rrokopujë, lesheli, përsesh, trazirë, tollovi, turbullirë, shkatërr, batërdi, çorbë, han, sallatë, rrëmet, llonxhë, llazurë, rrokullimë, vërdallë, shpartall;

**pazar:** panair, çabulle, katrahurë, paçariz, ara-mara, yrrja-byrrja, bjeri t'i biem etj.

Mjafton të shohim se si shprehet forma e brendshme vetëm me një realie të tillë, si: *të brendshmet* (që mbahen brenda, ngjitur me trupin), *mbathje* (nga mbath), *të paana* (nga anë), *shaloke* (nga shalë), *kofshare* (nga kofshë), *ndërresa* (nga ndërroj), *të përbrendshme* (nga brenda), *përbarkje* (nga bark), *qarkje* (nga qark, forma e mesit të trupit), *përbrendësa* (nga brenda) etj. Shumica e tyre formohen si sinonime eufemistike për të mos përmendur fjalën

tabu *brekë*, që në shqipen e sotme ka ngjyrim negative. Lidhja e realieve të mjediseve të ndryshme sipas ngjashmërisë së jashtme ose sipas funksionit të ngjashëm, shkruan J. Thomai, është në themel të mbartjes leksikore, gjë që mundëson motivimin e lehtë të kësaj mbartjeje. Fjala dialektore a krahinore, sado ndryshime të pësojë, edhe kur terminologjizohet, e ruan të tejdukshme formën e saj të brendshme dhe “fytyrën” fonetiko-gramatikore<sup>96</sup>.

---

<sup>96</sup> Thomai J., *Leksiku ...*vep. cit. , f. 50.

### KAPITULLI III

#### ANALIZA E KOMPOZITAVE NGA PIKËPAMJA E FORMËS SË BRENDSHME

*Përmbajtja e fshehtë e të gjitha gjuhëve është e njëjtë-shkenca intuitive e përvojës. Ajo është formë e shprehur që kurrë nuk mund të jetë dy herë e njëjtë.*

**Sapir**

#### 3.1. Motivimi semantik si mjet për të zbuluar formën e brendshme

Siç dihet, fjalë e përbërë (kompozitë) e mirëfilltë në gjuhën shqipe është quajtur ajo njësi dygjymtyrëshe, që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintaksore gjithnjë si një fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të përbërësve të saj<sup>97</sup>. Kompozitat shpesh cilësohen si “prodhim” i një “akti krijimi”, të cilat ndërtohen sipas gjedhesh të njohura në gjuhë dhe që nga pikëpamja strukturore ndahen gjithmonë në dy gjymtyrë, të cilat ruajnë pak a shumë në mënyrë të qartë kuptimet materiale, leksikore dhe hyjnë në lidhje të përcaktuara e shumë të ndryshme semantike-sintetike në bazë të ligjësive të brendshme të gjuhës shqipe. Për shkak të lidhjeve të brendshme kuptimore në të cilat hyjnë gjymtyrët e kompozitës, del një njësi e re leksikore.

Me studimin e kompozitave është marrë një varg studiuesish, shqiptarë dhe të huaj, duke filluar nga Boppi, Kamarda, Dozoni, Vaigandi, Hahni, Pekmezi, Sheperi, Myderrizi, etj., dhe më tej me studimet e plota të K. Cipos, A. Xhuvanit, A. Kostallarit etj. Kjo lëndë e pasur gjuhësore është pasqyruar në të gjithë fjalorët shpjegues të shqipes dhe në fjalorë dy-e-shumëgjuhësh.

Duke u mbështetur në arritjet teorike për studimin e fjalëve të përbëra dhe në trajtimin leksikografik në fjalorë të shqipes, ne kemi marrë në studim analizën e njësisve të tilla leksikore nga pikëpamja e motivimit semantik, për të zbuluar “formën e brendshme” të tyre.

---

<sup>97</sup> Kostallari A., *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972, f. 83.

Kjo bëhet duke këqyrrur emërtimin e realieve mbi bazën e *një tipari të caktuar*, i cili lidhet me një shkallë mjaft të hershme të zhvillimit shoqëror e botëkuptimor dhe që shërben si bazë për motivimin e kompozitave. Ky tipar është kyçi për të zbuluar *formën e brendshme* të tyre<sup>98</sup>.

Për të bërë një analizë të tillë, së pari, kemi marrë në vështrim kompozitat mbiemra, të cilat vlerësohen si një nga mjetet më të fuqishme për gjallërimin dhe pasurimin e leksikut të shqipes. Mbiemrat cilësorë mbartin të gjithë vlerat semantike e konotative të sintagmës dhe bëjnë që, në tërësi, struktura të fitojë një përmbajtje cilësore, e cila i vishet si atribut një realieje tjetër për ta cilësuar. Pjesa më e madhe e kompozitave mbiemërore që do të analizojmë në këtë kapitull përdoren në mënyrë të figurshme, janë metaforizuar duke fituar vlerat e mbiemrave cilësorë. Megjithë karakterin e ndërmjetuar të shënimit të tiparit dhe mënyrat e cilësimit të pjesës që zotëron realia, këta mbiemra ngjallin drejtpërsëdrejti parapërfytyrimin mbi dukuri të caktuara të realitetit<sup>99</sup>.

Lidhjet semasiologjike të fjalët e përbëra janë origjinale. Në qoftë se në fjalën e thjeshtë, si rregull, në bazë të formës së brendshme vihet një tipar (thelbësor ose jo), atëherë në fjalët e përbëra mund të ketë dy ose më shumë tipare. Krahaso angl. *Death-cup*, fjalë për fjalë “kupa e vdekjes”, ku në formën e brendshme përfshihen disa tipare: forma e rrumbullaktë e filxhanit (kupës) dhe pasqyrimi i cilësisë që të shpie drejt vdekjes. Por, në disa raste, fjalët e përbëra nuk kanë formë të brendshme, sepse forma e brendshme e fjalëve të përbëra të tipit *hekurudhë* është në thelb shumë e thjeshtë aritmetike e kuptimeve reale të atyre fjalëve, të cilat në strukturën e fjalëve të përbëra bëhen pjesë përbërëse e tyre. Sipas Potebnja-së, tipari fillestar i sendit është tipar thelbësor, meqenëse atë folësi e zgjodhi si përfaqësues të fjalës së dhënë. Por historia e gjuhës tregon se shumë tipare që njeriut i dukeshin si thelbësore, me kohë u bënë jothelbësore, si rrjedhim, emërtimet jo gjithnjë janë bartës të tipareve thelbësore të sendeve dhe dukurive. Forma e brendshme të fjalët, si rregull, tregon drejtpërdrejt tiparin e vendosur në bazë të kuptimit të fjalës së dhënë.

Analiza jonë për këta mbiemra ka për qëllim të parashtrojë disa prej teknikave më të rëndësishme që ka përdorur bashkësia shqipfolëse gjatë procesit të emërtimit dhe të

---

<sup>98</sup> Po aty, f. 183.

<sup>99</sup> Kostallari A., *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972, f. 98.

sintetizojë disa prej gjedheve më të përdorura të këtij procesi. Gjatë vjeljes së materialit ne kemi skeduar 977 kompozita mbiemra dhe i kemi klasifikuar ato sipas disa kritereve, të cilat lidhen me mënyrën se si është shenjuar tipari, duke u bazuar në cilësitë që zotëron vetë realia e cilësuar nga mbiemri apo nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të tij.

Gjithashtu, analiza jonë ka për qëllim zbërthimin e përbërësve semantikë dhe kundrimin e dukurive gjuhësore në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit. Interpretimi i lidhjeve dhe raporteve të cilësimit dhe shkallëzimi i tyre është parë gjithmonë në raport me qëndrimin subjektiv të folësit përkundrejt vlerësimit të tiparit që do të nxjerrë në pah dhe referentit të cilit ky tipar i vishet, çka bën që këto shenja gjuhësore të jenë të ngarkuara me nuanca kuptimore dhe ngjyime emocionuese.

## **3.2. Motivimi i brendshëm i kompozitave mbiemra sipas tipareve të referentit**

**3.2.1.** Tiparet e jashtme fizike të realies, të cilësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe që mbartin një ngjyrim emocionues pozitiv, përbëjnë një fushë të caktuar konceptore dhe leksikore. Gjymtyra e strukturës së përbërë, ajo që mbart edhe konceptin, është një pjesë e trupit të njeriut dhe gjymtyra plotësuese mbiemërore (ajo që mbart ngarkesën kuptimore dhe emocionuese) është zakonisht një mbiemër që shënon:

**3.2.2.** Tipare fizike dalluese të ngjyrës, si p.sh.: *flokartë, flokargjend, leshkuq, vetullzi, kokëkuq, qimeartë, qimebardhë, qimelarmë, qimemurrmë, qimeverdhë, qimezi pendëbardhë, pendëkuq, bishtakuq, bishtartë, bishtbardhë, bishtkuq, dhëmbëflorinjte, bukëkuq, mustaqezi, mustaqebardhë, mustaqekuq, faqekuq, faqeverdhë, këmbargjend, mjekërzi, mjekërbardhë, sylarmë, syartë, sybardhë syblertë, kokëzezë, këmbëkuq, flokëkuq (qimekuq) etj. Interesante janë përzgjedhjet e referentëve frymorë (kafshë ose njerëz) dhe nxjerrja në pah e përbërësve të treguesve të realies që do të cilësohen nga spektri i gjerë i ngjyrave. Frymorët kafshë janë identifikuar më tepër me ngjyrat e shtresës mbuluese të trupit (pendë/ qime/ lesh) dhe treguesve më të dukshëm të ndërtimit trupor (kokë/ bisht/ qafë). Edhe origjinaliteti i përzgjedhjes së ngjyrave është po kaq interesant; fusha konceptore e ngjyrave që bëhet tregues dallues përcaktues për këto realie ka sendërtuar një fushë të gjerë leksiko-semantike ku përfshihen që nga ngjyrat bazë të perceptura lirisht përmes shqisës së të parit ( e*



kuqe/ e zezë/ e bardhë), deri te nuancat dhe kombinimet e ngjyrave që abstragohen për shkak të përfyryrimeve më të thelluara apo për shkak të ngjashmërisë me elementë të realies që kanë këtë ngjyrë tipar dominant (e artë/ e argjendtë/ e blertë/e larmë/ e murrme). Duket se treguesi i ngjyrës ka shërbyer jo vetëm si cilësues, por edhe ka formësuar strukturalisht njësi të veçanta leksikore të leksikut të specializuar të fushës së bimëve dhe kafshëve, që shërbejnë si emërtime të përbëra *faqekuq* (zog i vogël këngëtar me kokë të kuqe), *këmbëkuq* (shpend sa një pëllumb zakonisht me ngjyrë të murrme me sqep të kuq), *bishtkuq* (zog i vogël këngëtar me bisht si të kuqerremtë), *bishtartë* (lloj future që e ka pjesën e poshtme të trupit me këtë ngjyrë), *pendëkuq* (një lloj krapi që ka ngjyrën e kuqe) etj .

Nga ana tjetër, frymorët njerëz janë identifikuar më tepër përmes cilësimit të tipareve të fytyrës (sy/ mjekër/ flokë/ faqe), por nuk mungojnë edhe rastet kur një tipar i veçantë identifikues në vetvete, siç është rasti i leksemës *mustaqe*, të përforcohet në më tepër se një mënyrë, duke u cilësuar edhe përmes ngjyrës (*mustaqezi, mustaqebardhë, mustaqekuq*) etj. Perceptimet e ngjyrave në pjesën më të madhe të rasteve janë më konkrete dhe më të kapshme dhe treguesi i ngjyresës nuk jepet në mënyrë të ndërmjetuar. Të gjitha këto kompozita mund të motivohen duke i zbërthyer në struktura më të zgjeruara që shprehin marrëdhënie përkitësie me realien që shenjojnë: *që e ka vetullën të zezë, që i ka flokët të zinj, që i ka sytë të bardhë, që i ka faqet të verdha* e kështu me radhë. Treguesi i qenësishëm cilësues i ngjyrës ka shërbyer në jo pak raste edhe në formësimin e kategorisë së emërtimeve që e shenjojnë realien në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, siç janë nofkat, duke e nxjerrë treguesin e ngjyrës si tipar dominant përcaktues e në shumë raste edhe identifikues për frymorët njerëz që e mbartin këtë veçori, si: *kokëkuqi, mustaqeziu, sybardhi, kokëziu, qimekuqi (leshkuqi), vetullziu* etj.

**3.2.3.** Tregues të cilësive të jashtme të lidhura me formën, gjatësinë, madhësinë, butësinë, ashpërsinë etj.: *flokëgjatë, flokëlëshuar, flokëpakrehur, flokëprerë, leshashpër, leshpalarë, barkmadh, barkrrumbullak, buzëmadh, buzëtrashë, gojëmadh, qafëgjatë, qafëhollë, kokëmadh/e, kokërruar, kokështypur, këmbëgjatë, këmbëshkurtër, këmbëprerë, krahëgjatë, krahëdrejtë, krahëfortë, qimegjatë, qimedredhur, qimehollë, qimerrallë, qimeshkurtër, pendëgjatë, bishtgjatë, bishthollë, bishtkëputur, bishtprerë, bishtshkurtër, dhëmbëdalë, hundështypur, hundëpërpjetë, këmbëthyer, këmbëvogël, këmbëzbathur, mjekërbutë, mjekërgjatë, mjekërashpër* etj. Këto kompozita mbiemra cilësojnë më së shumti

tipare fizike lehtësisht të dallueshme dhe me përbërës të realies që indentifikohen qartazi. Tiparet referenciale, që janë formësuar strukturalisht me anë të këtyre mjeteve gjuhësore, u asociohen kryesisht treguesve të jashtëm të fytyrës, trupit, aftësive fizike ose mungesës së tyre, si p.sh.: *buzë, flokë, kokë, bark, hundë, këmbë, mjekër, mustaqe* etj. Këta tregues kryesisht shenjohe me mbiemra cilësorë të panyjshëm (këmbëvogël, krahëdrejtë, bishtshkurtër), ose me mbiemra të krijuar prej pjesores së foljes (krahëprerë, kokërruar, qimedredhur) e më rrallë i përkasin strukturës *emër+pa+pjesore* (flokëpakrehur, leshpalarë, qimepadalë etj.), të cilët hyjnë në përbërje dhe grupime semantike që shprehin lidhje antonimike të tipit: *i gjatë-i shkurtër, i hollë-i trashë, i madh-i vogël, i drejtë-i shtrembër, i fortë-i dobët, i ashpër- i butë* etj., si: *flokëgjatë* (që i ka flokët e gjatë)- *flokëshkurtër* (që i ka flokët e shkurtër); *buzëtrashë* (që i ka buzët e trasha)-*buzëhollë* (që i ka buzët e holla); *këmbëvogël* (që e ka këmbën të vogël)-*këmbëmadh* (që e ka këmbën të madhe); *bishtshkurtër* (që e ka bishtin të shkurtër)-*bishtgjatë* (që e ka bishtin të gjatë) e kështu me radhë *qimëhollë-qimëtrashë, mjekërbutë-mjekërashpër, hundështypur-hundëpërpyjetë, krahëgjatë-krëhëshkurtër, qafëhollë-qafëtrashë* etj.

Të gjitha leksemat mund të zgjerohen strukturalisht duke përcaktuar raporte përkitësie midis dy përbërësve të kompozitës, marrëdhënie në të cilat elementi i dytë përcakton lidhjet cilësore me përbërësin e parë. Shumica e leksemave të përbëra të sipërpërmendura përveçse i kanë shprehur cilësitë në mënyrë të drejtpërdrejtë pa ndërmjetësinë e ndonjë referenti tjetër, u janë nënshtuar lëvizjeve semantike, duke zgjeruar kuptimin dhe duke fituar një kuptim të ri të figurshëm, madje duke zgjeruar edhe strukturën kuptimore në kushtet e shumëkuptimësisë ku këto njësi operojnë. Ky proces vëhet re qartë te kompozitat: *barkmadh* “që pasurohet në kurriz të të tjerëve” nga tema semantike “që e ka barkun e madh”, *gojëmadh* “lafazan, që nuk i pushon goja” nga “që e ka gojën të madhe”, *krahëprerë* “që i është kufizuar mundësia vepruese” nga “që e ka krahun të prerë”, *bishtprerë* “që nuk ka përkrahje, nuk ka ndikim te të tjerët” nga “që e ka bishtin të prerë”, *buzëhollë* “që zgjedh shumë e bën naze në të ngrënë dhe në të pirë” nga “që i ka buzët të holla”, *buzëçarë* “që ka hequr shumë në jetë, i shumëvuajtur” nga “që e ka buzën të çarë”, *buzëtrashë* “që ha çdo gjë pa e kuptuar se çfarë po ha” nga “që i ka buzët të trasha”, *buzëthatë* “që nuk ka vënë asgjë, i mjerë” nga “që i ka buzët të thata” etj.

Shumë interesante janë strukturat me përbërësin nominal “bisht”: *bishtpërpyjetë, bishtprerë, bishtkëputur, bishtdredhur/ përdredhur, bishtundur*, i cili, megjithëse shënon

tipare të jashme të cilësuar drejtëpërsëdrejti që u referohen kafshëve, është shndërruar figurshmërisht duke shënuar cilësi të karakterit të njerëzve, duke përlligjur edhe një herë faktin se procesi i formimit të kompozitave ka kaluar nëpërmjet më shumë se një etape. Një pjesë e këtyre kompozitave shënojnë cilësi fizike të amplifikuara qëllimisht dhe që përdoren si mjete identifikimi apo etiketimi dhe në pjesën me të madhe të rasteve mbartin ngjyrim emocionues negativ. Në këtë kontekst, duhet përmendur edhe fakti që folësit e gjuhës shqipe i kanë përdorur këto mjete cilësuese si kategori të përgjithësuara të gjykimit dhe paragjykimit për individë të veçantë, duke i përdorur si apelativa për të strukturuar semantikisht dhe për të shënuar nofka të tipit: *kokëmadhi, këmbëgjati, barkmadhi, buzëtrashit, hundëgjati, hundëpërpjeti, mjekërgjati* etj. Procesi i emërimit të këtyre njësive ka shërbyer për formësimin e njësive të reja leksikore dhe për të rritur vëllimin e tyre semantik.

Në raport me mbiemrat e sipërpërmendur, kompozitat mbiemra, që e shprehin cilësimin e tiparit në mënyrë të ndërmjetuar, pra nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të saj, janë të shumta në numër dhe të shumëllojshme për sa i përket shkallës së ndërmjetimit. Pjesa më e madhe e formimeve të tilla kanë në bazë metaforën që ka përfutur një varg njësish leksikore të cilat dallohen për njëjtësinë midis strukturës së jashtme dhe anës përmbajtëse. Gjatë analizës semantike vërejmë disa tipe të motivimit të brendshëm të strukturave semantike, të cilat mund të klasifikohen sipas mënyrës se si është ndërmjetuar veçoria dalluese dhe mbizotëruese nga i cilësuarit drejt referentit, tipari i të cilit po krahasohet.

### **3.3. Tipet e formës së brendshme sipas strukturave semantike**

**3.3.1.** Referenti, që mbart tipare mbizotëruese e që nëpërmjet metaforave të krijuara sipas besimit popullor dhe entitetit (qenësisë) mendtor të folësve, i janë veshur një realieje tjetër, mund të jetë një kafshë a shpend: *arushë, lepur, derr, dosë, mace, mushkë, dele, buall, sorrë, cjap, dac, gomar, stërg, maçok, ujk, flutur, akrep, dallëndyshe, dhelpër, gjel, kalë, pallua, shkabë, shqerrë, shqiponjë* etj. Të tilla janë kompozitat: *flokarushë, gjumëlepur, barkderr, barkdosë, barkmace, buzëmushkë, buzëdele, gojëbuall, gojëbilbil, gojëgjarpër, gojëlopë, gojënepërkë, qafëderr, qafëlejlek, qafëpatë, qafësorkadhe, vetull sorrë, kokëbuall, kokëcjap, kokëdac, kokëdac, kokëgomar, kokëmushkë, kokëstërg, këmbëmaçok, këmbësorrë,*

*shpirtujk, shpirtqen, krahëflutur, bishtakrep, bishtdallëndyshe, bishtdhelper, bishtgjel, bishtkali, bishtmushkë, bishtpallua, bishtpelëz, hundëshkabë, këmbujk, syshqerrë, syshqiponjë, buzëderr* etj.

Ndërtimi i brendshëm kuptimor i kompozitës si një njësi e vetme është realizuar përmes metaforës, ku të bie menjëherë në sy karakteri i ndërmjetuar i përcaktimit cilësor të tipareve. Barasvlerësimi i imazhit apo shembëllimit të një realieje konkrete frymor kafshë me një tipar dallues dhe identifikues të njeriut është i paramenduar dhe i mirëmenduar përveçse shpreh qartë karakterin e mendësisë së folësve që i kanë sendërtuar këto tipare dhe ndërveprimin midis gjuhës dhe kulturës sidomos në rrafshin e leksikut të hershëm burimor të gjuhës, pjesë e të cilit janë emërtimet e kafshëve dhe nga ku është marrë substanca semantike bazë e perceptueshme fizikisht, mbi të cilat është ndërtuar krahasimi. Ndërtimet leksikore të kësaj natyre janë produkt i drejtpërdrejtë i folësve dhe rrethanave konkrete jetësore, diktuar drejtpërsëdrejti nga kushtet natyrore të mjedisit, mënyra e jetesës apo mënyrat e sjelljes së individëve.

Figurshmëria dhe kuptimi i ri i fituar ka rritur aftësinë shprehëse të fjalës, sikundër e ka pasuruar me një kuptim të përforcuar dhe me ngjyrim të ri emocionues. Treguesit cilësorë, që janë përdorur si temë semantike për të ndërtuar njësi të prejardhura kuptimore, shënojnë tipare të jashtme të fytyrës apo trupit të njeriut si ngjyra, gjatësia, madhësia, mprehtësia dhe përbërësit nominalë të përcaktuar më shpesh janë *qafë, kokë, sy, buzë, hundë, bark* etj. Mënyrat se si shqipfolësit i kanë dalluar dhe përzgjedhur realiet mbi bazat e kategorizimeve të treguesve dominantë është shumë interesante dhe është pashmangshmërisht e përligjur me mënyrën se si këta folës e kanë perceptuar këtë realitet, andaj referentët e përzgjedhur jo rastësisht mbartin tipare të përgjithësuara.

Shndërrimet metaforike të këtyre njësive jo vetëm që rritin figurshmërinë dhe mjetet shprehëse të gjuhës, por edhe dëshmojnë për një njohje të plotë të të gjithë treguesve të realies nga bashkësia folëse, njohje e cila duket të jetë krahasimisht e njëjtë, përderisa në areale të ndryshme gjeografike folësit e kanë prerë realitetin në mënyrë të ngjashme dhe kanë zbuluar tipare të njëjta dominante të realieve për t'i bërë objekt identifikimi. Ja se si e ka zhbiruar konkretisht realitetin entiteti shqipfolës: treguesin cilësor të gjatësisë dhe formës e kanë shprehur figurshmërisht përmes metaforës *qafëlejlek* “me qafë të hollë, të gjatë si të lejlekut”, ku referenti që ka shërbyer si objekt krahasimi është *lejlek* “shpend me *qafë* dhe

sqep të gjatë”. E njëjta cilësi është identifikuar edhe në rastin e kompozitës *qafëpatë* “me qafë të gjatë dhe të bardhë si të patës”, me ndryshim se referenti i krahasuar është një shpend tjetër, *patë* “shpend i butë a i egër, me *qafë të gjatë* dhe me këmbë në trajtë të pëllëmbës”. Në të njëjtën mënyrë është perceptuar imazhi në rastin e leksemës *qafësorkadhe* “me qafë të hajshme e të bukur”, ku referenti është përsëri një frymor kafshë, *sorkadhe* “gjitarr dythundrak me brirë dhe qafë të gjatë”. Leksema *kokëbuall* “me kokë të madhe si të buallit”, është shenjuar materialisht duke marrë për bazë një tjetër tipar, atë të madhësisë, dhe elementi i krahasuar është marrë përsëri nga bota e kafshëve *buall* “kafshë shtëpiake me trup më të madh se te kaut” me dallimin e vetëm se treguesi dominant i formës është transferuar instiktivisht dhe qëllimisht te pjesa më dalluese e trupit të njeriut: *koka*. I njëjti arsyetim vlen edhe për përzgjedhjen *kokëlopë* “me kokë të madhe” me dallimin e vetëm se referenti i krahasuar është një kafshë tjetër, por që në perceptimin e përgjithshëm dallohet për trupin e madh dhe të rëndë. Kompozita *kokëdele* “me flokë të bardhë që në lindje, i thinjur” ka kaluar nëpërmjet një niveli tjetër abstragimi: ngjyra si tregues cilësor identifikues për këtë kafshë, nëpërmjet metaforizimit i është veshur njeriut. Te kompozitat mbiemërore me përbërës fjalën *sy*, përkatësisht *symëshqerë* “me sy të mëdhenj e me shprehje të butë dhe të ëmbël” dhe *sypetrit/ shqiponjë* “me sy të mprehtë dhe të fortë” butësia dhe mprehtësia janë njësuar figurativisht me dy kafshë të zgjedhurar qëllimisht nga folësit mbi bazën e tërësisë së perceptimeve që kanë ndërtuar mbi këto realie shumë të njohura për ta. Vlerat shprehëse të këtyre krijimeve origjinale dallohet dukshëm edhe në rastet e kompozitave të mëposhtme, ku tiparet e gjatësisë, trashësisë, formës dhe ngjyrës janë transformuar metaforikisht dhe përzgjedhja e referentëve është origjinale, e motivueshme, e perceptueshme lehtësisht mendërisht, sepse realiet e përcaktuara i mbartin më së miri vlerat dalluese të klasës që ata përfaqësojnë.

Duke i analizuar referentët rast pas rasti vërejmë se për kompozitën *buzëviç* “me buzë të trasha e të gjera si referent ka shërbyer fjala *viç*; *qafëderr* “me qafë të trashë dhe të shkurtër, shumë i shëndoshë” krahasimi është ndërtuar mbi fjalën *derr* “kafshë shtëpiake me trup dhe qafë të trashë”; *hundëshqiponjë* “që e ka hundën të kthyer si sqepi i shqiponjës” nga *shqiponjë* “shpend i madh grabitqar me sqep të kthyer e me sy të mprehtë”; *vetullsorë* “që i ka vetullat e zeza si pendët e sorrës” nga *sorrë* “shpend me pendë të zeza dhe sqep të kthyer”; *mjekërcjap* “që e ka mjekrën të gjatë dhe me majë, mjekërgjatë” nga *cjap* “kafshë me lesh të

gjatë dhe të ashpër”; *barkzhabë* “që e ka barkun të madh, të fryrë dhe të squllët” nga zhabë “kafshë e vogël me trup të gjerë dhe këmbë të gjata” etj. Vihet re se edhe pse kompozitat e sipërpërmendura nga pikëpamja e strukturës kuptimore janë në vetvete realizime leksikore të metaforizuara figurativisht, në mjaft raste u është rritur aftësia shprehëse duke iu mbivendosur një kuptim të ri të figurshëm leksikor çka bën që për nga fusha leksikore e njësisive që cilësojnë tipare fizike të jashtme të frymorëve, të kategorizohen si leksema që shprehin cilësi karakteriale të tipit *syshqiponjë* “trim, guximtar”, *kokëlopë* “i trashë nga mendja”, *kokëmushkë* “kokëfortë”, *buzëviç* “jo i zgjuar, i trashë”, *gojëbilbil* “që flet gjithmonë me fjalë të ëmbla dhe të mira” etj.

Në disa raste krahasimi i metaforizuar ka bërë që ndërmjetimi i tipareve të mos bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, si në shembujt e përmendur më lart, por në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke dëshmuar një shkallë shumë të lartë abstragimi të imazhit të cilësuar. Këto kompozita nuk mund të zërthehen si struktura me marrëdhënie përkritësie, por mund të shpjegohen kuptimisht me anë të sinonimeve leksikore përkatëse, kryesisht mbiemra. Kështu *shpirtujk/shpirtqen* nuk zërthehet semantikisht “që e ka shpirtin si të qenit/ të ujkut”, por “që është shpirtlig, shpirtkeq, i pamëshirshëm”, e kështu me radhë: *këmbëlepur* “këmbëshpejtë, që vrapon shpejt”, *gojënepërkë/gjuhënepërkë* “që flet keq, që i merr të tjerët nëpër gojë”, *barkbuall* “i pangopur, hamës i madh”, *kokëmushkë* “i pabindur, kryeneç”, *gojëgjarpër* “gjuhëhelm, që sulmon të tjerët me fjalë therrëse”, *gjumëlepur* “që e ka gjumin shumë të lehtë, që fle me merak”, *zemërpulë* “që trembet lehtë, që nuk ka guxim”, *zemërqen* “që nuk ndien dhembje, i pamëshirshëm, mizor”. Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e këtyre kompozitave mbartin nuanca të konotacionit negativ.

**3.3.2.** Një tip mjaft të pasur përbëjnë edhe kompozitat mbiemërore, të cilat raportin e krahasimit e ndërtojnë mbi bazën e asosacionit me tipare të dukshme të referentit që mund të jetë një lule, bimë apo frut: trëndelinë, bozhure, burbuqe, trandafil, shegë, piperkë, mollë, patate, patëllxhan, spec, pjeshkë, portokall, rrush, kaçka (arra), bajame, manushaqe, qershi, lule etj. Sipas këtij kriteri janë klasifikuar kompozitat e mëposhtme: *leshbozhure*, *leshtrëndelinë*, *buzëburbuqe*, *buzëtrëndafille*, *buzëkarafille*, *buzëshegë*, *gojëmarraqkë*, *gojëpiperkë*, *kokëgorricë*, *kokëmollë*, *dorëpiper*, *hundëpatate*, *hundëpatëllxhan*, *hundëspec*, *faqepjeshkë*, *faqeportokalle*, *faqemollë*, *faqerrush*, *sykaçkë*, *sybajame*, *symanushaqe*, *syqershi*, *qimegështenjë*, *buzëlule* etj.

Të gjithë shembujt e lartpërmendur kanë ngjyrimet të dukshme emocionuese dhe, nga pikëpamja e motivimit të brendshëm kuptimor, ato shprehin cilësi të lidhura me pamjen e jashtme ku vlerat kuptimore e ngjyrimet emocionuese i ka gjymtyra e dytë, si një referent që mbart të gjitha tiparet e qenësishme. Të marra së bashku, ato krijojnë një fushë të gjerë konceptore të tipareve fizike, kryesisht të lidhuara me pjesë të fytyrës. Shqipfolësit i kanë marrë realitetet e krahasuara që kanë prodhuar edhe bërthamën e çerdhes leksikore të këtyre njësive nga qasja e drejtpërdrejtë dhe njohja e plotë me realitetin, prandaj këto kompozita tingëllojnë shumë të thjeshta dhe të natyrshme dhe përlligjen bindshëm me veçoritë dhe ligjësitë e brendshme të fjalëformimit të shqipes. Këto kompozita, fryt i perceptimit të imazhit dhe përfytyrimit popullor si pasuri e gurrës popullore, u janë atribuar kryesisht vajzës, gruas, shoqes dhe mikes, si *buzëtrëndafile* “që i ka buzët e kuqe si trëndafili” dhe me një sërë lulesh, si: *burbuqe, trëndelinë, karafil, manushaqe, bozhure* etj., duke krahasuar, sipas rastit, herë ngjyrën, herë formën dhe herë me aromën tyre.

Të gjithë shembujt e lartpërmendur mbartin nuanca të dukshme konotative dhe, nga pikëpamja e përmbajtjes semantike, ato shprehin cilësi të lidhura me pamjen e jashtme dhe vlerat kuptimore i mbart gjymtyra e dytë, një referent që mbart të gjitha tiparet dalluese. Po kaq të afërta dhe të ngrohta janë kompozitat e formësuara gjuhësisht mbi bazën e referentëve *fruta* në njësi të tilla me konotacion pozitiv, si: *faqemollë* “që i ka faqet e kuqe dhe të mbushura, që i ka faqet si mollë”; *faqeshegë* “që i ka faqet e kuqe si shegë, që është plot shëndet”; *buzëqershi* “që i ka buzët e vogla dhe me ngjyrë të kuqe” e duke vijuar me referentë të tjerë, si: *bajame, kaçkë, rrush, portokalle*, etj. Por jo të gjitha referencat përkundrajt këtyre realieve kanë përfutur kompozita mbiemra që shprehin qëndrim subjektiv pozitiv apo tipare cilësisht të pëlqyeshme. Nën këtë arsyetim mund të përmendim kompozitat *kokëshinik* “që e ka kokën shumë të madhe”; *hundëpatate* “që e ka hundën të madhe” (me të njëjtin kuptim është përdorur edhe *hundëpatëllxhan*); *hundëspec* “që e ka hundën të kuqe”; *buzëmushkë* “që i ka buzët e mëdha dhe të përveshura”; *gojëmarraq* “i belbër, që i mbahet goja kur flet”; *kokëkungull* “që e ka kokën të madhe dhe të gjatë si të kungullit) etj.

Lëvizjet kuptimore me bazë tropet gjuhësore (në shumicën e rasteve metaforën) ka bërë që edhe ky grup kompozitash të shoqërohen me zgjerim të strukturës kuptimore, ku kuptimit të përmendur i është pranëvënë edhe një kuptim i figurshëm, i cili nuk mund të zërthehet në përbërës kuptimorë që shprehin marrëdhënie përkitësie si në strukturat e

përmendura më lart, por është sendërtuar materialisht mbi bazën e një imazhi psikik më të ndërlikuar, i cili perceptohet mbi bazën e parimeve të brendshme të zhvillimit mendor të folësve dhe shkodohet individualisht duke prodhuar kuptime të tilla të metaforizuara. Kompozitat e poshtëshënuara e kanë marrë kuptimin leksikor të figurshëm falë këtij procesi ndërmjetimi: *kokëshinik* “kokëngjeshur, kokëfortë”; *hundëspec* “që kërkon të grindet, grindavec”; *gojëpiperkë/gojëspec* “që flet fjalë therrëse, që thumbon me fjalë”; *dorëpiper* “që është i prapë, që nuk lë gjë pa lëvizur”, *gojësheqer/gojëmjaltë* “që flet butë dhe shtruar, gojëmbël”; *kokëkungull* “i trashë nga mendja, kokëtul” etj. Edhe këtu përftesat vijnë nga ndërtime të tilla, si: *që i ka buzët si burbuqe, që e ka hundën si patate, që e ka gojën si piperkë* etj.

**3.3.3.** Motivimi i brendshëm kuptimor mund të shfaqet dhe në tipa të tjerë kompozitash, kur realia e krahasuar është një objekt, send apo material konkret: *gur, calik, kacek, ledh, vozë, shpatë, kuti, brisk, bucelë, kamare, fyell, rrotë, sepete, cung, penë, lopatë, sqepar, sharrë, rrogos* etj. Referentët merren nga fushat konceptore të veshjeve, pajisjeve të punës, materialeve të përdorura në jetën e përditshme etj., ndërsa tiparet e krahasuara lidhen me cilësi fizike të realies. Si të tilla mund të përmendim: *leshgur, leshmëndafshi, leshratendë, barkcalik, barkdërrasë, barkkacek, barkledh, barkvozë, gojëshpatë, gojëkuti/kutizë, gojëbrisk, gojëkamare, gojëcorap, qafëdrapër, qafëgastare, vetullgjilpërë, vetullkalem, kokëbucelë, kokëdru, kokëfyell, kokëgaruzhde, kokërrrotë, kokësepete, kokëtrung, kokëgdhë, kokëdaulle, këmbëqiri, këmbëdrapër, krahcung, bishtpenë, bishtlopatë, dhëmbësqepar, dhëmbësharrë, hundëbri, faqerrogos* etj.

Në mendësinë dhe përvojën kolektive të folësve të gjuhës shqipe realiet e për zgjedhura, tiparet e të cilave qëndrojnë në thelb të bërthamës kuptimore që formëson njësitë e metaforizuara, e mishërojnë dhe e transmetojnë më së miri tiparin e qenësishëm që i identifikon ato, edhe për faktin se këto realie janë provë e njohjes konkrete që ata kanë me ata çka i rrethon, ndaj edhe këto struktura i rrinë kaq mirë dhe i vijnë kaq për shtat shqipes. Duke i njohur me hollësi të gjithë treguesit e realies, folësit e shqipes i shndërrojnë natyrshëm këto njësi në konstrukte semantikisht të figurshme. Metafora është kaq e fuqishme në të gjitha rastet e poshtëshënuara, sepse buron së brendshmi dhe merr jetë nga qasjet dhe perceptimet e ngushta, të përditshme të realitetit. Të gjithë referentët u përkasin kulturës



materiale, karakterit bujqësor dhe blegtoral të jetës së banorëve, të gjitha të prekshme, të kapshme, konkrete dhe të nevojshme.

Ndër të tjera, duhet theksuar fakti se një pjesë e leksemave që janë që u përgjigjen referentëve të cilësuar i përket lëndës gjuhësore të fondit të vjetër të leksikut popullor apo një leksiku më të specializuar, por që gjallon në letërsinë artistike dhe në folklor. Cilësitë e transferuara figurshmërisht janë të lidhura kryesisht me treguesit e fortësisë, formës, ashpërsisë apo butësisë si, p.sh.: *barkcalik / barkacek* “barkfryrë”, në të cilat referenti është një objekt konkret *calik-kacek/shakull* dhe cilësia e shprehur është *fortësia*; *barkdërrasë* “që e ka barkun të tharë e të futur nga të pangrënit”, ku krahasimi bëhet me realien *dërrasë* “fletë prej druri që nxirret duke sharruar një trung” dhe cilësia është dobësia trupore; *qafëcungal* “që e ka qafën të shkurtër dhe të trashë”, ku krahasimi bëhet me realien *cungal* “dru i shkurtër që vihet mbi trarët e çatisë”, dhe cilësia është gjatësia; *qafëgastare* “që e ka qafën të hollë dhe të gjatë”, ku referenti është *gastare* “enë prej qelqi, gotë, shishe” dhe cilësia e krahasuar është gjatësia; *qafëdrapër* “që e ka qafën të shtrembër”, përbërësi i realies krahasohet me drapër “vegël bujqësore me presë si hark” cilësia është forma; *vetullgjilpërë* “që i ka vetullat shumë të holla”, krahasimi bëhet sipas formës së referentit *gjilpërë* “fill i hollë çeliku me majë të mprehtë”; *vetullkurorë* “që i ka vetullat si hark”, ku përsëri treguesi i formës është shprehur në mënyrë të figurshme duke u krahasuar me *kurorë* “rreth i thurrur me degë a me lule”; *leshmëndafshi* “që i ka flokët të butë”, ku butësia dhe shkëlqimi janë cilësitë e krahasuara në këtë rast me një realien *mëndafsh* “fije të holla dhe të shndritshme”; *dhëmbëbrisk* “që i ka dhëmbët shumë të mprehtë”, në të cilën fortësia dhe mprehtësia janë nxjerrë si tipare dalluese përmes krahasimit me *brisk* “thikë çeliku me teh shumë të mprehtë”; *këmbëqiri* “që i ka këmbët e holla, të gjata dhe të drejta”, ku si referent për formën dhe trashësinë ka shërbyer realia *qiri* “shkop i drejtë prej dylli a dhjami që ndizet për të bërë dritë” etj.

Në pamje të parë, duket se kompozitat e lartpërmenduara, për shkak të perceptimit konkret dhe të dukshëm të realieve, e kanë sendërtuar realitetin nëpërmjet emërtimit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në disa raste, vërehet një zgjerim i strukturës dhe vëllimit kuptimor, duke krijuar kuptime të reja të figurshme, ndër të cilat mund të veçonim kompozitat e ndërtuara me përbërësin emëror “gojë” të tipit; *gojëpashmagje-gojëçorap-gojëbrisk-gojëkamare- gojëshpellë* etj. Të gjitha këto struktura janë ndërtuar mbi bazën e një

teme semantike të përbashkët, si nyje kuptimore për krijimin e këtij vargu ka shërbyer kuptimi leksikor “që e ka gojën shumë të madhe, që flet shumë, llafazan” etj. Qasjet e ndryshme përkundrejt realitetit e kanë shprehur këtë kuptim në mënyra dhe forma të ndryshme.

Shkalla e abstragimit dhe niveli i ndërmjetimit, të para në planin krahasues me kompozitat e lartpërmendura, janë më të theksuara dhe më dominante te kompozitat në të cilat gjymtyra përcaktore që mbart ngarkesën plotësuese është emër, kuptimi leksikor i të cilit, i veshur edhe me mbishtresimin konotativ, përftohet mbi bazën konkrete sendore-konceptore të referentëve me cilësi veçanërisht të dallueshme për mendësinë e përzgjedhësve të këtyre njëjësive.

Karakteri idiomatik është më i theksuar te strukturat e mëposhtme dhe ngarkesa semantike është më e madhe, pavarësisht se cilësimi i realies nuk është shenjuar formalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë *zemërkëllirë, zemërakull, zemërflori, zemërçelik, zemërshkëmb, zemërgur, zemërhekur, zemërkëllirë, zemrëkatran, buzëshkrumb, dorëflori, shpirtgur zemërhekur* etj. Vëllimi semantik i këtyre ndërtimeve leksikore është edhe më i theksuar për shkak se vetë gjymtyra përcaktuese është një emër që, për vetë shkallën e përgjithësimin që ka, i mbart në vetvete të gjitha tiparet. Më të gjitha rastet metafora shënon vlera të absolutizuara që realia e shprehur me gjymtyrën përcaktuese ia transmeton edhe elementit të përcaktuar. Edhe ky proces gjuhësor është i lidhur ngushtë me procesin e njohjes dhe të bashkëshoqërimit të imazheve të abstraguara me konceptin dhe veshjen tingullore përkatëse. Leksemat e përzgjedhura kanë kuptim të drejtpërdrejtë të intensifikuar dhe koncepti i përtëritur përshfaqet në gjuhë nëpërmjet realizimeve konkrete të këtyre kompozitave.

Bërthama semantike e këtyre krijimeve qëndron te njëri element, i cili natyrshëm ia transferon vlerat e amplifikuara elementit tjetër. Kështu ka ndodhur me kuptimin tërësor të kompozitës *zemërkëllirë*, e përftuar mbi temën semantike të emrit *këllirë* “papastërti, zhul” ku transferimi i imazhit të perceptuar mendërisht është bërë natyrshëm dhe organikisht për shkak të zgjedhjes së duhur të bazës lëndore. Nëpër të njëjtin proces ka kaluar *zemërakull* nga *akull*, një metaforë e hiperbolizuar. Treguesit e vlerës, rëndësisë, forcës, ashpërsisë, ligësisë etj., janë shprehur metaforikisht me leksemat *flori* “monedhë ari me vlerë të çmuar”; *çelik* “metal i fortë”; *shkëmb* “gur shumë i madh dhe i fortë”; *hekur* “metal i rëndë”; *katran*

“lëng i trashë me ngjyrë të zezë”; *shkrumb* “lëndë e zezë që mbetet kur digjen plotësisht sende të ndryshme”; *gur* “lëndë minerare e fortë dhe e patretshme në ujë” etj.

**3.3.4.** Figurat e besimit popullor zakonor, fetar dhe ato të demonologjisë kanë shërbyer edhe si objekt krahasimi në përfitim të një numri kompozitash mbiemra, ku cilësitë e përzgjedhuara janë të hamendësuara, jokonkrete, joreale dhe jo të prekshme, por ato mbartin vlera të theksuara kuptimore. Figurat janë marrë nga mitologjia, legjenda dhe folklori burimor, si: *kuçedër, shtrigë, stih, lubi, djall, lugat, engjëll, arap* etj. Shembuj të tillë janë: *flokëkuçedër, flokështrigë, barkstih, barklubi, shpirtdjall, shpirtlugat, sylugat, syengjëll, zemërdjall, zemërnjerkë, zemërshtrigë, gojënjerkë, flokarapi* etj. Karakteri i ndërmjetuar në këto njësi leksikore është më i theksuar për shkak se realitetet e konceptuara janë më abstrakte dhe fryt i imagjinatës së shqipfolësve, të cilët, edhe pse nuk e kanë realizuar njohjen e këtyre realiteteve përmes përvojave reale të drejtpërdrejta, kanë arritur të shkodojnë me anë të tingujve të gjitha imazhet e perceptuara, duke dëshmuar në të njëjtën kohë se i kanë zbërthyer më së miri të gjithë treguesit e realiteteve, të cilat i kanë ndihmuar për t’i përfytyruar konceptualisht ashtu siç duhet dhe për t’i dhënë veshjen e duhur tingullore.

Edhe në këto raste procesi i emërtimit është i motivuar dhe mund të argumentohet si më poshtë: për kompozitat *flokëkuçedër, flokështrigë* dhe *flokarapi*, është tipari i flokëve të çrregullt, që u atribuohet njerëzve të gjinisë femërore. Edhe figurat e krahasuara të krijimtarisë popullore janë përfytyruar si krijesa femërore, përkatësisht, *shtrigë* “plakë e keqe dhe e shëmtuar” apo dhe me kuptimin e metaforizuar “grua a plakë e vetmuar dhe e keqe”; *kuçedër* “gjarpër i madh me dy dhe trembëdhjetë kokë” dhe me kuptimin e figurshëm “grua zemërligë”. Më të ngarkuara emocionalisht janë kompozitat *zemërnjerkë, zemërshtrigë, zemërdjall, shpirtlugat*, të cilat i lidh një temë semantike “shpirtkeq, zemërkeq” dhe referentët e zgjedhur si subjekt për të realizuar krahasimin janë *djall* “qenie e mbinatyrshme e përfytyruar si sinonim i së keqes”; *shtrigë* “figurë e besimeve popullore që ha njerëz dhe bën magji të liga”; *lugat* “figurë e besimit popullor i cili në gjallje është shumë i keq dhe pas vdekjes ngrihet dhe tremb njerëzit”.

Më interesante është zgjedhja e leksemës *njerkë*, e cila, edhe pse në kuptimin e përmendur leksikor nuk mbart asnjë nuancë konotacioni negativ: “gruaja e dytë e babait përkundrejt fëmijëve të burrit”, për shkak të mendësisë së përgjithshme dhe paragjykimeve tradicionale është parë si një figurë “që sillet keq, ashpër dhe pa dhembshuri”, ashtu siç na e dëftën edhe

kuptimi i figurshëm që i është bashkangjitur kësaj njësie. Të njëjtat argumente mund t'i përdorim edhe për kompozitat me përbërës emëror *bark* me dallimin se për kompozitat *barkstih* dhe *barklubi* nyja semantike është kuptimi leksikor i figurshëm “që është i pangopur, që nuk ngopet, i babëzitur”, por edhe “njeri me përmasa të mëdha trupore”, duke perceptuar cilësitë e veçanta dalluese të dy figurave të përrallave popullore si qenie të mbinatyreshme me tipare dhe përmasa të pazakonta. Kuptimi i kompozitës *barkdreq* është “që rron në kurriz të të tjerëve, që e ka shpirtin e keq”, një njësi e përligjur plotësisht me besimin e përgjithshëm që kjo krijesë si simbol i së keqes dhe ngasjes për punë të liga, i ka të mishëruara të gjitha cilësitë negative

**3.3.5.** Ndër mënyrat e veçanta mbi bazën e të cilave ndërtohen një varg kompozitash mbiemra janë ato me ndërtime emër+pjesore e adjektivuar. Lidhja e së tërës me pjesën në këto raste, nuk bëhet përmes procesit të metaforizimit, por elementi i dytë i pjesores i shënon në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtu shkalla e abstragimit është më e ulët dhe përqsasja bëhet mbi bazën e mënyrës se si kryen veprimet, lëvizjet etj., për shembull: *flokëlëshuar*, *flokëpakrehur*, *flokëzbardhur*, *leshpalarë*, *barkngopur*, *barkmbushur*, *buzëplasur*, *buzëlidhur*, *buzëpjekur*, *buzëqarë*, *buzëthyer*, *buzëvarur*, *kokëqethur*, *mendjengjeshur*, *kokëthinjur*, *dorëgrisor*, *shpirtkulluar*, *shpirtndritur*, *zemërdjegur*, *zemërthyer*, *këmbëthyer*, *symbyllur* etj. Nga pikëpamja strukturore këto kompozita e mbartin në vetvete raportin përcaktues pronësor dhe mund të zbërthehen “që e ka barkun (buzën, kokën, këmbën, qafën) të fryrë (të thyer, të dredhur, të shtrembër, të thyer)” etj. Edhe pse në pamje të parë duket se këto kompozita e kanë ndërmjetuar cilësisht realitetin në mënyrë më të thjeshtë, një pjesë e tyre janë përtëritur në aspektin e shumëkuptimësisë, duke i shtuar ngjyresat, duke i zgjeruar bazën konceptore të kuptimit dhe duke fituar vlera më të mëdha shprehëse.

Këtij procesi i janë nënshtruar kompozitat *barkgjerë* që, përveç kuptimit të pammë të drejtpërdrejtë “që e ka barkun të gjerë apo të fryrë”, është pasuar figurativisht me kuptimin “zemërgjerë, dorëlëshuar”; *barkthatë* “që e ka barkun të thatë, i pangrënë, i uritur”, ka fituar kuptim të ri “që nuk lind dot fëmijë”. Në të njëjtën mënyrë janë zgjeruar kuptimisht kompozitat *buzëdjegur* “që i ka buzët të thara” dhe “shumë i dëshiruar për diçka”; *buzënxirrë* “që i ka buzët të nxira a të zeza” dhe “që ka hequr shumë në jetë”; *këmbëzbathur* “që i ka këmbët e zbathura” dhe “i varfër, i këputur”, *kokëprerë* “që i kanë prerë kokën” dhe “që ka mbetur pa përkrahje”; *qafëthyer* “që e ka qafën të thyer, të këputur” dhe “qafëkëputur, që e

theftë qafën” etj. Por ndodh edhe që struktura kuptimore të ketë lidhje kuptimore të një natyre më të ndërlikuar, gjatë së cilës kategoritë e përfuara në rrafshin e përmbajtjes nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë, por e shfaqin raportin korrespondues (korrelativ) mbi bazën e zhvendosjes paraprake të imazhit, duke krijuar njësi kuptimore që kanë shënuar formalisht realie abstrakte dhe, rrjedhimisht, mbartin vetëm kuptim të figurshëm. Të tilla janë kompozitat me element të përcaktuar emrat *mendje, kokë, shpirt dhe zemër*, si *mendjefletur, mendjengjeshur, shpirtpangopur, dorëgrisor, shpirtkulluar, shpirtndritur, zemërdjegur, zemërçelur, zemërdjegur, zemërdhënës, zemërhapur, zemërlëshuar, zemërthyer, kokëkrisur* etj. Këto ndërtime nuk zbërthehen si kompozita me marrëdhënie përkitësie. Kështu, *mendjefjetur* ka kuptimin “që është i qetë dhe i sigurt”; *mendjembledhur* “që e ka vendosur si duhet të veprojë”; *mendjendryshkur* “që ka mbetur pa u zhvilluar nga ana mendore”; *shpirtkulluar* “që e ka shpirtin e mirë, bujar, zemërmirë”; *shpirtndritur* “që e ka shpirtin të pastër dhe fisnik”; *zemërçelur* “i çiltër”, *zemërdjegur* “që i është plagosur zemra, i hidhëruar”; *zemërhapur* “që nuk ka asgjë për të fshehur”; *zemërlëshuar* “që e ka humbur besimin dhe guximin”; *zemërplasur* “që nuk i janë plotësuar dëshirat e zemrës”, *kokëkrisur* “që sillet dhe vepron me guxim të tepruar”; *kokëngjeshur* “kokëfortë, që nuk kupton” etj.

**3.3.6.** Nga tipat më frytdhënës, që kanë formësuar një numër të madh kompozitash mbiemërore, janë edhe gjedhet fjalëformuese të tipit *emër+mbiemër i panyjshëm*. Te këto kompozita, nga ana e motivimit të brendshëm, shkalla e ndërmjetimit është më e drejtpërdrejtë sepse realia shenjohe në bazë të tipareve të spikatura të saj. Në gjedhet fjalëformuese të këtij lloji pjesa përcaktuese e tiparit të referentit është zakonisht një mbiemër cilësues i drejtpërdrejtë (i egër, i mirë, i madh, i shtrembër, i thellë, i shkurtër, i trashë, i lehtë, i lirë etj.), që shpreh tiparet të qenësishme të realies të lidhura me formën, madhësinë, gjatësinë, ashpërsinë, butësinë etj., si: *leshëgër, buzëmadh, buzëtrashë, gjumërendë, gjumëlehtë, buzëprerë, buzëthatë, gojëzi, kokëbosh, kokëpërpjetë, kokështrembër, mendjeçalë, mendjegjerë, mendjehollë, mendjekeq, mendjelartë, mendjelehtë, mendjemadh, mendjemirë, mendjemprehtë, mendjepakët, mendjeshkathët, mendjetrashë, mendjethellë, mendjeulët, kokëtrashë këmbëshkurtër, këmbëshpejtë, këmbështrembër, dorëlibër, dorëhollë, dorëlartë, dorëlehtë* etj. Në këto njësi, megjithëse nuk bëhet ndonjë lëvizje e dukshme e kuptimit apo zhvendosje mbi bazën e tropeve të metaforës a metonimisë, motivimi i

brendshëm përftohet përmes procesit të një abstragimi më të thellë. Gjymtyra përcaktuese, që mbart ngarkesën plotësuese, luan rolin kyç në formësimin e njësisë së re leksikore.

Nëpërmjet këtij procesi kanë kaluar kompozitat e krijuara me përbërësin emër *mendje*, *shpirt* apo *zemër*, ku *mendjemadh* do të thotë “njeri që i pëlqen shumë vetja”<sup>100</sup>, *mendjelartë* “që punon e mendon për një çështje fisnike”, *mendjengushtë* “njeri që i gjykon gjërat cekët, që ka pak njohuri, i paditur” *mendjehollë* “që i kap gjërat shumë shpejt”, *shpirtmadh* “që ka në shpirt ndjenja të pastra”<sup>101</sup>, *shpirtthatë* “që nuk ka asnjë ndjenjë”<sup>102</sup>, *shpirtzi* “që do t’u bëjë keq të tjerëve”, *shpirtvogël* “që edhe për gjërat e vogla shikon përfitimin e vet”, *shpirtngushtë* “që nuk do t’u bëjë mirë të tjerëve”<sup>103</sup>, *zemërdobët* “që mallëngjehet shpejt”<sup>104</sup>, *zemërashpër* “që nuk ka dhembshuri për të tjerët”<sup>105</sup>, *zemërgjerë* “bujar, i durueshëm”, *zemërtharë* “që nuk ka asnjë ndjenjë njerëzore”<sup>106</sup>. Shumësia e kompozitave të krijuara në këtë mënyrë krijon një fushë të pasur leksikore mbiemrash që shprehin cilësi të karakterit, natyrës njerëzore dhe sjelljes.

**3.3.7.** Shkalla e abstragimit dhe niveli i ndërmjetimit, të para në planin krahasues të kompozitave të lartpërmendura, janë më të theksuara dhe më mbizotëruese të kompozitave ku gjymtyra përcaktore është një emër, kuptimi leksikor i të cilit sendërtohet mbi bazën konkrete sendore-konceptore të referentëve me cilësi veçanërisht të dallueshme për mendësinë e përzgjedhësve të këtyre njësisve. Karakteri idiomatik është më i theksuar te ndërtimet e mëposhtme ku ngarkesa kuptimore-stilistike është më e madhe, pavarësisht se cilësimi i realies nuk është shenjuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtij tipi fjalëformimi i përkasin kompozita të tilla, si: *zemërhekur*, *zemërakull*, *zemërshtrigë*, *zemërflori*, *zemërçelik*, *zemërshkëmb*, *zemërpulë*, *zemërqen*, *zemërbishë*, *zemërgur*, *zemërhekur*, *zemërkëllirë*, *zemërkatran*, *buzëshkrumb*, *buzëvrer*, *dorëborë*, *dorëflori*, *shpirtgur*, *shpirtlepur*, *shpirtqen*, *shpirtmizor*, *shpirtskllav*, *shpirtnjerkë* etj.

Duke u mbështetur në tipologjinë e shpjegimit të kuptimit leksikor të tyre, mund të analizohet dhe motivimi i brendshëm. Për shembull: *zemërakull* “që nuk ka ndjenja, që e ka

---

<sup>100</sup> *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 1112.

<sup>101</sup> Po aty, f. 1906.

<sup>102</sup> Po aty, f. 1907.

<sup>103</sup> Po aty.

<sup>104</sup> Po aty, f. 2225.

<sup>105</sup> Po aty.

<sup>106</sup> Po aty, f. 2227

zemrën të ftohtë” (fjala *akull* e shënon cilësinë në shkallën sipërore: *akull i ftohtë*); *zemërkatran* “që e ka shpirtin të zi, që kënaqet me fatkeqësinë e tjetrit”(fjala *katran*, gjithashtu, e shënon cilësinë në shkallë shumë të lartë). Pra, motivimi i brendshëm mbështetet në kuptimet e prejardhura mbiemërore ose ndajfoljore (në përgjithësi të figurshme) të emrave të tillë, si: *akull* “shumë i ftohtë”, *hekur* “shumë i fortë”, *çelik* “shumë i fortë, i çeliktë”, *shkëmb* “shumë i fortë, që s’tundet nga e tija”, *gur* “shumë i fortë e i ngjeshur”, *pulë* “njeri i urtë, i drojtur e tepër i butë; njeri frikacak, që përulet e nënshtrohet lehtë”, *flori* “shumë i mirë, i mrekullueshëm”, *bishë* “njeri shumë i egër, mizor”, *vrer* “shumë i hidhëruar, i vrerosur”, *lepur* “frikacak i madh”, *shkrumb* “shumë i zi”, *njerkë* “e keqe, që s’ka dhembshuri” etj.

### **3.4. Motivimi i formës së brendshme të kompozitave mbiemra mbi bazën e ngjyrimin emocionues**

Gjetja dhe përdorimi i mënyrave të ndryshme për ta cilësuar të njëjtën realie, përkujdesja për ta shtresëzuar kuptimin leksikor dhe mbivendosja e nuancave kuptimore dhe konotacionit edhe në rastet kur kuptimi leksikor duket se është i zhveshur nga kontacioni, si te kompozitat që shprehin cilësi fizike të referentëve, përligjen nga qëndrimi i folësve dhe raporti i afërsisë që ai ka me individin që do të cilësojë. Në këto njësi konotacioni është i përshkallëzuar: ai kalon nga tonet më të ulëta, neutrale, ku cilësia duket se shprehet më objektivisht, mbi bazën e mënyrës se si janë ndërtuar ato.

**3.4.1.** Me strukturë emër+emër: *barkbuall* “që e ka barkun shumë të madh”, *barkçalik* “barkfryrë”, *barkderr* “barkmadh”, *barkdërrasë* “që e ka barkun të tharë e të futur nga të pangrënët, barkthatë”, *barkdosë* “barkmadhe, e pangopur”, *barkhambar* “që s’ka të ngopur, hamës i madh”, *barkkacek* “barkfryrë”, *barkmace* “që ha shumë pak”, *barkpetë* “që e ka barkun të sheshtë, i dobët”, *barkzhabë* “që e ka barkun të madh, të squllët e të varur poshtë”, *buzëburbuqe* “me buzë të kuqe, të vogla e të mbledhura si burbuqe”, *buzëkuti* “që i ka buzët të vogla e të rregullta”, *buzëqumësht* “që është ende fëmijë, i parritur”, *buzësheqer* “gojëmbël”, *buzëviç* “që i ka buzët të gjera e të trasha si të viçit”, *dhëmbëbrisk* “që i ka dhëmbët shumë të mprehtë”, *dhëmbëçatall* “që ka dhëmbë të shtrembër e të dalë jashtë radhës, dhëmbëkatarosh”, *dhëmbëkatarosh* “që i ka dhëmbët kataroshë, që ka stërdhëmb”,

*dhëmbëqelibar* “që i ka dhëmbët të bukur e të shndritshëm”, *dhëmbërruazë* “që i ka dhëmbët të vegjël, të rregullt e të bukur”, *dhëmbëstrall* “që i ka dhëmbët shumë të fortë”, *dhëmbëshatë* “që i ka dhëmbët shumë të gjerë e të mëdhenj” etj.

**3.4.2.** Me strukturë emër+mbiemër: *bishtgjatë* “që e ka bishtin të gjatë”, *bishtpërdredhur* “1. që e ka bishtin të përdredhur. 2. e pamoralshme”, *bishtpërpjetë* “që e mban bishtin të ngritur përpjetë”, *bishtprerë* “që e ka bishtin të prerë”, *bishtshkurtër* “që e ka bishtin të shkurtër”; *buzëbardhë* “që i ka buzët të bardha, *buzëpalosur* “që i ka buzët të holla dhe që i mban të puqura fort njëri me tjetri”, *buzëpërdredhur* “që bën naze për çdo gjë, buzëhollë”, *buzështrembër* “që i ka buzët të shtrembra a që i shtrembëron me mospërfillje”, *dhëmbëkrimbur* “që i ka dhëmbët të krimbur, dhëmbëprishur” etj.

**3.4.3.** Si përftohet ngjyrimi emocionues në njësi të tilla leksikore? Jani Thomai shkruan se ngjyrimi emocionues është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj që përmend, vlerësim subjektiv i dikujt a diçkaje<sup>107</sup>. Kompozitat mbiemërore, përveçse janë mjete të zhdërvjellëta të shprehjes së qëndrimit subjektiv emocionues, ato mbartin vlera të qarta kuptimore dhe nuanca formuese dhe arrijnë të sintetizojnë, konkretizojnë dhe aktualizojnë gjykimin, mençurinë dhe mendësinë e kulturës në të cilën këto mjete ligjërimore kanë marrë jetë.

Një pjesë e madhe e këtyre kompozitave bën pjesë në ato shtresa stilistike të gjuhës që kanë nuanca të theksuara shprehëse dhe janë pjesë e gjuhës së folur. Këto nuanca janë shprehje e qëndrimit të folësit në kontekstin e familjaritetit, shakasë, ironisë, urrejtjes, përbuzjes, mospërfilljes etj. Madje, edhe të njëjtat tipare, cilësi, emocione, ndjesi etj., shqipfolësit rreken t’i emërtojnë në mënyra të ndryshme. Po sjellim për konkretizim vetëm disa prej vargjeve të tillë me të njëjtën tipologji shpjegimi të kuptimit leksikor, si: *hundëdash* “që e ka hundën të kthyer përbrenda e të lakuar si të dashit”, *hundëkalem* “që e ka hundën të drejtë, të hapur e të bukur”, *hundëkërrabë* “që e ka hundën me majë të kthyer poshtë”, *hundëqiri* “që e ka hundën të drejtë si qiri”, *hundëspec* “që e ka hundën të kuqe”; *këmbargjend* “që i ka këmbë të bardha e të bukura”, *këmbëdrapër* “që i ka këmbët të harkuara si drapër”, *këmbëgjarpër* “që vepron fshehurazi, dinak, që nuk i tregon këmbët”, *këmbëlepur* “këmbëshpejtë”; *sygështenjë* “që i ka sytë në ngjyrë të gështenjës”, *sygrifshë* “që i ka sytë të bardhëmë e të larmë”, *symace* “që i ka sytë të bardhë e të ndritshëm si të maces”,

---

<sup>107</sup> Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2005, f.101.



*syshqerrë* “që ka sy të mëdhenj dhe me shprehje të butë e të ëmbël”, *symizë* “që i ka sytë të vegjël e të zinj”, *sypetrit* “symprehtë”, *syrrush* “që i ka kokërdhokët e syve pak të dale”, *syshqiponjë* “që ka sy shumë të mprehtë, symprehtë” etj.

Sikurse shihet nga shembujt e dhënë, ngjyrimi emocionues i këtyre kompozitave është një mjet për motivimin e tyre fjalëformues e kuptimor, pra ai shërben për të gjetur “formën e brendshme” të tyre, në kuptimin e gjerë të fjalës dhe kjo sepse, siç vëren J. Thomai, ngjyrimi emocionues mund të shërbejë si temë semantike për fjalë të tjera <sup>108</sup>, siç ndodh te fjalët *dhelpëri*, *dhelpërisht* etj.

### **3.5. Organizimi kompozitave sipas fushave konceptore dhe leksikore në funksion të formës së brendshme**

Vargjet e gjata sinonimike të kompozitave përshfaqin variacione dhe përthyerje të efektshme; ato shmangin monotoninë dhe përsëritjen, gjallërojnë stilin, përsosin mjete të fuqishme të përdorimit figurativ duke paraqitur një qerthull mundësish për të konkretizuar dhe përgjithësuar dëshirat, qëndrimet dhe vlerësimet e individëve folës të gjuhës. Sinonimia është përftuar duke shfrytëzuar me përpikmëri ngjyrimet dhe nuancat, duke i plotësuar me konotacion shtesë, çka është karakteristike për ligjërimin e thjeshtë (thjeshtligjërimin). Së bashku me tipat dhe gjedhet fjalëformuese të “brumit të shqipes” vërehet se në këto raste është rritur shkalla e abstragimit dhe janë përtëritur format e shprehjes.


Analiza e kompozitave, si një nga mjetet më të fuqishme të pasurimit të leksikut të shqipes, na jep mundësi të shqyrtojmë nga pikëpamja praktike se dukuritë gjuhësore janë të lidhuara njëkohësisht me rrafshin e realitetit dhe të mendimit, me mënyrën se si një bashkësi gjuhësore e abstragon realitetin duke nxjerrë në pah tipare të veçanta të realieve, me mjetet që kjo bashkësi përzgjedh për të përpunuar formën e shprehjes, imazhet psikike që folësit sendërtojnë gjatë procesit të pëshfaqjes së koncepteve, me përfytyrimin që kanë këta të fundit për botën që i rrethon duke “prodhuar” një shumësi shenjash të ndryshme, origjinale dhe lehtësisht të dallueshme nga njëra tjetra. Dhe, në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se këto shenja gjuhësore formojnë një varg të zgjeruar sinonimik. Të njëjtat njësi formojnë një tërësi fushash konceptore dhe leksikore të bazuara te treguesit themelorë të


---


<sup>108</sup> Po aty, f. 105.

realies, të përzgjedhur dhe të sintetizuar mendërisht në bazë të perceptimeve të ndryshme që folësit zgjedhin për të asociuar simbolikën tingullore me një përkatësi “natyrore” të përmbajtjes së fjalës. Në rastin e kompozitave “substanca kuptimore” e lidhur me tërësinë e perceptimeve, qëndrimeve subjektive të folësve, ndjenjave dhe abstragimeve mendore, është e ndryshme.

**3.5.1.** Fusha konceptore, e lidhur me tipare të jashtme fizike të realies, ka formësuar një varg të gjatë sinonimik leksemash të mbishtresuara me konotacion pozitiv apo negativ. Kështu, tiparet e lidhura me *formën, rrumbullakësinë, shkëlqimin, ngjyrën* e fytyrës etj, folës të ndryshëm i qasin me treguesit fizikë të një fruti, që mund të jetë, sipas përzgjedhjes së tyre: *pjeshkë, mollë, portokalle, shegë, qershi, rrush, dardhë, mollçinkë* etj. Një fushë të ngjashme konceptore krijojnë kompozitat e bazuara te cilësitë fizike, si të *gjatësisë, madhësisë, formës,* duke i krahasuar me referentë të caktuar sipas shndërrimeve metaforike: *lejlek, patë, sorkadhe, kuti, qiri* etj. Më të shumta në numër dhe më të shumëllojshme nga pikëpamja e strukturës kuptimore janë kompozitat që shprehin cilësi të karakterit:







**3.5.2.** Raportet sinonimike të konkretizuara në brendësi të fushave konceptore dhe leksikore janë njëkohësisht edhe tregues i aftësisë fjalëformuese që përfshin në vetvete rritjen e shkallës së intensitetit dhe të vëllimit kuptimor, bashkëshoqëruar me diferencim të kuptimeve. Brenda së njëjtës fushe konceptore këto njësi mund të krijojnë raporte dhe marrëdhënie *pranëvënieje* (të barazisë apo ngjashmërisë, pra sinonimike) apo *kundërvënieje* (antonimike). Si vargje sinonimike me gjymtyrë që tregojnë raporte barazie shërbejnë të gjitha rastet e lartpërmendura, që paraqesin shumëllojshmëri sasiore dhe përshfaqin origjinalitet të aftësive kombinuase midis komponentëve të strukturave të përbëra.

Ndërsa raportet e kundëvënies paraqiten në struktura të çifteve dhe vargjeve antonimike, me strukturë emër+emër dhe emër+mbiemër:

*zemërmirë-zemërkeq;*

*shpirtmirë-shpirtkeq;*

*zemërpulë-zemërluan;*

*këmbëzi-këmbëbardhë;*

*shpirtvogël-shpirtmadh;*

*gojëmjaltë-gojëgjarpër-gojëzeher;*

*mendjethellë-mendjepakët;*

*duarflori-duartharë;*

*kryelartë-kokëulur;*

*mendjehollë-kokëmish;*

*qafëhollë-qafëtrashë;*

*leshashpër-leshbutë;*

*barkmadh-barkdërrasë;*

*qimeshkurtër-qimegjatë;*

*qafëdrejtë-qafëhark;*

*bishtgjatë-bishtshkurtër* etj., si dhe në struktura më të zgjeruara të tipit:

*shpirtlig-shpirtkatran-shpirtujk-shpirtzi-shpirtgur-shpirtkrimbur-shpirtlig-shpirtmizor-*

*shpirtmirë-shpirtkulluar-shpirtmadh-shpirtgjerë;*

*qafëgjatë-qafëhollë-qafëlejlek-qafëpatë-qafësorkadhe;*

*gojëgjarpër-gojënepërkë-gojëpiperkë-gojëspec-gojuthull-gojëzi-gojëmjaltë-gojëdukate-gojësheqer;*

*dorëkeq-dorëpiper-dorëcub-dorëfëlliqur-dorëdredhur-dorëthatë-dorargjendtë-dorëflori-dorëhapët-dorëçelët-dorëbardhë-dorëborë;*

*mendjeveri-mendjethellë-mendjengjeshur-mendjebardhë-mendjefemër-mendjehollë-mendjegjerë-mendjekthjellët-mendjefyçkë-mendjefyell-mendjehu-mendjekotë-mendjelaraskë-mendjepak-mendjepulë-mendjetrashë, mendjeshkurtër;*

*zemërlepur-zemërpulë-zemërbutë-zemërluan-zemërshkëmb-zemërçelik-zemërhekur-zemërzjarrtë;*

*bishtmushkë-bishtpallua-bishtpelëz-bishlopatë-bishlepur-bishtcung-bishtcubël-bishtcub etj.*

### **3.6. Kompozitat dëshirore dhe forma e brendshme**

Kompozitat dëshirore, si një pjesë e rëndësishme të leksikut popullor, dallohen për veçoritë e ndërliqura, të mbajtura me vlera të dukshme shprehëse dhe emocionuese. Mjetet dhe mënyrat e ndryshme që folësit gjejnë nga pikëpamja e kuptimësisë dëshirore janë të shumëllojshme. Forma e brendshme e tyre ka përmbajtje dëshirore dhe mund të zbulohet edhe kur nuk gjen pasqyrimin e saj të jashtëm në strukturën formale <sup>109</sup>. Ndërthurjet e gjymtyrëve të kompozitave të tilla janë të llojllojshme dhe nga ana semantiko-leksikore marrëdhëniet mes realies me përcaktuesin e saj dëshiror realizohen në mënyrë të ndërmjetuar e më të ndërlikuar. Për këtë qëllim ne kemi marrë në analizë rreth 110 kompozita dëshirore. Në përgjithësi, përmbajtja kuptimore e kompozitës mund të barazohet kuptimisht me fjali të plota të tipit dëshiror në formë mallkimi. Struktura kuptimore dhe semantika dëshirore e këtyre njësive është e ndryshme dhe mjaft origjinale.

Klasifikimi i treguesve të veçantë, që folësit e gjuhës shqipe kanë zgjedhur për të motivuar njësitë gjuhësore, mund të jepet si më poshtë:

**3.6.1.** Semantika dëshirore sendërtohet në kompozita njëkuptimëshe me vlerë mallkimi, ku vdekja, skamja, sëmundja, lëngata apo moslënia e pasardhësve, janë të shenjuarit mbi të cilët ngjizet forma e shprehjes së kuptimit dëshiror. Përbërësit e përcaktuar

---

<sup>109</sup> Kostallari A., *Kompozitat dëshirore*, vep. cit., f.155.

në pjesën më të madhe të rasteve janë leksemat: *ditë, derë, gojë, buzë, bark* etj., të shoqëruara edhe me pjesore të foljes apo me mbiemra prejfoljorë: *buzëlidhur, buzëkyçur, buzëmbërthyer, ditëprerë, nafakëpremë, orëdekun, orëpremë, orëvramë, drekëngrënë, emërshuar, grurëngrënë, gjumëmadh*. “Vdekja” është tema semantike mbi të cilën janë konkretizuar të gjitha këto njësi, të zberthyeshme semantikisht në fjali dëshirore në formë mallkimi: *t’u lidhtë buza, të humbtë vula, të hëngsha grurin, bëfsh gjumin e madh* etj., të cilat shërbejnë edhe si formë e brendshme për këto kompozita. Të përshkallëzuara me mjete më të fuqishme dhe të ngarkuara emocionalisht janë mallkimet që rëndojnë pas vdekjes, si: *varrvithisur, varrhumbur, varrtrapisur, vulëhumbur, emërshuar, varrpagjetur* etj. J. Thomai formimin e kompozitave të tilla e lidh me ato që i quan njësi frazeologjike pasthirmore ose në trajtë mallkimi<sup>110</sup>, duke i pranëvënë me njëra-tjetrën: *iu thaftë barku*→*barkthatë*; *iu lidhtë buza*→*buzëlidhur*; *iu thaftë dora*→*dorëtharë*; *i humbtë vula*→*vulëhumbur* etj.

**3.6.2.** Në gjuhën shqipe shenjohen në mënyra të ndryshme edhe mallkimet që lidhen me moslënien (mungesën) e pasardhësve. Në këto raste kompozitat janë të ngarkuara emocionalisht, si: *barktharë, barkshueme, derëmbyllur, derëkyçur, farëpalënë, derëshuar, djepfërrosur, farëhumbur, gjakshuar, derëkatran, farëpambetur, farëpapasur, derësterrë, pragshuar, zjarrshuar* etj.

**3.6.3.** Mallkimi për fatkeqësi, mundim, lëngim etj., në leksikun popullor konceptohet dhe aktualizohet me mjaft kompozita të tjera, si: *qafëthyer, qafëzi, qafëkëputur, jetëzi, jeterrët, udhëzezë, brengëmadh, syplasur, sydalë, sytharë, buzëpaqeshur, sypangopur, faqezi, buzëzi, buzerrët, ditëzi, diterrët, jetëzi, jeterrët, hundëpërshesh, grykëzënë, këmbëbigaçë, kambëçengel, dhëmbëskërbajë* etj.

**3.6.4.** Sëmundjet, në shumë raste ato të pashërueshme, janë një tjetër burim i formësimit të një numri kompozitash me vlera të theksuara dëshirore, si: *kolerëmadh, flamëngrënë, flamëmadh, murtajëmadh, alivanmadh, damblamadh, ëngëlmadh, lëngimmadh, pikëmadh, shapllamadh, tartakutmadh, shkumbëngarë, shkumëpërpjekur, shkumbëdalë, pikërenë* etj., të cilat, gjithashtu, kanë si tema semantike dhe strukturore njësitë frazeologjike në formë mallkimi: *të hëngërt flama, të rëntë pika* etj.

---

<sup>110</sup> Thomai J., *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, f.194.

**3.6.5.** Një nivel më i lartë abstragimi vërehet në rastet kur mallkimi ka për bazë një sëmundje apo paaftësi mendore apo kur “objekti” mbi të cilin do të bjerrë mallkimi nuk është sendërzuar në mënyrë konkrete. Të tilla janë njësitë: *brenëzënë, brenëmadh, dorëtharë, dorëkëputur, frymëzënë, grykëtharë, gjuhërenduar, gjuhëtharë, gjuhëprerë, kokëtharë, kokëhumbur, kryekëputur, qafëkëputur, qafëthyer, sytharë, trudalë, trurrjedhur, trushkulur, sypanopur, fatpadalë, buzëpagëzuar* etj.

**3.6.6.** Edhe kompozitat dëshirore me funksion eufemistik janë të larmishme: *gojëmylluri, gojëthari, gojëlidhuri, buzëmbërthyeri, buzëkyçuri, gojëqepuri, grykëtharë, grykëzënë, gjuhëtharë, qafëthyer, rrashbitisum, hajujku, qoftëlargu, farëmiri, punëhera* etj. Më të pakta në numër janë kompozitat dëshirore, të cilat mund të zërthehen në fjali dëshirore në formë urimi: *jetëgjatë, këmbëmbarë, shpirtlumtur, shpirtndritur, buzëqeshur, ndjezoti* etj.

### **3.7. Forma e brendshme e kompozitave terma**

Forma e brendshme e kompozitave terma është e mbështetur plotësisht mbi bazën e perceptimeve të sakta të imazheve dhe shëmbëllimeve të realieve dhe është po kaq lehtësisht e përligjur me përzgjedhjen e duhur leksikore që kanë bërë shqipfolësit. Këto emërtime janë të zërthyeshme strukturalisht dhe semantikisht dhe mund të analizohen si më poshtë.

**3.7.1.** Emërtime terma të cilat treguesi i ngjyrës përkufizon semantikisht edhe gjymtyrën përcaktuese të emërimit: *ballëverdhe* “zog i vogël, që e ka ballin të kuq me pika të verda”, *barkkuqe* “lloj kërpudhe që hahet, e cila e ka të kuqërremtë anën e poshtme të kësulës”, *bishtakuq* “peshk i familjes së krapit, me pendë të kuqe”, *bishtbardhe* “zog i vogël sa dallëndyshja, me pendë ngjyrë hiri dhe me bisht të bardhe”, *bishtkuq* “zog i vogël këngëtar, me bisht si të kuqërremtë, që jeton zakonisht nëpër vrimat e mureve a të ledheve”, *cinxakuq* “cinxami me një pullë të kuqe”, *ferrëbardhe* “shkurre e degëzuar me lule në ngjyrë të bardhe”, *gjarpërzi* “gjarpër i zi shumë i shkathët që rri në kënetat dhe gjuan minj nëpër ara”, *gjelazez* “shpend me pendë të zeza”, *gjembbardhe* “gjemb i bardhe”, *kashtëbardhe* “bimë e vendeve të lagështa me kërcell të mbushur me palcë, që ka gjethe të holla e me push të bardhe”, *kashtëkuq* “bimë e vendeve moçalore, që e ka kërcellin të kuq”, *kazezë* “lopë me qime të zeza”, *kokërrzezë* “bimë me kërcell të gjatë e me gjethe të rralla që bën kokrra si të



rrushit me ngjyrë të zezë në vjollcë”, *krahbardhë* “dhi etj., me një rën anë trupit të bardhë”, *larëmushkë* “dhi e murrme dhe me lara”, *lulebardhë* “bimë barishtore e egër me gjethe të vogla heshtore, me lule të bardha në vjollcë, që rritet zakonisht në arat e mbjella me drithëra”, *lulëkuqe* “bimë barishtore me gjethe të çara, me lule të kuqe me katër petla të mëdha që rritet në të lashtat”, *pendëkuq* “një lloj krapi i kuqërremtë” etj.

**3.7.2.** Në mjaft raste është nxjerrë në pah dhe është formësuar strukturalisht tipari dallues i formës, mënyrës së lëvizjes/veprimit. Termat e mëposhtëm e konkretizojnë këtë gjë: *barkgjerë* “peshk i vogël i ujërave të ëmbla me bark të gjerë”, *bishtagjatë* “trishtil me bisht të gjatë, që rron nëpër pyje”, *bishtatundës* “zog i vogël sa një trumcak, me ngjyrë të hirtë dhe me bisht të gjatë, që e tund kur ecën”, *bishthollë* “bimë barishtore me gjethe vezake, me kallinj të hollë e të vetmuar”, *brikeqe* “dhi me brirë të shtrembër”, *buzëmadhe* “bimë e egër barishtore, me gjethe të gjera si të lulëshqiponjës dhe me lule të bardha në trajtën e manushaqes”, *dygrrëmç* “sfurk me dy dhëmbë”, *dyzetkëmbësh* “shumëkëmbësh”, *lëkurëgjembore* “familje kafshësh të ujërave të kripura si iriqi i detit, ylli i detit etj., që e kanë lëkurën me gjemba”, *lëkurëtrashë* “kafshë gjitare si hipopotami, hundëbriri etj., që kanë lëkurë të trashë, me qime të shkurtra e të forta dhe bark të madh”, *qafëgjatë* “shpend uji i madh si çafka me qafë të gjatë dhe këmbë të gjata”, *sqepgjatë* “shpend i brigjeve të detit me trup mesatar, me kokë dhe me qafë të zezë, me bark të bardhë e me sqep të kuq”, *sqeptrashë* “zog i ngjashëm me trumcakun me pendë të murrme në të kuqërreme, me gushë të bardhë dhe me sqep të trashë”, *shumëkëmbësh* “kafshë e vogël unazore, me shumë këmbën të nyjëtuar” etj.

**3.7.3.** Një klasifikim tjetër mund të bëhet mbi bazën e mënyrës se si sendërtohen treguesit e funksionit, rrezikut apo dobisë që ka secila nga realiteti bimë apo kafshë. Nën këtë ndarje mund të renditim: *dhemizë* “mizë që pështyn mishin, mizë mishi”, *ferrëkapëse* “bimë barishtore me kokrra me gjemba që u ngjitet bagëtive në trup ose njerëzve në rroba”, *bythëpulë* “sëmundje lëkure me rrathë të vegjël puçrash të kuqërreme”, *buzëkuqe* “kandërr me ngjyrë të kuqe të errët që thith gjakun”, *fletëpërdredhëse* “sëmundje e bimëve që ua rrëzon gjethet ose i than fare ato”, *lulengjitëse* “bimë barishtore shumëvjeçare me lule të kuqe që i ka gjethet e kërcellin me push të imët ngjitës dhe që rritet në livadhe”, *sqepadruth* “zog me sqep të fortë me të cilin godet lëvoren e drurëve”, *sygjarpër* “lloj lulëkuqeje që rritet si bimë e egër dhe e dëmshme”, *tamblagjak* “bimë barishtore, kërcelli i të cilës nxjerr një lëng si

qumësht, shumë të hidhur”, *thithlopë* “lloj bretkose e madhe me lëkurë të gjelbër që i ngjitet lopës në sisë dhe ia thithte qumështin”, *farëngrënës* “buburrec i vogël që ha farat e bimëve” etj.

**3.7.4.** Metafora e ndërtuar mbi krahasimin dhe shndërrimin e figurshëm të imazheve të perceptuara nga një realie te një tjetër mbi bazën e ngjashmërive të dukshme ka përfutuar një varg kompozitash terma. Elementët e krahasuar në pjesën më të madhe janë kafshë, bimë apo dhe objekte konkrete dhe qasja me përbërës të realies mbi bazën e shembëlltyrës së përbashkët mund të kategorizohet:

**3.7.4.1.** Shndërrime metaforike të bazuar te forma e ngjashme e dy realieve të ndryshme. Tiparet mbizotëruese të krahasuara janë *balli*, *bishti*, *lulet* apo *gjethe*, si p.sh.: *ballëhënë* “kafshë me një ballë të bardhë si hënë”, *bishtfurkë* “nuselale, kafshë mishngrënëse me gëzof të murrmë dhe me bisht të gjatë”, *bishtgjele* “rosë e egër me bisht të gjatë si të gjelit”, *bishtfultere* “larvë bretkose me bisht të gjatë, bishtlopë”, *dorëzonjë* “shkurre kacavarëse që çel lule të kuqërreme, të cilat i ngjajnë një dore të vogël dhe kanë erë të mirë”, *dhëmbësutë* “guaskë e vogël deti e bardhë, e ngjashme me një dhëmb sute”, *thundërmushkë* “bimë barishtore me kërcell me push, me gjethe të dhëmbëzuara që i ngjajnë thundrës së mushkës”, *lulerruazë* “bimë barishtore që rritet deri në një pëllëmbë dhe çel lule të vogla si rruaza”, *lëkurëgjembore* “familje kafshësh të ujërave të kripura, si iriqi i detit, ylli i detit etj., që e kanë lëkurën me gjemba”, *lulebufkë* “bimë barishtore zbukuruese me gjethe të vogla e të holla, me lule të verdha e të grumbulluara në tufë”, *lulekupë* “bimë barishtore zbukuruese me tri-katër gjethe të trasha, të gjera e heshtore dhe me zhardhokë në rrënjë, e cila nxjerr vetëm një lule në trajtë kupe në çdo kërcell, pa erë e zakonisht në ngjyrë të kuqe, të verdhë”, *lulefilxhan* “bimë shumëvjeçare, me kërcell të drejtë, me lule si kupë e vogël a si filxhan në ngjyra të ndryshme, e cila rritet në natyrë ose mbillet si bimë mjekësore”, *lulegojë* “bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të degëzuar, me gjethe heshtore dhe me lule shumëngjyrëshe në trajtë goje që mbillet për zbukurim; gojë asllani”, *luleshqiponjë* “bimë shumëvjeçare zbukurimi, me gjethe të mëdha e të prera thellë, që u përngjajnë krahëve të shqiponjës”, *luleve* “bimë barishtore me gjethe, me frute të bardha e të rrumbullakëta si vezë, që mbillet për zbukurim” etj.

**3.7.4.2.** Kuptimi i figurshëm metaforik në mjaft raste nuk është kufizuar vetëm në identifikimin e një tipari dallues lehtësisht të perceptueshëm, por shkalla e abstragimit është

më e lartë dhe fazat nëpër të cilat ka kaluar procesi i emërimit janë më të ndërlikuara, duke u nxjerrë në pah dhe duke u identifikuar me më shumë se një tregues. Për shembull, tek emërtimi *bishtadhizë* “bimë barishtore me kërcell të hollë, me gjethe si zemër e me lule të bardha, që kacavaret në bimët e arave”, treguesit e ngjyrës dhe të formës së kërcellit na bëjnë të perceptojmë mendërisht ngjyrën e leshit dhe mënyrën e lëvizjes (kacavjerrjes) të kafshës nga e cila kjo bimë ka marrë emrin. Po kështu edhe *bishtaqen* “bimë barishtore e viseve malore, me kërcell të shkurtër dhe me lule vezake”, ku edhe pse jo i përcaktuar shprehimisht, perceptimi më i drejtë do të ishte krahasimi me formën dhe përmasat e bishtit të qenit (i shkurtër). Për termin kompozitë *bishtdhelëpër* “bimë barishtore, me gjethe të gjata me push nga sipër dhe me gjemba anash, që bën lule të blerta a ngjyrë vjollcë të mbyllur”, qasja me treguesit e realies, sipas bashkësisë shqipfolëse, është bazuar te forma (gjatësia) e bishtit të kafshës që po krahasohet (gjethe të gjata) dhe butësia (me push) e gëzofit të këtij referenti. Forma dhe gjatësia e bishtit të një realieje kafshë është marrë si element shënues për formësimin e emërimit *bishtpelëz* “bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe si të grurit, me lulesë si fshesë a si kalli, që shërben si ushqim për kafshët”. Të njëjtët tregues janë perceptuar si dominantë edhe në emërtimet terma: *gjuhëqen* “bimë barishtore me kërcell të degëzuar, me gjethe të zgjatura si gjuhë qeni”, *lulekrehër* “bimë barishtore me gjethe të holla e të gjata si dhëmbët e krehërit”. Forma dhe ndërtimi i realies është përzgjedhur për materializimin e termit *lulekëmborë* “bimë barishtore shumëvjeçare me kërcëj të drejtë e pothuajse të zbrazët përbrenda, me gjethe vezake, me lule në trajtë këmbore e me petla të bashkuara në ngjyrë vjollce, që rritet nëpër lëndina”, ndërsa elemente të mënyrës së lëvizjes dhe formës janë identifikuar te përmbajtja e leksemës *lulefasule* “bimë kacavarëse e ngjashme me fasulen e cila çel lule me dy ngjyra” etj.

Treguesi i vendit ku rritet bima, i shprehur në mënyrë të ndërmjetuar, është identifikuar me një realie kafshë që gjallon në këtë mjedis karakteristik për të, në rastin e termit *lulebreshkë* “bimë barishtore me gjethe e me degë të mbuluara me push të gjatë, me lule ngjyrë trëndafili që rritet në vende të thata e fushave”, duke përfutur një lëvizje kuptimore me bazë tropet gjuhësore të një lloji më të veçantë metaforo-metonimik. I njëjti shndërrim ka ndodhur edhe te emërtimi *luleqyqe* “bimë barishtore me gjethe të ngjashme me ato të zymbylit dhe me lule ngjyrë trëndafili të grumbulluara në një vile të dendur, që rritet e vetmuar nëpër kullota e livadhe” me ndryshimin e vetëm se mënyra e jetesës së gjallesës

kafshë ka shërbyer si motivim i brendshëm për realien bimë. Tek emërtimi *luleqershi* “shkurre e vogël me gjethe të imta gjithnjë të blerta, që bën kokrra të kuqe si qershi dhe që mbillet si bimë zbukuruese” janë ndërthurur natyrshëm treguesit e formës dhe ngjyrës, ndërsa te termi *lulemëllagë* “bimë zbukuruese me gjethe të rrumbullakëta si të mëllagës e me erë të mirë, me lule tufa- tufa në ngjyra të ndryshme që mbillet nëpër kopshte” janë marrë tiparet dalluese të ndërtimit, formës dhe aromës.

**3.7.4.3.** Edhe mbi bazën e metonimisë, si një prej tropeve më të përdorshme në procesin e lëvizjeve kuptimore, janë krijuar disa kompozita terma në të cilat treguesi i vendit dhe i kohës ka zëvendësuar në mënyrë të figurshme dhe ka emërtuar konkretisht realien bimë si në rastet: *gjeldeti*, *kalëdeti*, *lopëdeti* “gjitar me trup të madh që ka jetuar në tufa kryesisht në Oqeanin e Ngrirë të Veriut dhe që sot është zhdukur”, *luleborë* “bimë barishtore me lule të bardha, që rritet në vendet malore dhe që çel sapo shkrin bora”, *lulebrigje* “bimë barishtore me gjethe vezake, me lule të verdha ose të kaltra të grumbulluara në tufë që rritet zakonisht nëpër livadh”, *luledimri* “barishte zbukuruese me gjethe të rrumbullakta dhe të bardha”. Kështu janë formuar edhe *lulevjeshte*, *lulebrëmjeje* apo *lulemëngjesi/akshami* etj.

### **3.8. Analizë përqsase e formës së brendshme të kompozitave me anglishten dhe gjuhë të tjera indoevropiane**

Pas prejardhjes (derivacionit), kompozimi është një nga tipet më prodhues të fjalëformimit në gjuhën angleze. Në funksion të realizimit të objektivit kryesor të temës sonë, kompozitat që kemi përzgjedhur për analizë u përkasin të njëjtave fusha leksiko-semantike. Mënyra se si folësit e gjuhës angleze e konkretizojnë realitetin objektiv në njësi gjuhësore është pashmangshmërisht e lidhur me natyrën e gjuhës, traditën, mendësinë, veçoritë psikologjike, shkallën dhe nivelin e abstragimit, me situatat konkretet të ligjërit aktual dhe, mbi të gjitha, me qasjen dhe bashkëpërkimet që folësit e kësaj gjuhe gjejnë midis elementeve të realies dhe tërësisë së veshjeve gjuhësore për ta konkretizuar këtë realie. Sipas U. Eco-s “Gjuhët përpunojnë një “shpirt”, i cili i bën ato të pakrahasueshme me njëra-tjetrën, të afta për të shprehur përfytyrime të ndryshme të botës”<sup>111</sup>.

---

<sup>111</sup> Eco U., vep. cit., f. 116.

Pikërisht, në këtë kontekst, shpirtin origjinal dhe natyrën e pakrahasueshme e ruajnë në një pjesë shumë të madhe njësitë që kemi marrë për analizë. Këqyrja e tyre do të bëhet për strukturat kuptimore. Leksemat e vjela nga fusha e botanikës dhe zoologjisë do të analizohen në plan krahasues me përkatëset e tyre që mbartin të njëjtin variant leksiko-semantik. Mënyra se si anglishtfolësit e emërtojnë realitetin konkretizohet në këto mënyra:

**3.8.1.** Për kompozitën e shqipes *bishtagjel* “lloj rose e egër shtegtare, me bisht të gjerë”, (forma e brendshme e së cilës del nga krahasimi me bishtin e gjelit), përkatësja në anglisht është *pintail* e shënuar mbi bazën e formës dhe mprehtësisë të bishtit, duke e krahasuar më realie të ngjashme për këtë cilësi *pin*-gjilpërë, karficë, shtizë. Folësit e gjuhës italiane kanë nxjerrë në pah treguesin e mjedisit dhe kushtet natyrore në të cilat jeton realia, duke zgjedhur përbërësin mbiemëror *selvatica* (e egër). Ky element mbart edhe ngarkesën kuptimore të kompozitës, ndërsa elementi emër *anatra* (rosë) është i njëjtë me leksemat e përdorura edhe në shqipe dhe anglishte. Në gjuhën frënge kemi elementin emër *canard* (rosë).

**3.8.2.** Shumë interesante janë edhe formimet në shqip *dorëzonjë* dhe në anglisht *honeysuckle*. Në rastin e variantit shqip “bimë kacavarrëse me lule të kuqërremta që ngjajnë me një dorë të vogël”, cilësia e jashtme e lidhur me formën e dorës së vogël (të zonjës) ka përcaktuar formën e brendshme, ndërsa në emërtimin e bërë nga folësit e gjuhës angleze treguesi i përmbajtjes së lëndës, më saktë, ai i ëmbëlsisë, ka bërë që funksionin emërtues-përcaktues dhe gjithë ngarkesën kuptimore ta mbartë fjala *honey*-mjaltë. Varianti i gjuhës italiane *caprifoglio* është konceptuar në mënyrë krejt origjinale: treguesi i jashtëm i lidhur me shumësinë dhe varietetin e luleve ka prodhuar kompozitën *capri foglio* (*capri* shumë; *foglio* gjethe). Varianti i gjuhës frënge *chevrefeuille* që rrjedh nga latinishtja “*caprifolium*” ka kuptimin “gjethe dhie, ose cjapi” pra bima emërtohet duke theksuar se ajo është një ushqim i privilegjuar për këtë lloj kafshe.

**3.8.3.** Treguesi i mënyrës së lëvizjes së referentit që duhet të emërtohet është perceptuar njëlloj nga folësit e të dyja gjuhëve në rastin e kompozitës shqipe *bishtatundës* “zog i vogël sa një trumcak, me ngjyrë të hirtë dhe me bisht të gjatë, që e tund kur ecën” dhe në anglisht *wagtail*. Këto emërtime i janë nënshtruar të njëjtit model fjalëformimi: *emër+emër prejfoljor* në rastin e shqipes dhe *emër+folje* në rastin e anglishtes. Në të dyja rastet kuptimi tërësor i kompozitës është i njëjtë. E njëjta strukturë është përzgjedhur edhe në

italishte *coditermola* (emër+emër prejfoljor) nga *codo* (bisht) dhe *termola* (që dridhet). Edhe në këtë rast perceptimi është i bazuar mbi të njëjtën cilësi, atë të lëvizjes së bishtit, veçse në bashkëpërkuesin e zgjedhur në italisht kuptimi leksikor i elementit folje është më i intensifikuar. Edhe kategorizimi i llojeve të ndryshme të këtij shpendi i klasifikuar mbi bazën e treguesit të ngjyrës, në shqipe dhe anglishte është bërë njëlloj: *bishtatundës i bardhë-whitewagtail*, *bishtatundës i verdhë-yellow wagtail*, ndërsa në rastin e tretë tipari cilësor i ngjyrës është ruajtur në variantin anglisht *grey wagtail*, por është zëvendësuar me treguesin e vendit në rastin e shqipes *bishtatundës i malit*. I njëjti proces emërtimi vihet re edhe te kompozita *bishtbardhë* dhe *whitetailed* që përdoren për të njëjtën realie “kalli gruri me bisht të bardhë” Në frëngjishte në këtë rast emërtimi jepet me termat *bergeronnette*, një fjalë e prejadhur nga *bergere* (bareshë e deleve), e cila ka sinonim termin tjetër që është një kompozitë *hochequeue*, që përbëhet nga folja *hocher* ( lëviz) dhe emri *queue* ( bisht). Pra, perceptimi është i bazuar mbi të njëjtën cilësi, atë të lëvizjes së bishtit, si dhe në gjuhën italiane.

**3.8.4.** Kompozitat *buzëkuqe* “tartabiq” dhe *bedbug* kanë forma të ndryshme ndërmjetësimi: ngjyra e kuqe e gjakut dhe rreziku i kësaj kandre ka shërbyer si cilësues i dallueshëm për kompozitën shqipe, ndërsa vendi ku kjo gjallesë rritet është përdorur nga folësit e gjuhës angleze si element përcaktues specifikues për sendërtimin tingullor të realies *bed*-shtrat dhe *bug*-çimkë. Në frëngjishte jepet emri *punaise* i cili nuk është kompozitë. Ai e ka etimologjinë nga latinishtja *putere*, frëngj. *puer* ( qelbet, bie erë të keqe) dhe *nasus*, frëngj. *nez*).

**3.8.5.** Mjaft interesante është përzgjedhja në rastin e shqipes *çafkëlore* “laureshë” dhe në angl. *skylark*. Leksema shqipe, edhe pse jo një kompozitë e mirëfilltë, ka për bazë perceptimin e bërë mbi treguesin e formës “zog këngëtar me kaçul në kokë”, ndërsa në rastin e përkatëses në anglisht “një zog këngëtar, por që fluturon lart në qiell” është identifikuar pikërisht me leksemën *sky*-qiell dhe italisht *alodola*. Në frëngjishte kemi një emër *alouette* (një lloj trumcaku që gjendet në fusha).

**3.8.6.** Shpeshherë ndodh që qasja me realitetin objektiv të jetë pak a shumë e ngjashme dhe folësit e gjuhëve të ndryshme ta perceptojnë në të njëjtën mënyrë botën që i rrethon. Pikërisht ky këndvështrim i përbashkët ka bërë që në shumë raste konceptet të jenë sendërzuar mbi bazën e tipareve dhe treguesve të njëjtë të realieve. Të tillë janë shembujt:

*bishtlepur-rabbit tail* (rabbit-lepur, tail-bisht); *qafëzi-dark-necked* (dark-i errët, i zi/neck-qafë); *këmbëdac-cat's foot* (cat-mace, foot-këmbë); *bishtgërshërë/bishtçatall-scissor-tail* (scissor-gjilpërë, tail-bisht); *këmbëpatë-geesefoot* (goose-patë, foot-këmbë) etj.

**3.8.7.** Kompozitat mbiemërore të anglishtes janë ndërtuar sipas modelit strukturor *emër+emër* ose *emër+mbiemër prejpjesor*. Për vetë strukturën fjalëformuese të gjuhës angleze, pjesa përcaktuese e shqipes përkon me atë të anglishtes. Edhe në italishte ndodh e njëjta gjë. Në përgjithësi, këto mjete leksikore nuk kanë origjinalitet të theksuar nëse krahasohen me kompozitat e grupit semantik të analizuara më lart. Mënyra se si është perceptuar realiteti nga folësit e dy gjuhëve të ndryshme është e njëjtë në rastin e kompozitave: *white handed-dorëbardhë*; it. *mani bianche-dorëbutë*; *snowhanded-dorëborë*; *dorëbutë-soft handed*; *absent minded-mendjehumbur*- it. *mentecatto*; *chicken brained-mendjepulë*- it. *mente di gallina*; *foul-hearted-shpirtfëlliqur*- it. *malizioso*, frëngj. *malicieux*; *lost soul-shpirthumbur*-it. *anima perduta*; frëngj. *ame perdue*; *pure-hearted-shpirtpastër/shpirtkulluar*- it. *buonanima*; *open-handed-dorëçelë*- it. *mano larga*; *white hair-flokëbardhë*- it. *capelli bianchi*; *soft hair-flokëbutë*- it. *capelli morbidi*, frëngj. *cheveux doux*; *short hair -flokëprerë*- it. *capelli alla maschieta* etj.

**3.8.8.** Po të analizojmë strukturën semantike dhe përbërësit leksikorë të çifteve përkatëse sinonimike, do të vëmë re se në pjesën më të madhe të rasteve në gjuhën shqipe shkalla e lartë e abstragimit ka bërë që procesi i emërtimit të realizohet nëpërmjet një krahasimi të ndërmjetuar, ku shndërrimet metaforike kanë sendërtuar dhe konkretizuar një varg shenjash gjuhësore, ndërkohë që në përkatëset leksikore sinonimike të anglishtes dhe italishtes, qasja me tiparet konkrete të realies është më e drejtpërdrejtë, jo e nënkuptuar apo e ndërmjetuar. Në të gjitha rastet e analizuara, nxjerrja në pah e tipareve dalluese të referentëve bëhet nëpërmjet bashkangjijtes së mbiemrave cilësorë. Shembujt e sjellë për ilustrim e dëshmojnë konkretisht një dukuri të tillë. *Sweet-tongue* dhe *glib mouth* janë dy kompozita ekuivalente për kompozitën e shqipes *gojëbilbil*. Zgjedhja e tropeve gjuhësore për ligjet dhe motivohet nga folësit e shqipes me shpendin që i mishëron më së miri këto veti-bilbil. Në anglisht kjo metaforë është zëvendësuar me dy mbiemra me kuptime të ndryshme leksikore *sweet* dhe *glib*, përkatësisht *i ëmbël* dhe *i rrjedhshëm*, që përmbledhin veçoritë dalluese të realies që është krahasuar. Po kështu, edhe leksema *brisk* me të cilën është krahasuar tipari dallues i realies, mprehtësia në rastin e shqipes *gojëbrisk* është shprehur në mënyrë të

drejtpërdrejtë më anë të mbiemrit cilësor *i mprehtë* në rastin e emërimit anglisht *sharp tongue*. Kompozita e zgjedhur nga folësit e gjuhës italiane është e zhveshur nga nuancat konotative dhe për këtë rast është nxjerrë në pah vetëm treguesi i shpejtësisë dhe zhvjellësisë në të folur *pronta risposta* e formuar nga *pronta* (e shpejtë/e menjëhershme) dhe *risposta* (përgjigje), një ndërthurje *mbiemër+emër*, në të cilën vlera leksikore të njëtrajtshme mbartet në të dyja leksemat fjalëformuese. Në frëngjishte jepet shprehja *avoir la langue bien pendue, bien affile* ( e ka gjuhën shumë të varur, të mprehtë). Ngjyrimin e vërtetë emocionues në rastin e italishtes e jep një përcaktor, mbiemër i prejardhur *loquace* (llafazan/fjalëshumë) që sjell edhe nuancat negative. Simbolikë të ndryshme tingullore dhe, rrjedhimisht, perceptim të ndryshëm, ka kompozita e shqipes *gojëpiperkë*, e cila ka për përkatëse leksikore të njëjtën kompozitë të anglishtes *sharp tongue*. Edhe në këtë rast motivimi i përzgjedhjes është i njëjtë.

Qasjes metaforike të shqipes, pra krahasimit me një realie konkrete (edhe pse ka përdorim më të kufizuar dialektor), i është përafuar një kompozitë përcaktore e tipit emër+mbiemër *sharp tongue*, ku vlerat kuptimore tërësore të kompozitës i mbart mbiemri *sharp* (i mprehtë) i përdorur me kuptim të figurshëm. Shumë interesante është edhe përzgjedhja e bërë në gjuhën italiane *sputapepe*. Metafora qëndron në thelb të kësaj përftese, por në vend të përbërësve me vlerë sinonimike (gojë dhe gjuhë) të dy gjuhëve të sipërpërmendura, është zgjedhur një trajtë foljore e formës urdhërore *sputa* (e krijuar prej infinitivit *sputare*-të përshtysh) dhe një emri, si gjymtyrë mbi të cilin është bërë krahasimi *pepe* (piper). Të njëjtën gjedhe emërtimi vëmë re edhe shembujt *gjuhëgjarpër* për shqipen dhe *venomeous- tongue* në anglishte (venomeous- helmues/e; i/e helmët). Mbiemri cilësor, që shpreh tiparet dalluese të realies, ka shërbyer si temë semantike për leksemën e gjuhës angleze, ndërsa në rastin e shqipes abstragimi dhe qasja metaforike (krahasimi me një kafshë që në përfytyrimin popullor është identifikuar me këtë cilësi) ka konkretizuar bërthamën kuptimore të kompozitës duke rritur vëllimin e strukturës semantike të kësaj të fundit. Edhe varianti italisht *di lingua viperina* konceptualisht është ndërtuar njëlloj, është ruajtur përbërësi emër dhe si element përcaktues ka shërbyer një mbiemër *viperina* (nepërke/s, i nepërkës). Në frëngjishte kemi kompozitën *langue de vipere*, por në dallim nga italishtja kemi një emër me parafjalë që përcakton emrin e parë *langue*. Me këtë janë sinonime dhe *langue de serpent* ose *langue empoisonnee* ( gjuhë e helmuar) ku dallojmë mbiemrin që përcakton emrin në mënyrë konkrete.



**3.8.9.** Nëpër tipologji të ndryshme fjalëformuese kanë kaluar edhe kompozitat *long-tongue* dhe *gjuhëlopatë*. Qasjet metaforike të shqipes shfaqin një shkallë më të lartë abstragimi dhe ndërmjetësimi të tiparit kryesor, ndërkohë që në gjuhën angleze janë zëvendësuar me mbiemra të mirëfilltë cilësorë, përkatësisht *i gjatë*. Edhe varianti i përdorur nga folësit e italishtes *lingualunga* është shenjuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë me anë të një mbiemri cilësor *lunga* (e gjatë). Edhe varianti i përdorur nga folësit e frëngjishtes *longue langue* ose *grande langue* është shenjuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë me anë të një mbiemri cilësor i cili i paraprin emrit. Këtë proces emërtimi mund ta vëmë re edhe në rastet *faint-hearted* që në shqip përkon me *shpirtlepur*, kuptimi leksikor i veçantë i shenjës gjuhësore *faint- i dobët, i lehtë* mbart tiparet specifike të dallueshme për karakterin e realies që duam të cilësojmë, ndërsa vlera më të mëdha shprehëse mbart leksema e shqipes për shkak të transformimit metaforik që folësit kanë përzgjedhur si mjet për shenjimin e këtij karakteri, italisht *pussillamine*.

**3.8.10.** Të njëjtën tipologji vëmë re edhe në rastin e leksemave të përbëra *kokëdardhë-small head* (small-i/e vogël)- *testa piccola* (picola- e vogël) frëngjisht *cerveau creux*, ose *cerveau vide* (trubosh), por edhe fjala *course* (kungull); *kokëkungull -big/thick head* (big-i/e madh; thick- i/e trashë)- *testa di cavolo/testa di rapa* (cavolo-lakër dhe rrapa-rrepë); *kokëlopë* dhe *big head* (big- i/e madh/e)- *capoccione/capone* ; *kokëmish* dhe *fat head* (fat- i/e trashë), *duro di comprendonio* (që kupton me vështirësi). Në frëngjishte *tete dure-këmbëpambuk-light footed* (light- i/e lehtë) - *piedeveloce* (veloce-i/e shpejtë) etj.

**3.8.11.** Elemente të tjera të shprehjes gjuhësore janë sendërtuar në formën e një vargu sinonimik me kompozitën e shqipes. Mjaft interesant është grupi sinonimik *cherry-lip, red-lip* dhe *small-mouth* që ka si përkatëse leksikore kompozitën *gojëqershi* të gjuhës shqipe. Në variantet e gjuhës angleze janë formësuar me veshjen përkatëse tingullore për ngjyrën *red- i kuq* dhe formës *small- i vogël*, ndërkohë që kompozita tjetër është përfutur sipas të njëjtit perceptim sendor si ai i shqipes, duke krijuar nga pikëpamja e përbërësve të kuptimit leksikor një çift të plotë sinonimik. Më i thjeshtëzuar dhe i pandërmjetuar është gjegjësjja e italishtes me një strukturë *emër+mbiemër cilësor* që tregon madhësi *bocca piccolo* (bocca-gojë/piccola- e vogël). Dy kompozita të shqipes *dorëdhënë* dhe *dorëgjerë* kanë si përkatëse leksikore në anglishte *free-handed* dhe shkalla e përcaktimit është e drejtpërdrejtë në të dyja gjuhët. I njëjti argumentim vlen edhe për leksemën e italishtes *mano larga*, e cila, duke u

bazuar te kuptimi leksikor i mbiemrit *larga* ( i/e gjerë), është sinonim i plotë me mbiemrin *dorëgjerë* të shqipes.

**3.8.12.** Originalitet të theksuar shfaqin edhe variantet sinonimike për kompozitën e shqipes “mendjefyçkë/mendjelehtë”, që janë përkatësisht *light-minded*, *coxcomb* dhe *feather brained* ndërsa për italishten *testa vuota*, *testa di gallina*, *testa di una formicola*. Përzgjedhja e leksemave *light* (i lehtë) dhe *feather* (pupël/ pendë) përputhen më së miri me konceptin dhe tiparet që folësit duan të formësojnë gjuhësisht (papjekuri/mendjelehtësi), ndërsa leksema e tretë është një përdorim i vjetëruar, që edhe pse është një kompozitë dhe dy gjymtyrët e saj janë tema fjalëformuese me kuptime të mëvetësishme, motivimi etimologjik është errësuar. Për variantet e italishtes kompozitat janë përfutur mbi bazën e metaforës, ku krahasimi bëhet me dy realie frymorë kafshë që, me sa duket, në mendësinë e kulturën e këtij populli mbartin tiparin e mendjelehtësisë *gallina* (pulë) dhe *formicola* (milingonë), kurse ndërtimi i tretë është bërë me formulën emër+ mbiemër cilësor *vuota* ( e zbrazët/bosh). Në frëngjishte jepet kompozita *tete de linotte* (trumcak) në të cilën shihet krahasimi me kokën e vogël, pra jointeligjente të një zogu të vogël, trumcakut.

**3.8.13.** Vargu sinonimik në anglishte për kompozitën *mendjekeq* përbëhet nga tri njësi: *illintentioned*, *evilmind*, *wayward*. Në dy rastet e para mbiemrat cilësorë mbartin gjithë ngarkesën kuptimore dhe ngjyrimin emocionues. Veçori paraqet leksema e parë, sepse emri i përcaktuar *mendje* është zëvendësuar qëllimisht nga folësit me mbiemrin *intentioned- i qëllimshëm*. Bazuar në të njëjtën gjedhe fjalëformimi është krijuar kompozita me kuptim të kundërt *well-intentioned-dashamirës*. Kompozita *evilmind* ka kuptim të veçantë leksikor (mendjelig/i pashtruar/ i pabindur), por kuptimi i veçantë leksikor i dy leksemave fjalëformuese *evil* (i keq) dhe *mind* (mendje) nuk e motivon përmbajtjen tërësore të kompozitës. Të njëjtën tipologji fjalëformimi ka dhe kompozita e italishtes *malintenzionato* që nuk ka përkatëse të tjera sinonimike. Leksemës *mendje* i korrespondon një mbiemër i emërzuar *intenzionato* (që ka prirje për të bërë diçka) dhe një ndajfolje *male* (keq). Strukturalisht leksemat e të dyja gjuhëve janë ndërtuar njëjloj edhe për faktin se kompozita me kuptim leksikor të kundërt është ndërtuar sipas të njëjtit gjedh *beneintenzionato* (bene-mirë). Në frëngjishte jepen në këtë rast sinonimet *sans-coeur*, (pa zemër) që është një kompozitë e ndërtuar nga parafjala dhe emri, *mauvais esprit* dhe emri *malveillant*. Me antonimin *bienveillant*, pra njëjloj si në italisht.

**3.8.14.** Qasje të ndryshme ndaj realitetit objektiv kemi edhe në rastet *shpirtheluar* dhe *broken heart*, ku edhe pse të dy përbërësit përcaktues janë mbiemra prejfoljorë, kuptimi i tyre leksikor është krejt i ndryshëm dhe vëllimi semantik i leksemave përkatëse ndryshon (*broken*-i thyer, i copëtuar, i këputur). Kompozita përkatëse e italishtes është *anima vile* me një strukturë marrëdhëniesh përcaktore. Edhe këtu nuancat kuptimore të strukturës së brendshme të fjalës e bëjnë të dallueshme nga dy përdorimet e para për shkak të kuptimit leksikor të mbiemrit *vile* (i lig/ i poshtër).

**3.8.15.** Kompozita *dorëlëshuar* që në anglisht përkthehet *spendthrift*, ku të dyja leksemat përbërëse “harxhoj/ shpenzoj/ prish” dhe “kursim/ ekonomi” e motivojnë plotësisht kuptimin tërësor dhe konceptin që folësit kanë për këtë njeri. Në të dyja gjuhët kompozitat mbartin ngjyrim emocionues negativ. Më i intensifikuar është kuptimi tërësor i kompozitës së italishtes *manibuccate* për shkak të përdorimit të mbiemrit *buccate* (të shpuara), i cili e ka rritur vëllimin kuptimor të kompozitës duke forcuar edhe konotacionin negativ të fjalës.

**3.8.16.** Aftësia për të abstraguat është e lidhur ngushtë me aftësinë që kanë folësit e një gjuhe për të njohur elemente të veçanta të realitetit objektiv apo përbërës të caktuar të këtyre referentëve. Përzgjedhjet leksikore janë pikërisht dëshmi e perceptimit që individët folës kanë për botën dhe raportet që kjo bashkësi ndërton me realitetin nëpërmjet lidhjeve të shumta asociative që përshfaqin nivele të ndryshme shumëformësie dhe shumëkuptimësie. Se sa ndryshe e perceptojnë realitetin objektiv dy bashkësi të ndryshme mund të këqyret në leksemat e larmishme gjuhësore. Krahasimi me bazë metaforën ka sjellë dy kompozita sinonimike *këmbëdrapër* dhe *crook leg*, të cilat kanë raporte sinonimike. Këto njësi janë ndërtuar mbi bazën e metaforës, por kanë baza të ndryshme sendore konceptore. Treguesi identifikues i formës ka shërbyer për përzgjedhjen leksikore në të dyja, por realitet që kanë qëmtuar me kujdes janë krejtësisht të dallueshme *drapër* dhe *crook- grip*. Kompozita e italishtes *gambe arcuate* është sendërtuar sipas një referenti tjetër që ka shërbyer si objekt cilësimi, mbiemri *arcuato* (i harkuar) është një rrjedhim i emrit *arco* (hark) mbi formën e të cilit është shëmbëllyer edhe ky model metaforik. Në frëngjishte kemi termin *jambes arques* ose *jambes torsés*, i cili është një lidhje e lirë, pra nuk përbën kompozitë. Nën këtë logjikë emërtimi kanë kaluar edhe kompozitat *buzëburbuqe-rose mouth/cherrylip* (rose-trëndafil dhe cherry- qershi/vishnjë)- *bocuccia di rosa* (bocuccia -gojë e vogël dhe rosa (trëndafil);

*kokëmollçinkë* dhe *pin head* (pin-gjilpërë/karficë), ku qasja me elementet e realitetit objektiv të metaforizuar është krej e ndryshme.

**3.8.17.** Cilësi të njëjta shprehin edhe kompozitat *bishtgërshërë-fork tail-coda di rondine*, frëngj: *queue d'hirondelle*, ku, bazuar të kuptimi leksikor i veçantë e leksemave *gërshërë, fork* (pirun/cfurk) dhe *rondine* (dallëndyshe), referenti dhe baza sendore edhe këtu është e ndryshme. E njëjta analizë vlen edhe për shembujt *buzësheqer-honey lip* (honey-mjaltë)-*parola dolce*, ku cilësitë e ëmbëlsisë dhe dashamirësisë janë shprehur me mbiemra cilësorë, por niveli i ndërmjetimit është i ndryshëm dhe i përshkallëzuar nga *dolce* (i ëmbël)-*sheqer-honey* (mjaltë); *këmbëlopatë* dhe *web foot* (web-pëlhurë/rrjetë), *qafëderr* dhe *bull-necked* (bull-dem); *buzëviç* dhe *blubber lip* (blubber-dhjamë balene), *bishtdungë* dhe *shagy tail* (shaggy-drizë) etj.

Ndodh shpesh në përkatëset midis dy gjuhëve që krahasimi të mos qëndrojë në përkimet identike të të shenjuarve, por në përfrimin e tipareve, intensitetit të shprehjes së një cilësie apo në masën e realizimit të një veprimi. Të tilla janë rastet e kompozitat *buzëmushkë* dhe *dark mouthed*. Transformimi metaforik i përftuar në shqipe është zëvendësuar me tiparet cilësore të realies, por edhe këto të nënkuptuara dhe të ndërmjetuara; *buzëqumësht*, gjithashtu, përkon nga pikëpamja e shprehjes së treguesve cilësorë të realies me *wet-head*. Përbërësit e cilësuar të kompozitave i përkasin së njëjtës fushe konceptore, ndërsa përdorimi i mbiemrit, në rastin e anglishtes, me kuptimin e tij të specializuar në vend të një emri të metaforizuar të shqipes *wet-i lagur*, mbart ngarkesën themelore konceptore të strukturës kuptimore. Veshja gjuhësore e kompozitave *flappy bellied* dhe përkatësja e saj leksikore *barkzhabë*, dëshmojnë se baza konceptore është identifikuar me elementët e formës në mënyra të ndryshme.

Tiparet dalluese të lëvizjes së realies, me të cilën është sendërtuar kompozita e shqipes, janë njëjtësuar me mbiemrin *flappy-i lëvizshëm*, që përbën edhe bërthamën semantike të kompozitës. I njëjti model ka shërbyer edhe për kompozitat *këmbësheshtë* dhe *duck foot* (*duck-patë*) dhe *këmbëshakull* dhe *heavy foot*. Nuk mungojnë rastet, edhe pse të pakta në numër, kur shndërrimet metaforike kanë formësuar gjuhësisht njësi identike, qoftë nga pikëpamja strukturore, ashtu dhe nga ajo kuptimore. Kompozitat e mëposhtme janë ndërtuar sipas së njëjtës tipologji fjalë dhe kuptimformuese: *këmbëdac-cat's tail* (cat-mace); *barkthes-bag-bellied* (beg-çantë/trastë); *barkvozë-barrel-bellied* (barrel-bucelë/fuçi);

*barkdosë-sow-bellied* (sow-dosë); *bishtmi-rat's tail* (rat-mi); *bishtqen-dog-tail* (dog-qen); *buzëlepur-hare-lip* (hare-lepur) etj.

## KAPITULLI IV

### RRETH FORMËS SË BRENDSHME TEK EMËRTIMET E PËRBËRA

*“Gjuha përfaqëson, me një besnikëri të përkryer, metodën mendore të një populli, mënyrën e vet të zakonshme të drejtë idetë”*

**Faik Konica**

#### 4.1. Trajtesat teorike për emërtimet e përbëra në gjuhën shqipe

Për lëndën gjuhësore që do të analizojmë në këtë kapitull janë përdorur terma të ndryshëm. A. Kostallari i quan “emërtime të pathjeshtë”, “terma të pathjeshtë”, te të cilët vihet re se “njëri ose tjetri element e ka humbur kuptimin e tij themelor dhe në tërësi emërtimi është rikuptimësuar”<sup>112</sup> dhe si shembuj sjell ndërtime të tilla, si: *qime e gjallë, bar blete, bar gjaku, bar miu, thundër mushke, lule sapuni, lule blete, mollë dheu, nusja e lalës, Kashta e Kumtrit* etj., apo dhe “bashkëlidhje (togje) të qëndrueshme”, si: *inventar i gjallë, peshë e vdekur*<sup>113</sup>. J. Thomai i quan “terma jo të thjeshtë”<sup>114</sup>, si: *gjuhë lope, bisht lepuri, kandil deti* etj., duke i përfshirë në frazeologjinë gjuhësore për nga fakti se kuptimisht kanë vlerën e një fjale emërtuese; ose i quan “terma të pathjeshtë”, që në përbërjen e tyre kanë gjymtyrë pa kuptim të figurshëm: *shtylla kurrizore, pikë e vdekur* etj., si bashkime të njësuara për shkak të funksionit të tyre si terma e si njësi të vetme sintaksore<sup>115</sup>. Në FGjSSh (1980) ndërtime të tilla quhen “emërtime të pathjeshta” dhe përfshihen në këtë fjalor duke i shpjeguar zakonisht te gjymtyra kryesore. H. Pasho i quan “togfjalësha terminologjikë”<sup>116</sup>. Me studimin e ndërtimeve të tilla në gjuhën shqipe është marrë gjerësisht A. Duro, i cili ka argumentuar

---

<sup>112</sup> Kostallari A., *Parimet...* vep. cit., f. 39.

<sup>113</sup> Po aty, f. 41.

<sup>114</sup> Thomai J., *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1981, f. 20.

<sup>115</sup> Po aty, f. 23.

<sup>116</sup> Pasho H., *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe, nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX*. Tiranë, 2005, f. 122.

dallimin teorik midis tipave të *togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë* dhe *togfjalëshave të lirë*<sup>117</sup>. Togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) pasqyrojnë nëpërmjet koncepteve lidhjet ndërmjet objekteve të realitetit objektiv ose të objekteve e të vetive të tyre. Në togfjalëshat e qëndrueshëm këto lidhje janë të ngulitura e të përhershme që e ka bazën në ngulitjen e lidhjeve ndërmjet vetë objekteve ose objekteve e vetive, të cilat pasqyrohen në togfjalësh<sup>118</sup>. Ndërkaq, togfjalëshi i qëndrueshëm terminologjik përbën një njësi gjuhësore-konceptore ose logjiko-sendore dhe uniteti i këtij togfjalëshi është i dyfishtë: nga njëra anë paraqitet si lidhje e brendshme ndërmjet elementëve përbërëse për të shprehur një koncept të vetëm, kurse, nga ana tjetër, del si lidhje brenda sistemit në marrëdhënie me gjymtyrët e termave të tjerë<sup>119</sup>. Në togfjalëshat terminologjikë, si emërtime të përbëra, pasqyrohet më së miri botëkuptimi i një kombi, një bashkëjetesë midis formimit kulturor dhe rrjedhës së historisë, si shprehje e pastër e lëndës shpirtërore dhe mendësisë gjithnjë e në zhvillim.

#### **4.2. Analizë leksiko-semantike e togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë**

Mbledhja, skedimi, klasifikimi i emërtimeve të përbëra sipas treguesit tematik të fushës së përdorimit dhe, mbi të gjitha, analiza semantike dhe strukturore e tyre na lejon të bëjmë një pasqyrë të plotë të këtyre mjeteve të rëndësishme autoktone leksikore, që shërbejnë për gjallërimin e vlerave të mjeteve shprehëse në të gjitha shtresat stilistikore të leksikut duke e përtërirë dhe e bërë më të pasur dhe më të zhdërvjellët atë. Materiali i vjelë nga FGjSSh (1980), me rreth 370 njësi, bën të mundur që atë ta klasifikojmë në dy fusha të gjera tematike, si **fusha e botanikës**: *bar argjendi, bar beronje, bar bibe, bar blete, bar brengje, bar breshke, bar buçi, bar i çikës, bar i deles, bar dallëndysheje, bar delli, bar derri, bar djathi, bar i dreqit, bari i drithit, bar dhëmballe, bar ethesh, bar fare, bar gomari, bar griskle, bar gryke, bar guri, bar gjaku, bar gjalpi, bar gjarpri, bari i gjësë, bar helmi, bar hirre, bari i jetës, bar krimbi, bar lepuri, bar mjalti, bar nepërke, bar i së paemrës, bar pasrregulli, bar pate, bar peshku, bar plakash, bar pulash, bar qeni, bar squfuri, bari i syrit, bukë derri, bukë mali, buzë nuseje, dafinë deti, elb i egër, ferrë deti, ferrë gomari, fik deti, fik*

---

<sup>117</sup> Duro A., *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 151.

<sup>118</sup> Duro A., *Termi..vep. cit.*, f. 152.

<sup>119</sup> Po aty, f. 154.

*frëngu, ftua i egër, grurë breshke, kafe e egër, liri i breshkës, lule akshami, lule akulli, lule alle, lule argjendi, lule arushe, lule balsami, lule behari, lule blete, lule bore, lule breshke, lule bretku, lule bualli, lule çallme, lule deleje, lule derri, lule dielli, lule dimri, lule djathi, lule dushku, lule dylli, lule dhensh, lule ethesh, lule fieri, lule filxhani, lule floriri, lule fshese, lule gishti, lule gomari, lule gjaku, lule gjarpri, lule gjeli, lule gjembi, lule gjize, lule kadifeje, lule kashte, lule këmbore, lule krëhëri, lule kungulli, lule lakre, lule lepuri, lule letre, lule maji, lule mbrëmjeje (akshami), lule mëllage, lule mëngjesi, lule mize, lule mosmëharro, lule mosmëprek, lule ngjitëse, lule pashke, lule peshku, lule pjate, lule plepi, lule pranvere, lule preshi, lule qeni, lule qengji, lule qumështore, lule qyqeje, lule rruaze, lule sabahu, lule sahati, lule sapuni, lule syri, lule sharre, lule sheboje, lule shpate, lule shqerre, lule shqiponje, lule tamblë, lule thoi, lule vathi, lule vedre, lule vere, lule veze, lule vjeshte, lule vreshti, lule ylli, lule zjarri, lule zog, lule zonje, manushaqe e verdhë, maraqi i ëmbël, meli i pulës, menekshe gomari, misër qyqeje, pjepër i egër, presh gjarpri, qepë deti, qepë gjarpri, qersh i toke, rrush arushe, rrush gjarpri, rrush pule, rrush qeni, rrush i qyqes, rrush toke, rrush thëllëze, trëndafil breshke, thanë ujku, thua pule, thundër mushke, zonjë e bukur; dhe **fusha e zoologjisë**: dash deti, elefant deti, gështenjë deti, hithër deti, iriq deti, kali i detit, kali i qyqes, kalë shtrigash, kandil deti, krimbi i mëndafshit, luani i detit, mace e egër, mëllenjë e bardhë, nusja e lalës, nuse pashke, peshk elektrik, peshk guri, peshk pëllumb, plesht uji, shirit i njeriut, yll deti, zog bari, zog blete, zog bore, zog çaus, zog dervish, zog i dhenve, zog miu, zog mizë, zog i natës, zog nuseje.*

Treguesit sasiorë dhe larmia e strukturave të përdorura flasin jo vetëm për një origjinalitet të theksuar të veçorive gjuhësore, por bëhen edhe dëshmi e vlerave etnokulturore të trevave shqiptare. Konceptet që përdoren si bazë logjike për krijimin e kuptimeve leksikore “marrin jetë” nga realiteti të gjalla, të prekshme, të lidhura me jetën reale të banorëve të këtyre trevave dhe, duke gjykuar mbi bazën e përthyerjes që këto njësi shfaqin në realizimet konkrete ligjërimore dhe vëllimit të gjerë semantik që ato kanë, na japin mundësi të plota dhe konkrete për të kuptuar se këto krijime origjinale janë produkt i mendësisë së folësve të kësaj gjuhe, duke reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kufijtë e botës së tyre dhe perceptimin që ata kanë për atë çka i rrethon.



Metoda e përdorur për zbërthimin e kuptimeve në përbërës kuptimorë ka kaluar përmes analizës dhe sintezës. Analiza e përbërësve semantikë të njësive të tilla leksikore ka për qëllim të tregojë se përzgjedhja e fjalëve si lëndë konkrete e gjuhës është lehtësisht e motivueshme dhe përmes saj ne mund të kuptojmë qartë se baza sendore-konceptore mbi të cilën shqipfolësit kanë realizuar procesin e emërimit është e lidhur me përvojën e drejtpërdrejtë dhe cilësitë e dallueshme të sendeve në botën fizike dhe se raporti korrespondues midis realies dhe simbolikës tingullore është i përligjur me vetitë dhe veçoritë e dukshme të botës fizike, prandaj kuptimi leksikor i këtyre njësive është lehtësisht i zbërthyeshëm dhe përkatësia “natyrore” duket se është tipari dallues i këtyre shenjave gjuhësore. Procesi i emërimit në njësitë e skedua është bazuar mbi lëvizjet kuptimore të shoqëruara me një figurshmëri të dukshme të tropeve gjuhësore, konkretisht mbi bazën e metaforës dhe metonimisë. Treguesit e jashtëm të realies janë bërë burim për zhvillimet dhe lëvizjet semantike të një numri të madh togfjalëshash të qëndrueshëm terminologjikë.

#### **4.2.1. Motivimi mbi bazën e funksionit të referentit**

Përfitimi i togfjalëshit dhe strukturimi i përbërësve leksikorë në rastin e shembujve të mëposhtëm është ndërtuar mbi bazën e tiparit të përdorimit, funksionit dhe dobisë së realies. Ky tipar ka shërbyer si temë semantike për emërimet e përbëra të lidhura me një sferë të caktuar të përdorimit dhe duke formuar një fushë të gjërë konceptore, siç është ajo e bimëve mjekësore. Të tilla janë togfjalëshat: *bar beronje* “bimë barishtore me gjethe si të rigonit e me lule të bardha, dhe që përdoret në mjekësinë popullore për gratë që nuk lindin” nga *beronjë* “grua që nuk lind fëmijë”; *bar bibe* “bimë barishtore deri në një metër me lule të bardha si push, që përdoret për shërimin e sëmundjes së verdhëzës së bibave”; *bar blete* “bimë barishtore me gjethe vezake me lule ngjyrë trëndafili ose të bardha që përdoret për të mbledhur bletët kur roitin”; *bar djathi* “bimë që përdoret për të zënë qumështin djathë”; *bar dhëmballe* “bimë barishtore ose gjysmëshkurre me lule në trajtë vile që përdoret në mjekësi për shërimin e dhembjeve të dhëmbit”; *bar ethesh* “bimë barishtore njëvjeçare e helmët, me gjethe të holla, me lule tufa-tufa, të vogla, të kuqe e si hinkë, që përdoret në mjekësi”; *bar gjarpri* “bimë barishtore shumëvjeçare, pa lule, me zhardhok, që përdoret në mjekësinë popullore kundër helmimit nga gjarpri”; *bar hirre* “bimë barishtore njëvjeçare, me lule të

bardha, që rritet nëpër lëndina dhe që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e hurrës së kafshëve” nga *hurrë* “sëmundje e bagëtive që u prek kyçet e këmbëve dhe sytë”; *lule fshese* “bimë barishtore me gjethe të errëta e me lule të bardha që kur thahet përdoret për të bërë fshesa”; *bari i drithit* “bimë barishtore me gjethe të holla, të gjata e të dhëmbëzuara, që shtrohet në hambarët me drithë për të larguar kandrrat e dëmshme”; lule balsami “bimë barishtore me gjethe të holla e me erë të mirë që përdoret në mjekësinë popullore për të mjekuar plagët”; *lule vizhë* “bimë gjethet e të cilës janë ngjitëse dhe kapin kandrrat që qëndrojnë mbi to” etj. Në ndërtime të tilla, treguesit themelorë të realies janë sintetizuar mendërisht nga folësit dhe herë lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë pa shndërrime kuptimore me realien që paraqet rrezik dhe ia vesh asaj kuptimin leksikor (gjarpër, ethe, hurrë etj.) dhe herë ngarkesën semantike transferohet drejt referentit që vuan sëmundjen apo dëmtohet prej saj (bibë, beronjë, bletë, drithë etj.).

#### **4.2.2. Motivimet mbi bazën e ngjyrës së referentit**

Transferimet metaforike ku një tipar i jashtëm i realies asociohet më një tipar të dukshëm të një realieje tjetër, çojnë në zgjerim të vëllimit kuptimor. Tiparet e bashkëshoqëruara që qëndrojnë në thelb të lëvizjes kuptimore lidhen kryesisht me ngjyrën, si në rastin *bar dallëndysheje* “bimë barishtore me gjethe të vogla, të cilat kanë në mes një njollë të zezë”. Treguesi i ngjyrës së zezë është parë, në rastin e kësaj bime, si veçori mbizotëruese dhe formësimi i veshjes tingullore nuk është bërë mbi përcaktimin e drejtpërdrejtë të ngjyrës, edhe pse individët folës e kanë përzgjedhur si veçori mbizotëruese, por me asosacionin me një realie që ky tipar i është veshur sipas traditës si tipar identifikues (dallëndyshe). Përmes të njëjtit abstragim ka kaluar edhe emërtimi *bar nepërke* “bimë barishtore me gjethe si të gurit dhe me pika të zeza”. Edhe realia “nepërkë” në besimin e përgjithshëm popullor identifikohet më anë të ngjyrës dhe duket se i njëjti tipar është parë si mbizotërues edhe për këtë bimë. Po kështu, treguesi i ngjyrës ka shërbyer si temë semantike për emërtimin *lule gjaku* “bimë barishtore me lule të mëdha në ngjyrën e gjakut”, ku tipari i ngjyrës është parë si dominues dhe shndërrimi metaforik është po aq i dukshëm; *lule zjarri* “bimë barishtore me ngjyrë të kuqe të ndezur”.

Qasja apo krahasimi me bazë cilësinë e ngjyrës nuk është gjithmonë e nënkuptuar apo e supozuar, por vjen si rrjedhojë e një abstragimi më të ndërlikuar mendor, ajo shpesh është e drejtpërdrejtë, pa element të ndërmjetësuar si në rastet e ndërtimeve me strukturë emër+emër të tipit *lule argjendi*, *lule floriri* “bimë barishtore me gjethe të gjata, me një boçe me lule të verdha në krye”; *lule alle* “bimë barishtore me gjethe të thata me ngjyrë të kuqe të ndezur” (allë -ngjyrë e kuqe); *lule ari* “bimë barishtore me gjethe në trajtë zemre dhe me ngjyrë të verdhë dhe të shndritshme”; *lule bardhë* “bimë barishtore e egër me lule të bardha” etj.

#### **4.2.3. Motivimi mbi bazën e disa cilësive të referentit**

Zgjerimi kuptimor me bazë metaforën nuk kufizohet vetëm me treguesin e ngjyrës, siç u trajtua më lart. Shpesh bashkësia folëse përzgjedh më shumë se një tipar si mjet identifikimi. Të gjitha cilësitë e jashtme të realies duken se vlejné njëlloj. Të konceptuara në këtë mënyrë janë ndërtuar togfjalëshat *lule akulli* “bimë barishtore zbukuruese me gjethe të veshura me një cipë të bardhë dhe me lule të ashpra që nuk fishken”, ku vëmë re një ndërthurje të treguesve të ngjyrës, formës dhe qëndrueshmërisë. Tiparet dalluese të ngjyrës dhe lëndës kanë shërbyer për të asociuar kuptimin leksikor të togfjalëshit *lule dielli* “bimë barishtore me kërcell të gjatë, me lule të grumbulluara si një disk, e rreth e rrotull me petale të verdha me fara të zeza”. Ngjashmëria me formën dhe mprehtësinë e referentit të përzgjedhur ka formuar njësi interesante si *lule thoi* “bimë zbukuruese me gjethe të holla e të shkurtra si hala pishe, që çel lule të verdha”. Po në të njëjtën logjikë ka ecur edhe emërtimi i strukturës *thua pule* “bimë shumëvjeçare me rrënjë boshtore me gjethe pesë e nga pesë në çdo degë dhe me lule të verdhë në të kuqërremtë”, me dallimin se treguesit të ngjyrës i është bashkëvendosur edhe ai i formës lehtësisht të perceptueshme dhe të krahasueshme me këmbët e shpendit në fjalë. Edhe togfjalëshat *peshk shpatë* “peshk deti me trup petak e të gjatë dhe me turi të mprehtë” dhe *peshk sharrë* “peshk deti që ka para një zgjatim me dhëmbëza si sharrë” janë krijuar mbi bazën e të njëjtit model dhe ndërthurje të tipareve dalluese (formë+mprehtësi).

Nën të njëjtin argumentim mund të analizojmë shembullin e emërtimit *bar krimbi* “bimë barishtore me gjethe të vogla e të prera në mes, me lule të bardha dhe që bën një farë të murrme, të imët dhe të rumbullakët”, ku janë ndërthurur ngjashmëritë e treguesve të

tipareve të jashtme të formës, ngjyrës dhe përmasave me referentin e krahasuar *krimb* apo me ndërthurjen e veçorive të ngjyrës dhe formës, si në rastin *lule qershi* “shkurre e vogël me gjethe të imëta që bën kokrra të kuqe si të qershisë” apo të ngjyrës dhe vendit ku rritet realia, si në togun *lule kashtë* “bimë barishtore me lule të kaltra në trajtë heshte, që rritet në tokë të pastër e me shumë diell”, ose tregues të dallueshëm me të cilat referenti kafshë identifikohet, si për shembull, *lule lepuri*.

#### **4.2.4. Motivimi mbi bazën e një emërtimi tjetër të referentit**

Asosacionet metaforike nuk realizohen gjithmonë përmes lidhjeve apo ngjashmërive të dukshme midis realieve, por ndodh që ky proces të jetë më i ndërlikuar, i nënkuptuar. Në raste të tilla rritet vëllimi i nuancave kuptimore dhe vlerat shprehëse të emërtimit, si: *bar i dreqit* “bimë barishtore parazite me lule të verdha që dëmton rëndë bimët bujqësore”, ku qasja leksikore nuk është aspak e drejtpërdrejtë, por abstragimi është i diktuar nga përvoja fizike dhe mendore përmes së cilës një rrezik kaq i madh për “bukën e gojës” nuk mund të gjente krahasim veçse me qenien e frikshme demonike në fjalë. I njëjti argument vlen edhe për njësinë *bari i së paemrës* “bimë barishtore me kërcell të gjatë e të degëzuar, me gjethe pak më të vogla se të hithrës, me lule të bardha si të borzilokut që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e shpërgëtisë”. Transferimi metaforik dhe raporti asociativ është ndërtuar jo mbi bazën e emrit të vërtetë të sëmundjes, por të emrit zëvendësues me funksion eufemistik për sëmundjen e shpërgëtisë, pra *e paemra*. Edhe këtu teknika e përzgjedhur nga folësit është e menduar mirë dhe procesi i emërtimit ka kaluar përmes një abstragimi gjatë së cilit natyra e raporteve që i lidhin është përimituar me kujdes.

#### **4.2.5. Motivimi mbi bazën e formës së referentit**

Fusha konceptore e bimëve pasurohet më tepër përmes shndërrimeve metaforike që kanë për bazë qasjen ose krahasimin me një tregues të vetëm të realies, siç është forma. Tipari dallues i formës së jashtme është treguesi më dominant i përzgjedhur nga shqipfolësit gjykuar nga numri i madh i njësive dhe denduria e përdorimeve, por raporti asociativ dhe përngjasimi me referentët është jo vetëm i qëllimshëm, por edhe i motivueshëm. Tregues të

tjerë të formës së jashtme të realies në tërësi apo të elementeve përbërëse në veçanti kanë shërbyer për konkretizimin e një vargu të plotë realizimesh në rrafshin e formës dhe përmbajtjes. Kështu, mund të përmendim *lule pjatë* “bimë barishtore me gjethe të vogla në ngjyrë trëndafili e cila rritet e rrumbullakët si rreth”. Referenti i krahasuar në këtë rast është një objekt konkret që mbart si tipar dominues formën e rrumbullakët, të cilën folësit e kanë përzgjedhur për t’ia bashkëshoqëruar edhe emërtimit të përbërë të kësaj luleje. Edhe në rastin e emërtimit të përbërë *lule sahati* “bimë kacavarrëse me lule në ngjyrë të kaltër që i ngjan orës së xhepit” përzgjedhja e shenjuesit është bërë mbi bazën e treguesit të jashtëm të formës dhe referenti i krahasuar është një realie konkrete si në rastin e parë; *lule buri* “shkurre me kërcell të përdredhur me lule në trajtë gypi”; *lule filxhan* “bimë barishtore me lule si kupë e vogël a si filxhan me ngjyra të ndryshme”; *lule këmborë* “bimë barishtore me gjethe vezake me lule në trajtë këmbore me petale në ngjyrë vjollcë”; *lule krëhër* “bimë barishtore me gjethe të holla e të gjata si dhëmbët e krëhërit”; *lule kupë* “bimë zbukuruese me gjethe të gjata heshtore që nxjerr vetëm një lule në trajtë kupe”; *lule shqiponjë* “bimë zbukurimi me gjethe të mëdha e të prera thellë, që u përngajnë krahëve të shqiponjës”; *lule vath* “bimë barishtore që çel lule të vogla në ngjyrë të çelur që varen poshtë”; *lule vile* “shkurre kacavarrëse me gjethe në formë heshtake me lule të grumbulluara në vile”; *lule yll* “bimë me kërcell e me push të dendur që mbaron në majë në trajtën e një ylli”; *lule rruazë* “bimë barishtore që çel lule të vogla si rruaza”; *lule fasule* “bimë kacavarrëse e ngjashme me fasulen e cila ka lule me dy ngjyra”; *lule bufkë* “bimë barishtore zbukuruese me lule të vogla të grumbulluara në tufë”; *lulegojë* “bimë barishtore me gjethe të vogla dhe lule shumëngjyrëshe në trajtë goje, gojë asllani” etj.

#### **4.2.6. Motivimi mbi bazën e treguesit të kohës**

Një tjetër tregues i rëndësishëm që ka shërbyer si bazë sendore-konceptore për shenjimin e një vargu relativisht të gjatë njësisht është edhe treguesi i kohës në të cilën ose gjatë së cilës referenti i cilësuar çel apo gjallon. Emërtime të përbëra të lidhura me këtë tregues mund të përmendim si më poshtë: *lule maji* “bimë zbukuruese që kacavaret në mur dhe që çel në maj lule të bardha ose të verdha”; *lule mëngjesi* “bimë zbukuruese me lule të bardha të kaltra ose ngjyrë vjollcë të cilat rrinë të çelura vetëm në mëngjes ose në ditë pa diell”; *lule vere* “bimë barishtore me lule të verdha që çel në periudhën e verës”, *lule vjeshte*

“bimë barishtore e helmët që rritet në kullota të lagështa dhe që çel në vjeshtë”; *lule akshami* “bimë barishtore zbukuruese, me kërcell të lartë, me gjethe si zemër që çel afër mbrëmjes”; *lule dimri* “bimë barishtore shumëvjeçare me lule të bardha që rritet në dimër” etj.

#### **4.2.7. Motivimi mbi bazën e treguesit të lëndës**

Treguesi i lëndës ka rezultuar mbizotërues në disa përzgjedhje të spikatura leksikore, si psh: *lule ngjitëse* “bimë barishtore me ngjyrë të kuqe që ka në kërcell një lëndë ngjitëse”; *lule sapuni* (shkumëz) “bimë që përmban në rrënjë një lëndë shkumëzuese si sapuni”; *lule dylli* “bimë kacavarrëse me gjethe të mbuluara me një lëndë si dyllë” (qumështore, lulequmështore, luleradhiqe); *bar fare* “bimë barishtore me kalli si egjra e me fara” etj.

#### **4.2.8. Motivimi mbi bazën e treguesit të vendit**

Shumë njësi janë emërtuar duke pasur parasysh një tjetër tregues që nuk lidhet me cilësitë fizike të realies apo referentit, por me tiparet e vendit ku ky i fundit rritet. Të tilla janë emërtimet e përbëra: *bar guri* “bimë barishtore njëvjeçare, me lule ngjyrë vjollcë, që rritet zakonisht në shkëmbinj dhe bën fara prej tri kokrrash të imëta dhe të kuqe”, *peshk guri* “peshk i vogël me kurriz të murrme, që jeton në thellësi zakonisht nën gurë e nën shkëmbinj e që nuk hahet”, *lule qyqe* “bimë barishtore me lule ngjyrë trëndafili të grumbulluara në një vile të dendur që rritet e vetmuar nëpër livadhe” *lule brigje* “bimë barishtore me lule të grumbulluara që rritet në brigje apo livadhe” etj.

### **4.3. Shqyrtim përjasës i emërtimeve të përbëra të shqipes me gjuhë të tjera**

Emërtimi i përbërë *lule akulli* është e barasvlerëshme semantikisht me kompozitën e anglishtes *perpetual begonia*. Tipari i pandryshueshmërisë dhe qëndrueshmërisë nuk është shfaqur me krahasimin metaforik, por me një mbiemër me vlerë kohore të jetëgjatësisë *perpetual* (i përjetshëm, i përhershëm). Për këtë ndërtim në italisht *fiori di ghiaccio* ka një përkim të dukshëm me strukturën semantike të emërtimeve të përbëra të shqipes. Përbërësi përcaktues *ghiaccio* (prej akulli) është përdorur për të nxjerrë në pah treguesin e fortësisë dhe qëndrueshmërisë.

Gjegjësjë për togfjalëshin në shqipe *lule kaçë* në anglisht është *cowslip*. Analiza e përbërësve kuptimorë të kompozitës na çon në përfundimin se përzgjedhja leksikore është bërë mbi një ngjashmëri të pashprehur të formës së lules me treguesit e jashtëm të buzëve të një realieje tjetër të krahasuar *cow* (lopë) dhe *lip* (buzë).

Treguesi i kohës, përcaktues për përzgjedhjen në emërtimin e shqipes *lule mëngjesi/akshami* është ruajtur edhe në përkatësen në gjuhën angleze *morning glory*, me përjashtim të faktit se leksema *glory* (lavdi, lumturi, shkëlqim), e përdorur më tepër me funksion përcaktues dhe cilësues, është zgjedhur qëllimisht për të mbartur të gjithë ngarkesën kuptimore dhe emocionale dhe shërben si një emërtim përgjithësues për tiparet që referenti nëkupton.

Togfjalëshi *lule patate*, në anglisht është *earthnut*. Treguesi i vendit ku rritet kjo bimë ka shërbyer si komponenti përcaktues i kompozitës në anglishte *earth* (tokë), ndërsa në vend të emrit përgjithësues për klasën në të cilën bima bën pjesë (krahasojmë *lule* në shqip) është zgjedhur një emër, kuptimi i drejtpërdrejtë i të cilit lidhet me një referent të veçantë, por që mbart karakteristika dalluese të të gjithë klasës së referentëve *nut* (arrë, kokërr arre, bërthamë etj.)

Procesi i emërtimit për njësitë *lule sapuni* dhe *bitter cress* nuk ka kaluar në të njëjtin nivel abstragimi. Nëse në rastin e përfutimit të togfjalëshit të shqipes kemi një shndërrim metaforik, në anglishte është specializuar kuptimi në përbërësin e dytë të ndërtimit *cress* (lakërore) dhe është rritur vëllimi kuptimor i përbërësit të parë me një mbiemër cilësor *bitter* (i hidhur), duke nxjerrë në pah jo vetëm treguesin e lëndës, por edhe të rrezikut që paraqet kjo realie. Si barasvlerëse leksikore në gjuhën italiane shërben leksema *saponaria*- shkumëz (nga sapone-sapun). Nga pikëpamja e strukturës së fjalëformimit, folësit e italishtes kanë zgjedhur derivacionin, ndërsa përmbajtja e përbërësve kuptimorë është realizuar përmes metonimisë (efekti/rezultati i veprimit në vend të objektit që e realizon atë), pra *shkumëz* në vend të fjalës *sapun*.

Ndërtime në shqipe e anglishte *lule lepuri* dhe *lungwort* janë përdorur për të shenjuar të njëjtin referent. Edhe këtu qasja me realitetin objektiv është e ndryshme, në emërtimin shqip për të përzgjedhur elementin përcaktues të kompozitës ka shërbyer një kafshë për të cilën kjo realie përdoret si ushqim (lepur) dhe në rastin e gjuhës angleze funksioni shërues i kësaj bime është përçar me emrin e organit që kjo e fundit shëron *lung* (mushkëri).

Tregues të ndryshëm të realies kanë dashur të nxjerrin në pah folësit e të dyja gjuhëve në emërtimet *lule gjarpër* dhe *bindweed*, megjithëse kuptimi leksikor i veçantë i përbërësit të dytë e nënkupton edhe rrezikun që realia paraqet “weed” (bar i keq).

Një mënyrë po kaq interesante është përzgjedhur në rastin e shqipes *lule floriri* me përkatësen angleze *strawflower*. Në rastin e shqipes, si element përcaktues ka shërbyer treguesi i ngjyrës së lules, ndërsa për anglishten *kashtë* (straw) ka shërbyer një shndërrim metaforik, por si një kombinim i treguesve të ngjyrës dhe ashpërsisë. I njëjti konceptim është bërë edhe nga folësit e gjuhës italiane me ndërtimin *fior di paglia*, ku shkalla e ndërmjetimit është realizuar përmes ngjashmërisë me një objekt konkret *paglia* (kashtë).

Një shkallë tjetër e abstragimit është përdorur në rastin e përzgjedhjes *lule drethkël*, ku është nxjerrë në pah treguesi i formës. Në anglishte shkalla e ndërmjetësimit është shumë origjinale: krahasimi është bërë mbi bazën e personifikimit dhe elementët dallues të realies së krahasuar janë abstraguar. Trajta e përzgjedhur *old man's beard* nga *beard* (mjekër) dhe *old man* (i moshura, plak) dallohet për origjinalitet dhe nivel të lartë abstragimi.

Treguesit cilësorë të formës dhe ngjyrës kanë shërbyer edhe në rastin e emërtimeve *lule nure* dhe *leopard's lane* me dallimin kryesor se ndërtimin shqip folësit nuk e kanë lidhur me tiparet dalluese të bimës (gjethet e verdha dhe në formë zemre), por kanë abstragur deri në nivelin e përzgjedhjes së një emri me kuptimin e përgjithshëm (nur-pamje e jashtme, shkëlqim, dritë). Në variantin e gjuhës angleze përqsja dhe krahasimi (i ngjyrës së verdhë dhe njollave të zeza) është metaforizuar duke i krahasuar të njëjtat tipare me ato të një realieje tjetër me tipare veçanërisht të dallueshme *leopard* (leopard) + *lane* (vijë). Në rastin e italishtes *gorafono selvatico*, si bërthamë semantike për formimin e kompozitës ka shërbyer gjendja në të cilën rritet kjo bimë *selvatico* (e egër).

Perceptime të ndryshme dhe tipare të tjera dalluese janë nxjerrë në pah në rastet e emërtimeve *lule verdhë/ zhabinë* dhe *buttercup*. Tipari dallues i ngjyrës është vlerësuar në rastin e parë ndërsa treguesi i formës (lule të ngjashme me filxhanë të vegjël) ka motivuar përzgjedhjen në rastin e gjuhës angleze. Një qasje tjetër ndaj realitetit kanë pasur folësit e gjuhës italiane me ndërtimin *tartufo da prato* (tartuf i lëndinës/ livadhit), si një shndërrim metaforik, ku ngjashmëria e ngjyrës që ka kjo realie konkrete (tartuf- një lloj kërpudhe me ngjyrë të verdhë) me lulet e verdha që ka kjo bimë.



Ndodh që në ndërtime të tilla të ruhet tipari i ngjyrës, por kjo ndryshon në varësi të perceptimit të ndryshëm të folësve. I tillë është emërtimi *peshk i kuq*, *pesce rosso* (rosso- i kuq) dhe *goldfish* (gold-ar/flori). Në variantet e shqipes dhe italishtes është përzgjedhur treguesi i ngjyrës së kuqe ndërsa në anglisht ngjyra *e artë/ e florinjtë*.

Shpeshherë ndodh që qasja me realitetin objektiv të jetë pak a shumë e ngjashme dhe folësit e tria gjuhëve ta perceptojnë në të njëjtën mënyrë botën që i rrethon. Pikërisht, ky këndvështrim i përbashkët ka bërë që në shumë raste konceptet të jenë sendërtuar mbi bazën e tipareve dhe treguesve të njëjtë të realieve. Të tillë janë shembujt: *lule gjaku-blood flower* (blood-gjak/flower-lule); *bisht lepur-rabbit tail* (rabbit-lepur/tail-bisht); *lule argjendi-flower of silver* (silver-argjend/flower- lule)-argentifloro; *lule dushku-oak flower* (oak-dushk/flower-lule); *gjuhë dreri-hart's tongue* (hart-dre/tongue-gjuhë) etj.

## KAPITULLI V

### ANALIZË STRUKTURE-SEMANTIKE E NJËSIVE EUFEMISTIKE TË SHQIPES MBI BAZËN E KONCEPTIT TË FORMËS SË BRENDSHME

*“Gjuha shpreh shpirtin dhe kulturën e një populli, prandaj edhe fjalët e njëllajt kanë kuptime jo të barabarta, ekuivalente nga një gjuhë te tjetra, sepse shprehin shpirtin dhe kulturën të ndryshme”.*

**L. Poradeci**

#### 5.1. Përkufizimi i eufemizmave dhe studimi i tyre

Që në krye të këtij kapitulli lipset të sqarohet se eufemizmat mund të kundrohen për nga forma e brendshme e tyre, e cila vjen nga perceptimi i një referenti të dyfishtë, prej të cilëve njëri ngrihet në të shenjuar. Pra, forma e brendshme të eufemizmat mund të gjendet në mënyrë të tërthortë. Një ide e tillë shtëllitet nga mjaft studiues që janë marrë me këtë lëndë gjuhësore-etnografike. Sipas prof. Çabejt “Ata (eufemizmat) kanë vlerë mbasi nëpërmjet tyre ne njihemi me historitë e popujve të ndryshëm, me lashtësinë, veçoritë kombëtare, shkallën e zhvillimit, kushtet ekonomike, doket, zakonet. Ato lidhen me mitet dhe besimet me burim vendas dhe janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të popujve. Këtu pasqyrohet më së miri të folurit e figurshëm të gjuhës popullore<sup>120</sup>.”

Rawson thotë se eufemizmat janë mjete të fuqishme gjuhësore të rrenjosura aq thellë në ndërgjegjen tonë, sa shumë pak prej nesh mund të mos i përdorin çdo ditë. Eufemizmat janë “lingua non franca”. Si të tilla, ato janë shenja të jashtme dhe të dukshme të anktheve të brendshme, konflikteve, frikës, turpits etj. Ato janë si izotope radioaktive. *Duke i gjurmuar është e mundur të kuptohet se çfarë ka ndodhur ose po ndodh në gjuhën tonë, mendjen tonë dhe kulturat tona<sup>121</sup>.* Shprehjet gjuhësore janë produkt i faktorëve shoqërorë dhe kulturorë,

---

<sup>120</sup> Çabej, E., *Disa eufemizma të shqipes*. Studime Gjuhësore, nr. 4. Prishtinë, 1977, f.17.

<sup>121</sup> Rawson, H., *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, New York, Crown Publishers, 1981, f.1.

ndaj dhe mënyra se si njerëzit i përdorin eufemizmat është një pasqyrim i drejtpërdrejtë i faktorëve shoqërorë<sup>122</sup>.

Shqyrtime të sotme sociolinguistike, qoftë përsa u takon marrëdhëniet gjuhë-gjini, qoftë edhe për marrëdhëniet gjuhë-mendësi, mund të jenë edhe më të frytshme për studimin e kulturës shpirtërore të popullit, sidomos të një populli që ka ruajtur më shumë se kushdo dukuri të vjetra në gjuhën e tij. Eufemizmat janë “reparti pararojë” e dëshmues i gjuhës së grave<sup>123</sup>.

Tabutë dhe eufemizmat janë pjesë e procesit universal gjuhësor. Eufemizmat janë dukuri gjuhësore e përditshmërisë sonë, të cilat edhe pse mendohej se u përkasin kohëve të vjetra jo vetëm që nuk kanë shteruar, por po shtohen me sajesa a formime të reja<sup>124</sup>.

Eufemizmi është një figurë që zbut realizimin e disa ideve apo fakteve dhe që si antifraza bën që një fjalë apo shprehje të përdoret me një kuptim të ndryshëm nga ai që ka në realitet. Për shembull: *ai iku* në vend të *ai vdiq*<sup>125</sup>.

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, eufemizmi është përkufizuar si “fjalë ose shprehje që përdoret në vend të një fjale tjetër, të cilën nuk duhet ta zëmë në gojë, fjalë a shprehje e butë a e zbutur (p.sh.: të *bukurat* për *grykët*, e *paemra* për *sëmundjen e shpretkës*, *buzëlidhuri* për të *vdekurin*, *gojëlidhuri* për *ujkun*, u *nda prej nesh* në vend të *vdiq*”<sup>126</sup>.

A. Kostallari, kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipe, nga pikëpamja e përdorimit, i ndan në dy grupe: *eufemizma* dhe *disfemizma* ose *kakofonizma*. Ai shkruan se në bazën e këtyre dy grupeve qëndron synimi i folësve që me anë të zëvendësimit të emrave-tabu me një emërtim tjetër të mbrohen nga forcat e këqija, dëmprurëse që kujtohet se fshihen prapa tabuve, sikurse qëndron edhe synimi për të uruar, për të mbrojtur një qenie të dashur e për të mallkuar a sharë një qenie të urryer<sup>127</sup>.

Eufemizmat lindën në shoqërinë primitive dhe shumë prej tyre janë të lidhura me fenë dhe bestytinë. Njerëzit në kohët e lashta besonin se gjuha nuk ishte thjesht një simbol,

---

<sup>122</sup> Alen, K. & Burridge, K., *Euphemisms and Dysphemisms language used as a shield and weapon*, Oxford University Press, 1991, f. 5.

<sup>123</sup> Shkurtaç, Gj., *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f.

<sup>124</sup> Durmishi, I., *Tabutë dhe eufemizmat*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2010, f. 116.

<sup>125</sup> Encyclopedique Larouse, 1960-1961.

<sup>126</sup> *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 438.

<sup>127</sup> Kostallari, A., *Parimet..* vep. cit., f. 184.

por njëkohësisht ajo kishte edhe një pushtet magjik. Ajo mund t'u sillte njerëzve në të njëjtën kohë edhe fatkeqësi edhe mbarësi, prandaj vetë njerëzit i shmangnin nga përdorimi fjalë të tilla të konsideruara tabu dhe zëvendësohen nga shprehje të tjera të përafërta. Duke qenë se eufemizmat me përkufizim janë fjalë ose shprehje të stërholluara, të zbutura apo të zgjedhura me marrëveshje në mënyrë të logjikshme mund të mendojmë se kuptimi i tyre i vërtetë mund të jetë më i keq se ai i dukshmi (ai që shfaqet). Eufemizmat mund të përdoren me qëllim ngatërrimi apo qëllim të keq. Në këtë rast këto quhen *doublespeak* (ligjërim dyjar, i dyfishtë). Gjuha është një mjet, vegël apo armë e përdorur prej atyre që e zotërojnë atë për të arritur qëllimet në kurriz të të tjerëve. *Doublespeak* është gjuha që pretendon të komunikojë, që e bën të keqen të duket e mirë, negativën të duket pozitive, të pakëndshmen të këndshme apo të paktën të tolerueshme. Është gjuha që shmang, transferon përgjegjësinë, gjuha që i paraprin mendimit. Shoqëria post-moderne ka prodhuar një shumëllojshmëri eufemizmash. Karakteri i zgjeruar dhe i përhapur i kësaj dukurie u përcaktua gjerësisht edhe nga lindja e një termi të ri *eufematika*.

Në gjuhësinë shqiptare tashmë mund të flitet për krijimin e një tradite në studimin e eufemizmave si një dukuri e hershme e realitetit gjuhësor në shqipe dhe mund të bëhet një sintezë e ndihmesave teorike dhe praktike që kanë dhënë autorët shqiptarë në këtë lëmë, sidomos me shkrimet e Eqrem Çabejt<sup>128</sup>, Tomor Osmanit, Simon Pepës<sup>129</sup>, Gjovalin Shkurtajt<sup>130</sup>, Mustafa Ibrahimit<sup>131</sup>, Bexheti & Xhaferi & Ibrahimit<sup>132</sup>, Izmit Durmishit<sup>133</sup> Mehmet Elezit<sup>134</sup> etj. Gjithashtu, sot kemi një pasqyrë pak a shumë të plotë për trajtimin leksikografik të eufemizmave të shqipes në doracakë krahinorë, në fjalorë shpjegues dhe në vepra që u kushtohen tërësisht eufemizmave. Një realitet i tillë jep dorë dhe krijon mundësi për analiza e studime më të thelluara për njësitë eufemistike të shqipes, duke i vështruar ato nga pikëpamja e strukturës formale dhe semantike. Analiza semantike dhe strukturore e njësisve eufemistike do të bëhet mbi bazën e konceptit të formës së brendshme të gjuhës, pra,

---

<sup>128</sup> Çabej, E., *Disa eufemizma të shqipes*. Studime Gjuhësore, 4. Prishtinë, 1977.

<sup>129</sup> Osmani, T. & Pepa, S., *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000.

<sup>130</sup> Shkurtaj, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001.

<sup>131</sup> Ibrahimit, M., *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*, Interlingua, Shkup, 2009.

<sup>132</sup> Bexheti, V. etj. *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*, Tetovë, 2008.

<sup>133</sup> Durmishi, I., *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012.

<sup>134</sup> Elezi, M., *Fjalor i gjuhës shqipe*, Fishta, Shkodër, 2006.

mënyra se si është perceptuar realia dhe si është formësuar gjuhësisht ajo nga bashkësia folëse, duke u mbështetur në një nga tezat më të njohura të Humboldt për “formën e brendshme të gjuhës”.

Analiza jonë ka për qëllim të shqyrtojë qasjet teorike dhe studimet e bëra në lidhje me konceptin dhe karakteristikat e eufemizmave, t’i grupojë ato në kategori sipas veçorive kuptimore dhe të analizojë tiparet strukturore dhe kuptimore të eufemizmave, duke u përqendruar në shpjegimin e kuptimeve të eufemizmave të gjetura në situata të caktuara. Metodot e përdorura në këtë studim janë metoda përshkruese dhe analiza e përbërësve.

Të gjithë shembujt e mbledhur na bëjnë të arrijmë në përfundimin se në ndërgjegjen popullore njerëzit kanë besuar te forca e fjalës, sa zhdukjen e fjalës e lidhin me zhdukjen e vetë realies. Prania e një vargu të gjatë sinonimesh eufemistike, përveçse janë dëshmi interesante e një faze të hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, na shërben për të kuptuar më mirë se njerëzit kanë zgjedhur shenja të ndryshme gjuhësore, duke nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të realies, bazuar në perceptime, këndvështrime, botëkuptime apo mendësi të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme zhvillimi shoqëror apo kulturor. Spektri i gjerë i variacioneve dialektore apo krahinore nuk ka si të mos shihet i lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë e njerëzve të këtyre rajoneve, me kulturën materiale me përvojën psikologjike, me veçoritë e jetës shpirtërore, elementë që së bashku përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të një bashkësie gjuhëfolëse.

Duket se eufemizmat kanë lindur në shkallën më të hershme të zhvillimit të gjuhës ngaqë ato lidhen me mite dhe besime me burim vendas dhe përfaqen më të plota dhe më origjinale me një spektër të gjerë variacionesh dialektore në ligjërimin e gjallë dhe leksikun popullor. Eufemizmat janë produkt gjuhësor i një shoqërie, ato janë dëshmi e traditës dhe vijimësisë gjuhësore të një populli dhe, si çdo përftesë tjetër historike dhe social-kulturore, ato janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të gjuhëve.

## **5.2. Eufemizmat në kontekstin historiko-shoqëror si sendërtim i formës së brendshme**

Për çdo studiues shpesh shtrohen pyetje të tilla: Si dhe pse kanë lindur eufemizmat? Si është përfutur kjo lëndë shenjuese? A janë thjesht përzgjedhje gjuhësore rastësore vetjake dhe çfarë fshihet pas kompleksitetit të fjalëve dhe formësimit të mjeteve gjuhësore?

Një gjë është e qartë: eufemizmat kanë lindur nga nevoja e komunikimit dhe janë rrënjësuar thellë në korpusin gjuhësor, duke nxjerrë në dritë elemente të diakronizmit dhe etapave të zhvillimit, çka përvijon rrugëtimin e gjatë të shoqërisë prej zanafillës së mendimit njerëzor.

Eufemizmat janë sendërtuar vetiu në ndërgjegjen kolektive të popullit dhe, duke qenë të lidhura drejtpërdrejt me kushtet ekonomiko- shoqërore, bestytnitë, paragjykimet, doket, zakonet etj., ato e shenjojnë bashkësinë shqipfolëse si një entitet origjinal e të mëvetësishëm gjuhësor dhe kulturor, çka lidhet në mënyrë të njëmendtë me formën e tyre të brendshme.

Për të kuptuar natyrën e vërtetë të eufemizmave nevojitet një përimtim i rrënjëve historike të gjuhës dhe një vlerësim i plotë i kulturës, rrethanave dhe parakushtetve socio-etnografike. Në këtë kuadër, nuk duhet anashkaluar fakti se përpjekje të tilla i kapërcejnë kufijtë e shkencës së gjuhësisë, sepse kërkimet shkencore në shumë raste hepothen midis sociologjisë, historisë, filozofisë apo psikologjisë.

Eufemizmat më shumë se çdo njësi tjetër gjuhësore janë të rrënjësura në ndërgjegjen kolektive, janë tregues dhe mishërues i plotë i lidhjeve të bartësve të gjuhës me truallin që u ka rënë për pjesë të ndajnë dhe janë dëshmi e gjallë e ndasive kohore, mendësore, kulturore që ata përcjellin. Vise apo krahina të ndryshme shqiptare kanë llojshmëri në tradita, kulturë, histori, mjedise gjeografike etj., të cilat pasqyrohen edhe në ndryshime gjuhësore. Dihet që ndryshimet gjuhësore përcaktohen nga nevojat e shoqërisë, gjuha ndryshon në rrjedhën e kohës, fjalë të reja lindin dhe të tjera zhduken. Edhe eufemizmat nuk bëjnë përjashtim, ato i nënshtrohen një procesi të tillë. Në këtë kontekst, këto përzgjedhje gjuhësore janë një burim i hershëm i të folurit të figurshëm, që gjallon në të folmet dhe dialektet e shqipes si pjesë integrale e leksikut popullor. Ato i përkasin një shkalle të hershme të zhvillimit të shoqërisë dhe janë kryesisht të lidhura ngushtë me tabutë që zëvendësojnë, kur dihet se në të gjitha rastet eufemizmat dhe tabutë shenjojnë të njëjtën realie.

Eufemizmat tradicionale të shqipes janë prurje leksikore të lidhura ngushtë me jetën e përditshme, me kafshët grabitqare, me sëmundjet e pashërueshme dhe me fuqi të mbinatyrshme e të pashpjegueshme.

Nga një analizë statistikore që u kemi bërë eufemizmave të vjelë nga fjalorët dhe doracakët dialektorë dhe krahinorë, varietetet gjuhësore që kanë prodhuar numrin më të madh të sinonimeve eufemistike lidhen me kafshët: *ujk, gjarpër, bukla, dhelpër, milingonë,*

në lëmin e figurave të besimit popullor janë ato për *djallin (dreqin), zotin, të keqen, sëmundjet e pashërueshme* etj. Në të gjitha rastet e sjella për shqyrtim motivimi më i pranueshëm për përzgjedhjen e njësive gjuhësore është një përqsje, një “ngatërrim” midis emrave të sendeve dhe vetë sendit. Emri konsiderohet si një shtesë (zgjatim) i sendit, kështu që në mendësinë popullore kolektive të dish emrin do të thotë t’i japësh sendit fuqi, e cila në shumicën e rasteve mund të jetë të rrezikshme.

Duke i qëmtuar eufemizmat e shqipes, rast pas rasti, për të bërë një analizë të plotë semantike, vërejtëm se të zëvendësimet leksikore me funksion eufemistik lënda shenjuese është përzgjedhur mbi bazën e polisemisë, ku kuptimi i dytë i është shtuar realies mbi bazat e ngjashmërisë, afërsisë, funksionit, dobisë apo rrezikut që realia paraqet, si për shembull: *gjarpri- i helmuemi, përtrollës, hasëm, nëntokës, ai i malit, ai i bekuemi; epilepsia- shkumba, ajo e hënës, apo metaforës, duke marrë për bazë një tipar të jashtëm të realies, si: bukla- bishtfurkabukura, kalkuqe, pikaloshe, shtatpikaloshe; gjarpri-i përdredhuri, kulaçi, laramanlivadhi, brinoci, gjylpani, ujku-veshcurri, qafëtrash, turithime* etj. Në pjesën më të madhe eufemizmat ndërtohen mbi bazën e kompozitave dëshirore dhe janë interesante për larminë kuptimore dhe vlerat stilistikore dhe emocionuese që mbartin, si: *ujku- mbyllzogojën, guronazogojën, hajujku, shkoftlangu, mospjesi, mospastëpjesi, ai ujku i hangërt, shkoftlangu, ai iu gurtë goja, ajo kjoftë larg, atje i kjoftë/ qoftë, ai pranona zot, largneshi* etj.

Procesi i formimit të eufemizmeve ka kaluar përmes sinkretizmit dhe perifrazimit, procese gjatë të cilave njësia e përzgjedhur herë është shkurtuar, si: *bishë, bubë, buc, dhe, gjë, ai, ajo, ajo punë, ato/ata, i asaj pune* etj., dhe herë është perifrazuar me dëshirën për një plotëri sa më të madhe (*ai që as s’flet as kotet; ai që vran e kthjellë; ai i dheut të tretmë; ata që ujku i hangërt; ai që kjoftë tretë; ai që ia pret rrugën gjëja, ai që han grurë dhe gërshënë, ai që jeton në përrue, ai që pastë thyer qafën*).

Të gjithë këta shembuj tregojnë se në ndërgjegjen popullore njerëzit kanë besuar në një lidhje të mundshme të fjalës me sendin, kanë besuar fort te forca e fjalës, sa që zhdukjen e saj e lidhin me zhdukjen e vetë realies. Prania e një vargu të gjatë sinonimesh eufemistike, përveçse është dëshmi interesante e një faze të hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, na shërben për të kuptuar më mirë se njerëzit zgjedhin shenja të ndryshme gjuhësore duke nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të realies, bazuar në perceptime, këndvështrime, botëkuptime apo mendësi të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme të zhvillimit shoqëror e

kulturor. Spektri i gjerë i variacioneve dialektore apo krahinore nuk ka si të mos shihet i lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë e këtyre rajoneve, me kulturën materiale, me përvojën psikologjike të këtyre njerëzve, me veçoritë e jetës shpirtërore, të cilët, të marrë së bashku, përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të bashkësisë shqipfolëse. Shumëkush mund të bëjë pyetjen: a do të mund të thuhej që çdo gjuhë i përgjigjet njëfarë metaliteti? Psikologjia e popujve flet për një mentalitet shqiptar dhe për një mentalitet gjerman; dallimi që i ndan duhet të shprehet nëpërmjet të folurit, nëse është e vërtetë që të folurit është shprehje e mentalitetit<sup>135</sup>. Gjuhëtari gjerman Finck, duke rimarrë idenë e Herderit për prejardhjen e gjuhëve, thotë se gjuhët do të duhej të trajtoheshin vetëm si akte që shprehin mendjen e popujve<sup>136</sup>. Sidoqoftë, kur vjen puna për motivimin e eufemizmave, nuk ka si të mos u drejtohem besimeve popullore si veprimtari psikike.

### **5.3. Eufemizmat në këndvështrimin pragmatik**

Nevoja për të përdorur eufemizma është sa shoqërore, aq edhe emocionuese dhe vetjake, sidomos kur përzgjedhja gjuhësore pasqyrohet në një shumëllojshmëri kumtimesh dhe realizimesh të veçanta konkrete gjatë akteve ligjërimore, kur diskursi shoqëror është pashmangshmërisht i lidhur me tema të ndaluara apo tabu, si: vdekja, seksi, pamja e jashtme, të metat fizike apo mendore. Duke gjykuar nga përshfaqjet e shumta në numër, nga ndërliqësia e strukturave (konstrukteve) të përzgjedhura nga folësit e gjuhës që prej njësive më të vogla leksikore (fjalët) e deri te njësitë frazeologjike, si dhe nga stilet e ndryshme funksionale të gjuhës ku këto njësi gjejnë realizime konkrete, përgjigjja nuk mund të jetë veçse një: *eufemizmat janë mjete të përzgjedhura qëllimisht nga folësit e një gjuhë për të rregulluar marrëdhëniet shoqërore*. Eufemizmat na ndihmojnë mjaftueshëm jo vetëm për të kuptuar natyrën e gjuhës, por edhe për të zbërthyer natyrën njerëzore.

Forma e brendshme e eufemizmave i jep mundësi bashkëfolësit të krijojë një përshtypje për qëndrimin dhe përzgjedhjet vetjake gjuhësore të një folësi të caktuar për nocione të cilat nuk mund të pranohen hapur apo lehtësisht. Nga kjo anë, ne e kuptojmë se si

---

<sup>135</sup> Bejta B. *Gjuha dhe të folurit*, Buzuku, Prishtinë, 2007, f. 18.

<sup>136</sup> Po aty, f. 19.



njerëzit ndikohen apo kontrollohen nga tabutë shoqërore apo nga trysnia që shoqëria ushtron dhe se si reagojnë kur një ose më shumë norma të paracaktuara shkelen apo thyen. Eufemizmat na tregojnë se si njerëzit i kufizojnë idealet dhe bestytnitë e tyre brenda disa kufijve të vendosur (të përcaktuar) nga vetë shoqëria. Mënyrat e përzgjedhjes së përdorimeve eufemistike, të studiuara nga pikëpamja e përdoruesve të gjuhës, janë të lidhura drejtpërdrejt me kufizimet që ata ndeshin gjatë ndërveprimeve shoqërore dhe ndikimet që kanë këto përdorime të pjesëtarët e tjerë gjatë aktit të komunikimit. Nga pikëpamja pragmatike, funksioni parësor i përdorimit të eufemizmave është të shmangë keqkuptimet, fyerjet dhe lëndimet dhe të ndërtojë marrëdhënie të qëndrueshme shoqërore. Kjo përzgjedhje buron prej nevojës së brendshme të folësit për të zbutur konflikte të mundshme shoqërore, që mund të vijnë si rezultat i përdorimit të drejtpërdrejtë të njësisë leksikore në fjalë.

Në këtë kontekst, përmasat e përdorimit të eufemizmave janë më konkrete dhe të spikatura në karakterin e tyre sociokulturor, ku tradita, normat dhe kodet e pashkruara e bëjnë individin më të ndjeshëm dhe me të kujdesshëm në përzgjedhjen e fjalëve.

Zëvendësimi leksikor është një mënyrë mjaft e frytshme për të lehtësuar nënkuptimet përkeqësuese të fjalëve që konsiderohen si pa takt apo fyese në një kontekst të dhënë. Duket qartë se eufemizmat i përgjigjen dëshirës për të shmangur tabu të caktuara që ndikojnë negativisht, normat konvencionale të mirësjelljes apo dhe imazhin e sjelljes që folësi do të prezantojë.

Llojet e ndryshme të mënyrave të përzgjedhjes për përdorimin jo të drejtpërdrejtë të fjalëve motivohen përmes parimeve morale të mirësjelljes dhe janë më tepër dukuri sociokulturore, të lidhura dukshëm me dëshirën e folësit për të mbajtur marrëdhënie shoqërore korrekte. Është e rëndësishme të theksojmë se këto taktika verbale, jo të drejtpërdrejta, synojnë të pakësojnë forcën vepruese të aktit të ligjërimit pa ndryshuar përmbajtjen e mesazhit që duhet përcjellë. Akte të tilla ligjërimit zvogëlojnë fuqinë negative apo përkeqësuese dhe shmangin keqkuptimet apo konfliktet në nivelin e komunikimit ndërpersonal, andaj përdoruesit e gjuhës shpesh u drejtohen strategjive të tilla.

Eufemizmat e përzgjedhura për analizë në këtë aspekt përputhen me tabu të tilla, si: vdekja, lindja, shtatzania, marrëdhëniet intime, tipare të jashtme, paaftësi fizike apo mendore, veshjet e brendshme etj. Në të gjitha rastet shndërrimet semantike të fjalëve janë diktuar nga faktorë jashtëgjuhësorë, të lidhur me frikën, bestytnitë, paragjykimet, respektin, kulturën

vendase, kulturën materiale, normat dhe zakonet, doket krahinore, kushtet mjedisore, marrëdhëniet me fqinjët etj.

Është e qartë se eufemizmat kanë lindur bashkë me gjuhën në fazën më të hershme të zhvillimit të gjuhës, ato lidhen me mite dhe besime me burim vendas dhe përshfaqen më të plota dhe më origjinale me një spektër të gjerë variacionesh dialektore në ligjërimin e gjallë, sidomos në leksikun popullor. Eufemizmat janë produkt gjuhësor i një shoqërie si dëshmi e traditës dhe vijimësisë gjuhësore të një populli dhe, si çdo përftesë tjetër historike dhe social-kulturore, ato janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të gjuhëve.

#### **5.4. Analiza e formës së brendshme të disa eufemizmave të shqipes**

Njësitë eufemistike janë një pasuri e madhe dhe e pazëvendësueshme gjuhësore. Ato na japin mundësi që mendimi të shprehet gjuhësisht sa më i thukët dhe e bëjnë gjuhën më të larmishme, më të shkathët dhe më të fuqishme. Pikërisht, forma e brendshme e gjuhës realizohet përmes njësive konkrete që dallohen për karakterin popullor dhe lidhjet me gjuhën e folur të popullit i shpërfaqin përmes zhvillimit, pasurimit dhe diferencimit të vlerave kuptimore e funksionale. Baza lëndore-konceptore e përzgjedhjes së njësive të tilla merret drejtpërsëdrejti nga elemente të jetës së përditshme, që lidhen me frikën nga kafshët grabitqare, nga sëmundjet, me besimet fetare etj. Masa, gjerësia, gjallëria, larmia dhe origjinaliteti i eufemizmave të shqipes na jep mundësi që, krahas vendit që zë zgjerimi i vëllimit kuptimor të fjalëve të gjuhës shqipe, krahas analizës së proceseve të prejardhjes dhe strukturës kuptimore të saj, të analizojmë edhe kushtet historike, socialkulturore dhe rajonale që kanë diktuar zhvillimin kaq të madh nga pikëpamja sasiore dhe cilësore të kësaj dukurie të njohur gjuhësore.

Njohja e eufemizmave është parakusht për njohjen e mendësisë së një populli, i cili në gjuhë, në akte të tilla të mirëfillta krijimi të vullnetshme, e ka shkrirë gjithë vetëdijen dhe ndërgjegjen e tij kolektive. Ndaj, analiza semantike dhe strukturore e eufemizmave ngrihet mbi shtjellimin e leksemave të veçanta, duke i parë ato në planin krahasues midis sinonimeve eufemistike, çka do të trajtohet më poshtë.

#### 5.4.1. “Gjarpri” si tabu dhe eufemizmat për të

Për tabunë “gjarpri” në gjuhën shqipe ka shumë eufemizma, të cilat mbartin vlera të veçanta leksiko-semantike dhe janë të llojllojshme nga pikëpamja strukturore dhe për nga forma e brendshme. Një varg besimesh mitologjike lidhen me këtë kafshë. Gjarpri ka qenë totem për ilirët dhe kulti i lashtë i lidhur me këtë kafshë del i gjallë edhe sot në disa rajone të Shqipërisë së Veriut<sup>137</sup>. Prof. Çabej shkruan se në katundet e Tepelenës kjo qenie mendohej si mbrojtësja e shtëpisë dhe quhej *vitore*, ndërsa në Veri, një figurë që i ngjan vitores së Jugut është “bolla”. Këtë ide mund ta konkretizojmë edhe me ndonjë shembull tjetër, si: *i bekuomi, ora e shtëpisë, roja e shpisë* etj., ndoshta edhe për “ta marrë me të mirë”.

Përveç mitologjisë, kjo figurë është veçanërisht e përhapur edhe në folklorin shqiptar. Rreth 96 njësi eufemistike për këtë kafshë tabu kemi skeduar gjatë vjeljes së materialit nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, nga fjalorët përkatës dialektorë dhe doracakët apo fjalorthët e njësisve eufemistike. Të dhënat numerike, në rastin e analizës sonë, përbëjnë një argument. Larmia e këtyre eufemizmeve, ngjyresat e theksuara krahinore, shtrirja e përdorimeve në të dy dialektet dhe në një varg të folmesh, dëshmojnë se kemi të bëjmë me një prurje të pasur leksikore, ku spikaten aftësitë fjalëkrijuese të popullit shqiptar. Analiza e materialit gjuhësor na jep mundësi të kuptojmë se lënda shenjuese e zgjedhur për të emërtuar një rrezik që, në pamundësi për ta zhdukur, të paktën nuk duhej “ta zije goje”, është ndërtuar sipas disa gjedheve që na ndihmojnë të bëjmë zbërthimin kuptimor të fjalëve dhe të arrijmë deri te motivimi i tyre i brendshëm.

Porcesi i përfutimit të njësisve eufemistike shoqërohet me lëvizje të rëndësishme kuptimore sipas figurshmërisë së dukshme të mjeteve më prodhuese të tropeve gjuhësore (metaforës, metonimisë, sinekdotës etj.), ku eufemizmi i është ngjizur tabusë mbi bazën e ngjashmërisë apo afërsisë së realies në fjalë me realie të tjera. Në këtë proces vihet re një zgjerim i dukshëm i strukturës kuptimore, ku aftësia e shënuesit shoqërohet me vlera të tjera shprehëse dhe stilistikore. Nga ky proces janë përfutur emërtime të tilla, si: *bizele, buba, sfurk, fier, buçi, gjylpani, kulaçi, farkaçi* etj.

---

<sup>137</sup> Osmani, T. & Pepa, S., *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000, f. 20.

Po kaq interesante është simbolika gjuhësore e zgjedhur në rastet kur realies i janë veshur cilësi të kushteve fiziko-natyrore dhe krahinore në të cilat kjo kafshë gjallon, apo veçori të dukshme të kësaj tabuje të njohura në kulturën dhe mendësinë popullore. Në të gjitha rastet e shënuara më poshtë shenja gjuhësore është sinkretuar në përemrin dëftor “ai”+emërtimin e vendit ku kjo kafshë gjallon. Sipas kësaj gjedheje janë krijuar emërtime të tilla, si: *ai me briena, ai i gardhit, ai i dheut, ai i ferrës, ai i gurit të çamë, ai i nargurit, ai i shkambit, ai i tokës, ai i dheut të tretnë, ai i përrojeve, ai i pronit, ai qi vërret prronjeve, ai i shkamit, ai i shullanit* etj. Në disa raste procesi i sinkretimit është zgjeruar më tej aq sa, përmes metonimisë, emërtimi i vendit i ka kaluar kafshës në fjalë si në rastet *shojëz dhe shored*.

Një proces zgjerimi strukturor, i shoqëruar me perifrazim, ka ndodhur në rastet e mëposhtme, ku zëvendësimi leksikor nuk e ka asimiluar shenjën gjuhësore konkrete, përkundrazi, leksemës *gjarpër* i janë bashkëngjitur treguesit konkretë të cilësive të jashtme të realies apo vendit ku jeton, duke përfutuar njësi të tilla, si: *gjarpër i bjeshkës, gjarpër i larmë, gjarpër shullani, gjarpër i ujës, gjarpër helmuesi, gjarpër me kurorë* etj.

Tipologjia e përzgjedhjes leksikore në raste të tjera është ndërtuar mbi bazën sendore-logjike të treguesve të jashtëm të realies, cilësi konkrete apo tregues thelbësorë të realies që lidhen me pamjen e jashtme ose me rrezikun që paraqet kjo gjallesë, si: *i larmi, laraman, laramanlivadhi, i gjati, i helmuesi, laroshi, i përdredhuni, bishtcungu, kambshkurti, damtori, i zivi, sfurkuth, farkaçi, i ftohti, kulaçi, lizganjoci, këmbëfshehuni* etj.

Intersante janë edhe rastet ku një varg i tërë sinonimesh dialektore janë ndërtuar mbi bazën e një pike të përafërt semantike të lidhura me fjalët *dhé, tokë, truall, zhag*. Nga kjo përzgjedhje janë përfutuar leksema të tilla që përfshihen në të njëjtën fushë konceptore dhe leksikore, si: *padheu, përdhesi, përdheci, përtokësi, përtrollësi, përzhangësi, ai që shkon zhag, zhagësi, shpërdheci* etj. Nga pikëpamja e tipologjisë së fjalëformimit, koncepti është formësuar gjuhësisht nëpërmjet përngjitjes, ku gjymtyra e dytë del si një variacion i dukshëm sinonimik dialektor: *dhé, tokë, truall, zhag*. Edhe prapashtesat zvogëluese “c”, “z” dhe “ës” kanë vlerë në zgjerimin e kuptimit leksikor përmes mbartjes së nuancave kuptimore. Një cilësi e dallueshme e realies, që lidhet me mendësinë dhe konceptin e përgjithshëm popullor, është edhe mënyra se si kjo kafshë lëviz, ndaj, mbi këtë bazë konceptore, janë krijuar sinonimet leksikore të tipit: *rrëshajë, rrëshanjëzi, rrëshqitësi, rrëshqanësi* etj.

Kompozitat dëshirore me vlerë dhe funksion eufemistik zënë një vend të spikatur si nga pikëpamja numerike, ashtu edhe nga produktiviteti dhe gjallëria e vlerave kuptimore të krijuara. Realizimi material i këtyre njësive është ndërtuar mbi bazën e psikologjisë së individëve folës, të cilët besonin se rreziku i kësaj gjallese mund “të zhdukej” duke “i mbyllur gojën”. Të këtij tipi janë kompozitat: *gojëfarkuemi, gojëlidhuri, gojëmbylluri, gojëmbërthyeri, gojëngrimi, gojëngurti, gojëmbytimi, gojëqepuni, gojëthati* etj. Në të gjitha rastet këto njësi mund të zërthehen nga pikëpamja kuptimore në fjali të plotë dëshirore në formë mallkimi “*iu mbylltë/ ngriftë/ iu qeptë/ iu thaftë / iu bëftë gur*” *goja*. Megjithëse kuptimi në të gjitha rastet është i përfryrë, ndërgjegjja popullore dhe paragjykimi kolektiv bën që të zgjidhet një mekanizëm i tillë i përtëritjes semantike siç është nënkuptimi, i cili bën që aftësia emërtuese e fjalës t’i vishet realies në pamje të parë, si cilësi e dukshme e saj kur, në fakt, nuk është gjë tjetër veçse një mallkim i nënkuptuar. Të njëjtat vlera shprehëse të lidhura me emërtimin jo të drejtpërdrejtë të realies ka edhe kompozita *barkthatë* “*iu thaftë barku*”, e cila mbart nuanca kuptimore dëshirore si tek eufemizmat e analizuara më lart.

Në përpjekje për të hulumtuar kuptimin e sinonimeve leksikore eufemistike për këtë fjalë tabu, vërejmë se në disa njësi mallkimi bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ku ngjyresat shprehëse-emocionuese janë mjete të dallueshme: *ai që kloftë (qoftë) tretë, ai që ia preftë rrugën gjëja, ai ujku e hangër, ai që shkoftë larg, djegsh ai që u djegtë, farofsh ai që u faroftë, nxifsh ai që iu nxiftë koka, plasç bagëti që u fryftë e plastë* etj. Në disa raste këto shprehje shoqërohen me trajta paralele të sinkretizuara nga pikëpamja strukturore, por me vlerat e një dysori identik dialektor nga këndvështrimi semantik i tipit: *shkoftëlargu, qoftëlargu, shkoftëlargti, hajujku* etj.

#### **5.4.2. Një analizë e formës së brendshme për eufemizmat e tabusë “ujk”**

Një tabu tjetër e lashtë, e lidhur ngushtë me jetën e përditshme baritore dhe kushtet gjeografike rajonale dhe mjedisore, është dhe *ujku*. Në bestytnitë popullore shqiptare dhe ballkanase, në përgjithësi, për këtë kafshë “ndalohej” t’ia zije emrin ngoje. Siç dihet, fjala *ujk* i përket fondit të vjetër të leksikut idoevropian dhe në shqip ka shërbyer si temë fjalëformuese e një numri toponimesh dhe antroponimesh, për të mos përmendur faktin që në

disa rajone shihej edhe si “totem” (objekt adhurimi)<sup>138</sup>. Si e tillë, kjo tabu do të lidhej domosdoshmërisht me një varg emërtime nga më origjinalet e më të spikaturat, që përbëjnë një fond të pasur të leksikut popullor dhe që karakterizohen nga veçori të dallueshme të kuptimit të figurshëm dhe ngjyrimit stilistik, edhe pse përdorimi i tyre është i kufizuar vetëm në leksikon krahinor.

Gjatë analizës semantike të sinonimeve leksikore me vlerë eufemistike të lidhura me këtë tabu (rreth 50 të tilla), vumë re se, në dallim nga fjala *gjarpër*, eufemizmat për fjalën *ujk* nuk njëjtësohen shpesh me tiparet e jashtme të kafshës në fjalë apo me kushtet fizike dhe gjeografike ku kjo gjallesë jeton. Si rrjedhim, të paktë janë shembujt për klasifikimin e bazuar mbi këtë kriter. Edhe në ato pak raste që hasen, përzgjedhja leksikore nuk është bërë mbi bazën e bashkëshoqërimit të treguesve konkretë të jashtëm të realies, por të cilësive të nënkuptuara, të metaforizuara apo të hiperbolizuara, si: *bishtgjati*, *turithimë*, *qafëtrashi*, *zullap*, *veshcurri*, *i gjati*, etj. Qasjen me realien, duke e sendërtuar mbi bazën e onomatopesë, e vërejmë vetëm në fjalën *uluritësi*. Në rastet e përdorimeve të izoluara, që nuk kanë formuar vargje sinonimesh, mund të shtojmë edhe leksemën *gjë*, një shenjë gjuhësore shumëkuptimëshe, por e motivuar me qëllim që kësaj kafshe jo vetëm të mos i përmendet emri, por edhe t’i zhvlerësohen fuqitë. Nën këtë argument mund të analizohen edhe njësitë leksikore të krijuara mbi bazën e treguesve të vendit, të kohës etj., të cilat janë të kufizuara nga pikëpamja numerike dhe, rrjedhimisht, edhe nga denduria e përdorimit. Shembujt e mëposhtëm janë sjellë në këtë këndvështrim: *ai i malit*, *ai i natës*, *nëntokësi*, *ai i pragjeve*, *ai i dheut*. Por, në rastin e leksemës *nëntokësi*, qasja leksikore argumentohet më tepër me dëshirën e pashprehur, sesa me kushtet konkrete të realitetit objektiv. Struktura e njësive të përdorura është e njëjtë me atë të leksemës *gjarpër*, çka na bën të besojmë se simbolika tingullore, si reflektim i drejtpërdrejtë i abstragimeve të njëjta mendore dhe psikologjisë së përbashkët popullore, është përzgjedhur mbi bazën e të njëjtave kriteret të referimit apo të bashkëshoqërimit edhe kur referenti ndryshon.

Për nga produktiviteti i pasur leksiko-semantik vlerësohen edhe njësitë ku një tipar i qenësishëm i realies përbën edhe boshtin kuptimor të një fushe konceptore të lidhur me rrezikun që ka kjo kafshë. Nga pikëpamja e fjalëformimit, kjo bazë sendore-logjike ka

---

<sup>138</sup> Osmani, T. & Pepa, S., *vep. cit.*, f. 16.

prodhuar një fushë derivacionale të tipit: *egërsi, egërsinë, egërti, egërci* etj. Edhe nëse leksemat e krijuara i shohim si variante fonetike të së njëjtës fjalë, ato vlejné për të argumentuar përndarjen e njëtrajtshme në areale të ndryshme gjeografike dhe për të kuptuar se abstragimi i njëjtë mendor, si provë e pakundërshtueshme e mendësisë së përbashkët popullore, ka prodhuar njësi të ngjashme leksiko-semantike. Vëllimi kuptimor i fjalës rritet kur tipari cilësor i mbivendoset një lekseme të vetme *bishë* apo *hasm*, kuptimet leksikore të të cilave i mbartin të gjitha vlerat dhe nuancat kuptimore.

Besimi dhe mendësia e përbashkët popullore e ka përmbushur funksionin e plotë eufemistik (atë të zbutjes, të afrimit të realies, në pamundësi për ta zhdukur apo luftuar atë), duke zgjedhur ta shenjojë realien me cilësi që ajo nuk i ka, por që gjithkush do të donte që t'i kishte. Një përzgjedhje interesante janë kompozitat përcaktore *këmbëlehti, shpirtmiri, shpirtndrituri* që, më tepër se një cilësues konkret i realies, mund të interpretohet si një dëshirë e shprehur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, e zbrëthyer nga ana përmbajtësore në njësitë që shprehin dëshirë: *e pastë këmbën të lehtë, e pastë shpirt të mirë, i ndritë shpirti* etj. Të njëjtat vlera kuptimore mbartin leksemat *i pagoji, i paemri, i padukuri, i papjesi, i paqeni, i paudhi* etj., ku parashtesa *pa-* luan rolin kyç në aspektin përmbajtësor të leksemave. Po të zbrëthejmë përmbajtjen semantike të fjalës, duket se ajo përmbush funksionin dëshiror të një fraze të tërë: *ai që mos pastë gojë, ai që mos pastë emër, ai që mos u duktë, ai që mos pastë pjesë* etj.

Transferimet metaforike janë një dëshmi e pakundërshtueshme e mendësisë primitive dhe botëkuptimit të mbyllur rajonal. Qasjet e bëra në rastin e zëvendësimeve të shembujt e dhënë më poshtë, nuk lidhen me tregues realë dhe konkretë të realitetit objektiv, por me kalimet dhe transferimet metaforike të largëta dhe të paperceptueshme, çka shpjegohet vetëm me arsyetimin e bërë më sipër se psikologjia kolektive e folësve ka diktuar përzgjedhje kaq origjinale, sa ta quajë realien *shpend*, një fjalë me ngjyrim asnjës apo dhe me një njësi tjetër *shpend i egër*, ku mbiemri cilësor mbart nuanca negative të realies që zëvendësohet.

Adhurimi i lashtë, i lidhur me traditat dhe zakonet fetare, bën që përftesat leksikore për këtë realie të mbështeten në figura të besimit fetar, si *kumbara* dhe në sintagmën me raporte përcaktore *kumbara e natës*.

Kompozitat dëshirore eufemistike me strukturë emër+mbiemër prejfoljor të tipit: *gojëkyçuri, gojëlidhuri, gojëmbërthyeri, gojëmbyllëti, gojëfërkuemi, gojëshelni, gojëngrimi,*

*gojëqepuri, gojëthati, gojëzëni*, janë të njëjta me ato të zgjedhura në lidhje me tabunë *gjarpër* dhe motivimi është i njëjtë. Zbërthimin e plotë të përmbajtjes kuptimore e shohim vetëm në rastin e një përdorimi, ku eufemizmi ka marrë trajtën e një fraze të zgjeruar dëshirore të tipit “ai iu gurtë goja”.

#### **5.4.3. Bukla, nuselala etj. dhe forma e tyre e brendshme**

Shembull i njëmendtë për eufemizmat e botës shtazore janë edhe njësitë eufemistike për një qenie demoniake, jo vetëm për kulturën tonë, por edhe për një pjesë të popujve të Ballkanit, siç është *bukla (nuselala)*. Sipas prof. Çabejt, nderimi dhe frika për *nusen e lalës* është i gjallë edhe në popuj të ndryshëm të Ballkanit dhe më gjerë. Në frëngjisht quhet “belette”, në Milano “belora”, në Sicilinë e vjetër “billotuta”, në Sardenjë “donna de muru”, në Portugali “doninha”, në anglishten e vjetër “fairy”, në spanjisht “comadreja”. Mendohet se edhe emri latin i shtazës “mustela”, që do të thotë “të zësh minj”, është një eufemizëm në vetvete<sup>139</sup>. Po kaq interesante duken edhe në shqip këto njësi nga ana sasiore edhe nga shumëllojshmëria strukturore dhe kuptimore (rreth 39 njësi kemi skeduar si eufemizma për këtë kafshë).

Gjatë analizës së strukturës kuptimore të këtyre njësive vihet re se eufemizmat më të përdorura lidhen me tiparet e jashme të realies dhe me një prirje që në besimin popullor të dalin në pah cilësitë më pozitive, ku mbiemrat cilësorë *e bukur* dhe *e mirë* shërbejnë si tema semantike në procesin e prejardhjes kuptimore, duke shërbyer në të njëjtën kohë edhe si tema fjalëformuese. E gjithë fusha derivacionore shoqërohet me zgjerim të vëllimit kuptimor, duke krijuar shembujt e mëposhtëm: *e bukura, bukuri, bukulicë, bukulushkë, bukuroshe, bukuria e minjve, e bukura e dheut, e bukuria e zogjve, bukërza, bukrezë, buklezë* etj. Ndryshimet fonemore në variantet e fjalëve të prejardhura janë tregues i ngjyresave krahinore apo dialektore. Në të gjitha rastet morfema rrënjë, që ka shërbyer si temë fjalëformuese, është lehtësisht e dallueshme. Nga pikëpamja strukturore, te dy shembujt e emërtimeve të përbëra, përkatësisht *bukuria e minjve* dhe *e bukura e dheut*, kemi dy tema fjalëformuese të krijuara mbi bazën e morfemës rrënjë.

---

<sup>139</sup> Çabej, E., *Disa eufemizma...*vep. cit., f. 19.



Në besimin e lashtë primitiv popullor, por edhe në mitologjinë e vjetër greke, besohet në shndërrimin e një gruaje në *nuselale* dhe anasjelltas, ndaj dhe kjo figurë, e veshur me frikë dhe mister, në mendësinë popullore herë quhej *nuse*, herë *nusebukur* e më pas: *nuse e djemve*, *nusja e minjve*, *nuskëz lale*, *nuse e mirë*, *nusmira*, *nusëza*, *nusël* etj. Zëvendësimet eufemistike herë paraqiten si fjalë të parme, ku, metafora, edhe pse e justifikuar jo me tipare të qenësishme të realies (në rastin e njësisive *nuse*, *nusël*, *nusëza*), shërben si mjet për zgjerimin e kuptimit, herë si togfjalësha me strukturë *emër+ emër/mbiemër*, të ndërtuara mbi bazën e marrëdhënieve përcaktore: *nusja e minjve*, *nusja e djemve*, *nusja e mirë*, *nuskëz lale* (vini re funksionin e prapashtesës zvogëluese *z*), e herë si kompozita të mirëfillta (*nusebukur* apo *nusmira*), ku përbërësi i dytë stërzmadhon vlerat shprehëse kuptimore të përbërësit të parë.

Me interes për analizën tonë janë dhe vargjet e sinonimeve dialektore dhe krahinore të ndërtuar mbi bazën e treguesve të tipareve të jashtme të realies, të lidhura përkatësisht me ngjyrën apo me një tregues konkret dallues të realies, siç është *bishti*: *bishtafurka*, *bishtfurkabukura*, *larakuqe*, *pikaloshe*, *shtatpikaloshe* etj. Formimet e mësipërme, përveç kuptimit të plotë leksikor, mbartin edhe nuanca kuptimore të specifikuar dhe ngjyrim emocionues pozitiv. Në raste të tjera, metafora gjuhësore ka shërbyer si mjet i rëndësishëm për transferimet dhe zgjerimin e strukturës kuptimore të fjalës, duke përfutur njësi të tipit *hutbukur* dhe *kalkuqe*, ku aftësia e shenjuesit për të cilësuar një realie tjetër mbi bazën e asosacionit të hamendësuar e zgjeron vëllimin kuptimor edhe me ndihmën e mbiemrave cilësues “i/e bukur” apo “i/e kuq/e”. Ndërkaq, tregues të vendit dhe kushteve natyrore ku gjallon kjo kafshë ka sjellë përdorime të tilla, si: *ajo e gardhit*, *ajo e murit*, *ajo e skutave*, *ajo e dheut* etj. Sinkretimi i leksemës, duke e zëvendësuar me një dëftor të përshtatur sipas gjinisë, është një teknikë e njohur në formimin e njësisive eufemistike.

Nga ana tjetër, treguesi i funksionit, rolit apo dobisë që ka kjo kafshë e që lidhet ngushtë me jetën e përditshme dhe kushtet natyrore të banorëve vendas, shprehet përmes shenjave të tilla gjuhësore karakteristike për gjuhën popullore, si: *ajo që të fryn*, *e mira e mi(nj)ve*, *e mira e zogjve* etj.

#### **5.4.4. Rreth formës së brendshme të njërive eufemistike për tabu nga demonologjia**

Në lëmën e demonologjisë, një figurë e krijuar mbi bazën e paragjyqimeve mistikofetare është *djalli*. Në FGjSSh shpjegohet si “qenie e mbinatyrshe, e përfyturuar zakonisht si një njeri me brirë, me thundra e me bisht, mishërim i së keqes, shpirt i keq, e liga”<sup>140</sup>. Ndër figurat e tjera të besimin primitiv dhe paragjyqimeve popullore njësitë eufemistike të lidhura me këtë mishërim të së keqes vihet re një shumëllojshmëri si nga pikëpamja numerike, ashtu dhe laryshia kuptimore e strukturave që do të analizohen. Rreth 40 njësi gjuhësore me vlerë eufemistike kemi skeduar dhe analizuar, duke i klasifikuar si më poshtë:

**5.4.4.1.** Sipas tipologjisë së emërimit, ajo që na tërhoqi më tepër vëmendje është emërtimi i së njëjtës realie me një pikë semantike të përbashkët. Ajo që i bashkon të gjitha njësitë e analizuar është *koncepti i së keqes* që identifikohet drejtpërsëdrejti me realien, procesi i emërimit të së cilës nuk kalon përmes asosacionit apo përafrimit mbi bazën e metaforës, por qasja e strukturave kuptimore me vlerë eufemistike ndërtohet mbi bazën e cilësive të drejtpërdrejta që folësit i njohin kësaj realieje. Mbiemrat cilësorë të emëruar të krijuar mbi bazën e këtij modeli janë: *i paemni, i paudhi, i papjesi, i pafeu, i mallkuemi, i zvetënuemi* etj. Të gjitha leksemat kanë fituar nuanca kuptimore dhe mbartin ngarkesën stilistikore dhe intensitet emocionues. Nëse përqendrohemi te modeli i tipit fjalëformues të tri leksemave të para, elementet e parashtesimit (parashtesat mohuese pa-) nuk janë përzgjedhur rastësisht. Ato janë në funksionin tërësor të treguesve etnografikë dhe mendësorë të një bashkësie që fjalën e përdor “aty ku duhet” dhe “ashtu si duhet”.

**5.4.4.2.** Kompozitat dëshirore të krijuara dhe të përdorura me funksione eufemistike, si pjesë përbërëse e mbishtresimeve stilistike-emocionuese, luajnë një rol të rëndësishëm në pasurimin e vlerave shprehëse të gjuhës. Në listën e gjatë të këtyre shembujve mund të veçojmë *qafëthyeri, largneshi, shkoftëlargu, koftëlargu, hajujku, rrashtëbitisuri, jashtëkëtej, kambëshkurtri* etj. Pavarësisht prirjes të dukshme për një sintetizim të strukturave të përdorura, për ligjur me dëshirën e nënkuptuar që kësaj figure nuk “i duhej zënë aspak emri”, zbërthimi i strukturës së përmbajtjes kuptimore na bën të kuptojmë se, në fakt, emërtimet e

---

<sup>140</sup> *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 346.

përzgjedhura nuk janë gjë tjetër veçse njësi specifike të sinkretuara (për shkak të paragjykimeve apo bestytisë) të fjalive dëshirore në formë mallkimi, që nga përmbajtja kuptimore mund të përqsasen me struktura të plota të tipit “iu theftë qafa”, “e hëngërt ujku”, “shkoftë larg nesh”, iu shkurtofshin këmbët” etj. Sigurisht, përzgjedhja e kësaj mënyre shprehjeje krejtësisht të qëllimshme duhet të interpretohet mbi bazën e lidhjeve të brendshme dhe organike të rrafshit të mendimit me atë të gjuhës, lidhje të cilat sendërtojnë në mënyrë të plotë konceptin dhe mendësinë e rrënjosur thellë në botëkuptimin popullor, mendësi e cila dikton përzgjedhjen e veshjes tingullore bazuar te cilësitë e realies që folësi do të nxjerrë në pah dhe që në rastin konkret janë vetëm cilësi negative.

**5.4.4.3.** Shembujt e dhënë më poshtë na shërbejnë për të përligjur argumentet e paraqitura deri tani, atë të besimit te forca e fjalës si “mjete që të shpëton nga e liga”. Vargu i gjatë sinonimik shpreh perceptime të ndryshme dhe përdorimi i gjerë i shenjave gjuhësore dhe mënyrave të shprehjes nuk janë gjë tjetër veçse mënyra të ndryshme të menduarit dhe këndvështrime të ndryshme në raport me realien, të cilat e pasurojnë gjuhën dhe e bëjnë leksikun popullor një pasuri të vërtetë të trashëgimisë sonë gjuhësore dhe kulturore. Prirja që shfaqet dukshëm dhe nevoja për sinkretizim që çon në “rrudhje” të strukturës së jashtme të fjalës (justifikuar me faktin se modifikimi i fjalës do të çojë në ndryshim të vetë realies) sikundër u analizua në shembujt e pikës b, duket se bien ndesh me procesin e perifrazimit që u nënshtrohen prurjet leksikore të mëposhtme “ai që pastë thyer qafën”, “ai pranona Zot”, “ai qi kjoshin djegë”, “ai që ia pretë ujku udhën”, “ajo qi hangërt vedin”, “ai që shkoftë larg”, “largoje Zot” etj.

Teknikat e krijimit të këtyre eufemizmave janë bazuar në tipat më tradicionalë të fjalëformimit, por ajo që të bie menjëherë në sy është procesi i përtëritjes semantike, i gjallërimit të mjeteve shprehëse, ngjyresat e theksuara dialektore, pamja e përthyer që zë vend të rëndësishëm në realizimet konkrete gjatë veprimtarisë folëse. Në dallim nga fjala *gjarpër*, eufemizmat e përzgjedhura për fjalën *ujk* nuk njëjtësohen shpesh me tiparet e jashtme të kafshës në fjalë apo me kushtet fizike dhe gjeografike ku kjo gjallesë jeton. Andaj të pakta janë shembujt e klasifikimit bazuar në këtë kriter: *turithimë, qafëtrashë, zullap, veshcurri apo ai i mali ,nëntokësi, uluritsi*. Të gjitha leksemat e përzgjedhura mbartin vlera të dallueshme për ngjyrimin stilistikor dhe kuptimin e figurshëm me të cilin zënë vend në

fondin burimor të leksikut popullor, edhe pse përdorimi i tyre është i kufizuar në nënsistemin leksikor krahinor.

#### **5.4.5. Rreth formës së brendshme të njësive eufemistike për sëmundjet: epilepsia**

Eufemizmat për sëmundjet e ndryshme lidhen me të njëjtën tipologji dhe bazohen në mendësi të ngjashme të pazhvilluara kulturore, shoqërore, ekonomike, ngrihen mbi frikën dhe pamundësinë reale për të shpjeguar “pse”-të dhe ndërtohen mbi bazën e një paditurie kolektive të diktuar nga kushtet e ashpra natyrore. Njësitë eufemistike për sëmundjet e tuberkulozit, fruthit, epilepsisë, grykëve apo të ashtuquajturën “sëmundjen e fëmijëve” (një eufemizëm i mirëfilltë) na bën të mendojmë se këto kanë qenë sëmundjet më të përhapura që, me shumë gjasa, nuk u është gjetur shërim. Nga pikëpamja statistikore kemi vjelë rreth 30 njësi për epilepsinë.

Analiza kuptimore dhe zbërthimi i përmbajtjes së njësive eufemistike të lidhura me *epilepsinë* na shpie në përfundimin se populli ka zgjedhur mënyra të ndryshme për “ta larguar apo trembur sëmundjen me fuqinë magjike të fjalës”. Në ligjërimin bisedor emërtimi për këtë sëmundje është “sëmundja e tokës”, një eufemizëm i gjithëpërdorshëm, asosacioni i së cilës bëhet në lidhje me kontaktin që krijon me tokën personi që vuan nga kjo sëmundje në momentin kur shfaqen simptomat. Me *tokën* lidhen eufemizmat *ajo e tokës, ajo e trollit, lgata e tokës, tokësi* (ku kemi shmangie të qëllimshme të fjalës *sëmundje* me anë të sinkretizmit, një proces të cilit i nënshtrohen shumica e eufemizmeve, sidomos në rastet e përdorimit të dëftorëve “ai” ose “ajo”) dhe përcaktimi i sëmundjes është kufizuar, jo pa qëllim, vetëm me vendin ku kjo sëmundje shfaqet, si në rastin *puna e trollit*. Listës së eufemizmeve të lidhura me elementin “vend” (*tokë* në rastin tonë) i shtohet dhe një njësi eufemistike me vlerë të theksuar shprehëse, një fjali dëshirore në formë mallkimi ku “urohet” që “e keqja” e kësaj sëmundjeje të bjerë pikërisht aty ku edhe i sëmuri ndihet më keq: *ajo që i raftë tokës*. Në këtë kontekst, elementi *tokë* është shprehur me leksema sinonimike dialektore, si “trolli” në njësinë “puna e trollit”, apo kur zëvendësimi bëhet me leksema të përafërta për nga kuptimi, si “dheu” (*pranë dheu*), apo dhe me kuptim të zgjeruar dhe të përgjithësuar “bota”.

Zëvendësimi bëhet më interesant kur fjala *sëmundje* hiqet nga përdorimi dhe shprehja fiton origjinalitet të theksuar me leksemën “punë” që ka zënë vend në struktura të ngulitura,

të cilat, nga pikëpamja semantike, janë të barasvlershme me kuptimin e njërive të krahasuara më lart. Përveç njësisë eufemistike *puna e trollit*, për ta konkretizuar më shumë po japim shembujt: *puna e herës, puna e tokës, punëhera* etj.

Krahas prirjes së dukshme që të shmaget shenjimi i drejtpërdrejtë me emrin *sëmundje* për shkaqe të ndryshme zakonore, paragjyquese apo pamundësi reale për shërimin e sëmundjes, duke përdorur procesin e sinkretizmit përmes përdorimit të dëftorit “ajo” apo “ajo punë”, në shembujt e analizuar më poshtë na tërhoqën vëmendjen edhe rastet kur përdoret drejtpërdrejt fjala “sëmundje”, herë e shoqëruar me mbiemrin cilësor që bart vlera të plota semantike: *sëmundja e ligë*, dhe herë e lidhur me mendësinë popullore dhe besimet e ngushta krahinore se kjo sëmundje shfaqet më e rrezikshme në netët me hënë: *sëmundja e hënës, ajo e hënës, lgata e hënës* etj.

Eufemizma të tjera të ngjashme nga pikëpamja konceptuale, por të zëvendësuara nga njësitë përkatëse leksikore, gjejnë vend vetëm në një shtresë të kufizuar në leksikun dialektor apo krahinor të tipit: *ligë, flamë, bëtajë* etj., të cilat, nga ana e tyre, janë pasuruar dhe kanë rritur vlerat shprehëse stilistikore kur shoqërohen me epitetet *e ligë* dhe *e keqe*. Të këtij tipi janë shembujt: *bëtajë, liga e keqe, flama e ligë* etj.

Të lidhura me shenjat e jashtme, siç shpjegohet në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) “*sëmundje e rëndë nervore që shfaqet me kriza të papritura gjatë të cilave i sëmuri përpëlitet dhe nxjerr shkumë nga goja*”, perceptimi dhe asosacioni me këtë sëmundje jepen me njësitë eufemistike *shkumba, shkumbëlënë, shkumbëngarë*. Një njësi tjetër e veçantë është përftesa eufemistike *lodër* dhe *lodërzë* (i ra, e zuri lodërza), ku përlligjet fort ideja se njësitë eufemistike lindin edhe prej bestytive apo nga dëshira për ta zvogëluar dëmin që sjell kjo sëmundje.

#### **5.4.6. Rreth formës së brendshme të njërive eufemistike për sëmundje të tjera**

Një tjetër sëmundje e frikshme dhe e rrezikshme për besimin popullor është *sëmundja e fëmijëve*. Rreth 11 leksema dhe përdorime eufemistike kemi skeduar për këtë sëmundje. Është interesant fakti se si në rastin e sëmundjes së tokës, edhe kjo përzgjedhje na rezulton të jetë një eufemizëm në vetvete, paqka se në rastin konkret elementi i vendit ku kjo sëmundje shfaqet është zëvendësuar me emrin përgjithësues lidhur me kategorinë e moshës. Ashtu si

dhe epilepsia, kjo sëmundje shoqërohet me gjendje të fikti dhe humbje ndjenjash. Përzgjedhja eufemistike shpesh kufizohet te zëvendësimi i emrit *sëmundje* me dëftorin *ajo* (dihet që procesi i sinkretizmit është një nga proceset më produktive në emërtimet eufemistike që i vishen realies). Edhe në shembujt që kemi nxjerrë ky dëftor ose shoqërohet me emrin fëmijë (duke kategorizuar moshën) *ajo e fëmijëve*, ose me një dysor dialektor ku struktura kuptimore mbetet e njëjtë *ajo e cullve*.

Frika ndaj sëmundjes dhe besimi se duke shmangur emrin ke shmangur vetë atë, duket se shtohet në rastin e eufemizmit *ajo punë* ku, krahasuar me dy shembujt e lartpërmendur, dëftori *ajo* është shoqëruar me një emër, kuptimi leksikor i të cilit është jo vetëm i papërligjur në përdorimin konkret, por edhe i pamotivuar për të shërbyer si leksemë zëvendësuese për sëmundjen në fjalë. Ashtu si tek epilepsia, elementi *tokë* ruhet si vend përcaktues dhe identifikues *sëmundja e tokës, puna e trollit* apo dhe sintagma që mbartin vlera të theksuara stilistikore të veshura me ngjyrim emocionues të tipit *shkoftë truallit*, një strukturë që zërthehet në përbërës kuptimorë dhe merr vlerat e një fjalie dëshirore në formë mallkimi *ajo që i shkoftë (i rëntë) truallit (tokës)*. Të njëjtat vlera stilistikore dhe emocionale mbart edhe fraza dëshirore *ai qoftë larg*.

Shpesh ndodh që frika ndaj sëmundjes të çojë në një sintetizëm të skajshëm, si në rastet *ajo* apo *tokës* ose në përzgjedhje me vlera të theksuara shprehëse dhe emocionale të tipit *të ligt e keq*, ku konotacionit negativ me të cilin është përdorur emri prejmbiemëror *të ligt* i shtohet një mbiemër sinonimik (i përdorur në rolin e epitetit) që mbart po të njëjtin ngjyrim emocionues negativ *i/e keq*.

Në pamundësi për ta shmangur forcën e errët të natyrës dhe në përpjekje gati-gati të dëshpëruara për të shëruar “të pashërueshmen”, populli beson se gjithçka që ka në dorën e tij është fjala, prandaj zgjedh jo pak mënyra për “ta larguar” sëmundjen herë duke “mos e zënë gojë”, herë duke “e bërë mike” dhe herë “duke e mallkuar”. Të gjitha mjetet e përzgjedhura me kujdes nga bashkësia shqipfolëse janë dëshmi e gjallë e një fakti të pakundërshtueshëm se përftimi i shenjës gjuhësore është bërë mbi bazën e koncepteve të qarta që këta njerëz kishin mbi realitetin objektiv, andaj mendimi është i pjekur, i thukët dhe plotësisht i përligjur e i motivueshëm.

Një tjetër sëmundje-tabu që paraqet interes për vlerat leksiko-semantike që mbart dhe për shumësinë dhe shumëllojshërinë sinonimike dialektore është sëmundja e *tuberkulozit (pleuriti)*, për të cilën në shqipe ka dhjetë sinonime eufemistike.

Leksema që ka shërbyer si element bazë për krijimin e një sërë kompozitash ose sintagmash me lidhje përcaktore është fjala emërtuese për simptomën më karakteristike të kësaj sëmundjeje: *kolla*. Kësaj lekseme i janë shtuar, sipas rastit, dhe sipas perceptimit të rrafshit të realies nga folësit, mbiemrat cilësorë të tipit *e mirë*, ku cilësia e shprehur nuk lidhet me tiparin ashtu siç është, por ashtu siç do të dëshironte folësi të ishte (kollë e mirë), si dhe në rastet e togfjalëshave *kollë e thatë* apo *kollë e keqe*, ku cilësia e shprehur lidhet drejtpërsëdrejti me karakteristikat e simptomave të sëmundjes.

Të njëjtat vlera kuptimore të krahasueshme me togfjalëshat në fjalë mbart edhe struktura *sëmundja e thatë*, ku gjymtyra emër e grupit përcaktor nuk është një përzgjedhje eufemistike dhe përbërësi mbiemëror është i njëjtë me sa u shpjegua më lart, pikërisht me shenjat e jashtme që shfaq kjo sëmundje. Shumë interesant është përcaktimi në togfjalëshin *kollë nusesh*, ku motivimi i shenjës gjuhësore të përftuar mbase duhet të shihet nga faktorë jashtëgjuhësorë, etnokulturorë.

Ka eufemizma për sëmundje të tjera, të cilat nuk formojnë vargje sinonimesh, por dalin me funksione të përdorimeve të izoluara me një sëmundje të caktuar. Modelet e përzgjedhura për tipologjinë e emërimit janë të ngjashme me teknikat e përdorura më lart. Mbiemrat e emëruar mbartin nuanca të konotacionit pozitiv kur cilësohen, si: *të bukurat* për grykët, *e bekuara* për sëmundjen e lisë, *e mira* për sëmundjen shpretkës, ose mbartin ngjyresa neutrale ku folësit zhvishen nga ngarkesat e dukshme emocionale dhe dëshirën për ta shmangur sëmundjen e shprehin duke mos përmendur tabunë, si: *e paemra* për fryrjen e damarëve dhe urdhjen e shpërgetit, apo kur emërtohet *send* me kuptim leksikor të përgjithshëm, ku shmangia e referentit konkret dhe përgjithësimi lidhen me funksionin kryesor të përzgjedhjes së shenjës gjuhësore, atë të “mos zënies në gojë” të sëmundjes me qëllim zbutjen e saj. Përsëri edhe në këto përdorime “fuqia” e fjalës në funksion të shprehjes së mendësisë popullore ka diktuar përzgjedhjen e “menduar” mirë dhe plotësisht të motivuar dhe të pranuar nga bashkësia shqipfolëse.

#### **5.4.7. Vdekja dhe forma e brendshme e njësive eufemistike për të**

Një metaforë e njohur e koncepton vdekjen si një udhëtim me destinacion shpirtëror. Vdekja njerëzore është konceptuar si një largim, nisje nga kjo botë, si një udhëtim, një lidhje e cila siguron bazën e duhur për çlirim, lehtësimin gojor (verbal) të tabusë së vdekjes. Të shumta në numër dhe të ndërtuara me një larmi mjetesësh cilësisht të dallueshme për vlerat stilistiko-emocionale që mbartin, eufemizmat për një tabu si vdekja, që ndër shekuj është shoqëruar me frikë për humbjen e të dashurve, të deformimit të trupit, të asaj çfarë vjen pas vdekjes apo dhe frikën nga shpirtrat e këqinj.

Edhe procesi i emërimit lidhur jo me një realie konkrete apo me cilësi të dallueshme të sendeve, por me një perceptim abstrakt ku nevoja për të mos lënduar ndjenjat e atyre që kanë humbur njerëzit më të dashur, apo respekti për “atë që nuk është më”, përzier edhe me frikën e asaj që është “e pashmangshme” për të gjithë, është po kaq delikat ndaj mënyrat që folësit kanë zgjedhur janë kaq të përimtuara, të kujdesshme dhe çdo lëvizje kuptimore shoqërohet me një figurshmëri të dukshme. Strukturimi i përbërëve leksikorë është i menduar mirë dhe figurat gjuhësore me produktive janë metafora dhe metonimia. Nga pikëpamja kuptimore eufemizmat janë formuar me anë të sinekdokës me bazë metaforën. Metafora përfaqëson një burim shumë të fuqishëm mbi bazën e së cilës janë ndërtuar eufemizmat e lidhura me vdekjen.

Tipologjia e emërimit të strukturave me vlerë eufemistike në funksion të analizës së formës së brendshme, mund të shpjegohet si më poshtë:

**5.4.7.1.** Funkcioni eufemistik përmbushet me anë të zëvendësimeve leksikore dhe veçanërisht përmes strategjive eufemistike të përimtuara me kujdes. Tropet gjuhësore fitojnë një shkallë të lartë figurshmërie. Transferimet metaforike kanë çuar në zgjerim kuptimi dhe të gjitha njësitë janë ndërtuar sipas pikave të njëjta semantike, duke e njësuar vdekjen herë me dritën e diellit, me gjumin, me qetësinë, me botën e përtejme, me jetën etj. Të këtij modeli janë njësitë “drita e syve iu ka errë”, një përzgjedhje shumë e kujdesshme e foljes *err/errem*, që nga pikëpamja semantike lidhet me errësirën, pra, praktikisht, me mungesën e dritës. Me të njëjtin kontekst janë formuar dhe njësitë me vlerë sinonimike: *dritën e diellit kurrë nuk ka me pa, i ktheu sytë nga dielli, shkoi me mos pa diellin, fluturoi në qiell, e mori gjumi, hyn në dhe, ka shkuar në botën tjetër, fjeti, mbylli sytë, e la botën* etj. Në të gjitha rastet gjymtyrët



emërore *diell, qiell, gjuhë, botë* mund të perifrazohen dhe aktualizohen me humbjen dhe largimin nga kjo botë.

**5.4.7.2.** Shumë shpesh vdekja perceptohet si ikje, largim, humbje, mbarim etj. prandaj dhe përfitesat leksikore shpesh sinkretohen deri në leksema të thjeshta ose togje me vlerë foljore, të cilat mbartin vlera të mirëfillta kuptimore *iki, shuaj, humb, mbytem, mbaroi, na la, ndërroi jetë, u nda nga ne, vakem, nxirroj* etj.

**5.4.7.3.** Si tema semantike për krijimin e një vargu sinonimik kanë shërbyer leksemat *këmbë, sy, krahë, zemër* dhe, nga pikëpamja strukturore dhe kuptimore, përzgjedhjet kanë fituar vlerën e njësisive frazeologjike. Si njësi të krijuara mbi këto leksema mund të përmendim: *u ftof kambësh, e ktheu këmbën përjetë, i ra këmbës, tund këmbën, i ktheu këmbët* etj., të cilat paraqesin variacion leksikor në gjymtyrën foljore. Ndryshimi i gjymtyrës foljore të njësisë shoqërohet me ndryshime të nuancave kuptimore, shkallës së intensitetit dhe elementit emocionues subjektiv të folësit që përgjithësohen dhe kushtëzohen nga përdorimi kontekstual. Po kaq të specifikuar nga pikëpamja shprehëse dhe emocionuese janë njësitë e mëposhtme ku variacionit kuptimor të ndryshimit të gjymtyrës foljore i shtohen edhe gjymtyrët emra të cilat, pavarësisht se nga pikëpamja e kuptimit të drejtpërdrejtë të fjalës nuk prodhojnë sinonimi, në kontekstin e plotë të frazës referenti abstrakt “vdekje” mund të asociohet me procese të natyrshme dhe fare mirë të zëvendësohet nga to. Të këtij modeli janë: *i mbylli sytë, iu ndali zemra, i ktheu sytë nga dielli, i ktheu këmbët, i mbërtheu sytë, asht me një këmbë mbi dhe e me një kambë nën dhe, e mori ora e ligë* etj. Është shumë e rëndësishme të theksohet se në këtë kontekst disa prej leksemave të klasifikuara kanë fituar dhe janë përdorur me nuanca të dallueshme kuptimore dhe konotacioni negativ, ku qëndrimi i folësit ndaj “të vdekurit” nuk është dhe aq pozitiv.

**5.4.7.4.** Traditat fetare dhe zakonore pasqyrohen edhe në përzgjedhjet që populli sjell për njësitë e krijuara, që nga pikëpamja strukturore janë togfjalësha të zgjeruar ku elementet e riteve fetare dhe të besimit të jeta e pasvdekjes shoqëroren me ato të traditave e dokeve zakonore, si: *i foli prifti, iu mbarua vaji i kandilit, u martua me gurë e dhé, shkoi në jetë të vërtetë, puthi kryqin* etj.

Lëvizja kuptimore e përfutur nga njësitë e shumta eufemistike të lidhura me tabunë e vdekjes përbën një nga modelet më të përsosura se si mund të pasurohet shtresa emocionuese e leksikut dhe se si tropet gjuhësore mund të fitojnë një figurshmëri të dukshme si pasojë e

përdorimit dhe përpunimit të kujdesshëm të mjeteve shprehëse. Me sa duket, populli di t'i shprehë qartë ndjenjat e tij dhe, ashtu siç është i kujdesshëm edhe i matur për të mos lënduar “kujtimin e atij që nuk është më”, ashtu dhe nuk druhet të shprehë të gjitha ndjenjat negative, përçmuese për atë që nuk e do, aq sa duket ndonjëherë se me të njëjtin intensitet mund të dashurojë dhe mund të urrejë dhe në këtë dyzim ndjenjash edhe emocioneve përsëri është fjala që “me fuqinë e saj magjike” i hyn në punë. Në njësitë e mëposhtme eufemistike individët folës e shprehin qartë atë që ndiejnë, vetëm se mënyrat që përzgjedhin janë të drejtpërdrejta, të mbushura me mllef dhe urrejtje, aq sa disa njësi në të vërtetë mbartin të gjithë ngarkesën emocionuese të nëmës apo mallkimit: *i mblodhi lecat (plaçkat), i ra këmbës, i ktheu patkonjtë nga dielli, shkoi për thana, i ktheu kambt nga dielli, shkoi si qeni në rrush, i lau gjynahet, shkoi me të shumtët, lau borxhin, e bëri bishtin pallë* etj.

Eufemizmat apo disfemizmat, të cilat për nga pikëpamja strukturore dhe semantike ngjajnë me njësitë frazeologjike, vlerësohen për nga rikuptimësimi dhe ringjyrimi, sepse janë veshur me ngjyrim të theksuar emocionues. Në rrafshin semantik vihet re se në njësitë e përmendura është amplifikuar ngjyrimi emocionues i shprehjes, sidomos në rastet e ndërkëmbimit të një gjymtyre emërore në vend të tjetrës, si në rastin *lecat/ plaçkat* në vend të leksemës *rroba*, ku vihet re se dy leksemat e para mbartin nuanca të theksuara konotacioni negativ krahasuar me leksemën *rrobë/veshje* që e kanë zëvenduar nga pikëpamja sinonimike. Edhe në çiftin tjetër të sinonimeve frazeologjike *i ktheu kambt/patkonjtë nga dielli*, pavarësisht njëjtësimi të vlerave kuptimore, nuanca e hollë dhe ngarkesa emocionuese negative që mbart gjymtyra *patkonjtë* nuk ka si të mos vihet re. I njëjti arsyetim vlen edhe për njësinë *i lau borxhet/gjynahet*.

Rikuptimësimi i përfutur nga përdorimi i një lekseme karakteristike për ligjërimin e thjeshtë popullor (gjynah) ia rrit vlerat shprehëse njësisë dhe shmang shenjën e barazimit kuptimor në raport me leksemën e parë *borxh*, edhe për arsye se përdorimi kontekstual në aspektin ligjërimor është përcaktues për njësinë që folësi zgjedh për të shprehur kuptimin eufemistik. Njësitë e tjera me përdorim të zgjedhur dhe nuanca të theksuara ngjyrimi emocionues negativ, si *shkoi për thana* dhe *shkoi si qeni në rrush* motivimin etimologjik e kanë të errësuar dhe mund të quhen “njësi frazeologjike të pamotivuara” (shih kapitullin për formën e brendshme të njësisë frazeologjike).

## **5.5. Një përqsje e formës së brendshme të eufemizmave të shqipes me anglishten**

Në gjuhësinë angleze janë bërë studime të plota dhe shteruese për eufemizmat, madje ato janë përpunuar nga ana leksikografike në fjalorë të mirëfilltë për njësitë eufemistike. Përpjeket për trajtesa të plota shkencore në fushën e fjalorëve të mirëfilltë të eufemizmave të gjuhës angleze janë bërë qysh në vitin 1987 me botimin e “*Dictionary of American and British euphemisms*” për t’u shoqëruar me dy botime më të plotësuar të 1995 dhe 2002, përkatësisht “*A dictionary of euphemisms*” dhe “*How not to say what you mean: A dictionary of euphemisms*”. Për vetë ndjeshmërinë apo karakterin paksa “qesharak” që mbartin krijimet e këtij lloji dhe natyrën e veçantë të lëndës ndërtuese të përdorur, hartimi i këtyre fjalorëve paraqet një problematikë të një lloji të veçantë. Sipas autorit të fjalorit “*How not to say what you mean: A dictionary of euphemisms*”, Holder, skedimi dhe klasifikimi i këtyre njërive në krerë të veçantë dhe pasqyrimi në tregues të përcaktuar tematikë është i vështirë, për shkak se disa fjalë të tilla mund të vlerësohen nga folësit e gjuhës angleze si disfemizma apo as eufemizma e as disfemizma. Po kështu, në disa raste fjalët që mund të kenë vlerë eufemistike për gratë, nuk mbartin të njëjtën ndjeshmëri për burrat.

Gjatë punës për përpilimin e këtij fjalori janë skeduar fjalë të burimit autokton të gjuhës angleze, sikundër dhe fjalët e huazuara, veçanërisht ato me prejardhje nga latinishtja, gjermanishtja, spanjishtja etj. Autori sqaron qartë që në parathënie se ka përzgjedhur vetë kriteret e përfshirjes ose jo të fjalëve në fjalor dhe është ndier i lirë të “spekulojë” me motivimin etimologjik të tyre. Në pasqyrimin leksikografik autori i ka renditur njësitë eufemistike sipas treguesit alfabetik. Një tjetër përftesë me vlera të mirëfillta shkencore i është shtuar praktikës leksikografike të fjalorëve të këtij lloji me fjalorin e botuar në vitin 1981 “*A dictionary of euphemisms and other doubletalk*” me autor Rawson. Lënda leksikore e analizuar në këtë fjalor përfshin jo vetëm eufemizmat, por edhe të ashtuquajturat “doubletalk”. Në hyrjen e fjalorit autori rendit disa nga kriteret bazë që një fjalë duhet të ketë për të qenë eufemizem. Ndër të tjera, ai thekson se për folësit e gjuhës angleze një fjalë e huazuar nuk tingëllon aq e vrazhdë sa përkatësja leksikore e anglishtes. Po kështu, shkurtimet e fjalëve të pahijshme nuk kanë të njëjtin efekt negativ sa trajtat e tyre të plota. Përdorimi i termave dhe fjalëve abstrakte me kuptim të figurshëm apo të përgjithësuar e zbut fuqinë vepruese të fjalës në raport me përdorimin e saj në kuptimin konkret dhe të drejtpërdrejtë.

Sipas autorit, nënkuptimi zvogëlon “rreziqet” dhe ajo që folësve u paraqitet në mënyrë më indirekte dhe të zbutur është gjithmonë më pak “e keqe”, sesa ajo që u shprehet pa rezerva dhe më drejtpërdrejt. Si rregull, eufemizmat janë më të gjatë nga ndërtimi strukturor në krahasim me fjalët që e shënojnë cilësinë, veprimin apo gjendjen në formë të drejtpërdrejtë. Renditja e njësive të skeduar është bërë sipas rendit alfabetik, fjalët e përzgjedhura janë pasuruar me fushën e tyre leksematike dhe raportet kuptimore janë zgjeruar përmes vargjeve sinonimike dhe çifteve antonimike. Në fund të fjalorit është përfshirë edhe treguesi tematik.

Eufemizmat mund të klasifikohen mbi bazën e kriterëve, rregullave dhe parimeve të ndryshme. Rawson i ndan eufemizmat në dy lloje kryesore: *pozitive* dhe *negative*. Eufemizmat pozitive mund të quhen edhe *eufemizma stilistikore* ose të ekzagjeruara (të tepruara). Në mënyrë që të tregohen më të sjellshëm dhe të rrisin bashkëveprimin dhe komunikimin, folësit e gjuhës angleze dhe veçanërisht ata që përdorin variantin amerikan parapëlqejnë të përdorin teknikat e ekzagjerimit për të theksuar diçka të pakëndshme dhe të sikletshme. Eufemizmat pozitive përfshijnë emrat e profesioneve për të ruajtur (mbrojtur) egot e punonjësve që i kryejnë këto punë duke ngritur (lartësuar) statusin e profesioneve që ata kanë. Për shembull *inxhinierët e asgjësimit* (rat catchers) është një eufemizëm i përdorur për “kapës minjsh” ndërkohë që *kosmetolog* përdoret për “parukier/e” (*hairdressers*).

Duhet të themi se mjaft eufemizma pozitive janë “doblespeak”. Ata zakonisht hasen në fushën e leksikut që lidhet me politikën, ushtrinë, tregtinë etj. Përveç këtyre, një grup i madh eufemizmesh pozitivë përfshijnë tituj nderues (honorifikë), si: *kolonel*, *i nderuar*, *major* (the colonel, the honorable, the major), sikurse dhe shumë emërtime institucionesh, si: *spitale mendore* në vend të *çmendinë*, *universitete* në vend të *kolegje*, *emporiume* në vend të *ndërmarrje të biznesit të vogël* etj. Eufemizmat negative zvogëlojnë ose zbusin diçka. Ata kanë funksion mbrojtës dhe zbusin ose shmangin fuqinë e termave tabu, duke hequr nga përdorimi gjithçka me të cilën njerëzit nuk duan të përballen drejtpërdrejt. Eufemizmat negative mund të quhen edhe eufemizmat tradicionale. Ato janë krijuar shumë herët dhe janë të lidhur ngushtë me tabutë.

Eufemizmat në përgjithësi, qofshin pozitive apo negative, mund të ndahen në eufemizma të *ndërgjegjshme* ose të *pandërgjegjshme*. Kriteri për klasifikimin e tyre është kuptimi eufemistik, nëse ai është i lidhur me kuptimin origjinal apo jo. Eufemizmat e

*pandërgjegjshme*, ashtu siç na e tregon edhe termi, janë zhvilluar kohë më parë dhe nuk kanë pasur qëllim të nënkuptojnë apo të shmangin. Për shembull, termi standard për *varrezë* (cemetery) ka qenë një emër zëvendësues për *varrezë* (graveyard). Edhe në shqip kemi të njëjtën fjalë. *Sëmundje e lehtë* (indisposition) ka shërbyer si fjalë zëvendësuese për *sëmundje* (disease). Folësit e një gjuhe zor se e kanë të qartë (e kuptojnë) se kuptimi origjinal i kësaj fjale është paaftësia/ pamundësia për të bërë diçka. Le të marrim fjalën *dieter* “ai që mban dietë”, kuptimi origjinal ka qenë “të marrësh ushqim sipas një radhe ose rregulli të caktuar”, ndërsa tani është zëvendësuar me kuptimin eufemistik “ai që e kufizon ushqimin me qëllim që të humbë në peshë”.

Nga shembujt e mësipërm mund të dalim në përfundim se eufemizmat e *pandërgjegjshme*, duke qenë se janë zhvilluar shumë kohë më parë, shumë pak mund t’u njihet motivimi origjinal. Eufemizmat e tipit të dytë janë të përdorur gjerësisht dhe përfshijnë kategori më komplekse. Kur njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin, folësit në mënyrë të ndërgjegjshme përpiqen të jenë të kujdeshëm, në mënyrë që dëgjuesit të kuptojnë atë çka është e nënkuptuar. Për shembull, kur një zonjë ngrihet nga tavolina me preteksin se “do të bëjë një telefonatë” apo “do të pudrosë fytyrën”, njerëzit e pranishëm e kuptojnë se ajo “do të bëjë diçka tjetër, do të shkojë në tualet etj.”<sup>141</sup>. Përveç klasifikimeve të bëra më sipër, eufemizmat mund të ndahen në disa kategori semantike ose fusha eufemistike.

### **5.5.1. Eufemizmat e lidhura me profesionet**

Në vendet perëndimore puna mendore konsiderohet një punë e vlerësuar, ndërsa puna fizike si një punë e rëndomtë, përveçse ka edhe një ndryshim shumë të madh në shpërblimin që marrin. Në këtë mënyrë, është e kuptueshme që njerëzit me profesione të ndryshme kanë status të ndryshëm shoqëror. Punët që paguhen pak dhe që konsiderohen si “të padenja” në kulturën britanike shumë shpesh u gjenden terma eufemistike, thjesht për të shprehur mirësjelljen apo për të mos fyer ndjenjat e atyre që e kryejnë këtë punë.

Eufemizmat e anglishtes përdoren në vend të disa profesioneve për të rritur statusin apo prestigjin, duke bërë që shumë profesioneve “të pakëndshme” tani t’u vihen emra “të

---

<sup>141</sup> Holder, K., *How not to say what you mean: A dictionary of euphemisms*, Oxford University Press, 2008, f. 412.

pëlqyeshëm”. Kështu ka ndodhur në rastet e fjalëve *cleaning operator* (operator pastrimi) për fjalët *fshesaxhi* apo *pastrues*; *road sweeper/dustman*, *sanitation endineer* (inxhinier sanitar) për mbledhës *plehërash/pleraxhi* (garbage man), *meat technologist* (teknolog mishi) në vend të *kasap* (*butcher*) dhe *hairdresser* (parukier) është zëvendësuar me *beautician* (kosmetolog) etj.

### **5.5.2. Eufemizmat e lidhura me sëmundjet**

Në anglisht: *long illness* (sëmundje e gjatë) për kancer (*cancer*); *social disease* (sëmundje e shoqërisë) për *sifilizin* (*syphilis*) dhe AIDS; *lung trouble* (sëmundje e mushkërive) në vend të *tuberkulozit* (*tuberculosis*) etj. Për sëmundjet mendore mund të përdorim termin zbutës “është pak i hutuar/i ngatërruar” (*he/ she is a little confused*); *pak i ndërkohë*, që mund të shprehemi “ka vështirësi me dëgjimin” (*hard of hearing*) në vend të “i/e shurdhët”(deaf) etj. Në shumë shoqëri njerëzit i druhen vdekjes, kështu që përpiqen ta shmangin përdorimin e drejtpërdrejtë dhe përdorin një sërë mënyrash eufemistike duke zgjedhur qindra emra të zbutur dhe që tingëllojnë më bukur.

### **5.5.3. Eufemizmat e lidhura me marrëdhëniet seksuale**

Në anglisht: *the great divide*- ndarja e madhe-divorci; *willing woman*-grua e gatshme-grua e përdalë; *lost girl*-vajzë e humbur-prostitutë etj.

### **5.5.4. Eufemizmat e lidhura me fjalën-tabu *krim***

Në anglisht: *five-fingers*- pesë gishta- hajdut xhepush; *gentleman of the road*-zotëria i rrugës-grabitës; *hero of the underground*-heroi i nëndheshëm-droga/ heroina; *candy man*-shitës ëmbëlsirash-shpërndarës droge etj.

### **5.5.5. Eufemizmat e lidhura me fjalën-tabu *vdekje***

Në anglisht: *perish*-shuhem; *emit the last breath*-jap frymën e fundit; *end one's days*-i mbarojnë ditët; *return to the earth*- kthehem në tokë; *slide into oblivion*-harrohem/lihem në harresë; *to join the choir invisible*- ulem në karrigen e padukshme; *to pay the debt of nature*-paguaj/laj borxhet; *join the majority*-shkoj me të shumtët; *to answer the last call*-i përgjigjem

telefonatës së fundit; *a reward for some in Heaven*- shpërblehem nga parajsja; *in the world of unending glory*-shkoj në botën e lumturisë pa kufi; *enjoyment of the fruits of life*- shijoj frytet e jetës; *go west*-shkoj në perëndim; *be asleep forever*-fle përgjithmonë; *to be brought to one's long home* -çohet në banesën e përrjetshme; *return to dust*-bëhem/kthehem në pluhur; *they are called to God*- i thirri Zotit; *gone to be with the Lord*-shkuan me Zotin; *be asleep in the arms of God*-flenë në krahët e Zotit; *go to one's final summons*-shkoj në gjyqin e fundit; *to join the angels*-bashkohem me engjëjt; *to be taken to paradise*-shkoj në parajsë; *to go to a better place*-shkoj në një vend më të mirë; *to be home and free*- jam në shtëpi dhe i lirë; *to go home*-shkoj në shtëpi; *to go to one's own place*-të shkosh aty ku të takon; *to sleep in the arms of God*-të flesh në krahët e Zotit; *to have fallen asleep*-të biesh në gjumë; *to go rest*- të çlodhesh / të qetësohesh; *to have found rest*-të gjesh prehje/qetësi; *to rest in peace*-të prehesh në paqe; *to pass away*-iki/largohem; *to fade away*-tretrem/zhdukem; *to come to an end*-të të vijë fundi; *to go off*- të ikësh/të nisesh për diku; *to be gone*-të kesh ikur/larguar; *cached in their lips*- t'i vësh para në gojë; *bit the dust*-kafshoj pluhurin; *turn their toes up*- kthej thonjtë nga dielli; *gave up the ghost*-kthehem në shpirt; *take the last count*-marr llogarinë e fundit; *be out of the game*-të jesh/të dalësh jashtë loje; *jump the last hurdle*-kapërcej gardhin; *shuffled out of the deck*- rrëshqiti/ra nga kuverta e anijes; *buy the farm*-ble fermën; *cross over*-kapërcej; *cross the range*-kapërcej rradhën/rreshtin; *cross the bar*-kapërcej ekuatorin; *cross the border*-kaloj kufirin; varri: *future home*-shtëpia e ardhshme; *long home*- shtëpia ku do të rri gjatë; *narrow home*-shtëpia e ngushtë; *becoming a landowner*-bëhem pronar toke etj. Siç shihet, forma e brendshme e njërive eufemistike të anglishtes për vdekjen ndryshon mjaft nga eufemizmat e shqipes, që u trajtuan në sythin 5.4. të këtij kapitulli.

#### **5.5.6. Eufemizmat e lidhura me shtatzaninë**

Në anglisht: *to cancel all the social engagements*-të heqesh dorë nga angazhimet shoqërore; *to be in an interesting condition*- të jesh në pozitë (kushte) interesante; *to be in a delicate condition*-të jesh në kushte delikate; *to be in a family way*-të marrësh rrugën e familjes; *to except*- të preshës/të jesh në pritje; *anticipating*-të parashikosh etj.

### **5.5.7. Eufemizma me fjalët “gomar” dhe “ari”**

Mendohet se fjala “ass” në shqip “gomar” etimologjikisht mund të ketë rrjedhur nga latinishtja “asinus” dhe vetë kjo fjalë është zhvilluar si eufemizëm për fjalën *arse* (gomar). Shpjegimi për fjalën *donkey* (gomar) mund të motivohet me shkaqe tërësisht personale, kjo fjalë tingëllon e përafërt me emrin “Duncan” dhe ka të ngjarë që ky të ishte një nga emrat e përveçëm (ndër të tjerët mund të përmendim Dicky, Jenny, Neddy) me të cilin fermerët zgjidhnin që t’i quanin kafshët e tyre. Me sa duket, ky ishte dhe emri më i parapëlqyer, i cili u përzgjodh si fjalë emërtuese në Angli, por jo në Skoci, ku u mbajt emri tradicional “ass”. Në Skoci u përdor emri “cuddie” edhe ky i përcaktuar ndoshta nga përdorimi i emrit të përveçëm *Cuthbert*. Në rastin e gomerëve meshkuj, fjala “ass” na rezulton në disa variante të dubluara të tipit “jackasses”, “jackacks”. Të tjera eufemizma për këtë kafshë janë “arse” dhe “bottom”<sup>142</sup>. Për shqipen mund të përmendim: *veshgjati*, *veshlivrami*, *gzheli* etj.

Një eufemizëm shumë i përdorur për kafshët është edhe *grandfather* (gjyshi). Në varësi të vendit ku përdoret, ky eufemizëm mund të ketë kuptimin *bear* (ari), *tiger* (tigër), *elephant* (elefant). Ariu është “gjyshi” për banorët e Siberisë, për ata që jetojnë afër detit Baltik apo për indianët e Tete de Boule në Quebec. Mendohet se në rusisht edhe fjala *mjeved* është një eufemizëm i vjetër, kuptimi i të cilit është “mjaltëngrënës”. Eufemizmat në gjuhën angleze për fjalën “ari” (bear): *little old man*- plaku i vogël/plakushi; *dear uncle*-xhaxhai i dashur; *the wise one*- i mençuri/ i dituri; *honey-paw*- që i ka putrat me mjaltë; *broad foot*- këmbëgjeri.<sup>143</sup> Për shqipen mund të përmendim eufemizmat: *gojëmbërthyeri*, *gjëja*, *teza*, *mjaltëngrënës*.

### **5.6. Një klasifikim tematik i eufemizmave të shqipes**

Klasifikimi i mëposhtëm është dhënë për të krijuar një ide më të plotë për formën e brendshme të eufemizmave në gjuhën shqipe dhe mjetet leksikore për realizimin e tyre.

---

<sup>142</sup> Rawson, H., *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, NewYork Crown Publishers, 1981, f. 80.

<sup>143</sup> Po aty, f. 126.



## GJARPRI

ai i bekuemi, ai me brina, ai i gardhit, ai i dheut, ai i gurit të çamë, ai si koftë (që qoftë) tretë, ai i malit, ai i nargurit, ai i paemri, ai që ia preftë rrugën gjëja, ai i sheut, ai i sheut të trentë, ai i shkambit, ai i tokës, ai që shkon zhag, ai si (që) vërret përrojeve, ata të shenave, ata ujku i hangërt, i hangërt uki koqet, bardhec, barkdërrasë nga bark+dërrasë, barkthatë-që e ka barkun të thatë, bekuomi (i), bërdhan, bishtcung, bizele, bokë, brevë, brinoçi, bubë, buç, bukura (e) e dheut, çfurk, damtor, dhë, dheutokës, farkaç, farkofshi, fier, fjerë, ftofto (i), fuzan, gardhëç, gojëfarkuemi, gojëmylluni, gojëngrimi, gojëngurti, gojëqepuni, gojëthati, grabofç, gjarpën i bjeshkës, gjarpën i larmë, gjërpër shullani, gjarpënujës, gjati(i), gjylpani, helmuemi(i), iproni, kacitan, kambshkurti, kamprapshti, kastigimi, këkordhocë, kapastrec, kapërcyell, kulaçi, kumbar, laraman, laramanlivadhi, larosh, nëntokës, orëligu, përdredhuni (i), përdhe, përdhec, përtokëz, përtrollës, përzhasës, pështjellcë, pisirrengë, plasta bagla kalin hapshuer, qoftëlargu, rreshpak, rrëshajë, rrëshajëz, rrëshqitës, rrëshqanës, spaval, suval, shkandulli, shkoftlargu, shkoftlargti, shojëz, shorde, shpërdhec, i tokës, tokës, ujku e hangërt, zivi(i), zhagësi.

## UJKU

ai i malit, ai iu gurtë goja, ai i natës, ai që qoft i padukur, ai që iu trash hallka e zinxhirit, ai qi ta than vathën, bishë, bisha e pagojë, bishtgati, curran, egërci, egërcinë, egërsi, egërsirë, egërti, gojëfërkuet, gojëkyçuri, gojëlidhuri, gojëlithi, gojëmbërthyeri, gojëmyllti, gojëmshelun, gojëngrimi, gojëqepuni, gojëthati, gojazani, gurojazogojën, i gati, gjëja, hajujku, hasm, kumbar, kumbara e natës, këmbëlehti, largneshi, nëntokës, padukuri (i), paemri (i), pagoji (i), papjesi (i), paqeni (i), paudhi (i), qafëtrashë, qafëthyeri, qoftëlargu, shkoftëlargu, shpata e Zotit, shpend, shpeni i egër, shpirtmiri, shpirtndrituri, turithimë, ungër, uluritsi, veshcurri, ziu (i) i pragjeve, zullapi

### BUKLA

ajo e gardhit, ajo e murit, ajo që të fryn, bishtafurka, bishtfurka, bishtfurkabukura, bugëz, bujtës, bukël, bukël dheu, buklezë, bukrezë, buklicë, bukulushë, bukura (e), bukura (e) e dheut, bukuri, bukura (e) e minjve, bukura (e) e zogjve, bukuroshe, bukër, bulkëz, bungla, bungëlza, furrëbubëz, hutbukur, kalkuqe, larakuqe, mira (e) e mi(nj)ve, mira(e) e zogjve, ndrikull, nificë, nuse, nusebukur, nuse e djemve, nusël, nusja e minjve, nuskëz lale, nuse e mirë, nusmira, nusëza, pikaloshe, shtatpikaloshe.

### EPILEPSIA

ajo, ajo e botës, ajo e caullve, ajo e hënës, ajo e keqja, ajo e ligë, ajo e mxhovive, ajo e tokës, ajo punë, ajo qi i raftë tokës, ajo sëmundje, argjendta (e), egjertai, er e tij, bota, betuemi (i), bëtajë, farin-faresha, flamë, fëdigë, havale, liga e keqe, lodërz, mira (e), pikëmadhja, pranëdheu, puna e herës, puna e trollit, punëhera, shkelura (e), shkumba, shkumbëlëni, shkumbëngarë (e), sëmundja e hënës, sëmundja e ligë, terezi, tokës (e), tokësi, ujku raft ksajde.

### TUBERKULOZI (PLEURITI)

dergjë e thatë, gulshim, kollë e mirë, kollkeqe, kollë nuseshe, kolli i thatë, kulufiska, lgata e thatë, oftika, plevit, preka, sëmundja e thatë, veremi etj.

### JASHTËQITJA E NJERIUT

Balthe kë, cucmbasgardhi, fëlli qti, kacrrum, mender, pëgatë, pigjonsinë, pigjotë, rreshkadiell, rroum, shkulë, spurdh, të dalur, të fëlli qët, të fllim, testegjyl.

### ORGANI GJENITAL I MASHKULLIT

ai miku, ai sendi, alet, arrat, babuçi, bec (organi seksual i fëmijëve meshkuj), beci i vogël, bieci, bilbilushi, bilbilja, bile, bishtak, buçurruc, bylbyli/bilbili, car, cfurkuth, currak, çil, çole, çuk, çukallkë, çupe, çupërlluçka, duc, dy kodrat, fiku, fishek, gozhdar, hasdar, hallatet, herdhe, herrloj, kacagjel, kalemi, karabush, karklluk, karuc, karushë, koçan, krua, luc, llullak, llullë, maçarungë, manillë, matarak, matarosh, matrafell, matrakullë, mazhgull, mazllum, pallë, pashë, pllambanik, qushk, rrepan, rrip, rropell, rrotak, rrotoman, rrush, shaputan, shkërdhyes, shubak, shul, teshë, trap, tuk, ym, zdërvek

### ORGANI GJENITAL I FEMRËS

aguridh, ai vendi, ballëçamja, ballmodhja, baqth, bilbilja, birë, birbiraçë, bubë (organi gjeneral i vajzave të vogla), bubblesh, bubbleshi i s'amës, buç, buçuk, buzëkuqmustaqezi, buzorja, çapellë, çok, daflaku, dygishte, dyfel, felladug, gojëkali, gop, gjollë, kacagjele, klemëz, lemcë, lemezë, lorek, të leth, lug, lule-lulja, llapatan, llokumi, maknaq, matrafellë, mele, meskambësh, ndërmjetkambësh, papalak, pauli, pupulak, quk, quklinë, rrumbullak, shyt, taknaq, teshë, varrë, vete, zogu, zuzalak, zuzë, zumilek, vrime, vagon, vendi i lig, vendi i keq, vendi që s'kallëzohet.

### MENSTURACIONET

adetet, ato, ato gjëjat, ato të grave, bardhat (të), bukuroshet, ditët, dhemb(i) barku, gjetura(të), hanet e grave, hënët, larat (të), lulet, lulëkuqet, mikeshat, ndërresë, shplarat (të), tezja, zakonet.

### SHTATZANIA

o ba baburë, barkësuar, ju ajn barku, ka rënë miu në hambar, ka rënë miu në kos, ka rënë miu në qyp, ngarkohet, ngarkuar (e), rëndë (e),

### DJALL, SHEJTAN, XHIND, SHTRIGË

ai i hudhrës, ai i lumit, ai praona zot, ai që han grurë dhe gërshanë, ai që ia preftë ujku udhën, ai që jeton në përrue ajo qi hangërt vedin, ai që qoftë larg, ai qi pastë thyer qafën, ajo hangërt gurë e dru, ajo e natës (shtriga), asi qi kjoshin djegë, ai qi kjoftë tretë, ata ujku i hangërt, brijaneci, brinoci, dëtuemi (i), djallushi, gojëqepuri, gurët e sendit, haje uku, hajejuk, jashtë kënde/ jashtë këtej-djalli, jashtë këtej, jashtësme, kafsha e keqe, kafsha e ligë, kambëmbropshti, kambëshkurtri, koftëlargu, laneti, largkëtej, largneshi, largneshi, largoje zot, largqoftë, largqofti, mallkuemi(i)/i mallkuari, naleti/laneti, ndjesëpasti, njohës, orëlig, padukuri(i), paemër, paemër(i), paemni (i), pafe(i), pagojë(i), pagoji(i), panafaku(i), papjesi(i), paqeni(i), paudhi(i), piraksi, platgoja/plotgojë, prroit(i), qafëthyeri, qoftëlargu, rrashtëbitisuri, shejtani, shnjalli, shkoftëlargu, shtoftëlargu, të preftë ujku, thapku, zvetënuemi(i) etj.

## KAPITULLI VI

### RRETH FORMËS SË BRENDSHME TË IDIOMAVE

*“Gjuhë e foltur e popullit është një metaforë e madhe, që përgendron e shpreh në mënyrë origjinale e të papërsërtishme konceptet, idetë e ndjenjat e njerëzve”*

**A. Kostallari**

#### **6.1. Trajtime teorike dhe përkufizime për formën e brendshme të idiomave<sup>144</sup> në gjuhësinë shqiptare**

**6.1.1.** Studimi i njësive frazeologjike (i idiomave) për nga motivimi i brendshëm, pra “zbulimi” i formës së tyre të brendshme, është një fushë mjaft interesante që ka tërhequr vëmendjen e disa studiuesve. Pavarësisht nga termat që janë përdorur për të shprehur këtë koncept, mund të themi se edhe në gjuhësinë shqiptare përshenjen gjithandej disa prej rrugëve dhe mjeteve për të gjetur formën e brendshme të idiomave, madje edhe për përkufizimin e saj. Për herë të parë këtë koncept e ka shtjelluar J. Thomai në një sërë artikujsh për frazeologjinë dhe pastaj, në mënyrë të plotë, në monografinë “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe”, ku vihet si synim që “të ndiqet historia e të zbulohet formimi idiomatik i njësive frazeologjike të shqipes”, si një çështje që kërkon thellim të mëtejshëm<sup>145</sup>. Autori, në këtë vepër, konceptin e formës së brendshme e shpreh në mënyra të ndryshme, si “motivim i njësive frazeologjike”, “formë e brendshme”, “burim semantik”, “etimologji” etj., duke e shtjelluar mbi bazën e dy çështjeve të rëndësishme teorike.

Së pari, kur flet për “motivimin” e njësive frazeologjike, bën klasifikimin e tyre sipas këtij kriteri në dy grupe: të *motivueshme* dhe të *pamotivueshme*. Sipas autorit, motivimi i njësive frazeologjike ka rëndësi për gjetjen e burimit formal e semantik, për shpjegimin e shumë lëvizjeve kuptimore e të ndryshimeve kuptimore, për njohjen e truallit gjuhësor të

---

<sup>144</sup> Ky term është përdorur në kuptimin e gjerë, për të përmbledhur nën të gjithë ndërtimet e qëndrueshme: njësitë frazeologjike, proverbat, fjalët e urta (pra, të ashtuquajturën “frazeologji letrare”), thënie të ndryshme etj.

<sup>145</sup> Thomai J., *Çështje...*, vep. cit., f. IV.

formimit të tyre<sup>146</sup>. Pra, ai përdor termin “burim formal e semantik” për konceptin e formës së brendshme. Për të gjetur këtë “burim”, për motivimin e njësive frazeologjike, pra për të gjetur formën e brendshme të tyre, J. Thomai përcakton tri mënyra: gjetjen e lidhjeve strukturore (semantiko-formale) të njësisë frazeologjike me togfjalëshin burimor; zbulimin e vatrës së njësisë frazeologjike dhe njohjen e situatës, të kushteve historike, mjedisit shoqëror, truallit gjuhësor etj., ku ka lindur ose kur përdoret njësia frazeologjike<sup>147</sup>. Për njësitë frazeologjike që kanë lindur mbi bazën e përdorimit të figurshëm të togfjalëshave të lirë motivimi ose gjetja e formës së brendshme është më e lehtë dhe procesi i idiomatizimit mund të rroket edhe në planin sinkronik. Kështu mund të shpjegohet forma e brendshme për pjesën më të madhe të njësive frazeologjike të shqipes dhe të gjuhëve të tjera, si: *tund derën* (Mos e tund derën ashtu, se na mërzi-te-togfjalësh i lirë)- *tund derën* “nuk bën asnjë punë, merret me gjëra të kota, bën sikur punon” (A s’keni punë ju që tundni derën?-njësi frazeologjike); *vret miza* (Mos i vrit mizat me lopatkë, por merr një ilaç-tog. i lirë)- *vret miza* “nuk bën asnjë punë, merret me gjëra të kota, bën sikur punon, tund derën”.

Përmes këtij procesi ka kaluar edhe formimi i shumë njësive frazeologjike, si: *dredh (tund) zinxhirin*; *numëron qimet e postiqes, kruan thonjtë, trazon baltën me shkop, kërcet gishtërinjtë* (si sinonime të njësive frazeologjike të shpjeguara më sipër), *rreh gjoksin* “merr përsipër me guxim që të bëjë diçka të rrezikshme e të vështirë, mburret”, *i bie gjoksit me grushte* “e pranon haptazi përpara të tjerëve se është fajtor”; *i nxjerr (i tregon) gjoksin* “i del ballazi pa frikë dikujt”; *ra në gjunjë* “u gjunjëzua, u mund”; *i dridhen gjunjët* “është shumë i lodhur, s’ka fare fuqi”; *e shkeli në kallo*” e preku atje ku i dhemb më shumë, e preku në pikën më të dobët”; *i ka duart me kallo* “ka punuar shumë, është punëtor i madh”; *e hodhi lumin* “e kaloi një rrezik a një vështirësi”; *e mori lumi* “ e pësoi keq, e gjeti e keqja”; *hodhi një gur në lumë* “provoi njëherë diçka, pa qenë i sigurt se do të fitojë a do të arrijë atë që do”; *bredh (shkon, shëtit) lule më lule* “është tepër i dhënë pas vajzave dhe nuk ka dashuri të qëndrueshme”; *mbeta me duar në gji* “mbeta pa njeri, fill i vetëm; u shkretova, tashë në mjerim e varfëri”; *i fryn zjarrit, i hedh benzinë zjarrit, lag drutë me benzinë, fut zjarrin në kashtë* “e nxit qëllimisht një grindje që është gati të nisë, ndez një mosmarrëveshje a një sherr”;

---

<sup>146</sup> Thomai J., *Çështje...*, vep. cit., f. 180.

<sup>147</sup> Po aty, f.180.

Nga ana tjetër, J. Thomai përshkruan dhe njësitë frazeologjike të pamotivueshme, të cilat nuk kanë një strukturë të lirë “homoforme” që përdoret sot, që kanë idiomatikë të lartë, që nuk mund të nxirret kuptimi i së tërës nga gjymtyrët, duke i quajtur të zhveshura “nga forma e brendshme”<sup>148</sup> “...idiomat frazeologjike kanë një shkrirje të brendshme të gjymtyrëve. Kjo lidhje e brendshme në gjendjen e sotme të gjuhës (pa hyrë në një shqyrtim historik), nuk duket, pra, idiomat nuk motivohen”, shkruan autori<sup>149</sup>. Për këtë grup autori sjell si shembuj njësi të tilla, si: *bëj pallë, vë re, e humbi toruan, (e humbi) si Xhaferi simiten, (flet) si e ëma e Zeqos majë thanës, (e shet) sa frëngu pulën* etj. Njësitë frazeologjike të pamotivueshme autori i quan përngjitje frazeologjike ose idioma, të cilat, më shumë se njësitë e tjera frazeologjike “shprehin veçantitë kombëtare të zhvillimit të gjuhës, ato nuk përkthehen në gjuhë të tjera fjalë për fjalë, pasi ndërtimi i brendshëm kuptimor i tyre është errësuar shumë”.<sup>150</sup>

Së dyti, duke rimarrë çështjen e studimit diakronik të frazeologjisë shqipe, J. Thomai trajton dhe aspektin shoqëror-kulturor në historinë e formimit të njësive frazeologjike, pra shqyrtimin e tyre mbi bazën e faktorëve jashtëgjuhësorë, siç janë ata nga fusha të tilla, si: historia, etnografia, folklori etj. Analiza e njësive frazeologjike në këtë këndvështrim është, në thelb, një metodë që të shpie në shqyrtimin e formës së brendshme të tyre, pra për të motivuar frazeologjinë dhe për të gjetur etimologjinë e saj me rrugë kryesisht jogjuhësore. *Fondi frazeologjik i shumë popujve-shkruan autori-vërteton që në frazeologji, si në asnjë fushë tjetër të gjuhës, ndjehet gjallë lidhja me faktorët jashtëgjuhësorë*<sup>151</sup>. Ai arrin në përfundimin se një pjesë e njësive frazeologjike kanë formë të brendshme të veçantë për popuj të ndryshëm, çka lidhet me veçoritë e zhvillimit historik, me jetesën e profesionet, me sintaksën popullore etj.<sup>152</sup>

Këtu jemi në të vërtetë në konceptin e formës së brendshme. Për ilustrim në këtë libër sillen disa shembuj përqsasës mes shqipes dhe gjuhëve të tjera, si: *ku di dhia ç’është tagjia* “nuk është i zoti dikush të vlerësojë atë që është me të vërtetë e mirë dhe me vlerë (zakonisht për dikë që është i prapambetur e i pagdhundur)”, që në kontekstin e shqipes lidhet me dhinë (si vatër semantike) që ka qenë kafshë e rëndësishme për shqiptarët; në bullg. *разбурали ти*

---

<sup>148</sup> Thomai J., *Çështje...*, vep. cit., f. 184.

<sup>149</sup> Po aty, f. 184.

<sup>150</sup> Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Dudaj, Tiranë, 2005, f. 190.

<sup>151</sup> Po aty, f. 210.

<sup>152</sup> Po aty, f. 216.

*свинята от кладенгова вода* lidhet me *derrin*, që për bullgarët është, gjithashtu, me shumë vlerë; *s'e vlen barra qiranë*, që në shqip lidhet me zanatin e qiraxhiut, kurse në rumanisht *nu face ața cit fața* lidhet me zakonin e grave për të shkukur me pe qimet e fytyrës, në frëngjisht *le jeu ne vaut pas le chandelle* lidhet me lojën e letrave etj<sup>153</sup>.

**6.1.2.** Në parathënien e Fjalorit Frazeologjik Ballkanik thuhet se “Në mikrostrukturë fjalori ruan maksimalisht formën e brendshme të çdo njësie frazeologjike, që përbën një nga tiparet origjinale të çdo gjuhe, veçanërisht në frazeologji”<sup>154</sup>. Në këtë Fjalor, veç të tjerash, përfshihen në radhë të parë njësi frazeologjike me struktura identike të tipit “kalk” dhe barasvlerës frazeologjike semantiko-funksionale, por me temë semantike të ndryshme<sup>155</sup>. Siç shihet, përdoren dy terma për të njëjtin koncept: “formë e brendshme” dhe “temë semantike”. Më parë, duke shkruar për paralelet (përkimet) frazeologjike të gjuhës shqipe me gjuhë të tjera të Ballkanit, J. Thomai dhe Xh. Lloshi përmendin “*zbulimin e tipareve të përgjithshme dhe veçorive kombëtare të frazeologjisë së secilës gjuhë*”, duke arritur në përfundimin se shqipja i tregon tiparet e saj nëpërmjet ndërtimit të njësive frazeologjike që nuk kanë paralele të tyre në gjuhë të tjera të Ballkanit<sup>156</sup>. J. Thomai, në parathënien e veprës “Fjalor frëngjisht-shqip-frëngjisht” të Daniel Xhoxhajt, shprehet se ai është një burim bibliografik referimi për studime në fushën e frazeologjisë gjuhësore, edhe krahasimtare<sup>157</sup>.

Ka shembuj kur njësia frazeologjike është rezultat i rikuptimësimit të një njësie tjetër frazeologjike. Në këtë rast ndodh metaforizimi i dyfishtë: forma e brendshme e një njësie lind në bazë të formës së brendshme të një njësie tjetër paraardhëse. Këtu nuk kemi raportin midis një togfjalëshi të lirë, pra një strukturë e lirë “homoforme”<sup>158</sup> dhe njësisë frazeologjike, por dy njësi frazeologjike homonime, ku kuptimi i njësisë së parë ka shërbyer si formë e brendshme për njësinë e dytë. Për shembull: *vesh më vesh* I “1. në të gjithë fytyrën, i tëri, nga një vesh në tjetrin. 2. me kënaqësi të madhe” dhe *vesh më vesh* II “1. me zë të ulët, që të mos e dëgjojë kush. 2. nga njëri te tjetri, gojë më gojë”. Për njësitë frazeologjike homonime mund të

---

<sup>153</sup> Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, vep. cit., f. 216.

<sup>154</sup> Thomai, J. & Loshi Xh. & Hristova R. & Qirjazati K. & Melonashi A., *Fjalori Fjalor Frazeologjik Ballkanik*, Dituria, Tiranë, 1999.

<sup>155</sup> Po aty, f. 7.

<sup>156</sup> Thomai, J. & Lloshi, Xh., *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*. Studime filologjike, I, Tiranë, 1967.

<sup>157</sup> Xhoxhaj D., *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip-frëngjisht*, EDFA, Tiranë, 2010, f. IV.

<sup>158</sup> Thomai J., *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*. Tiranë, 1981, f. 181.



thuhet se janë shumë të rralla dhe pothuaj të të njëjtit model strukturor, sikurse: *majë më majë*<sub>I</sub> “keq, me grindje, pa pajtim”, nga njësia homonime *majë më majë*<sub>II</sub> “plot, deri në grykë”; *degë më degë*<sub>I</sub> “me rrënjë, hollësisht, me gjithë vëmendjen” dhe *degë më degë*<sub>II</sub> “pa lidhje, pa rregull, nga një çështje në tjetrën”; *breg më breg*<sub>I</sub> “lart e poshtë, kudo”, *breg më breg*<sub>II</sub> “kot më kot, pa ndonjë qëllim të caktuar”; *fluturon në erë*<sub>I</sub> “shkatërrohet krejt, vete dëm” dhe *fluturon në erë*<sub>II</sub> dikush “është mendjelehtë e i rrëmbyer” etj. merr erë, e merr era,

**6.1.3.** E. Shijaku, kur flet për “labirintet” e frazeologjisë së frëngjishtes, ka parasysht se pikërisht “forma e brendshme” bën që të jepen me vështirësi barasvlerësit e frazeologjizmave nga një gjuhë në tjetrën. “Frëngjishtes *dire* i përgjigjet shqipja *them*, por shprehja frënge *il va sans dire* nuk mund të kthehet fjalë për fjalë në gjuhën shqipe *vete pa thënë*”<sup>159</sup>.

**6.1.4.** S. Doku vëren te njësitë frazeologjike “koloritin kombëtar” dhe “origjinalitetin” e gjuhës gjermane, kur shkruan: “*Duke u përdorur vazhdimisht dhe duke u përsëritur për një kohë të gjatë jo me kuptim të drejtpërdrejtë, por me kuptim të figurshëm, mjaft struktura gjuhësore kanë kristalizuar kuptime të caktuara metaforike. Kjo lëndë frazeologjike e bën më të spikatur koloritin kombëtar dhe origjinalitetin e gjuhës gjermane*”<sup>160</sup>.

**6.1.5.** Një tjetër autor që ka shkruar për formën e brendshme është dhe V. Memisha, i cili, kur përmend shndërrimin e togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike, bën motivimin e tyre mbi bazën e tropeve më të rëndësishëm gjuhësorë që realizojnë procesin trishkallësh *togfjalësh i lirë- togfjalësh “i parapërgatitur”- togfjalësh (njësi) frazeologjik*<sup>161</sup>. Autori sjell dhe mjaft shembuj nga shqipja dhe anglishtja për të argumentuar formën e brendshme të njësisive frazeologjike.

**6.1.6.** Në një mënyrë origjinale i është qasur këtij problemi edhe T. Toska në tezën e disertacionit me temë “Përfaqësimi i përvojës së shqipfolësve në gjuhë, te njësitë frazeologjike”<sup>162</sup>, ku autorja merret me studimin e motivimit apo të formës së brendshme duke marrë në analizë atë lëndë frazeologjike që lidhet drejtpërdrejt me sendërtimin e shpirtit të popullit për kategori të tilla të jetës njerëzore, si: lindja, vdekja, martesja, madje, duke bërë

---

<sup>159</sup> Shijaku E., *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Dituria, Tiranë, 1998, f. 1.

<sup>160</sup> Doku S., *Fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip*, Tiranë, 1998, f. 4.

<sup>161</sup> Memisha, V., *Studime për fjalën shqipe*, Botart, Tiranë, 2011, f. 60.

<sup>162</sup> Toska, T. *Përfaqësimi i përvojës së shqipfolësve në gjuhë te njësitë frazeologjike*, (tezë disertacioni nën udhëheqjen e prof. dr. Shezai Rrokaj), Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë, 2012.

edhe shqyrtime të tilla më të hollësishme, kur shkruhet për njësi frazeologjike që mbartin mendësinë popullore për pragvdekjen dhe pasvdekjen etj.

## **6.2. Trajtime teorike dhe përkufizime për formën e brendshme të idiomave në gjuhësinë botërore**

**6.2.1.** Me formën e brendshme të idiomave janë marrë një radhë gjuhëtarësh të huaj. A. Potebnja vë në dukje se koncepti i formës së brendshme mund të hulumtohet jo vetëm për fjalë të veçanta, por edhe për një sërë togfjalëshash që karakterizohen nga një unitet i caktuar semantik, domethënë, togfjalëshat e tipit të qëndrueshëm-frazeologjizmeve. Sipas tij, në njësitë frazeologjike, shumë shpesh, kuptimi parardhës i njësisë së qëndrueshme, domethënë, kuptimi i saj fillestar, i drejtpërdrejtë (që del nga shuma e kuptimeve reale të komponentëve të saj) është ai që mund të quhet formë e brendshme e njësisë frazeologjike<sup>163</sup>.

Meqenëse dhe te njësia frazeologjike, sikurse te fjala, vëmë re lidhjen midis kuptimit të saj dhe kuptimit të komponentëve që e përbëjnë atë, mund të pohojmë se jo vetëm fjalët e thjeshta dhe të përbëra (siç trajtohet në kapitujt përkatës të këtij punimi), por edhe njësitë frazeologjike kanë formë të brendshme, por më të ndërlikuar dhe me të shumëllojshme sesa në leksema. Në përgjithësi është pranuar mendimi se *formë të brendshme të njësisë frazeologjike quhet ajo lidhje, e cila ekziston midis kuptimit frazeologjik të njësisë dhe kuptimeve reale të komponentëve që e përbëjnë atë. Pra, forma e brendshme e njësisë frazeologjike është prania e motivimit në njësinë e qëndrueshme. Po qe se te njësia frazeologjike mungon motivimi, atëherë kjo ka formë të brendshme, por ajo është e panjohur, ngaqë ne nuk dimë asgjë, si te shembujt që u përmendën më sipër për njësitë e pamotivueshme.*

Po a kanë të gjitha njësitë frazeologjike formë të brendshme? Jo të gjitha njësitë kanë motivim, pra, formë të brendshme. Shumë prej tyre e kanë humbur prej kohësh dhe, në këtë anë, ato janë shumë të ngjashme me fjalët, të cilat e “kanë tretur” formën e brendshme, p.sh. *verë, mirë* etj. Forma e brendshme e njësisë frazeologjike të kujton më shpejt “zinxhirin” etimologjik, në të cilin shumë hallka janë këputur dhe në këtë boshllëk (mungesë)

---

<sup>163</sup> Rojzenzon L. I., *Vnutrennia forma i vnutrennia forma frazeologizma*, në *Voprosi frazeologii*, Tashkent, 1965, f. 63-70. (përkthim nga rusishtja).

shpesh fshihet shkëputja (ndarja) midis kuptimit të njësisë frazeologjike dhe kuptimeve fillestare të gjymtyrëve të saj, psh.: *bëj pallë, vë re* etj.

Në ç'mënyrë dhe në ç'bazë krijohet forma e brendshme e njësisë frazeologjike? Këtë proces idiomatizimi mund ta shprehim si më poshtë:



Pra, kemi zgjerim të kuptimit sipas drejtimit nga konkretja te abstraktja. Në këtë rast, forma e brendshme e njësisë frazeologjike përmbahet në tërësinë e gjymtyrëve të saj, të përftuar nga kuptimet e tyre të drejtpërdrejta, jofrazeologjike, si: *e shkeli në kallo, e hodhi lumin, rreh gjoksin* etj., që i përmendëm më lart. Por forma e brendshme e njësisë frazeologjike, siç do ta trajtojmë edhe më poshtë, mund të përftohet jo vetëm në tërësinë e gjymtyrëve përbërëse, por edhe në bazë të një gjymtyrë të vetme të njësisë. P.sh. *po i hapet varri nën këmbë* “po vdes, po i vjen fundi”, ku koncepti i vdekjes përmbahet te fjala *varr*. Forma e brendshme e njësisë frazeologjike mund të bazohet jo në shumën e kuptimeve të drejtpërdrejta-të figurshme të gjymtyrëve përbërëse, por në kuptimin e drejtpërdrejtë-figurativ të togfjalëshit. P.sh.: *humbet rrugën në oborr* do të thotë *i paaftë, hutaq*. Këtë mund ta shohim edhe në idiomën e anglishtes *the Queen’s Shilling* (fjalë për fjalë- marr shillingat e mbretit), që do të thotë “hyj në shërbimin ushtarak”<sup>164</sup>.

Për gjetjen e formës së brendshme të njësisë frazeologjike mund të shërbejë dhe “etimologjia popullore”. Kjo vlen sidomos për rastet kur si burim i njësisë frazeologjike është një anekdotë, një ngjarje historike etj., si: *për mustaqet e Çelos, si e ëma e Zeqos majë thanës, që në kohën e baba Qemos, i duket ferra Brahim* etj.

---

<sup>164</sup> Po aty, f. 67.

**6.2.2.** Sipas Dobrovolskit dhe Baranovit “*Idiomat ndryshojnë nga të gjitha dukuritë e tjera leksikore vetëm përse i përket mundësisë që u jep forma e brendshme për të ristrukturuar nga pikëpamja semantike procesin e njohjes, që përfshihet në njohuritë bazë paradigmatiche ontologjike. Është pikërisht ky proces që i bën ato të dallueshme nga njëra tjetra. Idiomat na lejojnë të shohim në brendësi të botës konceptore*<sup>165</sup>.”

**6.2.3.** Lakov dhe Johnson theksojnë se idetë, besimet apo bindjet që krijohen mbi natyrën njerëzore përmes këtyre njësive duhet të shpjegohen dhe analizohen të lidhura me kulturën e vendit ku këto bëjnë pjesë. Nëse struktura (rrjeta) konceptore bazohet te karakteristikat biologjike dhe psikologjike, atëherë studimi i shprehjeve metaforike mund të na ndihmojë në procesin e të kuptuarit të universaleve gjuhësore. Shumë aspekte të jetës së përditshme nuk mund të përvijohen mbi bazat e përmasave natyrore të përvojës sonë. Kjo është më tipike për emocionet njerëzore, konceptet abstrakte, aktivitetet mendore, praktikat shoqërore. Megjithëse të gjitha këto mund të përjetohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga individët, asnjëri prej nesh nuk mund t’i kuptojë dhe perceptojë ato përveçse përmes entitetit dhe përvojës kolektive<sup>166</sup>.

Siç u theksua dhe më lart në këtë kapitull, në pjesën më të madhe idiomat mund të motivohen dhe mund t’i përgjigjen një logjike të identifikueshme, por edhe lidhjet e qarta (të shprehura) ndër-gjuhësore mund të shërbejnë për të kuptuar pasqyrimin e të përbashkëtave konceptore. Vargjet dy ose trigjuhësore idiomatike na ndihmojnë të kuptojmë dhe të konceptojmë veprimtaritë dhe tiparet njerëzore. Një nga tiparet më të spikatura të njësive të figurshme konvencionale si idiomat, është se ato nuk mund të kuptohen pa iu adresuar një njohjeje të thellë kulturore. Metaforat më të spikatura nuk lidhen drejtpërdrejt apo vetëm me njohuri të mirëfillta gjuhësore. Në mënyrë që të përcaktohet se si funksionojnë idiomat dhe se si mund të zbulohen tiparet kuptimore dhe pragmatike, duhen marrë parasysh edhe faktorët jashtëgjuhësorë, të cilët drejtojnë kalimin nga kuptimi i drejtpërdrejtë tek ai i figurshëm.

**6.2.4.** Duke qenë se idiomat janë njësi jo të rregullta të leksikut, ato nuk mund të analizohen mjaftueshëm me anë të instrumenteve metagjuhësore, sepse ndryshimi midis njësive gjuhësore figurative dhe jofigurative qëndron pikërisht në mënyrën se si folësit i

---

<sup>165</sup>Dobrovolskij, D. O. & Baranov A. N., *Cognitive modeling of actual meaning in the field of phraseology*, Journal of pragmatics, f. 428.

<sup>166</sup>Lakoff, G., & Johnson, M., *Cognitive theory of metaphor*, Chicago, University of Chicago Press, 1980, f. 177.

kodojnë lloje të ndryshme të njohurive. Nevojitet një teori e veçantë për të përshkruar parregullsitë e idiomave. Idiomat regjistrojnë dhe ruajnë njohuri të vlefshme si pjesë e planit të përmbajtjes (në formën e gjurmëve, njollave të imazhit), duke reflektuar tiparet e kulturës përkatëse<sup>167</sup>.

Klasifikimi më i njohur i njësive frazeologjike është ai i V.V. Vinogradov-it, i cili e shtjelloi tezën e hedhur më parë nga Charles Bally (Sharl Bali) dhe i dha një shtysë trajtesave të mirëfillta leksikologjike bazuar mbi materialet e mbledhura nga ai. Njësitë frazeologjike u trajtuan si njësi komplekse leksikore me tipare të veçanta semantike mbi bazën e të cilave duhej të klasifikoheshin. Tipizimi i tij u bazua në shkallën e motivimit të njësisë dhe lidhjen midis kuptimit të së tërës dhe kuptimit të pjesëve të veçanta. Shkalla e motivimit lidhet me ngurtësinë, pandashmërinë dhe lidhjen kuptimore të shprehjes, pra, me mundësinë e ndryshimit të formës apo rendit të përbërësve dhe aftësinë për t'u zëvendësuar nga një fjalë e vetme. Shpesh njësi të tilla quhen *idioma*, sepse në këto raste humbet plotësisht forma e brendshme. Shpjegimi i kuptimit të këtyre njësive duhet bërë nën dritën e analizave etimologjike. P.sh.: *tit to tat* ka kuptimin “të hakmerresh”, por askush nuk mund ta shpjegojë se çfarë do të thotë *tit* dhe *tat*, sikurse në shqip: *me kuç e me maç, me cull e mull* etj.

Dihet që idiomatika është një tipar i qëndrueshëm dhe i përhershëm i gjuhës. Në literaturën gjuhësore termi *idiomë* përdoret shpesh për një nënklasë të shprehjeve të ngurta, me cilësi të veçanta semantike. Këto njësi komplekse janë shprehje sintaksore që nxjerrin në pah kufizimet e përftesave leksikore, që nuk mund të shpjegohen me rregullat sintaksore dhe kufizimeve kuptimore, që përcaktojnë ligjet e brendshme të gjuhës. Këndvështrimi klasik në lidhje me kuptimin e idiomave është se ato nuk kanë strukturë të brendshme kuptimore dhe mund të zbërthehen semantikisht.

Sipas F. Cermak “moszbërthimi semantik” është “condition sine qua non” për substancën semantike” dhe mëton se kuptimisht idioma është një dukuri “holistike”, një tipar që shpesh pranohet se përjashton çdo mundësi për një analizë kuptimore objektive<sup>168</sup>.

**6.2.5.** U. Weinreich bën një analizë të plotë dhe të rëndësishme, duke ilustruar se si kuptimi idiomatik i një shprehjeje të përbërë mund të jetë pasojë e heqjes, shtimit apo zëvendësimit të disa përbërësve kuptimorë. Frazeologjizmat, përgjithësisht, janë më

---

<sup>167</sup> Wierzbicka, A., *Emotional Universals*, Language Design, 1999, f. 28.

<sup>168</sup> Po aty, f. 28.

kuptimplota sesa fjalët. Në terminologjinë e analizës së semave kjo do të thotë se, përveç bërthamës semantike, frazema përmban sema më të konkretizuara dhe më të diferencuara sesa një fjalë e krahasueshme kuptimisht. Njësia frazeologjike *u mbars mali dhe polli një mi* dhe shpjegimi i saj “ta zmadhosh diçka, ta frysh” mund ta ilustrojë më së miri këtë<sup>169</sup>.

**6.2.6.** Një nga problemet më kryesore semantike është përshkrimi dhe shpjegimi se si janë të lidhura mes tyre kuptimet dhe nivelet e kuptimit. Sa më e fortë të jetë lidhja, aq më e motivueshme është idioma. D. Dobrovolskij dhe E. Piirainen kanë dalluar disa lloje të ndryshme motivimesh semantike, ndër të cilat mund të veçojmë *motivimin metaforik* dhe *motivimin me bazë simbolet*<sup>170</sup>. Fakti është se, nëse duhet të themi që në idiomën *spill the beans* dhe jo *spill the peas* nuk zbatohet ndonjë rregull gramatikor, ajo thjesht duhet mësuar edhe sikur të mendojmë se semantikisht kjo njësi mund të jetë e analizueshme. Kjo do të thotë se idiomat janë shprehje të ngulitura që formohen me konvencion dhe, si të gjitha njësitet e këtij tipi, ato duhet thjesht të mësohen dhe të mbahen mend. Sigurisht, që ka disa kufizime në lidhje me mënyrën se si ndërtohen si strukturë e tillë. Shpesh këto kufizime përcaktohen nga parimet gramatikore, por ndonjëherë forma e kufizuar përcaktohet nga faktorë jashtëgjuhësorë. Simboli frazeologjik është një lloj i shenjës gjuhësore, baza e së cilës është transparenca e formës së brendshme (kuptimi etimologjik) që shërben si një lidhje midis kuptimit aktual dhe semantikës së drejtpërdrejtë të bazës së figurshme të njësive frazeologjike. Simbolet e frazemave bazohen te simbolet e formës së brendshme që përfaqëson përmbajtjen e abstraguar nga baza e figurshme e kuptimit të jashtëm të një fraze. Një shembull i mirë është semantika e bazuar te metafora *the pink of health* “ in very good condition either physically and emotionally”.; gjendje e mirë e kënaqshme.

Kuptimi i çdo shenje gjuhësore është përkthimi në disa shenja më të gjera dhe alternative në të cilat ajo mund të ndahet më tepër. Deri tani nuk ka patur asnjë metagjuhë të veçantë për përshkrimin e semantikës frazeologjike. Në kontrast me llojet e tjera të njësive leksikore, pjesa më e madhe e njësive të ngurta kanë një formë të brendshme të gjallë, e cila është një përbërës shumë i rëndësishëm i kuptimit të idiomave. Përshkrimi i semantikës idiomatike duhet të ketë dy pjesë të ndërlidhura: përshkrimi i semantikës, në kuptimin e

---

<sup>169</sup> Weinreich. U., *Problems in the analysis of idioms*, në Substance and Structure of Language, University of California Press, 1969, f. 35.

<sup>170</sup> Dobrovolskij D. O. & Piirainen E., *Cognitive theory of metaphor and idiom analysis*, Jazikosloviye, 6, Moskow, 2005, f. 30.

ngushtë të fjalës, pra prezantimi i specifikës së diferencuar dhe përbërësit integralë të kuptimit, pra përshkrimi i përbërësve të imazhit. Metagjuhët semantike moderne janë bazuar në arbitraritetin e shenjës gjuhësore (teoria e Saussure-it) për analizën e gjuhës.

Interpretimi semantik i i formës së brendshme mund të jetë eksplicit (i shprehur qartë) dhe implicit (i nënkuptuar). Strategjia eksplicite bazohet tek operatorët kuptimorë që prezantojnë në përfaqësimin kuptimor një ide të krahasimit të dy entiteteve. Strategjia implicite nënkupton që nuk ka operatorë të veçantë për formën e brendshme dhe informacioni i duhur kuptimor shpërndahet midis përbërësve të ndryshëm të përkufizimit. Konteksti luan një rol të rëndësishëm në semantikën e këtyre shprehjeve. Qëndrueshmëria e kuptimit frazeologjik është e lidhur ngushtë me qëndrueshmërinë e strukturës leksikore të asaj njësie. Forma e brendshme mund të jetë e shfaqur qartë ose e nënkuptuar dhe ndikon në kuptimin e përgjithshëm të strukturës. Tipari më i rëndësishëm i njësive frazeologjike është se kuptimi mund të riinterpretohet pjesërisht ose plotësisht. Njësitë figurative konvencionale, si idiomat, nuk mund të kuptohen plotësisht pa u njohur së pari me kontekstin kulturor.

Përveç karakteristikave semantike dhe pragmatike, çdo studiuues duhet të marrë parasysh konceptet kryesore kulturore, të cilat janë bazë për të kuptuar instrumentet jashtëgjuhësore. Duke qenë se idiomat janë njësi jo të rregullta të leksikut dhe mjete shprehëse të ligjërimit të figurshëm, na duhet, së pari, të shtrijmë kërkimet tona në të dhëna, metoda dhe fusha që shkojnë përtej gjuhësisë, për shkak se këto njësi të ligjërimit të figurshëm janë kaq të ndryshme për faktin se ato kodojnë lloje të ndryshme njohurish dhe, mbi të gjitha, ato regjistrojnë dhe ruajnë njohuri të vlefshme në planin e përmbajtjes (në formën e gjurmimit të imazheve), duke reflektuar, mbi të gjitha, kulturat dhe shoqëritë respektive.<sup>171</sup>

**6.2.7.** Në gjuhësinë e sotme vlen të përmenden ndihmesat e Olga Leotocivh (Leontoviç) për formën e brendshme të idiomave<sup>172</sup>, kryesisht me materiale të gjuhës angleze, duke trajtuar çështje të tilla, si: roli i formës së brendshme në përdorimin kontekstual stilistik të idiomave, problemi i formës së brendshme në aspektin nominativ, roli i formës së brendshme në strukturën e kuptimit frazeologjik etj.

---

<sup>171</sup> Po aty, f. 35.

<sup>172</sup> Shih bibliografinë në fund të punimit.

### 6. 3. Mënyrat dhe mjetet e motivimit të idiomave për nga forma e brendshme

A janë të mjaftueshme mjetet njohëse të kuptimit të figurshëm dhe metaforës, për të kuptuar idiomat apo të marrim parasysh instrumente të tjera të strukturës apo skeletit konceptor dhe mjeteve metalinguistike? Në teorinë konjitive të metaforës, frazeologjia, si një fushë që ka sferën e vet të studimit, luan pak ose aspak rol. Çështja më e theksuar në këto studime është se shumica e idiomave motivohen semantikisht dhe nuk janë arbitrare<sup>173</sup>. Në fakt, ideja se shumica e idiomave mund të motivohen është hedhur nga Sh. Bali. Ai shprehej se idiomat në pjesën më të madhe nuk janë elemente “të ngurtësuar të gjuhës”, as nuk janë arbitrare, po motivohen plotësisht nga struktura të ndryshme dhe rrafshe të ndryshme të njohjes<sup>174</sup>.

Motivimi i njësisë frazeologjike, pra “zbulimi” i formës së brendshme të tyre mund të bëhet mbi bazën e mjeteve që realizojnë shndërrimin e figurshëm të togfjalëshave të lirë në njësi frazeologjike. Nga ndonjë studiu ky quhet një proces shumëplanësh dhe i ndërlikuar<sup>175</sup>. Veirzbicka mendon se vlefshmëria e universaleve emocionale duhet studiuar me hollësi dhe analiza e gjuhëve të veçanta mbron ekzistencën e mundshme të një prirjeje universale për të shprehur emocionet dhe ndjenjat e ndërtuara mbi bazën e aftësisë njohëse të realitetit dhe të lidhura me imazhe figurative të qenies njerëzore. Në mënyrë natyrore njohësit e një gjuhe kërkojnë kuptimin dhe sistemin në inputin gjuhësor dhe pikërisht këtu idiomat dallojnë nga aspektet e tjera të gjuhës, të cilat mund të shpjegohen më lehtë mbi bazën e rregullave dhe tipareve semantike. Nëse kuptimi nuk gjendet në nivelin sipërfaqësor të idiomës për shkak të papërputhshmërisë së strukturës së jashtme, atëherë ku duhet ta zbulojnë kuptimin, pyet autori.<sup>176</sup> Kjo duket të *modeli ikonik: frika/tronditja* dhe *arkimetafora: trupi-ndryshimi i ngjyrës*, që del në forma të ndryshme. Për shembull: spanj. *Empalidese*; angl. *to turn pale* “të zverdhesh në fytyrë”; gjerm. *bläss warden*; angl. *to turn as white as a sheet* “të zbardhesh si letër duhani” (në gjermanisht *warden-* i/e bardhë); serbo-kroatisht *probijediti*; angl. *to turn white* “të zbardhesh në fytyrë”; turq. *bembeyaz almak samarmak*; angl. *to turn yellow* “të

---

<sup>173</sup> Lakoff G. & Johnson M., *Metaphors we live by*, Chicago, 1980, f. 448.

<sup>174</sup> Dobrovoskij D. O. & Baranov A. N., *Cognitive ...* vep. cit., f. 47.

<sup>175</sup> Memisha V., *Studime për fjalën shqipe*, Botart, Tiranë, 2011, f. 83.

<sup>176</sup> Wierzbicka A., *Emotional Universals*, Language Design, 1999, f. 23.



zverdhesh”; turq. *kokdan rengi atmak*; angl. *to change colour from fear* “të ndërrosh ngjyrën e fytyrës nga frika” etj.

Po kështu mund të themi se i njëjti model ikonik: trupi+lëvizja krijojnë metafora të lidhura me lëvizjen fizike. Për shembull: angl. *to tremble with fear, my heart skipped a jump* “të dridhesh nga frika/të të dridhet zemra/të hidhet zemra përpjetë”; gjerm. *von angst zittern* “të drishesh nga frika”; spanj. *temblar de miedo* “të dridhesh nga frika”, *me dio unvuelco el Corazon* “të të godasë (të të japë zemra) një goditje”; serbokroatisht *drhati od straha* “të dridhesh nga frika”; turq. *kalbim hop etti* “të të hidhet zemra përpjetë” etj.

Shpesh këto perceptime shoqërohen edhe me rritje të temperaturës fizike dhe në këtë rast arkimetafora është “trupi bashkë me temperaturën fizike”: angl. *my body ran cold* “m’u bë gjaku akull/ më ngriu gjaku”; spanj. *la sangre se me helo* “më ngriu gjaku”; gjerm. *mir frierte das Blunt* “më ngriu gjaku”; turq. *buz gibi oldum/buz kestim* “u bëra akull”. Kështu, mund të renditim edhe arkimetafora të tjera: inati, zemërimi, angl. *my blood boiled* “më zjeu gjaku”; spanj. *quemarsele la sangre* “më zjen gjaku”; gjerm. *mir kocht das Blunt in den Adern* “më zjen gjaku në vena”; zhgënjimi, angl. *my heart fell* “më bie/më rrëzohet zemra”; spanj. *se hundio el Corazon* “zhytet zemra”; *caersele el alma a los pides* “i bie shpirti nën këmbë”.

Semantika idiomatike dhe metafora konceptuale ka të bëjë me lidhjet midis ngjyrave të veçanta (e verdha, e gjelbra, e zeza, e kuqja, e bardha) dhe emocioneve, si zilia apo zemërimi. Nëse në pamje të parë këto postulate janë të bazuara në lidhje konceptore arbitrare, është e qartë se ka nevojë për sqarime të mëtejshme që lidhen me njohuritë kulturore apo me përvojat e drejtpërdrejta, megjithëse edhe në rastin e kësaj të fundit kultura duhet të pranohet deri në njëfarë mase, ashtu siç është dëshmuar nga kërkimet antropologjike tradicionale, të cilat lidhen me emocionet dhe përkimet e tyre në gjuhë të ndryshme. Nga pikëvështrime krejtësisht gjuhësore, e rëndësishme është të gjejmë se si çdo përbërës i imazhit kontribuon në kuptimin e vërtetë të frazës në secilin prej rasteve konkrete dhe se si përcaktohet “sjellja” kontekstuale e një idiome të dhënë.<sup>177</sup>

---

<sup>177</sup> Dobrovolskij D. O. & Piirainen, E., *Figurative Language: Cross-cultural and Crosslinguistic Perspectives*, Amsterdam, 1995, f. 429.

Lakov dhe Johnson mendojnë se burimi i imazhit metaforik është thelbësor për përvojën e përjetuar, që do të thotë perceptim i botës përmes aftësive abstraguese dhe sferës fizike të përvojës.<sup>178</sup>

Thuhet shpesh se kuptimi i idiomave është i paqartë. Për shembull, çfarë kuptimi ka në të vërtetë “të vrasësh me një gur dy zogj” (angl. *kill two birds with one stone*). A dihet me saktësi se çfarë do të thotë *dy zogj* dhe se çfarë veprimi kryen njeriu që vret në fakt dy zogj? Frazemat janë formula të zbrazëta që mund të përmbushen nga konteksti. Ka shumë karaktersistika të ndryshme nën etiketimin “aftësi shprehëse” të idiomave. Ato janë të mbiveshura me vlera shtesë konotative krahasuar me fjalët e thjeshta dhe me sintagmat. Te frazemat me dy kuptime, kuptimi i parë i drejtpërdrejtë mund të aktualizohet, kjo është veçanërisht e rëndësishme të shprehjet metaforike-metonimike. Në të tilla raste aftësia shprehëse barazohet me figurshmërinë.

Metafora dhe metonimia nuk janë të vetme trope që mund të karakterizohen nga njësitë frazeologjike. Për sa u përket vlerave semantike mund të kuptojmë se aspekti semantiko-pragmatik nuk ndahet nga njëri-tjetri. Një idiomë ka një kuptim frazeologjik të përgjithshëm. Fakti që *kick the bucket* ka kuptimin “vdes” nuk përputhet me asnjë parim të brendshëm të njohjes sonë. Përbërësit e një idiome janë kuptimi gramatikor dhe kuptimi leksikor. Në nivelin literal dhe jofrazeologjik këta përbërës kanë tiparet e një sintagme të zakonshme, kuptimi i të cilëve del prej kombinimit të rregullt të përbërësve në bazë të rregullave semantike dhe morfosintaksore<sup>179</sup>.

Mënyrat dhe mjetet e formimit dhe të motivimit të njësive frazeologjike janë të ndryshme, por si bazë për formimin e tyre shërbejnë tropet gjuhësorë, si krahasimi, metafora, metonimia, sinekdota, hiperbola etj., të cilat do t'i trajtojmë më poshtë.

### **6.3.1. Njësi frazeologjike të motivuara mbi bazën e krahasimit**

Këtë çështje e ka trajtuar gjerësisht J. Thomai<sup>180</sup>. Ai thekson se “*si në gjuhë të tjera, edhe në gjuhën shqipe shumë njësi frazeologjike formohen nëpërmjet krahasimit, përmes metaforës në leksikalizim*”. Me këtë figurë janë ndërtuar njësi frazeologjike në shumë gjuhë,

---

<sup>178</sup> Lakoff G., & Johnson, M., *Cognitive theory of metaphor*, Chicago, University of Chicago Press, 1980, f. 177.

<sup>179</sup> Weinreich, U., *Problems in the analysis of idioms*, 1969, f. 36.

<sup>180</sup> Thomai J., *Çështje ...vep. cit.*, f. 33-37.

p.sh., *si peshku pa ujë (në të thatë, në zall, në gjanë)* me kuptimin “pa mjete jetese, në ngushticë të madhe ekonomike; shumë i pakënaqur”, *si bletë e plotë* “1. plot, me të gjithë ata që duhen, së bashku dhe të pasur e të lumtur. 2. me shumicë, me bollëk të mirash”; *si bryma në diell/si kripa në ujë* “diçka që mbaron shpejt, që zhduket menjëherë, që shkrin sakaq pa lënë gjurmë”; (është) *si era e malit* “është i rrëmbyer; është shumë mendjelehtë dhe i papjekur”; *si si pulë e lagur; si mace e lagur; si mi i lagur* “njeri frikacak a shumë i druajtur; që rri i përlulur e i nënshtruar, sikur ka bërë faj a ka frikë”; *si pula në grurë (në thekër, në mulli)* “në mes të të gjithë të mirave, pa i munguar asgjë, në gjendje shumë të mirë”; *si zogjtë e korbit (e qyqes)* “1. të shpërndarë në të katër anët të përhapur gjithandej në vend të ndryshme. 2. rrugëve, pa ndihmë e përkrahje” etj.

Në përgjithësi, ndërtime të tilla përftohen dhe realizohen duke u mbështetur në botën sendore me realie shumë të njohura me cilësi të dallueshme, që shërbejnë për krahasim. Ndër to mund të përmendim realiet nga bota shtazore, sendore, e shpendëve, e insekteve, e bimëve etj<sup>181</sup>, p.sh.: (njihet) *si kau balash* “që shquhet shpejt si i veçantë; e dinë të gjithë kush është, që dallohet si dhia në mes të dhenve”; *si dashi me këmborë* “që vepron me siguri e krenari, që nuk i trembet syri”; *si qen i rrahur (i dëbuar)* “që e ka pësuar njëherë keq në jetë dhe nuk ka më guxim e nuk vetëvepron, ngaqë ruhet se mos e pëson përsëri”; *si viç i palëpirë* “i papjekur, kalama, i ngjathët e pa përvojë”; *si maçoku në thekër* “mendjemadh, mburravec, si kaposhi majë plehut”; *si kali në lëmë* “që bën ç’ të dojë”; *si nepërkë e shullërit* “shumë e zgjuar dhe lozonjare”, (njihet) *si parja e kuqe* “e njohin të gjithë, dallohet lehtë se kush është, bie në sy menjëherë”; *si eshka me urorin (me masatin)* “shumë keq, duke u grindur vazhdimisht”, *si vaji në lakra (në arme)* “pa u drojtur, pa u matur mirë, duke e tepruar”, *si kofini pas të vjelave* “shumë vonë, atëherë kur nuk duhet”; *si gjeli (kaposhi) majë plehut* “duke u mbajtur më të madh, duke u mburrur”; (shkojnë) *si macja me miun* “shumë keq, në grindje të vazhdueshme” etj.

Duhet vënë në dukje se shumica e njësive që formohen mbi bazën e krahasimit e kanë të bjerrur lidhëzën krahasuese *si*, duke ndërruar dhe përkatësinë leksiko-gramatikore: *dash me këmborë, nepërkë e shullërit, viç i palëpirë, kaposh mbi plehë, gur varri* etj. J. Thomai vëren me të drejtë se “në rastet kur lidhëza krahasuese nuk është e pranishme në mes të gjymtyrëve të togfjalëshit, sidoqë mund të nënkuptohet, është më e mundshme: e do qofte “e do

---

<sup>181</sup> Memisha, V., *Studime...vep. cit.*, f. 84.

*gjithmonë gati*”, *iu bë ferrë “iu ngjit”*, *e bën mizën buall “e stërmadhon”* etj<sup>182</sup>. Mungesa e lidhëzës krahasuese na shpie drejtpërdrejt te metafora, që, siç përkufizohet gjithandej, është një krahasim i nënkuptuar, meqë ka në bazë ngjashmërinë mes realieve.

### **6.3.2. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e metaforës**

Shumica e njësive frazeologjike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera janë ndërtuar dhe motivohen mbi bazën e metaforës: *u bë dyllë i verdhë, (është) pemë pa kokrra, mësallë me dy faqe, thes i shpuar, daulle (teneqe) e shpuar, fole grerëzash, kërcu mbi samar, shes mend, me zemër të thyer, i vë pleshtit fre (zile), e ha preshin nga bishti, m'u bë rodhe, derr me zile, derr në thes, (është) kripë në diell, kënga e (avazi i) Mukes, ujk me brirë, e vë festen bi sy, shportë karavidhesh* etj.

### **6.3.3. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e metonimisë**

*më shkuan shtatë palë djersë, e mbaroi çanakun, na mori të keqen, tund (luan) derën, i ngrys ditët, ka marrë frerin nëpër këmbë, i pjell edhe gjeli (këndezi), rrodhën qiejt, vë brirë, është në buzë të varrit, mbeti me gojë hapur* etj.

### **6.3.4. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e sinekdokës**

*fut hundët, fut duart, burri i botës, e drodhi këmbën, e dredh bishtin* etj.

### **6.3.5. Njësi frazeologjike të formuara mbi bazën e hiperbolës dhe litotës**

*e bën mizën buall, e bën qimen tra, e futi shtatë pashë nën dhé, u bë deti kos, e fut minaren në thes, e than detin me lugë, e bën priftin me barrë, nxjerr të vdekurin nga varri, fut shejtanin në shishe, të peshon me flori, s'e lan dot as lumi, i mbyll dymbëdhjetë dyer me një shul, hëngri dynjanë, me një këndes plaçka, shpëtoi për një qime, thëngjill i mbuluar, varet në fije të perit, s'të jep një pikë ujë, është bërë lugë, etj.*

---

<sup>182</sup> Thomai J., *Çështje...* vep. cit., f. 34-35.

#### **6.4. Idiomat në teorinë konvencionale të gjuhës së figurshme**

Kjo teori është formuluar nga Dobrovolski dhe Pirainen. Ata mendojnë se ka një strukturë konceptuale specifike që përfshihet në kuptimin e njësive të figurshme. Struktura konceptuale, si një figurë e imazhit, bazohet në imazhe mendore dhe është një figurë e rëndësishme në planin e përmbajtjes. Motivimi i njësive të figurshme nuk nënkupton lënien mënjane të përshkrimit etimologjik si një pjesë e rëndësishme përbërëse. Ka shembuj të mjaftueshëm që tregojnë se “kujtesa etimologjike” e një idiome përcakton dhe funksionin në ligjërim<sup>183</sup>. Klasifikimi i idiomave sipas fushave konceptore, në funksion të analizës së formës së brendshme, mund të bëhet si më poshtë:

##### **6.4.1. Inati/zemërimi**

Angl.: *go through the roof* (fj. p. fj: kaloj përmes, kapërcej çatinë) t’i biesh murit me kokë; *blow a fuse* (fj. p. fj: fryj një fitil), *blow your top* (fj. p. fj: të të fluturojë kapaku, mbulesa, maja), *fly your lid* (fj. p. fj: të të fluturojë kapaku), të të luajë mendja e kokës, të të pëlcase koka, të të lëvizë tepeleku i kokës); *lose your cool* (fj. p. fj: e humbas qetësinë), *lose your rag* (fj. p. fj: i humbas lekat, zhelet)e humbas qetësinë/toruan; *see red* (fj. p. fj: shoh ngjyrë të kuqe), *blow a stream* (fj. p. fj: lëshoj avull) më lëshon koka tym; *make your blood boil* (të të zjejë gjaku) më hipëm gjaku në kokë, më vjen në majë të hundës; *burst a blood vessel* (fj. p. fj: shpërthen, plas një enë gjaku) iu ndez gjaku; *somebody’s blood is up* (fj. p. fj: i hipi/iu ngrit gjaku) iu ndez gjaku, turfullon nga inati; *bite somebody’s head off* (fj. p. fj: ia këput me dhëmbë kokën dikujt) i luan mendja, lajthit; *cut sb. down to size, give sb. a piece of your mind* (fj. p. fj: ia pres/shkurtoj madhësinë/masat dikujt) ma heq trurin; *give sb. a rocket* (fj. p. fj: t’i hedhësh dikujt një fishekzjarr, një fushqetë) e shaj, lëndo dikë, i lëshoj fjalë pa vend; *give sb. the rough side of your tongue* (fj. p. fj: t’i tregosh dikujt anën e egër të gjuhës), e lëshoj gjuhën, shaj dikë; *jump down somebody’s throat* - i hedh thonjtë në fyt/në grykë; *ruffle somebody’s feathers* (fj. p. fj: ia shpurpuris pendët dikujt) e bëj peshk, ia bëj kurrizin

---

<sup>183</sup> Dobrovolskij, D. O. & Piirainen, E., *Figurative Language...* vep. cit., f. 430.

më të butë se barkun; *get up steam, have steam coming out of your /be steamed ears-të të lëshojë koka tym, të të marrë koka zjarr; be hot under the collar* (fj. p. fj: të të nxehet pjesa e poshtme e jakës së këmishës, qafores) të të marrë koka zjarr; *mad as a hornet* (fj. p. fj: i çmendur si një grerë) më kanë hipur kacabujtë; *be up in arms* (fj. p. fj: të ngresh armët) të të vijë në majë të hundës; *bite one's tongue off* (fj. p. fj: të kafshosh/hash gjuhën) më vjen ta ha veten nga inati; *beat somebody black and blue* (fj. p. fj: e bëj dikë të zi dhe blu) e zhdëp në dru; *get into a rage*-inatosem, tërbohem; *bite one's lip*- kafshoj buzën nga inati etj.

Italisht: *perdere la testa* (fj. p. fj: humb kokën) humb toruan; *vedere le stele al mezzogiorno* (fj. p. fj: shoh yje më mes të ditës), i luajti mendja, lajthiti; *scoppiare di rabbia*-pëlcas nga inati; *spruzzar fiamme dagli occhi* (fj. p. fj: nxjerr tym nga sytë) i lëshojnë sytë xixa nga inati; *dare con la testa nel muro*- i bie murit me kokë; *mettersi in capo*-më hipën në kokë, më kërcen delli; *essere nero come del calabrone* (fj. p. fj: të jesh/të bëhesh i zi si karboni), i nxirrë nga inati, i xhindosur; *perdere il ben dell'intelletto* (fj.p.fj: të humbasësh anën e mirë/pozitive të inteligjencës/intelektit) e humbas toruan, rrjedh nga trutë; *avere la bava alla boca* (fj. p. fj: të kesh papastërti/zhul në gojë) i del shkumë nga goja, turfullon/shkumëzon nga inati; *gli ha dato di balta il cervello*- ka luajtur nga mendë e kokës etj.

#### **6.4.2. Ngjashmëria, tiparet e përbashkëta, afërsia**

Angl.: *as like as two peas* (fj. p. fj: të ngjashme si dy bizele) si dy pika uji; *cut from the same cloth* (të prerë nga e njëjta copë) janë të një prerje, miell i një thesi; *chip of the old block* (fj. p. fj: ashkël e nxjerrë nga një kërcu, dru i vjetër), sikur e ka nxjerrë nga hundët; *birds of a feather flock together* (zogjtë me të njëjtën pupël/pendë mbledhen tufë bashkë), miell i një thesi; *great minds think alike* (fj. p. fj: mendjet e mëdha mendojnë njëjloj) të jesh i një mendjeje; *in tune with, be of one mind*-të luash të njëjtën melodi, të një mendjeje, të një avazi; *get on the same page*- të jesh në të njëjtën faqe); *be on the same wavelength*-në të njëjtën gjatësi vale; *speak the same language* (fj. p. fj: flas të njëjtën gjuhë), e gjej gjuhën; *speak with one voice*- të flasësh me të njëjtin zë; *be a carbon copy* -të jesh kopje me letër kopjativ, kopje karboni, janë kopje; *like two peas in a pod* (fj. p. fj: si dy bizele një një bishtajë) si dy pika uji; *like father likeson*- si i ati dhe - biri; *in the same breath*- me të njëjtën frymë/të marrësh frymë njëjloj, me të njëjtën gjuhë etj.

Italisht: *essere carne cunghia*-janë si mishi me thoin, janë mish dhe gjak; *quei due sono pane e cacao* (fj. p. fj: janë si buka me çokokremin) janë si mollë e pandarë, si të lidhur në një kërthizë; *tale padre tale figlio*-bëmë baba të të ngjaj; *e suo padre nato e sputato*- i ka prerë kokën të atit, sikur e ka nxjerrë i ati nga hundët; *i figlioli dei gatti pigliano i topi* (fj. p. fj: macet e vogla (kotelet) zënë minj); dardha nën dardhë do të bjerë; *chi si somiglia si piglia* (fj. p. fj: ata që ngjasin rrinë bashkë, lidhen) gjeti tenxherja kapakun; *sonno tutti della medesima tacca* (fj. p. fj: janë bërë nga i njëjti dru) janë të një kallëpi; *essere una coppia e un paio* (fj. p. fj: janë sa një palë dhe një kopje) ka gjetur tenxherja kapakun etj.

### **6.4.3. Probleme, shqetësime, vështirësi, gjendje e rëndë ekonomike**

Angl.: *sth is hard/difficult to swallow* (nuk e kapërdij/kapërcej dot/ kafshatë e madhe); *sth is like pulling teeth*-si një dhëmb që hiqet; *sth is not bad of roses*- jeta nuk është fushë me lule; *sth is not picnic*- jeta nuk është piknik; *have your back to/against the wall*- të jesh i vënë me shpatulla pas murit; *not to have a bean*- nuk kam asnjë grosh; *to be/feel like a fish without water*- ngelem si peshku pa ujë (në zall); *between the devil and the deep sea* (fj. p. fj: midis djallit dhe ujit të thellë) mes dy zjarrve; *tighten your belt*-të shtërngosh rripin; *it's a dog's life*-jetë qeni; *put your head in the lion's mouth* (fj. p. fj: ta vesh kokën në gojën e luanit) të jesh në gojë të ujkut; *fish in troubled waters*-peshkoj në ujëra të turbullta; *to go through fire and water* (fj. p. fj: të ecësh/ të shkosh përmes ujit dhe zjarrit) të heqësh të zitë e ullirit; *get into deep waters* (fj. p. fj: të jesh në ujëra të thella) të jesh në hall të madh; *get into a mess*- të futesh në telashe; *keep the pot boiling* (fj. p. fj: vazhdoj ta mbaj vorbën në zjarr duke u zjerrë) fitoj sa për të mbajtur shpirtin gjallë etj.

Italisht: *aver le tasche asciutte* (fj. p. fj: t'i kesh xhepat e thatë) i kam xhepat e shpuar; *non avere il becco di un quattrino*-s'kam asnjë dyshkë, s'kam asnjë grosh; *avere le mani buchate*-jam dorëshpuar, e kam dorën me vrimë; *ridursi alla candela/essere alla candela* (fj. p. fj: të të zvogëlohet qiriri) jam trokë fare, jam si mos më keq; *essere povero in canna*- është pykë, është rrasë në diell, fakir fukara; *soffrire come un danato* (fj. p. fj: të vuash si njëi dënuar) heq të zitë e ullirit; *suonare a messa con gli embrici*- është i këputur fare nga gjendja ekonomike; *essere a terra*- jam përtokë, jam i dërrmuar; *navigare in basse acque* (fj. p. fj: notoj në ujëra të cekëta) noton në ujëra të turbullta etj.

#### **6.4.4. Lehtësi**

Angl.: *as easy as falling off a log*- si të biesh nga një copë dru; *as easy as pie* (fj. p. fj: e lehtë si të bësh byrek) si buka që ha; *be a breeze*- si një puhizë e lehtë; *be a piece of cake* (fj. p. fj:si një copë tortë/kek) si bukë me djathë; *be home and dry* (fj. p. fj: të jesh në shtëpi dhe i thatë/i terur) si në shtëpinë tënde; *sb. can do sth. in his/her sleep*-e bën një gjë me sy mbyllur/duke fjetur; *sb can do sth. with one hand*- e bën me një dorë; *sb. takes to sth like a duck to water*-si rosa në ujë etj.

Italisht: *e come un bicchier d'aqua* (fj. p. fj:si një gotë ujë) si bukë me djathë; *e come bere un' bicchier d'acqua* (është si të pish një gotë ujë)e bëj me sy mbyllur etj.

#### **6.4.5. Dallime të sjelljes dhe karakterit**

Angl.: *another kettle of fish*-është botë më vete; *a new ball game*-si topi i parë i një ndeshjeje; *be like chalk and cheese* (fj. p. fj: të jesh si djathi dhe shkumësi) të jesh si dita me natën; *a different animal*- një lloj tjetër kafshe; *oil and water*- të jesh si uji dhe vaji; *be poles apart* (fj. p. fj: të jesh në pole të kundërta) hane Shan, hane Bagdat; *be worlds apart*- të jetosh në botë të ndryshme; *go/swim against the current*- të ecësh kundër rrymës; *march to a different drum*- t'i lozësh këmbët sipas një daulleje tjetër; *a rare bird*- zog i rrallë; *stand out like a sore thumb*- të rrish si gishti i madh i vvarë; *like an apple to an oyster* (fj. p. fj: të jesh si një mollë për një stridhe (goce deti), s'piqen gjëkund etj.

Italisht: *essere come l'aqua e il fuoco*- janë si uji me zjarrin; *tanti paesi, tante usate*-fshat e zanat; *quante teste, tanti cervelli* (fj. p. fj: mendje mendje, sa kokë aq edhe mendje).

#### **6.4.6. Paditura, moskokëçarrja, papjekuria, nxitimi**

Angl.: *put the cart before the horse*- të vesh karrocën para kalit; *beat the air/the wind* (fj. p. fj.: rrah/godas erën) rrah ujë në havan; *build castles in Spain* (fj. p. fj: ndërtoj kështjella në Spanjë) ndërtoj kështjella në ajër/rërë; *cast pearls before swine to* (fj. p. fj: t'i vësh derrit perla (margaritarë) përpara), di dhia ç'është tagjia; *cut off one's nose to spite one's face* (fj. p. fj: të presësh hundën për të larë hakun e fytyrës, për t'u hakmarrë për fytyrën) në vend të vësh



vetulla nxjerr sytë; *drop a brick to-* hedh një tullë, hedh një fjalë pa vend; *fight with one's own shadow* (fj. p. fj: lufton me hijen e vet) luftoj me mullinjtë e erës; *if the sky falls we will catch larks* (fj. p. fj: nëse bie/rrëzohet qielli në tokë do të kapim lauresha) kur të bëhet deti kos, kur të bëjë gjeli ve; *first catch your hare then cook him* (fj. p. fj: në fillim kape lepurin, pastaj gatuaje), i bëj hesapet pa hanxhinë/ peshku në det tiganin në zjarr; *cost the earth* (fj. p. fj: të të kushtojë sa toka) të të kushtojë sa bishti koka; *cost a pretty penny to-* kushton një djall e gjysmë; *ride two horses at the same time* (fj. p. fj: ngas dy kuaj në të njëjtën kohë) mbaj dy kunguj në një sqetull; *count one's chickens before they are hatched* (fj. p. fj: numëroj pulat para se të çelin /të dalin nga veza) i bëj hesapet pa hanxhinë; *drop in the bucket(ocean)-* një pikë ujë në oqean; *end in smoke-* në tym; *flog a dead horse* (fj. p. fj: fshikulloj një kalë të ngordhur) rrah ujin në havan, bëj diçka në tym; *can't say boo to a goose* (fj. p. fj: nuk i thotë dot yyy një pate) nuk e nxjerr qimen nga qulli; *catch the wind in a net* (fj. p. fj: kap erën me rrjetë) mbaj ujë me shoshë etj.

Italisht: *abbaiare alla luna/al vento* (fj. p. fj: t'i flasësh hënës, erës) flas kot, bërtas në vesh të shurdhët; *fare un buco nell' acqua-* bëj një vërë në ujë; *portare acqua quando la casa e bruciata* (fj. p. fj: të sjellësh ujë pasi është djegur shtëpia) si kofini pas të vjelit; *arrivare quando si spengono le candele* (fj. p. fj: të vish pasi janë shuar qirinjtë) si kofini pas të vjelit; *arrivare a spogliare il prete* (fj. p. fj: të vish të zhveshësh priftin) si kofini pas të vjelit; *fuggir l'acqua sotto le grondaie* (fj. p. fj: të të ikë (bjerë) uji poshtë ulluqeve) kërkuj të vë vetulla dhe nxjerr sytë; *non avere ne arte ne parte* (fj. p. fj: të mos kesh as talent, as një pjesë ku të luash) nuk di nga lidhet gomari, nuk di si lidhen ushkurët; *essere come l'asino al suoana della lira* (fj. p. fj: të jesh si kërraçi (gomari) para lirave (parave), ku di gomari ç'është bari, ku di dhija ç'është tagjia; *mettere il carro davanti ai buoi-* vë karrocën para qeve, i hip gomarit së prapi, del si kërraçi para gomarit; *fare i conti senza l'oste-i* bëj heaspet pa hanxhinë; *cercare un ago nel pagliaio-*kërkuj gjilpërën në kashtë; *fare come quello che cercava l'asino e c'era sopra-* gomar hipur gomar kërkon; *aspettare che cali dall cielo/aspetare che cali il panierino dal cielo-* pres të më bjerë nga qielli; *portare acqua nell mare-*shpie ujë në det; shpie dru në pyll; *non cavare un ragno da un buco* (fj. p. fj: nuk di të nxjerrë një merimangë nga vrima) nuk e nxjerr qimen nga qulli, nuk di t'i japë ujë gomarit, nuk di të lidhë poturet; *per un punto martin perse la cappa-* për një gozhdë humbet patkoi; *fare dei castelli in Spagna* (fj. p. fj: bëj kështjella në Spanjë) shoh ëndrra në diell, me sy

hapur, bëj petulla me ujë, ngre kështjella në erë, ngre kodra mbi det; *buttare il denaro a due mani* (fj. p. fj: hedh/flak paratë me të dyja duart) i bën rrush e kumbulla; *non dire quattro fincle non l'hai nel sacco* (fj. p. fj: mos thuaj katër nëse nuk i ke në thes) mos e shit lëkurën e ariut pa e vrarë, peshku në det, tigani në zjarr; *spendere e spender* -i bëj rrush e kumbulla

#### **6.4.7. Vdekja**

Angl. : *emit the last breath*-jap frymën e fundit; *end one's days*-i mbarojnë ditët; *to pay the debt of nature*-paguaj/laj borxhet; *join the majority*-shkoj me të shumtët; *to answer the last call*-përgjigjem telefonatës së fundit; *a blissful reward*-shpërblim i lumtur; *in the world of unending glory*-shkoj në botën e lumturisë pa kufi; *enjoyment of the fruits of life*-shijoj frytet e jetës; *go west*-shkoj në perëndim/ iu mbaruan ditët; *be asleep forever*-fle përgjithmonë; *to be brought to one's long home*-shkoj në banesën e fundit; *return to dust*-bëhem/kthehem në pluhur; *to go to one's own place*-të shkosh aty ku të takon; *bit the dust*-ha dhë; *turn their toes up*- kthej patkonjtë nga dielli; *have one foot in the grave*- të jesh me një këmbë në varr; *dig your own grave*- i hap varrin vetes/i bën gropën vetes; *kick the bucket*-vdes.

Italisht: *andar a dare calci al vento* (fj. p. fj: të shkosh të gjuash me shkelma erën) e drodhi këmbën; *dare calci all'aria* (fj. p. fj: e gjuaj erën/ajrin me shkelma)i kthen patkonjtë nga dielli; *dare calci al rovaio*-tund këmbët; *battere l'ultima capata*-jap frymën e fundit; *essere in fin di vita*- po jep shpirt; *ha finito i propri giorni*- iu mbaruan ditët etj.

#### **6.4.8. Tipare të karakterit, pabesia, gënjeshtër, mosmirënjohja**

Angl.: *cry one eye and laugh with another* (fj. p. fj: qaj me njërin sy dhe qesh me tjetrin) jam me dy faqe/mësallë me dy faqe; *elbow one's way* (fj. p. fj: e gjuaj me bërryla dikë) i vë shkopinj nën rrota (dikujt); *pull the wool over somebody's eyes* (fj. p. fj: i hedh lesh syve) i hedh hi syve; *run with the hare and hunt with the hounds* (fj. p. fj: të vraposh me lepurin dhe të gjuash me zagarin) ha me dy lugë, lëpij në dy sahanë; *pour oil out on the flames*- i hedh benzinë zjarrit; *see how the cat jumps to* (fj. p. fj: të presësh/të shohësh nga kërcen macja) kthej gunën nga fryn era; *see how the wind blows to* (fj. p. fj: shikoj se nga

fryn era) kthej gunën nga fryn era; *set fire to something-* i vë zjarrin diçkaje; *stick to somebody like a bug, burr, limpet, leech-*i bëhem rrodhe, i ngjitem si rriqër, si balta pas këpucës.

Italisht: *gettare acqua sul fuoco-* i hedh benzinë zjarrit; *levare le castagne dal fuoco con la zampa del gatto-*nxjerr gështenjat nga zjarri me duart e tjetrit, kur ke mashën pse të djegësh duart; *fare di una mosca un elefante* (fj. p. fj: e bëj mizën elefant) e bëj qimen tra, e bëj mizën buall; *avere una faccio di bronzo* (fj. p. fj: të kesh fytyrë prej bronzi) i është bërë lëkura shollë; *fare il buono e il cattivo tempo* (fj. p. fj: të bësh vetë edhe motin e mirë edhe të keq) jam vetë zot, vetë shkop, kam dhe gurin dhe arën; *avere il fiele nela lingua-* e ka gjuhën zeher, i ka fjalët farmak, është gjuhë nepërkë; *sedere su due portrone-*të ulesh/të zësh vend në dy karrige, ha në dy sahanë; *sputare nel piatto in cui si mangia* (fj. p. fj: të pështysh në pjatën ku ha) ha bukën dhe përmbys kupën; *tenere il piede su due staffe-* ha me dy lugë; *avere la faccia tosta* (fj. p. fj: ta kesh fytyrën të ashpër) i është bërë faqja shollë; *fare di ogni fuscello una trave* (fj. p. fj: ta bësh fijen e kashtës tra) e bëj qimen tra, e bëj mizën buall.

## **6.5. Përqsasje për nga forma e brendshme e idiomave të shqipes me bullgarishten<sup>184</sup>**

Përfshirja e këtij sythi në punim synon të bëjë një përqsasje të ndërtimeve idiomatike të bullgarishtes me shqipen, për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet lidhur me formën e brendshme të tyre. Këto mund t'i përmbledhim në dy grupe:

**a.** Njësi frazeologjike që kanë ndryshime në shprehjen e formës së brendshme, si: *t'i biesh murit me kokë/ s'i bihet murit me kokë-*чукам си главата с два камъка (fj. p. fj: godas kokën me dy gurë); *më vjen në majë të hundës-*душата ми е под носа (fj. p. fj: shpirtin e kam nën hundë); *i luan mendja/ lajthit-*мръднал с ума си (fj. p. fj: luan me mendjen); *e bëj peshk-*направи на кайма (някого) (fj. p. fj: e bëj kajmak dikë); *e humbas toruan, rrjedh nga trutë-*загуби и ума и дума (fj. p. fj: humbi mendje e fjalë); *jeta nuk është fushë me lule-*обещавам златни планини (fj. p. fj: premtoj male floriri); *të heqësh të zitë e ullirit-*мина през сито и решето (fj. p. fj: kalon nëpër sitë e shoshë); *është pykë/ rrasë në diell, fakir fukara-*като арнаутски пишов (fj. p. fj: si pistoletë arnauti); *si bukë me djathë-*като хляб и

---

<sup>184</sup> Për hartimin e këtij sythit na ka ndihmuar prof. dr. Dhimitri Bello, për çka autorja i është mirënjohëse.

сол (fj. p. fj: si bukë e kripë); *di dhia ç'është tagjia*-разбира ти свиня от кладенчова вода (fj. p. fj: kupton derri nga uji i pusit); *kur të bëhet deti kos, kur të bëjë gjeli vezë*-има с шепа да вземаш (fj. p. fj: ka të marrësh me grushte); *bëj një vërë në ujë*-направи дупка в морето (fj. p. fj: bën vrimë në det); *si kofini pas të vjelit*-след дъжд качулка (fj. p. fj: pas shiut kapele); *i bëj rrush e kumbulla* - прахоса богатството (fj. p. fj: pluhuros pasurinë); *i kthej patkonjtë nga dielli*-обърна с краката на горе (fj. p. fj: kthej me këmbë përjetë); *ha dhé* - напълвам хендека (fj. p. fj: mbush hendekun); *e drodhi këmbën* - хвърлям петалата (fj. p. fj: hedh patkojtë); *e bëj qimen tra, e bëj mizën buall*-правя от влакно руно (кросно) (fj. p. fj: bën nga qimja turashkë ); *shtrij këmbët sa kam jorganin*-протягам си краката според чергата (fj. p. fj: shtrij këmbët sipas çorgës) etj.

**b.** Njësi frazeologjike që e shprehin njëlloj formën e tyre të brendshme, si: *më hipën gjaku në kokë*- качи ми се кръвта в главата (më hipën gjaku në kokë); *të të lëshojë koka tym, të të marrë koka zjarr*-запали ми се огън в главата (fj. p. fj: m'u ndez zjarr në kokë); *më kanë hipur kacabujtë*-влизат ми рогатите (fj. p. fj: më hyjnë brirët (për djallin); *ia bëj kurrizin më të butë se barkun*-чупя костите (fj. p. fj: ia thyej kockat); *të të luajë mendja e kokës, të të pëlcasë koka*-мръднал с ума си (fj. p. fj: lojti mendjen); *i lëshojnë sytë xixa nga inati*-искри искачат от очите му (fj. p. fj: xixa më kërcëjnë nga sytë); *i del shkumë nga goja, turfullon/shkumëzon nga inati*-пяна излиза от устата (fj. p. fj: shkumë del nga goja); *si dy pika uji*-като две капки вода; *janë si mishi me thoin, janë mish dhe gjak*-нокът и месо (fj. p. fj: thua e mish); *gjeti tenxherja karakun*-търкунала се тенжерата, та си намерила похлупака (u grotullis tenxherja e gjeti karakun); *janë të një kallëpi*-от един калъп; *si një dhëmb që hiqet* (përkthim fjalë për fjalë)- тегля един зъб (heq një dhëmb); *të jesh vënë me shpatulla pas murit*-притискам до стената (fj. p. fj: shtrëngoј pas murit); *nuk kam asnjë grosh*-не давам ни пукнат грош (fj. p. fj: nuk jap as grosh të plasur); *ngelem si peshku pa ujë*-като риба на сухо (si peshku në të thatë); *mes dy zjarreve*-между два огъня; *të shtërngosh rripin*-стягам каиша; *jetë qeni*-живея като куче по стряха (fj. p. fj: jetoј si qeni nën strehë); *të jesh në gojë të ujkut* -влизам на вълка в устата (hyj në gojë të ujkut); *peshkoј në ujëra të turbullta*-хващам риба в мътна вода (fj. p. fj: zë peshk në ujë të turbullt); *fitoј sa për të mbajtur shpirtin gjallë*-колкото да не умрем от глад (fj. p. fj: sa mos vdes nga uria); *i kam xhepat e shpuar*-продран джоб (fj. p. fj: xhep i rrjepur); *rrah ujë në havan*-бия вода на хаван; *ndërtoј kështjella në ajër/rërë*-строя на пясък (ndërtoј në rërë); *në vend të vësh*

*vetulla nxjerr* sytë-вместо да направа вежди, изваждам очи (fj. p. fj: në vend të bëj vetullat, nxjerr sy); *kushton një djall e gjysmë*-дьявол и половина (djall e gjysmë); *mbaj dy kunguj në një sqetull*-нося две дини под една мишница (mbaj dy kunguj në një sqetull); *i bëj hesapet pa hanxhinë*-права си сметката и без ханджията (bëj llogarinë pa hanxhinë); *rrah ujë në havan, bëj diçka në tym*-бия водата в хаван (rrah ujin në havan); *mbaj ujë me shoshë*-нося с решето вода (shpie ujë me shoshë); *flas kot, bërtas në vesh të shurdhët*-прави се на глух (fj. p. fj: bëhet shurdh); *i vë shkopinj nën rrota*-слагам прът в колелото (fj. p. fj: fut purtekë në rrotë); *i hedh hi syve*-хвърля пепел в очи (fj. p. fj: hedh hi në sy); *nxjerr gështenjat nga zjarri me duart e tjetrit*; *kur ke mashën pse të djegësh duart*-изваждам къстените от огъня с чужди ръце (fj. p. fj: nxjerr gështenjat nga zjarri me duar të huaja); *i është bërë lëkura shollë*-има дебела кожа (fj. p. fj: ka lëkurë të trashë); *bie nga shiu në breshër*-бяга от дъжд сполетя го град (fj. p. fj: ikën nga shiu e mbyt breshëri); *rri /eci si mbi gjemba*-като на тръни съм (jam si në gjemba) etj.

Siç shihet edhe nga shembujt e përqsur, shumica e njësive frazeologjike formën e brendshme e shenjojnë njëllor, sepse, megjithë dallimet e mëdha ndërmjet shqipes dhe gjuhëve sllave, “dëshmojnë afritë që u krijuan në bashkëjetesën e gjatë historike, përputhjet në mendësinë e psikologjinë popullore, ngjashmëritë etno-kulturore etj.”<sup>185</sup>


## **6.6. Forma e brendshme e vargjeve sinonimike idiomatike që shprehin të njëjtin koncept**

Në vazhdim të analizës së formës së brendshme të idiomave, duke hulumtuar në *Fjalorin Frazeologjik të Gjuhës Shqipe* të J. Thomait, vumë re se një varg sinonimesh idiomatike mund të shprehin të njëjtin koncept, ndaj dhe mund t’i përmbledhim sipas fushave të ndryshme konceptore<sup>186</sup>. Për shembull, koncepti për çmendurinë, lajthitjen, budallallëkun etj., mund të shenjohet me një sërë njësish frazeologjike që dallojnë për nga forma e tyre e brendshme: *i ka luajtur çikriku* “nuk është në rregull nga mendtë, ka shkarë”; *i ka ikur mëtkë* “ka luajtur mendsh”; *është dy miza e një grerë* “vepron pa logjikë”; *ka një dërrasë (ca dërrasa) mangët, i mungon një dërrasë, i ka krisur një dërrasë* “është budalla”, *ka një hatull*

<sup>185</sup> *Fjalor frazeologjik ballkanik*, Dituria 1999, Tiranë, f. 5.

<sup>186</sup> Shih për këtë dhe Chollet I & Robert J., *Précis Les expressions idiomatiques*, CLE, 2008.

*mangët, s'është në terezi, s'është në liq, s'është tamam nga koka, i janë liruar rrathët, e kanë lëshuar rrathët, iu zbërthyen dërrasat, iu liruan vidhat, i ka marrë koka erë, i ka hipur në kokë etj.*



**çmenduria/lajthitja/kokëkrisja**

i ka luajtur çikriku, i ka ikur mëtkë, është dy miza e një grerë, ka një dërrasë (ca dërrasa) mangët, i mungon një dërrasë, i kakrisur një dërrasë, ka një hatull mangët, s'është në terezi, s'është në liq, s'është tamam nga koka, i janë liruar rrathët, e kanë lëshuar rrathët, iu zbërthyen dërrasat, iu liruan vidhat, i ka marrë koka erë, i ka hipur në kokë.

**dënimi, dhuna**

ia bëj samarin copë, ia bëj kurrizin më të butë se barkun, e bëri çëço, e bëri nuse me tel, i dha një dajak të mirë, e bëri daulle, i hoqi një dredhë, i dha (i hoqi) një dru (një dajak, një hu) të mirë, e shtroi (e shqepi, e zhdëpi, e ngordhi, e kalbi, e dendi) në dru, i theu dhëmbët, i nxori shkumë nga goja, e bëri për lezmë, e bëri për dyshek, i theu dhëmbët (brinjët)

**djallëzia/sinqeriteti/të qenët i mirë**

i ka hyrë djalli në bark, e ka djallin (shejtanin) në bark, ka të paudhin në bark, i ka hyrë dreqi në bark, e ka maçokun në bark, mban draprin në thes e majën jashtë, bën dredha, dredha e djallit, dhelprë plakë (e vjetër), e ka dhelprën në bark, dhuratë e Perëndisë, ethe e butë, thëngjill i mbuluar, limë e butë, i bie drejt, s'e gjen në të gjithë botën, s'e ka një të dytë, nuk i gjendet shoku, s'i gjendet një i dytë

**dinjiteti/përlësia**

lëpin putrën; i lëpin (i puth) çizmet, i puth këmbët, i lëpin bythën, i bëhet bajgë, i bëhet cergë, lëpin çanakët

**dobësia/shëndoshja**

u bë cironkë, u bë kockë e lëkurë, u bë çengel, u bë cingaridhe, u bë kërrabë, cironkë e tharë në tym, është bërë cipë e kockë (e kokallë), e ka qafën me një dell, është bërë për ta lidhur në djep, u bë një dorë, u bë një grusht, u bë dërrasë, nuk e nxë dera

**fjalëkotësia**

çan dërrasa, çan dokrra, çan ashra, flet në erë, bluan egjër, grin lakra, grin sallatë, i bie legenit, rreh ujë në havan, llogje Kavaje, flet kodra pas bregut

**gjëra të pamundura**

(kërkon) dardha në shënëdre (në dimër), (kërkon) dardha në boriga, (kërkon) rrush në shënëdre, (kërkon) thana në shënëdre, (kërkon) qiçra në hell, (kërkon) kallëz në dëborë, kërkuj detin me shkop, kërkon të kapë erën

**hutimi, ngatërresa**

ia bëj mendjen çarçaf, e ka mendjen çarçaf, është me mendje të prishur, ia bëj mendjen çorbë, ia bëj mendjen çorap, ia bëj kokën (mendjen) dhallë, m'u bë koka tym, e kam kokën çorbë

**inati, zemërimi**

i kërcëu damari, i kërcëu delli, iu frynë tëmthat, e zuri rrembi, i hipën (i kërcyen) kacabujtë, i hipi gjaku në kokë, i hipën (i kërcyen) djajtë, më shtiu djajtë, më ngriti nervat, i hipën (i kërcyen) dreqërit, ha dheun me dhëmbë, ha veten me dhëmbë



**kokëfortësia**

e ka kokën me cepa, e ka kokën me gunga, e ka kokën gur, e ka kokën gdhe, e ka kokën cangë, nuk i bën koka def, nuk ia bën syri tërr, nuk ia bën syri bef, pëlçet edhe derrin

**kënaqësia/pakënaqësia**

i qeshi buza, i ndriti fytyra; i erdhi thartë, përveshi buzët, mblodhi (thartoi, shtrembëroi) buzët (turingjtë), s'i qesh buza, më plasi buza, i vari (i lëshoi) buzët një pëllëmbë

**kurrë, asnjëherë**

kur të pëllasë gomari mbi çati, kur të shijë Hajdini urovë, kur të qethen viçat, në lëmë të duhanit, kur të bëjë qarri arra, kur të hipë derri në fik, kur të bëhen dy ditë bashkë, kur të bëjë larushku rrush, kur të pjellë gjeli (këndesi), kur të pjellë mushka, kur të pjellë kau, kur të hipë gomari në fik, kur të flasin lopët, kur të bjerë shi i kuq, kur të qethen dhentë e kuqe, kur të bashkohet qielli me tokën

**kokëkrisja, veprime të pamatura**

të bëhet ç'të bëhet, tym të bëhet, tym të dalë, njëra të bëhet, (edhe sikur) bota të përmbysset, (edhe sikur) qielli të përmbysset, (sikur) qeni qepën ta hajë, ku rrafsha mos u vrafsha, gjysma e mijës pesëqind, jap hop, ja top, ja shyt ja fyt, tafti bafti, ku ta nxjerrë trapi

**kot, për asgjë të rëndësishme**

për bishtin e dhelprës e lagu s'e lagu (bishtin dhelpra), për bishtin e laraskës, për të bardhat e laraskës, për pesë para spec, për mustaqet e Çelos, për mjekrën e qoses, për një lëkurë lepur, për mjekrën e qoses, për një kokërr hudhër

**kopracia, të qenët dorështrënguar, kursimi**

e rrjep morrin nga bishti, nxjerr dhjamë nga pleshti, e ha preshin nga bishti, s'ka çelës që i bie, e shtrëngoj (e mbledh, e rruadh) dorën, e bëj groshin kacidhe, e bën një në dy, pret dru e shet ashkla, nxjerr vaj nga guri, nxjerr dhjamë nga guri, nxjerr mjaltë nga guri, nxjerr dy lëkurë nga një berr (nga një dele), qeth shelegët, qeth edhat, mjel edhe morrin, e vë (e shtie) morrin në hell, e mbledh (e rruadh) dorën, e shtrëngoj dorën, mbaj dorën, shtrëngoj rripin

**lodhja, rraskapitja, stërmundimi**

Më ra bretku, më ranë (m'u këputën) kryqet, më ranë këllqet, m'u këput kurrizi, më ranë krahët copë, më ranë kockat, më ra ëngla, më ra lëkurë, më ranë thonjtë, më ra mekthi, rashë copë, m'u këputën brinjët, i shkuar (i shkelur) në dërstilë, çan dërrasa pa pykë, më dolën djersët e vdekjes, derdh djersë, më kullon djersa, e lag me djersë, më shkuan shtatë palë djersë

**lidhja e ngushtë**

janë arkë e dry, janë si mishi me thoin, është bukë e djathë me dikë, u bë bark e shpinë, hanë në një çanak, pjerdhin në një kungull, janë bythë e brekë

**mashtrimi/tinëzia**

e hëngri sapunin për djathë, e hëngri shapin për sheqer, e hëngri kilen për okë, e mori arëzën për bletë, t'i shet golgat për arra, të jep ujë me shpinë të dorë, të shpie në çezmë e s'të jep ujë, ta shet sapunin për djathë, të vë në bisht të lugës, ta shet gjizën për djathë, ta shet hirrën (shëllirën) për qumësht, ta shet ujin për raki, ta shet ujin(e posit) për verë, ta shet bakrin për ar, t'i shet goglat për arra, ta shet kilen për okë, të hedh hi syve, punon nën dhë, punon nën rrogoz, punon nën gunë, punon prapa krahëve

**maturia**

nuk shkel në dërrasë (në dhogë) të kalbur, e mat shtatë herë dhe e pret një herë, nuk hipën në degë të hollë, nuk futet (nuk hyn) në ato thekra

**marrëdhëniet mes njerëzve**

shkojnë si eshka me urorin (me masatin), shkojnë si macja me miun, shkojnë si qeni me macen

**mendjemadhësia**

vret degë më degë, shet mend, shet dëngla, i duket hunda dyfek, dhi e zgjebosur bishtin përpjetë, edhe qeros edhe fodull, breshri e rreh e hunda me majë

**mendjelehtësia, verbëria**

është si era e malit, ia ka marrë mendtë era, e ka mendjen veri, i kanë zënë sytë cergë, i janë veshur sytë, i kanë zënë sytë perde, ia ka merrë mendtë era

**mërzitja**

u bëra derr, m'u bë shpirti derr, derr në kotec

**ngutja për të pamundurën**

e nget arën me tre qe, merr nga tri sërë

**nxitja për të keqen, grindjen**

i hedh benzinë (vajgur) zjarrit, fut zjarrin në kashtë, i fryn zjarrit, i hedh dru zjarrit, fut flakën, i fryn farkës, shtyn (ngacmon, shkrep) urët, luan (trazon, shtyn, shkrep, ngacmon) urët, lag drutë me benzinë

**moskokëçarja**

aq më bën, nuk çaj kokën, nuk e prish gjakun (terezinë), s'më djersin veshi, s'më lagen drutë, nuk më plasi barku, nuk më ftohen fasulet, nuk më prishet gjiza, nuk më ftohet byreku, nuk më bëhet vonë, nuk më ftohet pilafi, fle majë dëllinjës

**mosbindja**

nuk ha arsye, nuk i mbushet mendja (koka), s'ha (s'merr) pykë, s'lëshon ashkël, s'lidhet as për bishti e as për krye, s'ha të gdhendur bukë e ti me gurë, i ka dhëmbët me bukën time

**ndershmëria/pandershmëria,  
naturëësia**

kam cipë, kam një fytyrë, kam gjak në fytyrë;e hëngri turpin me bukë, i ka plasur peta e ballit, i ka plasur damari i ballit, i ka plasur perdja, nuk ka perde, s'ka ujë në sy, i doli huri në majë të kokës, i është bërë faqja rrogoz, i doli boja, i plasi cipa, as skuqet e as zverdhet, nuk e ka për gjë, e ka fytyrën shtatë hektarë, u bë cergë, u bë leckë

**njohja**

e njoh me dhëmbë e dhëmballë, e njoh sa dhëmbë e dhëmballë ka në gojë, e njoh me rrënjë e me dhëmballë, ia di zorrët e barkut, e njoh me rrënjë e me degë, ia di fundin e barkut, ia di sa lugë ka në shportë, i kam marrë erë në qafë

**pështjellimi mendor**

ia bëj kokën (mendjen) dhallë, ia prish mendjen, ia bëj mendjen (kokën) çorbë, ia bëj mendjen hirrë, ia bëj kokën (mendjen) bozë, ia bëj kokën (mendjen) tym, ia bëj kokën (mendjen) përshesh, ia bëj kokën (mendjen) sallatë, ia bëj mendjen çorap, ia bëj kokën daulle, ia bëj mendjen mulli, ia bëj mendjen livadh, ia bëj mendjen çarçaf



**pragvdekja**

i ka ditët të numëruara, i ka të pakta bukët, nuk pjek dy bukë në një hi, është në buzë të varrit (të gropës), është me një këmbë në varr, është në fill të vdekjes, është larë e shkuar, i erdhi fundi, e hëngri çairin, e hëngri livadhin, e hëngri tagjinë, i perëndoi ylli, e hëngri (e mbaroi) çanakun, numëron ditët

**përsëritja, monotonia**

bathë bathë po një kokërr (një koqe), i bie po atij avazi, i bie jongarit në një tel, i bie fyellit në një vrimë, i bie po atij teli, i bie daulles në një vend

**rrugëzgjdhja, rrugëdalja**

ia gjej anën, ia gjej vjegën (veglën), ia gjej rrëfanën, ia bëj rrethin, ia gjeti çaren, ia gjeti barin (ilaçin), ia gjeti melhemin, ia gjeti çelësin

**stërzmadhimi, e pamundura**

e bën priftin (dhespotin, hoxhën) me barrë, e bën kaun me viç, e mbars mushkën, e bën mizën (pleshtin) buall, e bën qimen tra, e bën vezën deve, i vë pleshtit fre (zile), e bën trarin bluashka

**tallja, qesëndia**

e vuri në bisht të lahutës, e vuri në lojë, e vuri në shoshë, e vuri në sitë e në shoshë, e vuri në qese të duhanit, e luan nëpër gishta, luan arushë (me dikë), i vunë dajren, i varën (i vunë) teneqenë, i vunë daullen, e zunë me daulle

**trimëria-frika**

të ha në dritë të syrit, ecën mbi driza, mban ferra lakuriq, është një burrë e gjysmë; burrë me çika, e ha hekurin me dhëmbë, i mbushi brekët, s'ia mban bytha

**thënia e tërthortë**

i bie derës të dëgjojë qilari (penxherja, derriçka), i bie pragut të dëgjojë dera, godit strallin të marrë eshka, rreh (vret) gjetkë

**varfëria/bollëku**

të pafsha në dyert e botës, mbeti me gisht në gojë, mbeti me një grusht miza, ra nga dynjallëku, jam (mbeta) pa një dysh në xhep, jam fishek, i vijnë dhentë pa çoban, i vjen e mira në derë, i pjell edhe gjeli, e gjen e mira vetë, i zuri bishti dhjamë.



**vdekja**


shkoi (vajti) në atë botë (në atë dynja, në botën tjetër), ndërroi jetë, u nda nga jeta, shkoi me të shumtët, e bëri sheshin breg, hëngri botë, shkoi për të bërë vorba, shkoi për të bërë vegsha, shkoi për të bërë ponica, i bëri këmbët baraz, i nderu (i bëri) këmbët çift, i mbledhi këmbët, ra me këmbë nga dielli, i bëri këmbët bigë, i mbiu bari një pëllëmbë, këputi dellin e qafës, e mbylli derën, e mbylli shtëpinë, i vuri (i hodhi) rezen shtëpisë (derës), e thau vatrën, i ktheu patkonjtë (këmbët) nga dielli, mbylli sytë, perëndoi (fali) sytë, e ndjeu Perëndia, i ktheu sytë nga qielli, iu shuan (iu fikën) sytë, zbardhi sytë, shkoi si qeni në vreshtë, shkoi (vajti) në atë dynja, shkoi (vajti) në atë botë, hëngri dhe, hëngri baltë, kafshoi (zuri, hëngri) gjuhën, theu gërmicën, të ngrëntë (të përpiftë) dheu, i ha shpina dhë, iu hap dheu (nën) këmbë, hyri në dhe.

**vjedhja/rushfeti/mitmarrja**

ka dorë, e ka dorën (krahun) të gjatë, ka thonj të gjatë, është me thonj, e ka thoin të keq, i ka lyer (i ka përlyer) duart, i ka lyer buzët, e ka ngjyer gishtin, ka gisht, ia leu dorën, ia njomi (ia lagu) dorën, ia leu rrotën

**vrasja**

ia preu ditën, e shpuri me të shumtët, i dha gjysmën e lekut, ia shkurtoi jetën, ia preu jetën, ia hodhi patkonjtë në erë, ia hodhi trutë në erë, ia hodhi leckat në erë



### **6.7. Çështje të formës së brendshme te kalket frazeologjike**

Siç dihet, kalket frazeologjike janë përkthime fjalë për fjalë nga gjuha burimore dhe gjenden si të tilla në shumë gjuhë dhe përdoren gjithandej në ligjërimin e shkruar për arsye të përmbajtjes së ngjeshur si “esenca” e lëndëve të ndryshme, që ka dalë nga “kullimi” i

ngjarjeve historike, i ndodhive të fabulave e të legjendave, i mendimeve dhe i veprimeve të moralshme e të pamoralshme, i përfundimeve prekëse në jetë e në legjendë.<sup>187</sup> Këto njësi bashkojnë përvojat historike, kulturore, psikologjike etj.<sup>188</sup>. Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, shprehjet e huazuara nuk duhet të vështrohen si “mish i huaj” në trupin e shqipes, por pjesë e saj si gjuhë kulture, si shenjë e marrëdhënieve të ndërsjellëta në kulturat e popujve të ndryshëm dhe si shprehje konkrete e përngritjes kulturore të popullit shqiptar<sup>189</sup>.

Në qoftë se te njësitë frazeologjike dhe shprehjeve të tjera idiomatike, në një pjesë të madhe të kësaj lënde gjuhësore, kundrohen ato veçori a tipare që i bëjnë të veçanta nga një gjuhë në tjetrën, çka i bën ato të papërkthyeshme fjalë për fjalë, te kalket frazeologjike mund të flitet për konceptin e universaleve në gjuhë, ngaqë kjo “materie” gjuhësore gjendet njëlloj, në ndërtim dhe në kuptim, në shumicën e gjuhëve, pavarësisht nga përdorimet dhe transformimet strukturore dhe semantike në gjuhë të ndryshme.

Lidhur me formën e brendshme të kalkeve frazeologjike na ndihmon klasifikimi i tyre sipas ndërtimit mbi bazën e togfjalëshave të lirë dhe sipas burimit.

### **6.7.1. Klasifikimi i kalkeve me burim nga togfjalëshat e lirë**

Këtu ne nuk marrin përsipër për të gjetur gjuhën burimore, por kemi nxjerrë ato kalke<sup>190</sup> që kanë strukturë të njëjtë në shqipe dhe në gjuhë të tjera, pra përbëhen nga të njëjtat gjymtyrë dhe kanë të njëjtën vatrë kuptimore.

#### **6.7.1.1. Kalke frazeologjike me vlerë foljore**

*është në ajër* (dikush a diçka) “1. nuk ka siguri dikush; është krejt pezull; nuk di ç’ të bëjë. 2. nuk është vendosur, është ende në mëdyshje diçka”. angl. *be in the air*; rus. *в воздухе*; frëngj. *être en l’air*; *fluturon në ajër* (dikush) iron. “ndjehet shumë i lumtur; i duket çdo gjë e lehtë, e bukur a e mirë, ngaqë e ka rrëmbyer gëzimi; nuk është me këmbë në tokë; *sheh ëndrra me sy hapur* “mendon a thotë gjëra të kota; ka dëshira të pambështetura dhe që

---

<sup>187</sup> Thomai J., *Një fjalor që i mungonte kulturës shqiptare*, Gjuha shqipe, nr. 1, 2008, Prishtinë, f. 103.

<sup>188</sup> Mujaj H., *Gjuhësia e tekstit*, Faik Konica, Prishtinë 2004, f. 55.

<sup>189</sup> Jashari A., “*Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*”, Dudaj, 2007, f. VI.

<sup>190</sup> Të gjithë shembujt e cituar janë marrë nga “*Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*”, i hartuar nga Ali Jashari, ku autorja e këtij punimi ka qenë konsulente për gjuhët e huaja.

nuk plotësohen kurrë”. angl. *floating on air*; ital. *andare per le nuvola*; rus. *вумаем в облаках*; *qëndron (mbetet) në ajër* (diçka) “është pa mbështetje; nuk merret kush me të”. angl. *be up in the air*; *çaj (thyej, shkrij) akullin* “1. bëj hapin e parë dhe më të vështirë; hap i pari shtegun për një çështje që ka mbetur në vend dhe pa u zgjidhur; them ose bëj diçka që të tjerët të kapërcejnë ngurrimin dhe të ndjehen më të gatshëm a më të guximshëm për të folur (në një mbledhje etj.). 2. shmang a luftoj pengesat e vështirësitë që dalin; bëj përpjekje për të ndryshuar gjendjen e vështirë që është krijuar për diçka”. angl. *break the ice*; frëngj. *rompre la glace*; rus. *разбить лёд*; ital. *rompere il ghiaccio*; *i lëshoi (i dorëzoi, i hodhi, i uli) armët* (dikush) “1. nuk lufton më; u dorëzua; nuk kundërshton me forcë për diçka; kapitulloi. 2. i pushoi përpjekjet; nuk bën më qëndresë; nuk ngul këmbë më për diçka, nuk e mbron më një çështje etj.). angl. *throw down arms*; ital. *abbasare le armi*; frëngj. *rendre (déposer) les armes*; *mettre bas les armes*; rus. *складывать оружие*; *e mban (e ka) asin në mëngë* (dikush) “ka një plan sekret a një argument të fshehtë, që mund ta përdorë me sukses kur i duhet; e ruan një mënyrë a një mjet për çastin vendimtar; ka një gur të fortë në dorë”. angl. *have an ace up your sleeve*; frëngj. *avoir un as dans sa manche*; ital. *avere l’aso nella manica*; *e bën të bardhën të zezë* (dikush) “e paraqit diçka krejt ndryshe nga ç’është në të vërtetë; e mohon krejt a e shtrembëron të vërtetën; diçka të mirë e sjell si të keqe”. angl. *to call white black*; frëngj. *il rend noir ce qui est blanc*; *jam në të njëjtën barkë* (me dikë) “jam në të njëjtën situatë dhe kam të njëjtat probleme a kushte me dikë; kam të njëjtin fat, do të vuaj të njëjtat pasoja me të”. angl. *be in the same boat*; frëngj. *être du même bateau*; ital. *essere nella stessa barca*; *i karrikoi (i ngarkoi) bateritë* (dikush) “i mblodhi fuqitë dhe u bë gati për t’ia hyrë një pune, një vështirësie, një debati etj.; harxhoi mjaft kohë për të pushuar në mënyrë që të jetë më i aftë dhe energjik për të përballuar punën dhe problemet”; angl. *to recharge the batteries*; frëngj. *recharger les batteries*; ital. *caricare la batteria*; *i hedh benzinë zjarrit* “nxit me qëllime të caktuara (zakonisht të këqia) grindjen në mes të dy a më shumë vetave; fut sherrin diku për të nxjerrë përfitime; acaron edhe më shumë mosmarrëveshjet a grindjet që ka dikush me dikë; i fryn zjarrit”. angl. *to pour oil on the fire*; frëngj. *verser (jeter) de l’huile sur le feu*; ital. *gettare l’olio sul fuoco*; *është (ndodhet) me një këmbë në varr* (dikush a diçka) “po i mbarojnë ditët e jetës; është afër vdekjes; nuk mund të zgjatë më diçka; është në buzë të varrit”; angl. *with one foot in the grave*; frëngj. *avoir un pied dans la tombe(dans la fosse)*; rus. *стоять одной ногой в могиле*; ital. *avere un piede*

*nella tomba; i bie daulles* (dikush) “përmend ose sjell diçka publikisht me të gjitha energjitë dhe emocionet; bën zhurmë për diçka; jep kushtrimin” angl. *bang the drum for*; frëngj. *battre la caisse* (la grosse caisse); *e kap (e zë) demin për (prej) brirësh* “1. e gjej një rrugë të shpejtë e vendimtare për të dalë nga një situatë e vështirë; veproj me vendosmëri për t’ia arritur qëllimit. 2. e filloj një punë a diçka tjetër ashtu siç duhet; kap gjënë më themelore në zgjidhjen e një problemi”; angl. *take the bull by the horns*; frëngj. *prendre le taureau par les cornes*; ital. *prendere il toro per le corna*; rus. *брать быка за рога*; *ia përplasi derën në fytyrë* (dikujt) “ia mbylli derën para hundës; e përzuri dhe nuk e qas më; u nda përfundimisht me dikë”; angl. *to slam the door in face*; frëngj. *claquer la porte au nez de qqn*; ital. *chiudere la porta in faccia a qlcu*; *i ka ditët të numëruara* (dikush a diçka) “nuk do të jetojë a nuk do të qëndrojë gjatë ose nuk do të vazhdojë të jetë për një kohë të gjatë; do të marrë fund shpejt, do të zhduket etj.” angl. *sb’s days are numbered*; frëngj. *ses jours sont comptés*; rus. *у него дни сочтены*; ital. *avere i giorni contati*; *i doli (i shpëtoi) nga dora* (dikush a diçka) “1. nuk e kontrollon dot më; nuk ka më ndikim mbi të; ka marrë rrugë të gabuar dhe nuk e pyet më; i iku nga duart. 2. nuk e ka më; i shkoi dëm a i shpëtoi rasti për të marrë diçka shumë të vlefshme”; angl. *get out of hand*; frëngj. *craquer (claquer) dans les mains*; rus. *сходить с рук*; *i lëshoj frerën* (dikujt a diçkaje) “keq. e lë të lirë të sillet e të veprojë si të dojë; nuk e mbaj më nën kontroll; nuk i sjell asnjë pengesë në rrugën e vet”; angl. *bet go of the reins*; frëngj. *lâcher la bride à qqu*; *numërohen me gisht (me gishtat e dorës)* “janë shumë pak a shumë të rrallë; janë aq sa nuk përfillen e nuk kanë rëndësi”; angl. *count on the finger of one hand*; frëngj. *compter sur ses doigts*; rus. *по пальцам можно сосчитать*; ital. *si cantano sulla dita; si cantano sulla punta delle dita*;

### **6.7.1.2. Kalke frazeologjike me vlerë emërore**

*të dyja anët e medaljes* (e së njëjtës medaljeje) “edhe e mira, edhe e keqja (përdoret për të thënë se dy probleme ose dy gjendje janë të lidhura ngushtë, saqë ato realisht janë dy pjesë të së njëjtës gjë”. angl. *two sides of the same coin*; frëngj. *les deux faces de la médaille*; *ana tjetër (e pasme, e kundërt) e medaljes* “pjesa përbërëse më e keqe dhe më negative e diçkaje; ajo që nuk të intereson në një çështje të caktuar; vetia më e dobët dhe më e papranueshme e diçkaje”. angl. *the other side of the coin*; frëngj. *le revers de la médaille*; ital.

*l'altra faccia della medaglia; il rovescio della medaglia; rus. оборотная (другая) сторона медали; armë e bardhë* “armë që pret a shpon (thika, shpata etj.)”; angl. *bladed weapon*; frëngj. *l'arme blanche*; ital. *arma bianca; balonë prove (sondazhi)* “mjet a mënyrë që përdoret për të parë në praktikë vlerën e diçkaje; formë për të hetuar mendimin e të tjerëve, për të njohur një mendim të përgjithshëm rreth një çështjeje të rëndësishme a të re; rrugë a formë për të sqaruar diçka”; angl. *a trial balloon*; frëngj. *ballon d'essai*; ital. *ballone sonda*; rus. *пробный шар; bombë (minë) me sahat* “diçka shumë e rrezikshme që do të shpërthejë me siguri sipas parashikimeve të dikujt; diçka që nga çasti në çast mund të të rrezikojë a të të dëmtojë; rrezik i fshehtë që s'i dihet kur del; minë me sahat”. angl. *mine with a time*; frëngj. *bombe à retardement*; ital. *bomba a orologe; çun mamaje* “njeri i përkëdhelur, i cili është gjithnjë në mbrojtje të nënës; djalë i llastuar; i rritur në pupla; (thuhet për dikë që nuk është i pavarur në ato që thotë a që bën); djalë mamaje”; angl. *mother's boy; mama's boy*; frëngj. *fils à maman*; ital. *figlio di mamma*; rus. *маменький сынок; dele e zezë* “një pjesëtar i familjes a i një bashkësie tjetër, që veçohet a lihet mënjanë nga të tjerët, sepse nuk sillet mirë a nuk zbaton normat e vendosura nga shumica; njeri që tregohet me gisht për ato që ka bërë”; angl. *the black sheep*; frëngj. *brébis noire*; ital. *la pecora nera; dora e djathtë* “ndihmësi kryesor i dikujt; njeriu që i jep mbështetjen kryesore drejtuesit të një pune; ai që mban barrën më të rëndë pas tij; njeriu më i sigurt, të cilit mund t'i besosh më shumë për t'ia arritur diçkaje; krahu i djathtë”; angl. *right hand*; frëngj. *les bras droit de qqn*; rus. *правая рука*; ital. *il braccio destro; la mano destra; flluskë sapuni* “diçka pa peshë ose e paqëndrueshme, që zhduket shpejt e pa lënë gjurmë; diçka që nuk zgjat shumë”; angl. *soap bubble*; frëngj. *bulle de savon*; ital. *bolle di sapone*; rus. *мыльный пузырь; gur themeli (guri i themelit; gur themeltar)* (i diçkaje) “pjesa më e rëndësishme e themelore e diçkaje; diçka shumë e vlefshme dhe e qëndrueshme; ajo çka shërben si mbështetje kryesore për dikë a diçka; *guri i qoshes*; angl. *the corner-stone; foundation stone*; ital. *pietra angolare*; frëngj. *pierre angulaire*; rus. *краеугольный камень; letra (karta) e fundit* “i vetmi mjet, mundësi a e vetmja mënyrë që i ka mbetur dikujt për të zgjidhur një situatë të vështirë; guri i fundit; karta e fundit; fisheku i fundit”; angl. *final card*; frëngj. *dernière carte*; ital. *l'ultima carta; patate përvëluese (e nxehtë)* “një temë a çështje e ndërlikuar (zakonisht politike), për të cilën askush nuk do që të ketë lidhje, sepse i shqetëson shumë; çështje me zarar”; angl. *a hot potato*; frëngj. *patate bouillante*; ital. *patata bollente*.

### **6.7.1.3. Kalke frazeologjike me vlerë ndajfoljore**

*në anën tjetër të barrikadës* “në anën e kundërshtarit; në pozicion a në qëndrim të kundërt me dikë a me diçka”; angl. *on the side of the opponent*; frëngj. *(être) de l'autre côté de la barricade*; ital. *dall' altra parte della barricata*; *me armë në dorë* “gati për luftë; pa u dorëzuar; duke luftuar; pa u përkulur”; frëngj. *les armes à la main*; ital. *a mano armata*; ballë për ballë “1. njeri kundër tjetrit; me fytyrë njëri përballë tjetrit; përballë. 2. njëri kundër tjetrit si kundërshtarë; në luftë të hapur me dikë a me diçka, pa iu trembur e me guxim”. angl. *face to face*; frëngj. *fâce à face*; ital. *faccia a faccia*; rus. *лицо к лицу*; në buzë të varrit “1. në rrezik të madh për jetën. 2. duke vdekur; në minutat e fundit të jetës. angl. *on the edge of grave*; ital. *sull' orlo della fossa*; rus. *на краю могилы*; frëngj. *au bord de la tombe*; *dorë më dorë* “duke ia kaluar njëri-tjetrit; pa e lënë asnjë çast”; angl. *hand in hand*; frëngj. *de main en main*; rus. *рука в руку*; ital. *di mano in mano*; *me të dyja duart* “1. pa kufi, shumë; me bujari, pa u kursyer, sa të mundet. 2. me shumë dëshirë, pa asnjë ngurrim, me gjithë qejf”; angl. *with both hands*; ital. *con ambo (ambe) le mani*; *nga duar të dyta (të treta)* “jo drejtpërdrejt; nëpërmjet të tjerëve a të diçkaje tjetër; nga burime të tërthorta”; angl. *at second hand*; frëngj. *le seconde main*; rus. *из вторых (из третьих) рук*; *me krahë hapur* “me dashuri e me ngrohtësi; me dëshirë e përzemërsi të madhe; krahëhapur” angl. *with open arms*; frëngj. *à bras ouvert*; ital. *a braccia aperte*;

### **6.7.2. Klasifikimi i kalkeve frazeologjike sipas burimit**

#### **6.7.2.1. Kalke frazeologjike me prejardhje biblike:**

*alfa dhe omega* “1. gjëja më kryesore ; ana më e rëndësishme; thelbi i diçkaje. 2. pjesa kryesore; ajo që ngremë shumë peshë; fillimi dhe fundi; e tëra” angl. *alpha and omega*; frëngj. *l'alpha et l'oméga*; ital. *l'alfa el'omega*; rus. *алфа и омега*; *ku ishe ti Adam?* “përdoret për dikë që shfaqet ose që merr qëndrim me vonesë ndaj një ngjarjeje a ndaj një problemi të rëndësishëm” lat. *Adam, ubi est?*; *ardhja e dytë* “e ardhmja e largët, kohë e cila nuk dihet kur ka filluar; një kohë e largët e pacaktuar; kthimi i dytë” angl. *the Second Coming*; frëngj. *second retour*; rus. *второе пришествие*; *arka e Noes* “1. mjet a vend

shpëtimi për t'i shpëtuar diçkaje të rrezikshme; mënyrë për t'iu përshtatur kushteve të reja që krijohen papritmas. 2. njerëzimi; bota; barka e Noes; varka e Noes” angl. *Noah's arc*; frëngj. *Arche de Noé*; ital. *arca di Noe*; rus. *Ноев ковчег*; (shitet); për tridhjetë aspra “shumë lirë, duke tradhtuar a hidhur në anën e kundërshtarit për një shpërblim të vogël; (tradhton të diçka të shtrenjtë a të shenjtë) për hiçgjë; (shitet) shumë lirë” angl. *thirty pieces of silver*; it. *vendersi per trenta denari d'argento*; frëngj. *lestrente deniers (de Judas)*; rus. *тридцать серебряников*; *fletë (gjethe) fiku* “mjete a mënyrë e sajuar, që përdoret më kot për të fshehur a mbuluar një të vërtetë; përpjekje hipokrite për të mbuluar diçka të pahijshme a të turpshme” angl. *a fig leaf*; frëngj. *feuille de figue*; ital. *foglio di fico*; rus. *фиговый листок (листочек)*; *gomari i Balamit* “njeri i nënshtruar dhe i heshtur; njeri i lindur për të pësuar, për të duruar dhe për të vuajtur, por që befasi ngre krye kundër padrejtësisë”; angl. *Balaam's ass*; frëngj. *l'âne de Balaam*; rus. *Валаамова ослица*; *hedh gurin e parë*” nis i pari sulmet a sharjet ndaj dikujt, e godas i pari; jam i pari që e quaj fajtor dhe e qortoj” angl. *cast the first stone*; ital. *scagliare la prima pietra*; frëngj. *jeter la première pierre*; rus. *бросать первый камень*; lat. *Primus lapidem mittat*; *kulla e Babelit* “kaos, parregullsi, ngatërresë e madhe; vend ku nuk e merr vesh i pari të dytin; gjendje lesh e li; rrëmujë e plotë; shenjë mosmarrëveshjes; është Babiloni” angl. *a tower of Babel*; ital. *la torre di Babele*; frëngj. *la tour de Babéle*; rus. *вавилонская башня*; *mollë e ndalur* “gjë e dëshiruar, por e paarritshme; diçka që nuk lejohet të përdoret a të shfrytëzohet; diçka që nuk lejohet të bëhet; gjë e ndaluar; pemë e ndaluar” angl. *the forbidden fruit*; frëngj. *le fruit défendue*; *pomme défendue*; rus. *запретный плод*; *neveria shkatërrimtare* “diçka që ngjall urrejtje të madhe; një gjë që shihet me mospëlqim a neveri nga njerëzit”; angl. *anabomination of desolation*; frëngj. *l'abomination de la désolation*; rus. *мерзость запустения*; *zë në shkretëtirë* “thirrje e kotë, që mbetet pa përgjigje a vëmendje; fjalë, mendim a këshillë që nuk e dëgjon askush; përpjekje e kotë”; angl. *the voice (crying) in the wilderness*; ital. *voce nel deserto*; frëngj. *une voix dans le désert*; rus. *глас вопиющий в пустыне*; lat. *vox in deserto*; *voxcclamants in deserto*; *biri (djali) plangprishës* “i penduari; ai që i ka kuptuar thellë gabimet që ka bërë ndaj dikujt a ndaj diçkaje; djali plangprishës”; angl. *a prodigal son*; frëngj. *l'enfant prodigue*; *le fil sprodigueur*; rus. *блудный сын*; ital. *figlio prodigo*; *dashi i kurbanit (dash kurban)* “njeriu, të cilit i ngarkohet faj; dikush që sakrifkohet padrejtësisht për dikë a për diçka tjetër; koka e turkut”; angl. *scapegoat*; frëngj. *bouc émissaire*; ital. *capro espiatorio* etj.



### **6.7.2.2. Kalke frazeologjike me prejardhje nga mitologjia:**

*pastroj ahuret e Avgjisë* “vë rregulla aty ku ka rrëmujë e papastërti të madhe; përmirësoj rrënjësisht e shpejt një gjendje shumë të keqe a të meta të mëdha të grumbulluara prej kohësh; pastroj diçka të keqe që është rritur prej shumë kohësh”; lat. *Augeas cloacas purgare*; angl. *to clean Augean stables*; ital. *pulive le stalle di Augia*; frëngj. *nettoyer les écuries d’Augias*; rus. *чистить авгиевы конюшни*; *bashka e artë* “diçka shumë e çmueshme, fuqplotë a çudibërëse, që ke dëshirë ta zotërosh”. angl. *the golden fleece*; frëngj. *la Toison d’or*; ital. *il Tosone d’oro*; rus. *золотое руно*; *briri i bollëkut* “burim i madh e i pashtershëm të mirash materiale; simbol i begatisë; diçka nga e cila rrjedh një sasi e madhe dhe e pashtershme” angl. *the horn of plenty*; frëngj. *la corne d’abondance*; ital. *il corno dell’abbondanza*; rus. *рог изобилия*; *mbolli dhëmbët e dragoit (dikush)* “veproi në një mënyrë të tillë që të sjellë armiqësi, përçarje; të shkaktojë turbullira të mëdha”; angl. *dragon’s teeth*; frëngj. *semer les dents du dragon*; rus. *зубы дракона*; *filli i Arianës* “mënyrë a mjet për të gjetur rrugëdalje nga një gjendje e vështirë; ndihmë që i jepet dikujt a çelës për të zgjidhur diçka të ndërlikuar; peri i Arianës; lëmshi i Arianës”; angl. *the thread of Ariadne*; frëngj. *le fil d’Ariane*; ital. *il filo do Arianna*; rus. *Ариаднина нить*; *fluturimi i Ikarit (i Dedalisë)* “shprehja përdoret kur duam të vëmë në dukje guximin e çmendur të dikujt që pëson disfatë, një veprim të paparë e të guximshëm, por pa frytë”; angl. *the flight of Icarus*; frëngj. *le vol d’Icare (de Dédale)*; rus. *полет Икара*; ital. *il volo di Icaro*; *frutat e Tantalit* “vuajtje të padurueshme nga pamundësia për të arritur qëllimin e dëshiruar, të cilin e ke shumë afër; diçka e paarritshme; diçka që të josh dhe nuk e arrin dot; punë shumë e vështirë; mundimet e Tantalit”; angl. *the torments of Tantalus*; frëngj. *les fruits de Tantale*; ital. *il supplizio di Tantalo*; rus. *муки Тантала*; *shtrati i Prokrustit* “ajo që shërben si masë për diçka; ajo në të cilën futet ose përshtatet me forcë diçka; masë a vendim artificial që përpiqen t’ua përshtatin fakteve reale”; angl. *the bed of Procrustes*; frëngj. *le lit de Procruste*; ital. *letto di Procuste*; gjerm. *Procrustebett*; rus. *Прокрустово ложе*; spanj. *el lecho de Procrustes*; *kova e Danaideve* “punë e padobishme e që s’ka fund; punë pa frute; të mbash ujë me shoshë”; angl. *Danaide’s work*; frëngj. *le tonneau des Danaïdes*; ital. *botte (vaso) delle Danaïdi*; rus. *бочка Данаид*; gjerm. *Danaidenfass*; *në krahët e Morfeut* “në gjendje gjumi”; angl. *in the arms of Morpheus*; ital. *in braccia a Morfeo*; frëngj. *être dans les bras de Morphée*; rus. *в объятиях Морфея*; *kutia e Pandorës* “gjithë të këqijat dhe mjerimet për

njerëzit: sëmundjet, luftërat, gjyqet, uria, tërmetet etj.”; ang. *Pandora's box*; frëngj. *la boîte de Pandore*; ital. *il vaso di Pandora*; gjerm. *die Pandorabüchse*; spanj. *la saca de Pandora*; *mollë sherri* (grindjeje) “shkak, arsye grindjesh, përçarje shkak kundërshtimesh serioze ndërmjet dy njerëzve, dy palëve etj”; angl. *the apple of discord*; frëngj. *pomme de discorde*; ital. *pomo della Discordia*; gjerm. *Der Apfelder Zwietracht*; greq. *millon tis eridhos*; lat. *malum discordiae*; rus. *яблоко раздора*; *nyja gordiane* “çështje e ngatërruar për t’u zgjidhur; zgjidhje e vështirë; punë a detyrë e ngatërruar. *pres, (këput, zgjidh) nyjen gordiane* “zgjidh një çështje të ngatërruar me anën e forcës, me guxim e përnjëherësh”; angl. *the Gordian knot*; frëngj. *le noeud gordien*; ital. *nodo gordiano*; gjerm. *den gordischen Knoten*; rus. *Гордиев узел*.

### **6.7.2.3. Kalke frazeologjike me burim nga historia, gjeografia, politika**

*e mban barutin të thatë* “është parashikues dhe i gatshëm për çdo të papritur; është gjithnjë i përgatitur për mbrojtje; nuk mund ta zësh në befasi; pret qetësisht të shohë se si zhvillohet një situatë para se të vendosë se ç’duhet të bëjë”; angl. *keep one's powder dry*; frëngj. *tenir la poudre sèche*; ital. *tenere asciutte le polveri*; rus. *держат порох сухим*; *betimi i Hanibalit* “shprehje e vendosmërisë së fortë për të qenë i papajtuëshëm me dikë a me diçka; betim a vendosmëri për të luftuar deri në fund”; angl. *Hannibal's vow*; frëngj. *serment de Hannibal*; rus. *Ганнибалова клятва*; *edhe ti (o) Brut?* “i thuhet me ironi a me çudi një miku a një shoku të ngushtë që të del nga fjala a të thyen besën e dhënë”; angl. *And thou too, oh Brutus?* frëngj. *Toiaussi, Brutuss?* lat. *Et tu, Brute?* rus. *и ты, Брут ?; ose Cezar ose asgjë* “ose të jesh i pari (fitimtari), ose asgjë; ja mbi të tjerët, ja askush”; frëngj. *ou César, ou rien*; lat. *aut Caesar, aut nihil*; *ditët e fundit të Pompeit* “një gjendje a kohë rrëmuje e frike, trazire e shqetësimi të madh ose një gjendje e pashpresë; kur gjithçka ka marrë fund. angl. *the last day of Pompei*; frëngj. *derniers jours de Pompei*; rus. *последний день Помпеи*; *dhurata e danajve* “nuk duhet t’i besosh një armiku a kundërshtari, sado bujar që të duket ai; ruhu nga hileqarët; kujdes ndaj atyre që të bëjnë lajka e të japin diçka, se është me pasoja”; angl. *a greek gift*; frëngj. *un cadeau danai*; rus. *дарух данайцев*; *fitore si e Piros* (fitorja e Piros) “fitore me humbje shumë të mëdha; një fitore e arritur me sakrifica të shumta; një fitore që nuk lakmohet a që nuk ia vlen ta arrish”; angl. *a Pyrrich victory*; frëngj. *la victoire a*

*la Pyrrihus*; ital. *la vittoria di Pirro*; gjerm. *Pyrrhussieg*; rus. *Pirrova pobeda*; spanj. *victoria Pirrica*; kali i Trojës (*kalë Troje*) “armik i brendshëm që zhvillon veprimtari të fshehtë kundër vendit të tij; rrezik i fshehtë; mjet a mënyrë dinake për t’ia arritur diçkaje; simbol që shënon veprime dinake, mashtruese nën maskën e dashamirësisë”; angl. *the Trojan horse*; frëngj. *cheval de Troie*; ital. *cavallo di Troia*; rus. *троянский конь*; lat. *equus Troianus*; *pas nesh (meje) kiameti* “kur ne po vdesim, le të vdesin të gjithë”; angl. *after us the deluge*; frëngj. *après nous le deluge*; ital. *dopo di noi il diluvio*; rus. *после нас хоть помон*; *kolona e pestë* “armik i fshehtë; njerëz që në fshehtësi zhvillojnë veprimtari kundër dikujt a diçkaje tjetër” angl. *the fifth column*; spanj. *quinta columna*; frëngj. *la cinquième colonne*; rus. *пятая колонна*; ital. *quinta Colonna* etj.

#### **6.7.2.4. Kalke frazeologjike me burimin nga filozofia**

*ligj i pashkruar* “ një rregull, normë, veprim etj., që, megjithëse nuk njihet si i miratuar zyrtarisht, zbatohet prej të gjithëve; zakon” lat. *lex non scripta*; angl. *the unwritten law*; frëngj. *la loi non écrite*; rus. *неписанный закон*; *dashuri platonike* “1. dashuri e fortë për dikë pa menduar për seks; dashuri shpirtërore. 2. prirje e fortë për t’u lidhur me dikë për interesa të çastit”; angl. *Platonic love*; frëngj. *l’amour platonique*; rus. *платоническая любовь*; *dora lan dorën (njëra dorë lan tjetrën)* “është e natyrshme që njerëzit e afërt, që kanë qëllime a interesa të përbashkëta, që kanë lidhje gjaku a miqësore, të përkrahin njëri-tjetrin, ta mbrojnë, ta mbështetin”. angl. *one hand washes the other*; ital. *una mano lava l’altra*; frëngj. *une main lave l’autre*; lat. *manus manum lavat*; rus. *рука руку моём*; *të gabosh është njerëzore (gabimi është për njeriun)* “njeriu nga natyra gabon; gabimi është në natyrën e njeriut; përdoret kur arsyetohet një gabim i paqëllimtë”; frëngj. *se tromper est humain*; ital. *errare é umano*; lat. *errare humanum est*; *qëllimi justifikon mjetin* “përdoret me kuptimin se çdo veprim (zakonisht i keq) është i pranueshëm për një përfundim të mirë të diçkaje që dëshirojmë ta arrijmë” angl. *the end justifies the means*; frëngj. *la fin justifie les moyens*; ital. *il fine quistifica i mezzi*; rus. *цель оправдывает средства*; *gomari i Buridanit* “njeri i pavendosur, që lëkundet midis dy dëshirave të njëjta a dy zgjidhjesh të së njëjtës rëndësie dhe e pëson se nuk di nga t’ia mbajë; dikush që midis dy objekteve me vlera të barabarta, nuk është në gjendje të vendosë”; angl. *Buridan's ass*; frëngj. *l’âne de Buridan*; ital. *l’asino di*

*Buridano*; rus. *Буриданов осёл*; e mesmja e artë “ 1. gjendje as këtej, as andej; veprim që nuk të çon në ndeshje mes dy palëve të kundërta dhe që lejon të përfitosh nga të dyja anët; pozicion a gjendje ku nuk ka asnjë rrezik. 2. zgjidhje e një kundërshtie pa asnjë pasojë; zgjidhje që mendohet si më e mira; përdoret për të karakterizuar ndonjë veprim a mënyrë të menduari ku është shmangur qëndrimi i skajshëm; mesi i artë ; angl. *the golden mean*; frëngj. *juste milieu*; ital. *l'aurea mediocrità*; rus. *золотая середина*; *kështjella në rërë* “diçka e paqëndrueshme, në dukje e fortë, por pa themele të shëndosha, që mund të rrezikohet a të prishet lehtë; fantazi boshe; punë pa fryte; ëndrra në diell; kështjella në erë; kala prej letre” angl. *castles in the air*; frëngj. *châteaux sur le(du) sable*; ital. *castelli in aria* etj.

#### **6.7.2.5. Kalke frazeologjike me burim nga letërsia, folklori dhe besimi popullor**

*lamtumirë armë* “përdoret me shaka a me tallje kur humbim një gjë të mirë ose një shok të ngushtë, kur largohemi nga një punë a veprimtari që kërkon përpjekje etj., ose kur braktisim diçka me të cilën kemi qenë të lidhur” angl. *farewell arm*; frëngj. *Adieu aux armes!*. Shprehja vjen nga titulli i romanit të E. Heminguejit “*Lamtumirë armë*”, ku personazhi kryesor, Henri, e braktis luftën, duke kujtuar se ai do të rrojë i lumtur bashkë me Ketrinën e tij; *bukë dhe lodra* “që s’ka shumë kërkesa; që kënaqet me pak gjëra”; angl. *bread and circuses*; frëngj. *du pain et des jeux*; lat. *panem et circenses*; rus. *хлеба и зрелищ*. Shprehje përçmuese e Juvenalit (Satira, X, 81), drejtuar romakëve në kohën e rënies dhe të shturjes, ku tiranëve nuk u kërkohet veçse bukë dhe cirk falas; *mohikani i fundit* “përfaqësuesi i fundit nga dinastia a nga familja e dikujt ose flitet me ironi për dikë që përfaqëson një grup shoqëror me emër, por që po zhduket”. angl. *the last of the Mohicans*; frëngj. *le dernier des Mohicans*; rus. *последний из Могикан*. Shprehja lidhet me titullin e veprës së shkrimtarit amerikan Fenimor Kuperit (1789-1851), ku përshkruhet lufta e mohikanëve, që ishin një fis indianësh fisnikë të Amerikës së Veriut , me banorët e ardhur nga Evropa. Një shekull më parë, ashtu si dhe shumë popuj të tjerë amerindianë, u zhdukën nga të bardhët; *muaji i mjaltit* “1. periudha menjëherë pas fejesës ose pas martesës së një çifti. 2. iron. lulëzimi, koha më e bukur, periudha e marrëdhënieve më të mira midis njerëzve, partive, shteteve etj” angl. *the honeymoon*; frëngj. *la lune de miel*; rus. *медовый месяц*. Në romanin filozofik me titull “*Zagidosefati*”, Volteri shkruan: “*Zagid provoi se muaji i parë i martesës është muaj mjalti,*

ndërsa muaji i dytë është muaji i ftohtësisë dhe i boshllëkut; *lufton me mullinjtë e erës* “harxhon forcat pa u menduar dhe pa sukses në një luftë a punë me shumë rrezik, me pengesa e vështirësi; lufton në mënyrë imagjinare; lufton kundër shakujve me verë”; angl. *to tilt at (the) windmills*; frëngj. *se batter contre des moulins à vent*; ital. *prendersela (lottare) coi mulini a vento*; spanj. *acometer molinos de viento*; rus. *сражаться с ветряными мельницами*. Shprehja ka lidhje me episodin e romanit "Don Kishoti i Mançës" i Servantesit, kur Don Kishoti ndeshet me mullinjtë e erës; *të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja* “gjendja është shumë e vështirë dhe duket si pa rrugëdalje; shprehja përdoret për të karakterizuar ndonjë gjendje a situatë shumë të vështirë”; angl. *to be or not to be, that is question*; frëngj. *être ou ne pas être, c’est ça la question*. Shprehja vjen nga monologu i Hamletit në tragjedinë me të njëjtin titull të Shekspirit (akti III, skena I). Përdoren dhe të dyja pjesët veç e veç; *furtunë në gotën e ujit* “zhurmë a bujë për asgjë të rëndësishme; diçka që paraqitet si e madhe, por që nuk ka asnjë forcë e vlerë; zhurmë e kotë dhe pa pasojë që bëhet për diçka; stuhi në gotën e ujit; shtrëngatë në gotën e ujit”; angl. *a storm (tempest) in a tea – cup*; frëngj. *la tempete dans un verre d’eau*; ital. *tempesta in un bicchier d’aqua*; spanj. *tempestad en un vaso de aqua*; rus. *буря в стакане воды*; gjerm. *Ein sturm in Glase äasser*. Shprehja e përdorur nga Balzaku (romani “Le curé de Tours”) i përket Montesksesë (1689-1755), veprimtar politik dhe mendimtar francez, që të tregonte me këtë pështjellimin politik në republikën e vogël të San-Marinos. Kjo shprehje duhet të jetë perifraksim i thënies latine *exitare fluctus in simpulo*, e cila haset për herë të parë te Ciceroni; *mban(rrit gjarprin në gji)* “thuhet kur dikush kujdeset për një njeri, i cili më vonë, me pabesi, ia shpërblen të mirën me të keqe; e ka brenda atë që do t’i bëjë të keqen; i kushton vëmendje e i jep dashuri një njeriu, i cili ia shpërblen me mosmirënjohje; pra mirëbesimi shpërblehet me pabesi”; angl. *cherish a viper in one’s bosom*; frëngj. *réchauffer (nourrir) un serpent dans (sur) son sein*; ital. *scaldare serpe al seno*; rus. *отогревать змею на груди*. Shprehja vjen nga fabula "Fshatari dhe gjarpri" e La Fontenit: Një vit në janar/ Doli një fshatar/ Jashtë nëpër ara, / Kur gjeti përpara/ Mbuluar me borë/ Një gjapër të mpirë /Të mbledhur, të ngrirë, / E mori në dorë, /Në shtëpi e shpuri/ Dhe pranë zjarrit e vuri. / Gjarpri, kur u ngroh , u zgjua, / U drodh e u rrotullua, / Ngriti kryet, u lëshua/ Me qëllim për të kafshuar/ Fshatarë q’ë kish shpëtuar!/ “Unë, - tha fshatar’ i mjerë. - /Të prura këtu të ngrova. / Sot nga vdekja të shpëtova, /Dhe ti do të më lësh vrerë!/ Qënke i lig sa s’ke shokë”/ Q’atë çast fshatar’ i ngratë/ Me vrap mori një sëpatë/ Dhe i

ra gjarprit në kokë; *gjuha e Ezopit* “1. rrugë, mjet a mënyrë që përdoret për t’i shprehur mendimet në mënyrë të figurshme a të tërthortë. 2. mendim i shprehur jo në mënyrë të drejtpërdrejtë”; angl. *the language of Aesop (aesopian language)*; frëngj. *la langue d’Ésope*; rus. *езоповский (Езопов) язык*. Shprehja lidhet me emrin e fabulistit të antikitetit, Ezopit (shekulli VI p.e.s.), i cili, për shkak të censurës, ishte i detyruar të përdorte alegorinë, si formë të shprehjes së mendimeve, për të thënë të vërtetën; *kalif për një ditë* “shprehja përdoret për një njeri të cilit i dhurojnë diçka të përkohshme ose që ka pushtet për një kohë të shkurtër”; angl. *a caliph for a day*; frëngj. *calif (khalif) pour un jour (un nuit)*; rus. *калиф (халиф) на час*. Shprehja vjen nga një përrallë arabe (Një mijë e një net), ku tregohet se një i ri nga Bagdadi, Abu-Hasan, ftoi një të huaj në shtëpi, pa e ditur se ishte kalif, sepse që i maskuar. I riu i tha se ëndërronte të bëhej kalif, qoftë edhe për një ditë të vetme. Kështu kalifi i dha një ilaç dhe e vuri në gjumë, pastaj urdhëroi shërbëtorët që ta trajtonin të riun sikur të ishte kalif. Por lumturia nuk zgjati shumë. Natën kalifi i dha edhe një dozë tjetër ilaçi dhe, kur u zgjua, djali e gjeti veten në kasollen e tij të vjetër; *kalorës me fytyrë të vrerosur* “njeri i frymëzuar nga ideale kalorësiake dhe aspak praktik; ai që ngrihet kundër realitetit të egër të kohës dhe mundet prej tij; naiv; ëndërrimtar i kotë”; angl. *the knight of the rueful countenance*; frëngj. *chevalier à la triste figure*; rus. *рыцарь печальнового образа*. Shprehja e ka burimin nga romani “Don Kishoti i Mançës” i Servantesit. Në këtë vepër autori përshkruan Don Kishotin, një zotëri fshatar që niset për të nxjerrë nga varri dëshirat kalorsiake, tashmë të harruara. Ai ngatërron hanet me kështjellat; mullinjtë e erës me gjigandët; kriminelët me viktimat e tiranisë; *ligji i xhunglës* “shprehja përdoret për të karakterizuar një situatë në të cilën nuk zbatohen rregullat ose ligjet e vendosura dhe njerëzit e fortë bëjnë gjithçka; gjendje në të cilën peshku i madh e ha të voglin”; angl. *the law of the jungle*; frëngj. *la loi de la jungle*; ital. *la legge della giungla*; lat. *nascetur ridiculus mus*. Shprehja vjen nga jeta e kafshëve në xhungël, ku ka një luftë të ashpër dhe të pamëshirshme për të mbijetuar. Kjo është teza kryesore e teorisë evolucioniste për seleksionimin natyror, sipas së cilës, mbijetesa e qenieve të gjalla përcaktohet nga aftësia e tyre për t’u përshtatur. Shkrimtari anglez Roduard Kipling (1865-1936) botoi në vitin 1895 “Librin e xhunglës” në dy vëllime. Në librin e dytë ai përmend dhe ligjin e xhunglës, ligjin e më të fortit, ku kafsha më e fortë ha kafshën më të dobët; *mali polli një mi* “thuhet fjalë të mëdha ose bëhen shumë premtime, por punë bëhet pak; bëhet shumë zhurmë, por s’nxirret gjë në dritë; u fry shumë,

por dha pak; një fillim i bujshëm dhe premtues, shpesh përfundon në diçka”; ang. *mountain has brought forth a mouse*; frëngj. *c'est la montagne qui accouche d'une souris*; ital. *fare come la montagna che partori topo*. Shprehje e Horacit (Arti poetik, 139): parturiunt montes, nascetur ridiculus mus- pjellin malet, por lindin minj qesharakë. Kjo shprehje lidhet me fabulën e Ezopit “Lindja e malit” dhe me atë të La Fontenit “Mali i mbarsur”: “Një mal nga dhimbja për të pjellë/ Bërtiste me të madhe aq fort/ Sa, kushdo të ishte nga sikleti i thellë/ Duke mos duruar dot/ Besoj, do pillte më parë vetë/ Një qytet më të madh dhe nga Parisi / Mirëpo mali na polli një mi.

#### **6.7.2.6. Kalke frazeologjike me burim nga matematika, fizika, astronomia dhe shkencat tjera**

*Arusha e Madhe* “term që përdoret në astronomi për të shënuar një yjësi në gjysmë rruzullin verior të qiellit, që përbëhet nga shtatë yje të renditur si qerre”; angl. *the Big Dipper*; lat. *Ursa Major*; frëngj. *la Grande Ourse*; rus. *Большая Медведица*; ital. *l'Orsa Maggiore*; *Arusha e Vogël* “term që përdoret në astronomi për të shënuar një yjësi në gjysmërruzullin verior të qiellit, që përbëhet nga shtatë yje të renditur si qerre, njëri prej të cilëve (ylli i bishtit) është Ylli Polar i Veriut”; angl. *the Little Dipper* lat. *Ursa Minor*; rus. *Малая Медведица*; ital. *l'Orsa Minore*; frëngj. *la Petit Ourse*; *forcë lëvizëse* “njeri, mjet a mënyrë që shërben për të çuar më përpara a për të ndryshuar diçka të rëndësishme” frëngj. *la force motrice*; ital. *forza motrice*; rus. *движущая сила*; *leva e Arkimedit* “mjet i fuqishëm që të ndihmon për të vënë në lëvizje diçka; pikë mbështetjeje”; frëngj. *le levier d'Archimède*; rus. *рычаг Архимеда*; *lotë krokodili* “pikëllim i pasinqertë; vuajtje e shtirur; qarje hipokrite; ankesa të paqena”; angl. *crocodile tears*; frëngj. *larmes de crocodile*; gjerm. *Krokodilsträne*; ital. *lacrime di coccodrillo*; rus. *крокодильовы слёзы*. Sipas besimit, krokodili, duke ngrënë viktimën e tij, qan. Shkencëtarët suedezë, Ragnar Fänge dhe Knut Schmidt-Nilsson, vërtetuan se vërtet krokodilët derdhin lotë, por thjesht për shkaqe biologjike; *pika e gravitetit* (e rëndësës) “ana më e rëndësishme në një punë a në një veprimtari; ajo që luan rolin kryesor dhe që kërkon vëmendje të veçantë; diçka shumë e rëndësishme; qendra e graviteti”; angl. *centre of gravity*; frëngj. *center (point) de gravite*; ital. *centro di gravità*; pikë mbështetjeje “pika më rëndësishme për të arritur diçka; dikush a diçka që shërben si bazë mbështetëse për të tjerët; leva e Arkimedit”; angl. *point of support*; lat. *punctum saliens* rus. *точка опоры*;

frëngj. *point d'appui*; pikë e vdekjes “gjendje pa rrugëdalje e pa zhvillim të mëtejshëm; ngecje në vend; përdoret edhe për dikë që do të mbyllë një bisedë të papëlqyeshme”; angl. *drop dead*; frëngj. *point mort*; rus. *мертвая точка*; ital. *punto morto*. Shprehja përdoret së pari në fushën e fizikës dhe shënon pikën ku një trup është në qetësi e nuk lëviz pa një shtytje të re, si dhe pikën ku zëri dëgjohe shumë pak ose nuk dëgjohe fare etj.

## **6.8. Një analizë e formës së brendshme të njësive frazeologjike mbështetur në veprën e D. Agollit**

Idea kryesore e këtij sythi lidhet me një tezë të njohur, se leksiku popullor në përgjithësi, por sidomos frazeologjia dhe urtia popullore, mbartin vlera shënuese dhe shprehëse emocionuese, të cilat i vijnë në ndihmë shkrimtarit të pasurojë dhe të zhërvillojë gjuhën e tij për të realizuar synimet ideoestetike me mjete stilistikisht të fuqishme.

Siç e trajtuam më lart, rrugët e formimit të këtyre njësive frazeologjike janë të ndryshme. Një pjesë kanë lindur nga shndërrimi i figurshëm i togfjalëshave të lirë, p.sh. *e hodhi lumin*; *ra nga kali*; *e hëngri sapunin për djathë*; *e shkeli në kallo* etj. Por ka mjaft njësi frazeologjike që nuk mund të motivohen, pra nuk është e lehtë t’u gjendet “etimologjia” e tyre. Kjo lidhet me “formën e brendshme” të njësive frazeologjike, ose, e thënë ndryshe, me jetën shoqërore, me zakonet, doket, me mendësitë e njerëzve, me mënyrën e jetesës, historinë, folklorin etj. Në një mënyrë ose një tjetër, “forma e brendshme” e njësive frazeologjike ka të bëjë me botën shpirtërore dhe materiale të njerëzve të një krahine, të një bashkësie gjuhësore.

Duke u mbështetur në materialet e botuara, por sidomos në “Fjalorin leksiko-frazeologjik të Devollit”<sup>191</sup>, mund të arrijmë në përfundimin se visari leksiko-frazeologjik i veprës së Dritëro Agollit, megjithë ndërthurjen që ka me leksikun dhe frazeologjinë e gjuhës letrare shqipe, mund të kundrohë edhe nga pikëpamja “e formës së brendshme” dhe përmes tij mund të përshenjen dhe mjaft pamje “të botës” devollite në kuptimin e figurshëm, sepse smilari i kësaj “bote” qëndron në bazë të krijimit të shumë fjalëve, njësive frazeologjike, fjalëve të urta, urimeve dhe mallkimeve etj. Njësitë frazeologjike dhe shprehje të tjera mund të analizohen nga pikëpamja e formës së brendshme. Jani Thomai thekson se leksiku dhe

---

<sup>191</sup> Jashari A., *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, Korçë 2014 (në proces botimi).



frazologjia i nënshtrohet një shtresimi në planin gjuhësor, gjithëkombëtar, krahinor, lokal, dialektor, ndërghjuhësor dhe se: “*Shumë njësi frazeologjike të këtij grupi lidhen me jetën fshatarake e baritore, shprehin këtë mënyrë të jetesës dhe të të menduarit dhe në përgjithësi janë të motivueshme me përbërësit e kësaj jete.*”<sup>192</sup>. Duke u nisur nga kjo ide mund të bëjmë një analizë të hollësishme të treguesve leksiko-semantikë të gjymtyrëve përbërëse të njësive frazeologjike dhe mënyrave të tjera të formimit të tyre.

### **6.8.1. Analiza sipas gjymtyrëve të njësive frazeologjike**

**6.8.1.1.** Gjymtyrë të shprehura me emra vendesh të krahinës së Devollit, si: *për një kockë gjer Poloskë* “për gjëra pa rëndësi”; *i ka mëntë majë Ivanit* “është i lehtë nga mendja, i papjekur”; (*është bërë*) *si damazi i Rakickës* “mendjemadh”; *u mbyt Rakicka* “nuk ndodh kurrë, asnjëherë”; *akoma në lakrat e Cangonjit* “që nuk di gjë për një problem, që nuk e di si ka ndodhur”; *s’do pragu dhi, do nuse prej Treni* “duhet punë dhe jo gjëra të kota”; (*flet*) *si hoxha i Bickës* “flet gjepura, flet kot”; (*bën*) *prëska me ujë Todoreci* “bën gjëra të kota”; *e vrau Muken e Stropanit* “nuk punon fare, është dembel”; *sikur je pe Otojake* “nuk di gjë, nuk kupton”; *na i kthen dhentë mbi Bickë* “mburret kot”; *do t’ja dijë Ivani se bie dëborë!* “është i zoti, që nuk pyet për fjalët e të tjerëve”; *pyet Vranishti për Bickë!* “është i pari, nuk do t’ia dijë për të tjerë”; *doli Borshi mbi Poloskë* “është mendjemadh, shet mend” etj.

**6.8.1.2.** Gjymtyrë të shprehura me emra njerëzish që janë përdorur ose përdoren në këtë krahinë. Mjaft syresh kanë kaluar në përdorim në mbarë gjuhën shqipe, si: (*u zunë*) *për mustaqet e Çelos* “kot”; *si Kolja me Deden* “bashkë, të pandarë”, ndërsa pjesa më e madhe janë krijime të njëmendta në të folmen e Devollit dhe bëhen shprehëse të mendësisë “devollite” si për nga formimi i emrave të njerëzve, si *Cankë, Ximkë, Kole, Hysenkë*, ashtu edhe për nga gjymtyrët e tjera përbërëse që lidhen me Devollin (emrat e fshatrave që tregojnë vendbanimin e dikujt që përmendet në njësi, p.sh. *si Hysenka i Trenit*, apo edhe nga fjalë, të cilat janë karakteristike për popullin e kësaj krahine, si: *dem, djathë, lakra, ledh, lëmë, leshtë, opingë, revani*, etj.

Për ta konkretizuar këtë po japim disa shembuj, si: *s’e ha Canka revaninë* “bën sikur s’e pëlqen diçka”; (*është*) *lagu Kole të të ruaj* “diçka pa shije, shumë e lëngshme”; *s’pyet*

---

<sup>192</sup> Thomai J., *Çështje ...vep. cit.*, f. 215.

*Muçoja për gjela deti* “nuk do t’ia dijë nga të tjerët”; *ku këput ai s’e ngjit as Ramo kovaçi* “merret me thashetheme dhe u prish punë të tjerëve”; *është si lopa e Sheqeres* “është i padurueshëm, që i fut hundët kudo”; *ia bëri kufirin (sinorë) te ledhi i Tasit* “nuk e la të bënte si të donte”; *si qeni i Ramços* “pa vlerë, i plakur”; *te lëmi i Telos prapë do të vish* “do të shihemi përsëri, nuk ke ku të shkosh”; *kush pyet për Sali bejnë* “i thuhet dikujt që hiqet kapadai, që nuk pyet për të tjerët”; *i dha opingat e Sherros* “nuk i dha asgjë”; *mbjell Zaluja, korr Malua* “punën e bën dikush, por një tjetër korr frutet e saj”; *e kërkon si Zequa dhinë* “bën një punë me vonesë, jo në kohën e duhur”; *si Ximka me Nadirenë* “bashkë, të pandarë”; *s’punoj për Beqirë e Lazës* “nuk punoj kot, nuk punoj për të tjerët”; *shtrihet si demi i Zelos* “nuk punon, është dembel”; *kur të shijë Ajdini urovë* “kurrë, asnjëherë”; *e hëngri djathën e Koles* “vdiq”; *hesapi i Zylalit sa lakra i vë kalit* “nuk të duhet gjë ty, secili e di punën e vet”; *s’i bën kërraba Mihalit* “nuk është më i zoti, u plak; (mbeti) *si Kasua në vreshtë* “është i trembur, i pafajshëm”; *mori leshtë e Curres* “nuk mori asgjë, mbeti pa gjë”; *e bëri si Demir efendiu* “shpenzoi shumë, pa hesap”; *ç’bën moj Shaqe, përvëlaqe* “thuhet për dikë që punon kot, kalon kohën pa punë të dobishme”; *je bërë si Abedini i Shagut* “thuhet për dikë që është i prapë, ters” etj.

**6.8.1.3.** Gjymtyrë të shprehura me emra të përgjithshëm, karakteristike për të folmen e Devollit, si: *buçe, buallicë, bubuzhel, latoshkë, gobellë, kleçkë, katëk, killë, i luspitur, hoshafkë, fronkë, gallof, gomarkë, haliç, farashkë* etj. Për shembull: *mbeti si latoshkë pa bisht* “nuk ka më asnjë vlerë”; *sikur ka ngrënë katëkun e pulës* “është shumë i dobët”; *si hoshafkë e fishkur* “i dobësuar, që nuk ka asnjë tipar të bukur”; *gallof pa pendë* “budalla”; *ia ngriti pizgat* “e nxiti për keq”; *i dha gërgëmën* “punoi me shumë vrull për ta përfunduar diçka”; *kleçkë për të kruajtur dhëmbët* “qesharak, i pavlerë”; *e vuri në fronkë* “ia mblodhi, i kërkoi llogari”; *gomarka pre balte* “gjëra të kota”; *bën dible para petës* “i bën punët së prapi”; *i mbyti mackat* “i mbuloi të palarat”; *gjeti mana për trahana* “gjeti një shkak të kotë për të justifikuar atë që bëri” etj., ku fjalët e përmendura më sipër shërbejnë edhe si vatra kuptimore të të gjitha njësive frazeologjike.

### **6.8.2. Analiza sipas mendësisë popullore dhe botës shpirtërore**

Formimi i njësive frazeologjike lidhet me tradita e rite fetare e jofetare, që kanë të bëjnë me “botën” devollite apo me ngjarje historike që ka përjetuar devolliu në vite dhe i ka sendërtuar përmes gjuhës së vet, si dhe me tipare të karakterit të njerëzve etj., si: *s’bën vezë të kuqe* “s’ka pse të dallohet nga të tjerët”; *të lidhça buzën me shami* “vdeksh”; *të hëngsha grurët* “vdeksh”; *i ha preshtë nga bishti* “është dorështrënguar”; *mbi daulle një zurna (karadyzen)* “diçka shumë e tepërt”; *mbahet si e bija e sadrazemit* “është mendjemadhe”; *kërcen si çallmë moskovi* “është i lëvizur, nuk rri në një vend” etj.

Si formë e brendshme e njësive frazeologjike shërbejnë anekdota apo ngjarje të selitura përmes folklorit, të tilla si: *e kërkon si Zequa dhinë* “e bën një punë me shumë vonesë”; *s’pyet Muçoja për gjela deti* “nuk do t’ia dijë nga të tjerët”; *kur të shijë Hajdini urovë* “kurrë, asnjëherë”; *s’e ha hoxha (Cania) revaninë* “hiqet sikur nuk i pëlqen diçka”; *kërcen prifti nga belaja* “është i detyruar të bëjë si të tjerët”; *e bëri si prifti hostenë* “e prishi keq një gjë”; *është nga fshati i gruas* “ndihmon a flet mirë vetëm për njerëzit e sojit të gruas”; *s’ka më ha Muço, pi Muço* “mbaroi koha e bollëkut dhe e të mirave”; *opingën (opingat) e Sheros* “asgjë” etj.

### **6.8.3. Analiza sipas kulturës materiale**

Forma e brendshme e njësive frazeologjike lidhet me zeje e punë të tjera karakteristike për fshatrat e krahinës së Devollit, sidomos me traditën e bujqësisë e të blegtorisë, si: *me sëpatën e dardharit* “prerazi, pa e zgjatur”; *e di si plaka furkën* “e bën me lehtësi një punë”; *të korr killën* “është shumë i zoti në punë”; *në lëmë të duhanit* “kurrë, asnjëherë”; *i ndezi groshi* “e pësoi keq nga dikush” etj.

Në të mirë të kësaj çështjeje flet edhe fakti se shumica e njësive frazeologjike kanë në përbërjen e tyre fjalë të sferës së bujqësisë, të blegtorisë, etj., karakteristike për Devollin. Madje, njësitë frazeologjike këtu formojnë vargje të tërë, duke patur si vatër kuptimore fjalë të tilla, p. sh., FASULE: *është si fasulja në lule* “është ende i vogël, i papjekur”; *mbeti si fasule e ciknosur* “i kanë dalë të palarat, u zbulua për atë që kishte bërë”; *fasulja është mish i*

*fukarait* fj. u.; *përdridhet si fasulja në shkop* “tregohet dinak e dredharak në bisedë”; *aq i thonë fasulet* “është pa mend, sillet si i papjekur”; *zien si fasulja në poçe* “është i shqetësuar, ka diçka që e mundon”; *ziejnë fasulet në diell* “është shumë vapë” etj. DJATHË: *e hëngri sapunin për djathë* “u mashtrua”; *e hëngri djathën e Koles* “vdiq”; *e ka si bukë e djathë* “e ka të lehtë, nuk ka asnjë vështirësi për ta bërë”; *i zë djathi krimba* “nuk është nikoqir”; *iku djathi, mbeti hira* “humbi diçka e mirë dhe mbeti diçka e keqe”; *atij iu prish djathi, ti pyet për hirën* “ai e pësoi keq, ti merresh me gjëra pa rëndësi”; *e lë djathin pa shëllirë* “e lë punën në mes, nuk punon si duhet” etj. DHI: *di dhia ç’është tagjia* “i thuhet dikujt që nuk di të vlerësojë të mirën, të dobishmen”; *si dhia majë drizës* “në pozicion të vështirë”; *si dhia ndër dhen* “që dallohet lehtë nga të tjerët”; *i kanë ikur dhitë* “nuk është mirë nga mendtë”; *si dhia dhe kakërdhia* “njëlloj”; *hidhet si dhia në stapt të çobanit* “është shumë i lëvizur”; *ku i ke dhitë* “i thuhet dikujt që është i pavëmendshëm”; *mblidhi dhitë* “kujdes, mendohu mirë”; *dhia mish, capja mish* “e njëjta gjë, pa asnjë ndryshim”; *një nga dhija, dy nga vija* “thuhet kur bulmetin e hollojnë me ujë për ta shtuar si sasi”; *qesh dhia me delen se e ka bishtin të shtrembër* “tall dikë që s’duhet ta tallë”; *edhe dhi e zgjebosur e bishtin përpyetë* “i thuhet dikujt që mburret pa të drejtë” etj.

Faktet që sollëm më sipër për të gjetur formën e brendshme të njësive frazeologjike janë të karakterit jashtëgjuhësor. Ndërkaq, nuk mund të lihen jashtë vëmendjes edhe argumente thjesht gjuhësore, që flasin si për karakterin popullor të njësive frazeologjike, ashtu dhe për natyrën “devollite” të tyre. Kështu mund të përmendim ndërtimin e tyre mbi bazën e krahasimit të figurshëm (të shprehur ose të pashprehur), p. sh.: *si dielli pas qindie* “vonë”; *si gomari në pollog* “mirë, rehat”; *hapet si vaji na lakra* “flet a sillet pa u drojtur, duke e tepruar”; *e heq si Mitro Qorrin* “e merr pas ngado që vete”; *e lë si çobani gunën* “nuk kujdeset, nuk e vlerëson si duhet”; *rri si miu prapa poçes* “është në gjendje a pozitë të vështirë”; *si rroshkë e thatë* “shumë i dobët” etj., apo *u bë tym*; *e bëri gajde (daulle, kopan, kacek)* etj., ku krahasimi është i pashprehur. Krahasimi në të gjithë rastet bëhet me realie të njohura, madje shumë herë të dala nga përdorimi, por që kanë mbetur vetëm si gjymtyrë të njësive frazeologjike a shprehjeve të tjera të ngurosura.

Ajo çka është “devollite” nga visari frazeologjik i shqipes mund të dallohet edhe përmes raportit gjuhë letrare-gjuhë e folur, megjithëse një pjesë e mirë e njësive frazeologjike me burim nga e folmja e Devollit ka kaluar nga “rrethi” i kësaj të folmeje. Kjo ka ndodhur

për meritë të njerëzve të penës, shkrimtarë e publicistë devollinj, që kanë artitur mjaft fjalë e shprehje me burim popullor dhe i kanë shtënë fort bukur në veprat e tyre<sup>193</sup>.

Dritëro Agolli në veprën e tij ka përdorur me mjeshtëri qindra njësi frazeologjike të të folmes së Devollit, sepse frazeologjia gjuhësore, sidomos ajo popullore, është pjesë e pandarë e formës së shprehjes artistike, njësoj siç është leksiku dhe sintaksa.

“Forma e brendshme” e frazeologjisë popullore në veprën e Dritëro Agollit kundrohet për nga prania e gjymtyrëve përbërëse të njësive frazeologjike, si ato që shënojnë emërvende të krahinës së Devollit, leksiku me kuptim të përgjithshëm që është karakteristik për të folmen e Devollit dhe shërben si vatër kuptimore për shumë njësi frazeologjike, leksiku dhe frazeologjia që lidhen me tradita fetare dhe jofetare të popullit të Devollit, me anekdota dhe ngjarje të selitura përmes folklorit, me bujqësinë, blegtorinë dhe zeje të tjera karakteristike, me mënyrat se si urohet dhe mallkohet, gjetjet karakteristike për krijimin e eufemizmave etj. Veç individualizimit gjuhësor të personazheve, njësitë frazeologjike përdoren edhe për të dhënë ngjyresën lokale të ngjarjeve, sepse ato lindin në një vend të caktuar dhe në një kohë të caktuar. Edhe pse prirjen të bëhen pronë e mbarë folësve, ashtu sikurse dhe fjalët, njësitë frazeologjike ruajnë disa veçori të të folmes a dialektit. Këtë veçori shkrimtarët e përdorin edhe për të dhënë ngjyresën lokale të ngjarjeve, si: *s’e lan as lumi i Devollit* (“Komisari Memo”); *ç’na e do e bardha zemër* (“Komisari Memo”); *me kuçe e me maçe* (“Dështaku”); *tersi i Pojanit* (“Komisari Memo”); *si cironkë e tymosur* (“Arka e djallit”); *qeni qepën të hajë* (“Arka e djallit”); *trokashkë mulliri* (“Arka e djallit”); *u rrit kungulli mori gardhin* (Zhurma e erërave të dikurshme); *më març pleshtat* (Njeriu me top) etj.

Dihet që njësitë frazeologjike kanë figurshmëri të spikatur. Kjo është një veçori e përgjithshme e tyre. Duke qenë të figurshme, ato hyjnë drejtpërdrejt edhe në ndërtimin e figurave të tilla letrare, si krahasimi, metafora, hiperbola, ironia, sarkazma, metonimia etj. Ja disa shembuj: “Këtu jam *si dhia në mes të dhenve*/ më duket se kurrkush s’ma var” (“Poezi”); *O dreq i lajthitur/ më të rënçin mishrat/ unë jam sëmurë/ ti më kërkon cicat!* (Shpirti i gjyshërve); *Në tabut të lanë/ këmbët dhë s’u zunë/ Xheladin xherahu/ të futi në gunë* (Njeriu me top); *Ai nga buzët llullën hoqi/ e foli dy-tri fjalë: /”Që mos ia hajë qeni shkopin,/ pëllumbi im, o djalë.* (Udhëtoj i menduar) etj.

---

<sup>193</sup> Si shembull mund të sillet vepra e Dritëro Agollit, Sotir Andonit, Teodor Laços, Andon Andonit, Thanas Jorgjit, Thani Naqos, Bujar Brahos dhe të tjerë krijues me prejardhje nga krahina e Devollit.

## VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky punim është një përpjekje modeste për të dëshmuar edhe një herë se brenda formësimit aktual dhe praktik të shenjave gjuhësore “fshihet” një botëkuptim i caktuar, i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që e flet dhe se gjuha është një realitet mendësor, kulturor, etnografik, historiko-shoqëror. Lidhja e veshjes tingullore me bazën sendore-logjike është çështje perceptimi, reflektimi, botëkuptimi dhe se ndërliqësia e procesit krijues, me të cilin gjuhët përballen çdo ditë, buron së brendshmi nga dëshira që ka çdo bashkësi dhe kulturë për ta vulosur realitetin sipas mënyrës së vet.

Në përmbyllje të tezës së shtjelluar përgjatë kapitujve të këtij punimi lidhur me teoritë për formën e brendshme dhe zbatimin e tyre në një kuadër praktik shqyrtimesh kontrastive të materialit leksiko-frazeologjik të vjelë nga korpusi gjuhësor i shqipes dhe i disa gjuhëve indoevropiane, mund të nxirren disa përfundime, të cilat, në mënyrë të përgjithësuar, po i japim më poshtë:

**7.1.** Termin “formë e brendshme” e hasim për herë të parë në veprën e Humboldt-it, madje vetëm një herë te “Mbi gjuhën Kavi në ishullin Java”. Otto Funke dëshmon se rrënjët më të thella mund të gjenden te Shaftesbury, i cili flet për “formë të brendshme, thelbësore, të qenësishme” (inward form) në veprat e artit. Ishte James Harris-i që këtë term e përdori së pari edhe në fushën e gjuhësisë<sup>194</sup>. Vepra e Harris-it njihej nga Hajmann-i dhe Herder-i dhe besohet se përmes këtyre lidhjeve termi arriti deri te Humblodt-i, i cili e përshtati dhe e vuri në themel të filozofisë së tij të gjuhës. Që nga ajo kohë ky koncept nuk “u braktis” asnjëherë dhe u përdor gjatë nga autorë të ndryshëm, në kohë dhe vende të ndryshme, me përkufizime, kuptime dhe interpretime që ndryshojnë mjaft nga njëra-tjetra. Në fushën e artit kuptimi original lidhet me konceptin aristotelian për “formën” si “diçka e saktë, e përpunuar me finesë”. Humboldt-i e përdor me të njëjtin kuptim<sup>195</sup>, si antonim të fjalës “pa formë, amorfe”. Por, në kontekstin e përdorur nga Humblodt-i termi mbulon një fushë më të gjerë:

---

<sup>194</sup> Leopold W., *Inner Form*, Language, vol. 5, nr. 4, 1929, f. 254.

<sup>195</sup> W.V. Humboldt: *Die Sprachphilosophie Werke*, ed. Steinthal, Berlin 1883-84.

interpretimi statik pasurohet nga ai dinamik, forma e brendshme identifikohet me forcën vepruese, e quajtur në disa raste edhe “kuptimi i ligjërimit të brendshëm”, i cili i jep formë (e transformon) formën e papërpunuar, duke e ngritur (lartësuar) këtë të fundit në pozitën e formës ideale. Duke u mbështetur në teorinë kantiane të perceptimit, që ka vlerë universale, Humboldt-i e bëri formën e brendshme (innere Sprachform) të çdo gjuhe përgjegjëse për renditjen dhe kategorizimin e të dhënave të përvojës, pra, ata që flasin gjuhë të ndryshme, rrjedhimisht, jetojnë në botë pjesërisht të veçantë dhe kanë sisteme të ndryshme mendimi<sup>196</sup>.

Por ajo çka kuptohet nën këtë term është shumë më e gjerë dhe është shtruar e hulumtuar që së lashti. Nga shumica e gjuhëtarëve dhe e filozofëve të gjuhës është pranuar se gjuha nuk duhet parë si një produkt i vdekur (pa jetë), por si një proces krijues, ajo funksionin si një mjet komunikimi dhe ka një lidhje të fortë me veprimtarinë e brendshme shpirtërore. Thelbin e formës së brendshme të gjuhës e ka përimituar për bukuri Sh. Rrokaj, kur shkruan: *“Gjuha e një bashkësie nuk është vetëm një mjet i thjeshtë komunikimi, një rregullator i marrëdhënieve të gjithanshme shoqërore, ajo është një mjet që jep mundësinë për formimin e botëkuptimit të individit si pjesëtar i bashkësisë, si dhe shpreh gjithë zbërthimin e qenies së tij shpirtërore. Veçanësia e një gjuhe në raport me një tjetër, krahas dallimeve të njohura, qëndron edhe në faktin se çdo gjuhë përfaqëson në mënyrë shumë origjinale se si pjesëtarët e bashkësisë folëse perceptojnë marrëdhëniet e gjithanshme, nga ato ekzistenciale deri ato etnokulturore. Vetëm në gjuhën e tyre vlerat shpirtërore të një populli gjejnë mënyrën më të mirë të shprehjes, sepse ato nuk janë të krijuara jashtë kësaj gjuhe”*<sup>197</sup>.

Shkolla të ndryshme gjuhësore dhe filozofike, po ashtu dhe studiues të shumtë, i janë qasur kësaj çështjeje nga këndvështrime të ndryshme. Megjithë “mozaikun” e shtjellimeve dhe përkufizimeve për formën e brendshme, mund të themi se sot kemi një teori të plotë për këtë çështje, e cila mbetet në rend të ditës, ngaqë shpesh studiues të rinj, por edhe ata që kanë një përvojë të gjatë në fushën e gjuhësisë, i drejtohen asaj për gjuhë të ndryshme në kuadrin e gjuhësisë kontrastive apo gjuhësisë së aplikuar.

**7.2.** Leksiku i shqipes dhe i gjuhëve të tjera është një lëndë e gjallë gjuhësore për të kuptuar se në fazën më të hershme të përvijimit të sistemit bazë leksikor, i cili përbën edhe

---

<sup>196</sup> Robins R, vep. cit., f. 223.

<sup>197</sup> Rrokaj, Sh. *Çështje të gjuhës shqipe 1*, Albatros, Tiranë 2007, f. 263.

pjesën më të gjallë, më vepruese dhe organike të gjuhës, ku tërësia e tipareve të realitetit është konceptuar dhe më pas është gjuhësuar, duke u diktuar nga parimet dhe ligjësitë e brendshme, të përcaktuara natyrshëm dhe instiktivisht nga gjuhëfolësit. Forma e brendshme e gjuhës, si dëshmi e këndvështrimit të veçantë të folësve në një vend dhe në një kohë të caktuar, është sendërtuar në të gjitha klasat dhe nënklasat e leksikut.

**7.2.1.** Për të kuptuar dhe për të konkretizuar me shembuj formën e brendshme të gjuhës së një populli, duhet gjurmuar sa më thellë në histori nëpërmjet analizës etimologjike, si një metodë e frytshme për të arritur te forma e brendshme e fjalëve të shqipes. Etimologjia, veç të tjerash, mëton të studiojë edhe zonën e përhapjes sot e dikur të fjalës, mjedisi ku ajo u formësua, historia dhe zhvillimi i brendshëm i saj etj. Në këtë përfundim arrijmë duke u mbështetur në konceptin e prof. Çabejt, i cili analizën etimologjike e lidh ngushtë më formën e brendshme të fjalës. Analiza semantike dhe, sidomos, këqyrja e ndryshimeve kuptimore të fjalëve në rrjedhën e kohës, përveç shndërrimeve metaforiko-metonimike, dëshmojnë për karakterin origjinal të shqipes.

**7.2.2.** Shtjellimi i formës së brendshme të fjalët e prejardhura jep mundësi të tjera për t'u thelluar përmes shembujve dhe analizave konkrete. Në këtë lëndë gjuhësore, tema fjalëformuese bën që të motivohet kuptimisht fjala e prejardhur, pra që të gjendet forma e brendshme e saj. Shkalla e motivimit varet edhe nga qartësia e lidhjeve kuptimore ndërmjet temës fjalëformuese dhe fjalës së prejardhur. Në këtë rast, forma e brendshme e fjalës përfshihet në kuptimin e temës fjalëformuese, që mund të jetë fjalë rrënjë (kuptimi i parmë) ose një fjalë tjetër e prejardhur. Nga shembujt e analizuar vërehet se në pjesën dërrmuese të fjalëve të prejardhura motivimi i brendshëm është i kapshëm dhe gjendet lehtë, ai është mbivendosur natyrshëm mbi bazën e transferimit të imazhit, duke u bazuar në tiparet më dalluese, të cilat folësit i kanë gjykuar si identifikuese. Tiparet më karakteristike të realies së shenjzuar nga një fjalë e parme shërbejnë si temë semantike për fjalën e prejardhur dhe, sipas rastit, nxjerrin më në pah treguesit e formës, madhësisë, ndërtimit, funksionit, përdorimit, lëndës, përmbajtjes etj. Në të gjitha rastet motivimi është i dukshëm, edhe pse shkalla e figurshmërisë, për shkak të transferimit të kuptimit përmes tropeve gjuhësore, është më e lartë te fjalët e prejardhura. Fjalët e prejardhura që kanë të njëjtën rrënjë (pra që formojnë një familje apo një çerdhe), si formë të brendshme kanë kuptimin leksikor të temës



fjalëformuese, që, në këtë rast, është rrënja e fjalës. Duke ndërtuar çerdhen e fjalëve të 10 leksemave të përzgjedhura, arritëm në përfundimin se të gjitha kuptimet e fjalëve të prejardhura (të cilat nga pikëpamja numerike ishin përkatësisht: 41 për fjalën e parme *larë*; 26 për *lule*; 23 me fjalën *lesh*; 24 për *sy* etj.) formën e brendshme e kanë të lidhur drejtpërsëdrejti me kuptimin e fjalës rrënjë, pavarësisht nga përkatësia e tyre leksiko-gramatikore.

**7.2.3.** Forma e brendshme mund të hulumtohet edhe përmes dukurisë së homonimisë. Homonimet e këqyrura për nga motivimi i formës së brendshme tregojnë se ajo përmbahet në kuptimin e fjalës homonime parake dhe përputhet plotësisht me të sipas veshjes tingullore. Në fjalët homonime që sillen në vështrim, vërehet se kemi të bëjmë me procesin e prejardhjes semantike nga polisemia në homonimi, pra, kalimi nga rrafshi i brendshëm (struktura kuptimore e fjalës së parë, etimonit homonimik) në rrafshin e jashtëm, duke krijuar një fjale të re homonimike, e cila, si formë të brendshme (motivim) ka kuptimet ose një nga kuptimet e fjalës së parë homonimike, që shërben si *temë themelore fillestare*. Nga shqyrtimi i homonimeve semantike që u përzgjedhën nga fjalori (rreth 30 njësi), del se përftimi i tyre bëhet mbi bazën e tropeve të ndryshme gjuhësore, si: metafora, metonimia, sinekdoka etj.

**7.2.4.** Qasja drejt formës së brendshme të emrave të përveçëm tregon se shqipja ka një origjinalitet të veçantë krijues në mënyrën se si e ka pasuruar spektrin e emrave, duke shfrytëzuar sfera të ndryshme të jetës materiale dhe shpirtërore, për të ruajtur autenticitetin dhe për të mbajtur gjallë karakterin kombëtar. 277 antroponimet e sjella në vështrim tregojnë se emrat e përveçëm të shqiptarëve janë krijuar kryesisht mbi bazën e emrave abstraktë, të emërtimeve të botës bimore dhe shtazore, përmes prejardhjes nga emra të natyrës në përgjithësi, sipas antroponimeve nga emra të përveçëm, si: male, fusha, lumenj etj., shumica e të cilëve janë kompozita, të formuara mbi bazën e krahasimit të një cilësie të dallueshme të referentit.

**7.2.5.** Në lëndën gjuhësore të marrë në analizë për shqyrtimin e formës së brendshme mund të sillen edhe emrat-terma që përdoren vetën në numrin shumës. Ky “status” leksiko-gramatikor realizohet për shkak të formës së tyre të brendshme: një tipar karakteristik i një realieje bëhet shenjues i të gjitha realieve që kanë të përbashkët këtë tipar, duke i përmbledhur ato në një klasë të caktuar. Për shembull, *kërcorët* “klasa e peshqve që e kanë

skeletin kërcor”, nën këtë term shenjohen të gjithë llojet e peshqve që i bashkon pikërisht ky tipar “skelet kërcor”, që përbën edhe formën e brendshme të tyre; *kryqore* “bimë barishtore që i kanë petlat dhe nënpetlat në formë kryqi”, ku tipari i dallueshëm “formë kryqi” është formë e brendshme për të gjitha bimët që e kanë të përbashkët këtë tipar.

**7.2.6.** Për analizën dhe konkretizimin e formës së brendshme nuk mund të lihet jashtë vëmendjes edhe një dukuri e kahershme etno-gjuhësore, siç është ajo e nofkave, pra krijimi dhe përdorimi i emrave familjarë ose humoristikë i njerëzve në vend të emrave të tyre të vërtetë. Të cilësuarat si arkaizma provinciale dhe rajonale, përzgjedhja leksikore e këtyre mjeteve gjuhësore është plotësisht e motivueshme dhe e kushtëzuar kryesisht nga rrethana apo faktorë etnogjuhësorë, rajonalë, fetarë, shoqërorë etj. Gjeografia e shpërndarjes dhe denduria e përdorimit të mjeteve të tilla gjuhësore është e njëtrajtshme për të gjitha hapësirat shqiptare dhe dukuria është pothuajse e barasvlerëshme në të dyja dialektet dhe në tërësinë e korpusit të të folmeve. Uniformiteti i vërejtur mund të përbëjë një argument mbështetës për idenë se prirja për të etiketuar apo karakterizuar individët mbi bazën e një stereotipie të caktuar është produkt i mendësisë dhe psikologjisë popullore. Përpos të gjithave, trajtat e pafundme dhe reflektimet e ndryshme, pasojë e qasjeve të ndryshme ndaj realitetit, kanë bërë “pronë” dhe “pasuri” të leksikut popullor një mori përzgjedhjesh. Tipologjia e përzgjedhjeve leksikore (në analizën tonë u morën në shqyrtim rreth 200 nofka) është shumë interesante: bashkësia shqipfolëse nuk zgjedh ta nominojë dikë “rastësisht”, përkundrazi, të gjitha nofkat janë sendërtuar mbi bazën e perceptimeve individuale apo grupe të cilësive (tipareve) të dallueshme të individëve, të cilat më pas janë bërë përcaktuese, diferencuese dhe identifikuese si emra përgjithësues për grupe apo bashkësi individësh me të njëjtën përkatësi shoqërore apo territoriale. Duke analizuar tipologjinë e emërimit të nofkave vërehet se shqiptarët përgjithësisht zgjedhin tregues të tillë, si: tiparet apo ndërtimin e trupit të njeriut, cilësitë e dallueshme si defekte, cene, paftësitë fizike, tiparet e karakterit, cilësitë pozitive apo negative, sikundër dhe profesionet apo përkatësitë fetare dhe etnike.

**7.2.7.** Potenciali gjuhësor dhe vetë tipologjia e leksikut popullor, gjerësia dhe shkalla e lartë e përhapjes dhe përdorimit të njësive të tilla leksikore, krijojnë mundësi të shumta që sinonimia leksikore të shqyrtohet edhe si shprehje e realizimit të formës së brendshme. Sinonimia leksikore dialektore jep ide të qarta dhe mundësi potenciale për të kuptuar se si e ka shfrytëzuar fjalën një bashkësi folëse, e cila, përveç vlerave, mendësive të përbashkëta

dhe mënyrave për ta perceptuar realien nga këndvështrime të ndryshme, duke paraqitur jo vetëm larmi nga pikëpamja tipogjike dhe strukturore, por edhe pasuri të vlerësueshme për nga pikëpamja e nuancave kuptimore dhe ngjyresave emocionuese që mbartin këto shenja.

Kjo shumëllojshmëri e vargjeve sinonimike nuk ka si të mos shihet e lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë krahinore, me kulturën materiale, me përvojën njerëzve, me veçoritë e jetës shpirtërore, elementë, të cilët, së bashku, përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të një bashkësie gjuhëfolëse. 298 sinonimet dialektore të skeduar nga lëma e leksikut popullor argumentojmë bindshëm se edhe brenda të njëjtimit komunitet gjuhësor, folësit e një gjuhe e perceptojnë, e kuptojnë apo e interpretojnë realitetin objektiv në mënyra të ndryshme dhe se mjetet e përzgjedhura për të shenjuar një realie, për të komunikuar një ide apo një përmbajtje të caktuar, ndryshojnë jo vetëm nga dialekti në dialekt, por edhe nga e folmja në të folme. Dallimet jo të pakta dialektore në fushën e leksikut të bindin se faktorët ekstralinguistikë (jashtëgjuhësorë), ndër të cilët do të përmendim: faktorët shoqërorë, kulturorë, ekonomikë, etnografikë, gjeografikë, të kulturës materiale, të lidhur ngushtë me mënyrën e jetesës, me parapëlqimet dhe shijet, qëndrimet ndaj zhvillimeve shoqërore, paragjykimet, kushtet mjedisore, normat dhe zakonet, traditat, doket krahinore marrëdhëniet me fqinjët etj., janë faktorët më domethënës dhe elementet më përcaktues në formimin e leksikut krahinor, sikurse, në të njëjtën kohë, dhe mund të renditen ndër shkaqet kryesore të dallimeve dialektore.

**7.3.** Analiza e kompozitave për të zbuluar “formën e brendshme” të tyre, mund të bëhet duke shqyrtuar emërtimin e realieve mbi bazën e *një tipari të caktuar*, i cili lidhet me një shkallë mjaft të hershme të zhvillimit shoqëror e botëkuptimor dhe ka shërbyer si bazë për motivimin e kompozitave. Ajo çka vërehet gjatë analizës së kompozitave mbiemra (rreth 977 njësi të tilla) është fakti se veshja gjuhësore apo përzgjedhja e elementeve gjuhësore për të shenjuar të njëjtën realie, nuk është gjithmonë e njëjtë, që do të se dhe brenda të njëjtimit komunitet gjuhësor, folësit e një gjuhe e perceptojnë, e kuptojnë apo e interpretojnë realitetin objektiv në mënyra të ndryshme dhe se mjetet e përzgjedhura për të shenjuar një realie, për të komunikuar një ide apo një përmbajtje të caktuar, ndryshojnë jo vetëm nga një gjuhë te tjetra, por edhe brenda një gjuhe, nga dialekti në dialekt apo nga një e folme në tjetrën.

**7.3.1.** Megjithë karakterin e ndërmjetuar të shenjimit të tiparit dhe mënyrat e cilësimit të pjesës që zotëron realia, kompozitat sjellin drejtpërsëdrejti parapërfytyrimin për dukuri të

caktuara të realitetit. Zbërthimi i përbërësve semantikë në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit tregon se interpretimi i lidhjeve dhe raporteve të cilësimit dhe shkallëzimi i tyre bëhet gjithmonë në raport me qëndrimin subjektiv të folësit, përkundrajt vlerësimit të tiparit që do të nxjerrë në pah dhe referentit të cilit ky tipar i vishet, çka bën që këto shenja gjuhësore të jenë të ngarkuara me nuanca kuptimore dhe ngjyime emocionuese.

Gjatë analizës semantike të motivimit të brendshëm sipas tipareve të referentit vihet re se gjymtyra e strukturës së përbërë, ajo që mbart edhe konceptin, është një pjesë e trupit të njeriut dhe gjymtyra plotësuese mbiemërore (ajo që mbart ngarkesën kuptimore dhe emocionuese) është zakonisht një mbiemër që shënon, sipas rastit, tipare fizike dalluese të ngjyrës, tregues të cilësive të jashtme të lidhura me formën, gjatësinë, madhësinë, butësinë, ashpërsinë. Tiparet referenciale, që janë formësuar strukturalisht me anë të këtyre mjeteve gjuhësore, u asociohen kryesisht treguesve të jashtëm të fytyrës, trupit, aftësive fizike ose mungesës së tyre. Shumica e leksemave të përbëra, përveçse i kanë shprehur cilësitë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësinë e ndonjë referenti tjetër, u janë nënshtruar lëvizjeve semantike, duke zgjeruar kuptimin dhe duke fituar një kuptim të ri të figurshëm, madje duke zgjeruar edhe strukturën kuptimore në kushtet e shumëkuptimësisë ku këto njësi “gjallojnë”.

**7.3.2.** Një dukuri tjetër shumë e rëndësishme e vërejtur gjatë analizës së gjedheve më të spikatura në formimin e kompozitave mbiemra të shqipes është cilësimi i tiparit në mënyrë të ndërmjetuar, pra nëpërmjet krahasimit me një realie tjetër, duke i veshur të shenjuarit një nga tiparet dalluese të saj. Pjesa më e madhe e formimeve të tilla kanë në bazë metaforën, me anën e së cilës janë përftuar një varg njësisish leksikore. Në mendësinë dhe përvojën kolektive të folësve të gjuhës shqipe, tiparet e realieve të përzgjedhura, të cilat qëndrojnë në thelb të bërthamës kuptimore që formëson njësitë e metaforizuara, e mishërojnë dhe e transmetojnë më së miri tiparin e qenësishëm që i identifikon ato, edhe për faktin se këto realie janë provë e njohjes konkrete që ata kanë me ata çka i rrethon, ndaj edhe struktura të tilla i rrinë kaq mirë dhe i vijnë kaq për shtat shqipes. Duke i njohur me hollësi të gjithë treguesit e realies, folësit e shqipes i shndërrojnë natyrshëm këto njësi në konstrukte semantikisht të figurshme. Metafora është kaq e fuqishme në të gjitha rastet e analizuara, sepse buron së brendshmi dhe merr jetë nga qasjet dhe perceptimet e ngushta, të përditshme të realitetit. Të gjithë referentët u përkasin kulturës materiale, karakterit bujqësor dhe blegtoral të jetës së banorëve, të gjitha

të prekshme, të kapshme, konkrete dhe të nevojshme. Ndër të tjera, duhet theksuar fakti se një pjesë e leksemave që janë që u përgjigjen referentëve të cilësuar i përket lëndës gjuhësore të fondit të vjetër të leksikut popullor apo një leksiku më të specializuar, por që gjallon në letërsinë artistike dhe në folklor.

**7.3.3.** Analiza e kompozitave, si një nga mjetet më të fuqishme të pasurimit të leksikut të shqipes, na dha mundësi të shqyrtojmë nga pikëpamja praktike se dukuritë gjuhësore janë të lidhuara njëkohësisht me rrafshin e realitetit dhe të mendimit, me mënyrën se si një bashkësi gjuhësore e abstragon realitetin duke nxjerrë në pah tipare të veçanta të realieve, me mjetet që kjo bashkësi përzgjedh për të përpunuar formën e shprehjes, imazhet psikike që folësit sendërtojnë gjatë procesit të pëshfaqjes së koncepteve, me përfytyrimin që kanë këta të fundit për botën që i rrethon duke “prodhuar” një shumësi shenjash të ndryshme, origjinale dhe lehtësisht të dallueshme nga njëra- tjetra. Dhe, në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se këto shenja gjuhësore kanë formuar vargje të zgjeruara sinonimike, sikurse dhe një tërësi fushash konceptore dhe leksikore të bazuara te treguesit themelorë të realies, të përzgjedhur dhe të sintetizuar mendërisht në bazë të perceptimeve të ndryshme për të asociuar simbolikën tingullore me një përkatësi “natyrore” të përmbajtjes së fjalës. Në rastin e kompozitave, “substancia kuptimore” e lidhur me tërësinë e perceptimeve, qëndrimeve subjektive të folësve, ndjenjave dhe abstragimeve mendore, sipas mendimit tonë, është e ndryshme.

**7.3.4.** Kah kompozitave ekzocentrike, një tip tjetër shumë prodhimtar i fjalëformimit në shqipe janë edhe kompozitat dëshirore. Ndërthurjet e gjymtyrëve janë të llojllojshme dhe nga ana semantiko-leksikore marrëdhëniet mes realies me përcaktuesin e saj dëshiror realizohen në mënyrë të ndërmjetuar e mjaft të ndërlikuar. Në përgjithësi, përmbajtja kuptimore e kompozitës mund të barazohet kuptimisht me fjali të plota të tipit dëshiror në formë mallkimi. Struktura kuptimore dhe semantika dëshirore e këtyre njësive është e ndryshme dhe mjaft origjinale. Semantika dëshirore sendërtohet në kompozita njëkuptimëshe me vlerë mallkimi, ku vdekja, skamja, lëngata, moslënia e pasardhësve, fatkeqësitë, mundimet, lëngimet, sëmundjet apo paaftësitë mendore, janë të shenjuarit mbi të cilët ngjizet forma e shprehjes së kuptimit dëshiror.

**7.3.5.** Pronë dhe pasuri e paçmueshme e leksikut të përgjithshëm, por edhe atij të specializuar në fushën e botanikës dhe zoologjisë, janë kompozitat terma. Përfundime po kaq

interesante gjetëm edhe në këtë sferë të përdorimit të strukturave të përbëra (rreth 78 njësi) lidhur me motivimin e brendshëm të këtyre njërive. Motivimi i brendshëm i kompozitave terma është i mbështetur plotësisht mbi bazën e perceptimeve të sakta të imazheve dhe shembëllimeve të realieve dhe është po kaq lehtësisht e përligjur me përzgjedhjen e duhur leksikore që kanë bërë shqipfolësit. Këto emërtime janë të zbërthyeshme strukturalisht dhe semantikisht dhe, gjatë analizës, rezulton se treguesit e ngjyrës, formës, mënyrës së lëvizjes/veprimit, funksionit, rrezikut apo dobisë, përkufizojnë semantikisht edhe gjymtyrën përcaktuese të emërimit. Veç të tjerash, metafora e ndërtuar mbi krahasimin dhe shndërrimin e figurshëm të imazheve të perceptuara nga një realie te një tjetër mbi bazën e ngjashmërive të dukshme, ka përfutur një varg kompozitash terma. Elementët e krahasuar në pjesën më të madhe janë kafshë, bimë apo dhe objekte konkrete.

**7.3.6.** Analiza kontrastive e kompozitave u realizua midis tri gjuhëve: anglishtes, italishtes dhe frëngjishtes. Mënyra se si folësit e këtyre gjuhëve e konkretizojnë realitetin objektiv në njësi gjuhësore është pashmangshmërisht e lidhur me natyrën e gjuhës, traditën, mendësinë, veçoritë psikologjike, shkallën dhe nivelin e abstragimit, me situatat konkrete të ligjëritimit aktual dhe, mbi të gjitha, me qasjen dhe bashkëpërkimet që folësit e kësaj gjuhe gjejnë midis elementeve të realies dhe tërësisë së veshjeve gjuhësore për ta konkretizuar këtë realie. Nga analiza e strukturës semantike dhe e përbërësve leksikorë të çifteve përkatëse sinonimike, vihet re se në pjesën më të madhe të rasteve në gjuhën shqipe shkalla e lartë e abstragimit ka bërë që procesi i emërimit të realizohet nëpërmjet një krahasimi të ndërmjetuar, ku shndërrimet metaforike kanë sendërtuar dhe konkretizuar një varg shenjash gjuhësore, ndërkohë që në përkatëset leksikore sinonimike të anglishtes, italishtes dhe frëngjishtes, qasja me tiparet konkrete të realies është më e drejtpërdrejtë, jo e nënkuptuar apo e ndërmjetuar. Aftësia për të abstraguar është e lidhur ngushtë me aftësinë që kanë folësit e një gjuhe për të njohur elemente të veçanta të realitetit objektiv apo përbërës të caktuar të këtyre referentëve. Përzgjedhjet leksikore janë pikërisht dëshmi e perceptimit që individët folës kanë për botën dhe raportet që kjo bashkësi ndërton me realitetin, nëpërmjet lidhjeve të shumta asociative që përshfaqin nivele të ndryshme shumëformësie dhe shumëkuptimësie.

**7.4.** Në togfjalëshat terminologjike, si emërtime të përbëra, pasqyrohet më së miri botëkuptimi i një kombi, një bashkëjetesë midis formimit kulturor dhe rrjedhës së historisë, si shprehje e pastër e lëndës shpirtërore dhe mendësisë gjithnjë e në zhvillim. Treguesit sasiore

dhe larmia e strukturave të përdorura, flasin jo vetëm për një origjinalitet të theksuar të veçorive gjuhësore, por bëhen edhe dëshmi e vlerave etnokulturore të trevave shqiptare. Konceptet që përdoren si bazë logjike për krijimin e kuptimeve leksikore “marrin jetë” nga realie të gjalla, të prekshme, të lidhura me jetën reale të banorëve të këtyre trevave dhe, duke gjykuar mbi bazën e përthyerjes që këto njësi shfaqin në realizimet konkrete ligjërimore dhe vëllimit të gjerë semantik që ato kanë, na japin mundësi të plota dhe konkrete për të kuptuar se këto krijime origjinale janë produkt i mendësisë së folësve të kësaj gjuhe, duke reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kufijtë e botës së tyre dhe perceptimin që ata kanë për atë çka i rrethon. Përmes togfjalëshave terminologjike, kryesisht nga fusha e botanikës dhe biologjisë, mund të kuptohet qartë se baza sendore-konceptore, mbi të cilën folësit e një gjuhe kanë realizuar procesin e emërimit, është e lidhur me përvojën e drejtpërdrejtë dhe cilësitë e dallueshme të sendeve në botën fizike dhe se raporti korrespondues midis realies dhe simbolikës tingullore është i përligjur me vetitë dhe veçoritë e dukshme të botës fizike. Pikërisht për këtë, kuptimi leksikor i këtyre njësive është lehtësisht i zbërthyeshem dhe përkatësia “natyrore” duket se është tipari dallues i këtyre shenjave gjuhësore.

**7.5.** Analiza semantike dhe strukturore e njësive eufemistike mbi bazën e konceptit të formës së brendshme të gjuhës, tregon qartë mënyrën se si është perceptuar realia dhe si është formësuar gjuhësisht ajo nga bashkësia folëse. Prania e një vargu të gjatë sinonimesh eufemistike, përveçse janë dëshmi interesante e një faze të hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, shërben për të kuptuar më mirë se njerëzit kanë zgjedhur shenja të ndryshme gjuhësore, duke nxjerrë në pah aspekte të veçanta të realies, duke u bazuar në perceptime, këndvështrime, botëkuptime apo mendësi të ndryshme dhe në shkallë jo të njëjta zhvillimi shoqëror apo kulturor. Spektri i gjerë i variacioneve dialektore apo krahinore nuk ka si të mos shihet i lidhur me faktorët historikë dhe gjeografikë, me botëkuptimin dhe mendësinë e njerëzve të këtyre rajoneve, me kulturën materiale me përvojën psikologjike, me veçoritë e jetës shpirtërore, elemente që, së bashku, përfaqësojnë dhe manifestojnë të kuptuarit e pjesëtarëve të një bashkësie gjuhëfolëse.

**7.5.1.** Eufemizmat tradicionalë të shqipes janë prurje leksikore të lidhura ngushtë me jetën e përditshme, me kafshët grabitqare, me sëmundjet e pashërueshme dhe me fuqi të mbinatyrshme e të pashpjegueshme. Nga një analizë statistikore e eufemizmave të vjelë nga fjalorët dhe doracakët dialektorë dhe krahinorë, u vërejt se varietetet gjuhësore që kanë

prodhuar numrin më të madh të sinonimeve eufemistike lidhen me kafshët: *ujk, gjarpër, bukla, dhelpër, milingonë*; në lëmin e figurave të besimit popullor janë ato për *djallin (dreqin), zotin, të keqen, sëmundjet e pashërueshme* etj. Në të gjitha rastet e sjella për shqyrtim, motivimi më i pranueshëm për përzgjedhjen e njësive gjuhësore është një përqsje, një “ngatërrim” midis emrave të sendeve dhe vetë sendit.

**7.5.2.** Studimi kontrastiv i eufemizmave të shqipes me ato të anglishtes dëshmon edhe për një fakt tjetër të rëndësishëm: eufemizmat janë të lidhura ngushtë me përditshmërinë, me paditurinë dhe pamundësinë kolektive, me kushtet e vështira natyrore dhe ekonomike etj. Eufemizmat e anglishtes nuk janë aspak zëvendësime leksikore për realie tabu, kafshë apo sëmundje, por janë kryesisht “doublepeak”. Ato hasen zakonisht në fushën e leksikut që lidhet me politikën, ushtrinë, tregtinë etj. Përveç këtyre, një grup i madh eufemizmash pozitivë përfshijnë tituj nderues (honorifikë), kryesisht për profesionet, si dhe ato për marrëdhëniet seksuale, kriminalitetin, pijen, shtazaninë etj.

**7.6.** Një fushë mjaft interesante, që ka tërhequr vëmendjen e disa studiuesve shqiptarë dhe të huaj, është studimi i njësive frazeologjike (i idiomave) për nga motivimi i brendshëm, pra “zbulimi” i formës së tyre të brendshme. Dihet që idiomatika është një tipar i qëndrueshëm dhe i përhershëm i gjuhës. Pavarësisht nga termat që janë përdorur për të shprehur këtë koncept, mund të themi se në gjuhësinë shqiptare dhe atë botërore janë studiuar disa prej rrugëve dhe mjeteve për të gjetur formën e brendshme të idiomave, madje edhe për përkufizimin e saj. Në pjesën më të madhe idiomat mund të motivohen dhe mund t’i përgjigjen një logjike të identifikueshme, por edhe lidhjet e qarta (të shprehura) ndërgjuhësore mund të shërbejnë për të kuptuar pasqyrimin e të përbashkëtave konceptore. Vargjet idiomatike dy ose trigjuhëshe na ndihmojnë të kuptojmë dhe të konceptojmë veprimtaritë dhe tiparet njerëzore. Një nga veçoritë më të spikatura të njësive të figurshme konvencionale si idiomat, është se ato nuk mund të kuptohen pa iu adresuar një njohjeje të thellë kulturore. Metaforat më të spikatura nuk lidhen drejtpërdrejt apo vetëm me njohuri të mirëfillta gjuhësore. Në mënyrë që të përcaktohet se si funksionojnë idiomat dhe se si mund të zbulohen tiparet kuptimore dhe pragmatike, duhen marrë parasysh edhe faktorët jashtëgjuhësorë, të cilët mundësojnë kalimin nga kuptimi i drejtpërdrejtë tek ai i figurshëm.

**7.6.1.** Duke qenë se idiomat janë shtresë më vete e leksikut, ato nuk mund të analizohen mjaftueshëm me anë të instrumenteve metagjuhësorë, sepse ndryshimi midis



njësive gjuhësore figurative dhe jofigurative qëndron pikërisht në mënyrën se si folësit kodojnë lloje të ndryshme të njohurive. Idiomat regjistrojnë dhe ruajnë njohuri të vlefshme si pjesë e planit të përmbajtjes (në formën e gjurmëve, njollave të imazhit), duke reflektuar tiparet e kulturës përkatëse. Një nga problemet më kryesore semantike për idiomat është përshkrimi dhe shpjegimi se si janë të lidhura mes tyre kuptimet dhe nivelet e kuptimit. Sa më e fortë të jetë kjo lidhje, aq më e motivueshme është idiomat. Motivimi i idiomave, pra “zbulimi” i formës së brendshme të tyre, mund të bëhet mbi bazën e mjeteve që realizojnë shndërrimin e figurshëm të togfjalëshave të lirë në njësi frazeologjike. Roli i kulturës bëhet edhe më i rëndësishëm në rastet e krahasimit midis gjuhëve apo dialekteve. Ajo çka duket natyrale dhe e padiskutueshme nga perspektiva e një kulture, mund të jetë konvencionale nga perspektiva e variacionit gjuhësor dhe kulturor të një bashkësie tjetër. Në lëmën e idiomave, natyra identike e qenieve njerëzore prodhon më pak lidhje të motivueshme midis imazheve mendore dhe kuptimeve aktuale, sesa mund të prodhohen nga pikëpamja e krahasimeve midis kulturave të popujve të ndryshëm.

**7.6.2.** Siç dihet, kalket frazeologjike janë përkthime fjalë për fjalë nga gjuha burimore dhe gjenden si të tilla në shumë gjuhë dhe përdoren gjithandej në ligjërimin e shkruar për arsye të përmbajtjes së ngjeshur si “esenca” e lëndëve të ndryshme, që ka dalë nga “kullimi” i ngjarjeve historike, i ndodhive të fabulave e të legjendave, i mendimeve dhe i veprimeve të moralshme e të pamoralshme, i përfundimeve prekëse në jetë e në legjendë. Këto njësi bashkojnë përvojat historike, kulturore, psikologjike etj. Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, shprehjet e huazuara duhet të vështrohen si shenjë e marrëdhënieve të ndërsjellëta në kulturat e popujve të ndryshëm.

Në qoftë se te njësitë frazeologjike dhe shprehjeve të tjera idiomatike, në një pjesë të madhe të kësaj lënde gjuhësore, kundrohen ato veçori a tipare që i bëjnë të veçanta nga një gjuhë në tjetrën, çka i bën ato të papërkthyeshme fjalë për fjalë, te kalket frazeologjike mund të flitet për konceptin e universaleve në gjuhë, ngaqë kjo “materie” gjuhësore gjendet njëlloj, në ndërtim dhe në kuptim, për shumicën e gjuhëve, pavarësisht nga përdorimet dhe transformimet strukturore dhe semantike në gjuhë të ndryshme.

## VIII. REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

- Agalliu F. & Memushaj, R. & Reso, M. *Hyrje në gjuhësi*, ShBLU, Tiranë, 1989.
- Ahmanova O. S., *Slovar lingvističeskih terminov*, Moskva, 1969.
- Alen K. & Burridge K., *Euphemisms and Dysphemisms language used as a shield and weapon*, Oxford University Press, 1991.
- Aligihieri D., *Mbi të folurin e popullit*, “Nëntori”, nr. 5, 1965, përkthyer nga A. Kasimati.
- Aligihieri D., *Komedia Hyjnore*, Parajsa, Tiranë, 1966.
- Alliday M. A. K., *Language as a social semiotic*. London, Edward Arnold, 1978.
- Barthes R., *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008.
- Bejta B., *Gjuha dhe të folurit*. Buzuku, Prishtinë 2007.
- Bernhard Walchli, “*Quantifying Inner Form*” *A Study in Morphosemantics*, Bern, 2011.
- Bexheti V. etj., *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*, Tetovë, 2008.
- Bidollari, Ç., *Fjalor i patronimeve të shqiptarëve*, QSA, Tiranë, 2011.
- Blis, A. J., *A Dictionary of Foreign Words & Phrases in Current English*, London, 1968.
- Burridge K., *Lexicon. Political correctness; euphemisms with attitude*, English Today, 1996.
- Cardona G. R., *I sei lati del mondo, Liguaggio ed esperienza*. Editori Laterza, 2011.
- Cavalli L. L. *Gjenet, popujt dhe gjuhët*, Besa, Tiranë, 2012.
- Chollet I & Robert J., *Précis Les expressions idiomatiques*, CLE, 2008.
- Cipo K., *Rreth disa kompozitave në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I. Tiranë, 1972.
- Cowie A.P., *Semantics*, Oxford University Press, 2009.
- Çabej E., *Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe*, Studime Gjuhësore, 1, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- Çabej E., *Disa eufemizma të shqipes*. Studime Gjuhësore, 4, Prishtinë, 1977.
- Çabej E., *Studime etimologjike të gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1982.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VII, Tiranë, 2005.
- Çabej E., *Hyrje në indoevropianistikë*, Çabej, Tiranë, 2008.

- Daka P., *Mbi disa dukuri të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*. Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, III, Tiranë, 1969.
- Dhima Th., *Histori e gjuhësisë*, Infbotues, Tiranë, 2014.
- Baccaria G. L., *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Einaudi, Torino, 2004.
- Dobrovolskij D. O. & Piirainen E., *Figurative Language: Cross-cultural and Crosslinguistic Perspectives*, Amsterdam, 2005.
- Dobrovolskij, D. O. & Piirainen E., *Cognitive theory of metaphor and idiom analysis*, Jazikosloviye, 6, Moskow, 2005.
- Dobrovoskij D. O. & Baranov A.N., *Cognitive modeling of actual meaning in the field of phraseology*, Journal of pragmatics, 1996.
- Doku S., *Fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip*, Tiranë, 1998.
- Dubois M., *Modern French-English dictionary*, Larousse, Paris, 1969.
- Dubois J. etj., *Dictionaire de linguistique*, Larousse, Paris, 2001.
- Durmishi I., *Tabutë dhe eufemizmat*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2010.
- Durmishi I., *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012.
- Duro I & Hysa, R., *Fjalor shqip-anglisht*. Tiranë, 1988.
- Duro A., *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.
- Duro A., *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
- Eco U., *Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën europiane*, Dituria, Tiranë, 2008.
- Elezi M., *Fjalor i gjuhës shqipe*. Fishta, Shkodër, 2006.
- English idioms and how to use them*, Oxford University Press, 1978.
- Fida A., *Fjalor frazeologjik Italisht-Shqip*, Tiranë, 1998.
- Fjalor i termave të gjuhësisë (shqip, rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1975.
- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- Flavell L. & R., *Dictionary of Idioms and Their Origins*, London, 1994.
- Flora e Shqipërisë* Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1988.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1996.

- Gjinari J. & Shkurtaç Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003.
- Gosturani Xh., *Historia e gjuhësisë botërore gjatë shekujve*, Erik, Tiranë, 1993.
- Graffi G., *Ç'është gramatika gjenerative*, Toena, Tiranë, 2010.
- Hand P., *Dictionary of Idioms*, Chambers, 1996.
- Hudson R., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2004.
- Humboldt W.V., *On the differences of the human Sprachbaues and its influence on the mental development of the human race*, Stuttgart, 1963.
- Ibrahimi M., *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmeve shqiptare*, Interlingua, Shkup, 2009.
- Jashari A., *Përsiatje për gjuhën shqipe*. Korçë, 2003.
- Jashari A., *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë, 2000.
- Jashari A., *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2007.
- Kadare I., *Vepra 15, SPIRITUS*, Onufri, 2009.
- Kçiku R., *Fjalor i gjuhësisë*, Educa, Ferizaj, 2009.
- Kostallari A., *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972.
- Kostallari A., *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972.
- Kostallari A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972.
- Kostallari A., *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë, 1972.
- Krasniqi M., *Gjurmë e gjurmime*. Tiranë, 1982.
- Kretchmer P., *Ditunija gjuhësore indogjermane*, Fryma, Tiranë, 2007.
- Kryeziu B. & Jashari A., *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008.
- Lakoff & Johnson, *Cognitive theory of metaphor*, Chicago, University of Chicago Press, 1980.
- Lakoff G. & Johnson, M. (1980). *Metaphors we live by*, Chicago.
- Lamarque P., *Concise encyclopedia of philosophy of language*, Edinburgh, 1997.
- Leech G., *Semantics*, 1974 .
- Leka F. & Simoni Z., *Fjalor italisht shqip*, Tiranë, 2002.

- Leontoviç, O., *The Role of the Inner form in the Contextual Stylistic Use of Idioms*. In Phraseological Semantics. # 211. – Moscow, Moscow Institute of Foreign Languages, 1983.
- Leontoviç, O., *The Problem of the Inner Form of Idioms in the Nominative Aspect*. In Phraseological Semantics in Paradigmatics and Syntagmatics. # 226. Moscow: Moscow Institute of Foreign Languages, 1984.
- Leontoviç, O., *The Role of the Inner Form in the Structure of Phraseological Meaning*. INION of the Academy of Sciences of the USSR. "New Soviet Literature on Social Sciences," 1987.
- Leontoviç, O., *The Problem of The Inner Form of Idioms (on the material of the English Language)*. Doctoral dissertation. Moscow: Moscow Institute of Foreign Languages, 1987.
- Leontoviç, O., *The Syntagmatic Aspect of the Inner Form of Idioms*. In Syntagmatic Approach to Words, Word Combinations and Sentences. - Volgograd: Volgograd State Pedagogical University, 1988.
- Leontoviç, O., *Neutrality of the Inner Form of Idioms in the Context in Communicative Aspects of Meaning*. - Volgograd: Volgograd State Pedagogical University, 1989.
- Leontoviç, O., *Typological Characteristics of the Inner Forms of Idioms for Their Phraseographic Description in Phraseological Dictionaries and Computer Phraseography*. Materials of a seminar. - Oryol: Oryol State Pedagogical University, 1990.
- Leopold W., *Inner Form*, Language, Vol. 5, nr. 4, 1929.
- Littellmore J. & Low G. *Metaphoric Competence, second language learning, and communicative language ability*, Applied Linguistics, 27, 2006.
- Losener H., *Zweimal Sprache: Weisgerber und Humboldt*, Munster: Nodus Publikationen, 2000, f.197-212. Hans Losener, *Twice Language: Weisgerber and Humboldt* (përkth. anglisht).
- Lloshi Xh., *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, I. Tiranë, 1972.
- Lloshi Xh., *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, I. Tiranë, 1972.

- Longman, *Idioms dictionary*, Edinburgh, 1998.
- Lukreci, *Mbi natyrën e sendeve*, Tiranë, 1961.
- Lyons J., *Language and linguistics*, Cambridge University Press, 1981.
- Lyons J., *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001.
- Marty Anton, “Über subjektlose Sätze und das Verhältnis der Grammatik zur Logik und Psychologie”, *Vierteljahrsschrift für äissenschaftliche Philosophie* 8, 56-94 (1st article, also in Marty, [eds.] Eisenmeier et al. 1918, 3-35), 161-192 (2nd article, also in Marty, [eds.] Eisenmeier et al. 1918, 36-62), 292-340 (3rd article, also in Marty, [eds.] Eisenmeier et al. 1918, 62-101).
- Marty Anton. *Untersuchungen zur Grundlegung der allgemeinen Grammatik und Sprachphilosophie*, Vol. I. Halle a. S.: Max Niemeyer, 1908.
- Matews P. H., *The Concise Oxford Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 1977.
- Memisha V., *Studime për fjalën shqipe*, Botart, Tiranë, 2011.
- Memushaj R., *Gjuhësia gjenerative*, ShBLU, Tiranë, 2008.
- Mujaj H., *Gjuhësia e tekstit*. Faik Konica, Prishtinë, 2004.
- Newmark L., *Albanian English Dictionary*, Albin, Tiranë, 2000.
- Osmani T. & Pepa S. *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000.
- Osmani T. *Shejzat për gjuhën shqipe*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2013.
- Oxford advanced learner's dictionary*, 7<sup>th</sup> edition, Oxford University Press, 1997.
- Oxford Albanian-English dictionary*, Oxford University Press, 1999.
- Oxford Idioms*, Oxford University Press, 2006.
- Dictionary of Synonyms and Antonyms*, Oxford, 2007.
- Palmer F. R., *Semantics*, Cambridge, 1977.
- Pasho H., *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe, nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX*. Tiranë, 2005.
- Potebnja A. *Thought and language*. Oxford, 1926.
- Presheva A., *Filozofia e gjuhës*, Prishtinë, 1998.
- Presheva A., *Gjuha dhe metagjuha*, Filara, Tiranë, 2009.
- Preza A. & Preza E., *Fjalor Italisht-shqip*. Tiranë, 2004.
- Qesku P., *Fjalori Shqip e Anglisht*, EDFFA, Tiranë, 2002.
- Qesku P., *Fjalori Anglisht-Shqip*, EDFFA, Tiranë, 2004.

- Qosja R., *Nocione të reja albanologjike*, Prishtinë, 1983.
- Rawson H. *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, New York; Crown publishers, Inc., 1981.
- Robins H. R. *Historia e gjuhësisë*, Dituria, Tiranë, 2007.
- Rojzenzon L. I. *Forma e brendshme e fjalës dhe forma e brendshme e njësive frazeologjike në Voprosi frazeologji*, Tashkent, 1965.
- Routledge, S., *Key ideas in linguistic and philosophy of language*,
- Rrokaj Sh., *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, ShBLU, Tiranë, 2005.
- Rrokaj Sh., *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Arbëria, Tiranë, 2012.
- Rrokaj Sh., *Çështje të gjuhës shqipe 1*, Albatros, Tiranë, 2007.
- Rrokaj Sh., *Filozofia e gjuhës*, Arbëria, Tiranë, 2010.
- Rrokaj Sh., *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2014.
- Sapir E., *Gjuha. Hyrje në studimin e ligjërimit dhe studimet mbi sistemin fonetik*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Sausure F. *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002.
- Saviano, R., *Gomorra*, Dudaj, Tiranë, 2008.
- Stefanllari I. & Dheri V., *Fjalor frazeologjik anglisht-shqip*, Tiranë, 1981
- Stefanllari I. *A course in English lexicology*, Tiranë, 2011.
- Sharpe M. E., *The inner form of the word*, Journal of Russian and East European Psychology, Volume 38, Number 4, 2000.
- Shijaku E., *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Dituria, Tiranë, 1998.
- Shkurtaj Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001.
- Shkurtaj Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, ShBLU, Tiranë, 2004.
- Shkurtaj GJ., *Kultura e gjuhës*, ShBLU, Tiranë, 2006.
- Shkurtaj Gj., *Kundrime gjuhësore*, Tiranë, 2006.
- Shpet G. G., *The inner form of the words-Essays and variation on the theme Humboldt/Vnutrennyaya forma slova-Etyudu i variatsii nga temy Gumbolta*, M. 2009.
- Toska T., *Përfaqësimi i përvojës së shqipfolësve në gjuhë të njësitë frazeologjike*. (tezë disertacioni në udhëheqjen e prof. dr. Shezai Rrokaj), Tiranë, 2012.
- Thomai J. & Lloshi Xh., *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*. Studime filologjike, nr. 1, 1967, Tiranë.

- Thomai J. & Loshi Xh. & Hristova R. & Qirjazati K. & Melonashi A. *Fjalori Fjalor Frazologjik Ballkanik*, Dituria, Tiranë, 1999.
- Thomai J., *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1981.
- Thomai J., *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989.
- Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, ShBLU, Tiranë, 1999.
- Thomai J., *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
- Thomai J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.
- Thomai J., *Një fjalor që i mungonte kulturës shqiptare*, Gjuha shqipe, nr. 1, 2008, Prishtinë.
- Thomai J., Samara M., Shehu H., Feka Th., *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- Veselaj N., *Fjalor shprehjesh frazeologjike anglisht-shqip*, Prishtinë, 1990.
- Xhoxhaj D., *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip-frëngjisht*. EDFFA. Tiranë, 2010.
- Xhuvani A., *Kompozitat*, Vepra, 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980.
- Yule G., *Pragmatics*, Oxford University Press, 1996.
- Zanicheli, *Dizionario compiatto della lingua italiana*, Zanichelli editore, 1996.
- Zhyllia D., *Fjalor i filozofisë*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1994.
- Zoto V., *Fjalor emrash*, Desara. Tiranë, 2005.
- Zvegincev V. A., *Semasiologjia*, M. 1957. (përkthim nga rusishtja prej Akad. Jani Thomai, kopje e daktilografuar).
- Weinreich. U., *Problems in the analysis of idioms*, në Substance and Structure of Language, University of California Press, 1969, f. 35.
- Weisgerber Leo, *Broad content-based grammar*, German Language I, Dusseldorf, 1962.
- Wierzbicka A., *Emotional Universals*, Language Design, 1999.



## **Përmbledhje**

Në këtë disertacion kemi marrë përsipër të bëjmë një analizë përqsëse të njërive leksiko-frazeologjike të shqipes dhe disa gjuhëve indoeuropiane, me qëllim përligjen e faktit se forma e brendshme e gjuhës (një nga tezat më të spikatura të gjuhësisë së shek. XIX, të shtjelluar nga Ë.Humboldt-i) është pasqyrimi më i qartë dhe më konkret i dallimeve midis gjuhëve, sidomos në fushën e leksikut dhe frazeologjisë dhe, mbi të gjitha, është mekanizmi më i fuqishëm që përçon mendësinë, botëkuptimin, psikologjinë dhe shpirtin krijues të një populli.

Në këtë aspekt, ndër elementet e leksikut që përshfaqin më tepër veçori dalluese, karakterizuese dhe identifikuese, përzgjedhëm kompozitat, eufemizmat, njësitë frazeologjike, fjalët e prejardhura, antroponimet, togfjalëshat terminologjikë etj. Teoria e formës së brendshme është plotësisht e përligjur në rastin e analizës sonë dhe na çoi në përfundimin se mjetet gjuhësore përmes të cilave kategoritë e logjikës sendërtohen materialisht në shenja gjuhësore, janë pasqyrim i botës së brendshme shpirtërore.

Mënyra se si folësit e gjuhëve e perceptojnë realitetin, lidhja dhe materializimi i veshjes tingullore me konceptin që shprehet me anë të saj, përzgjedhja e elementëve gjuhësorë origjinalë që bashkësitë e ndryshme gjuhëfolëse zgjedhin për të shenjuar një realie, për të shprehur një përmbajtje të caktuar etj., nuk mund të shpjegohet tjetër veçse me traditën, kulturën, botën materiale, mendësinë, shkallën e njohjes së realitetit objektiv, kushtet dhe mënyra e jetesës etj. Veç të tjerash, dallimet e dukshme në fushën e leksikut përcaktohen nga dallimet e parimeve të brendshme të logjikës dhe perceptimit. Koncepti triplanësh që Humboldt-i kishte për gjuhën, duke u shprehur se forma e brendshme e gjuhës është shpirti i popullit dhe gjuha vetë, shprehet edhe me faktin se qasjet dhe bashkëpërkimet që folësit e këtyre gjuhëve gjejnë midis elementeve të realies dhe tërësisë së veshjeve gjuhësore dëshmojnë shpirtin origjinal dhe natyrën e pakrahasueshme të këtyre gjuhëve.

## **Abstract**

The aim of this thesis is to conduct an inquiry on one of the most important thesis of the 19<sup>th</sup> century linguistic studies established by Wilhelm Von Humboldt, the principle of inner form, as well as to demonstrate that the inner form of the language which serves as a means of expressing the psychic content of it, is the most concrete and evident demonstration of the particular features and special characteristics a language possesses especially in terms of lexicon and phraseology as it transmits and conveys the national spirit, point of views and general outlook. This thesis aims to make a contrastive analysis of lexical items between Albanian and other Indo-European languages. Humboldt's theory appeared of great interest and provided us a lot of evidence to fully justify the fact that during the process of shaping and structurally formalizing the basic sound patterns of different languages, people have dissolved their spirit, their mentality, their way of thinking and understanding.. The notion of the inner form is not neither abstract nor inconceivable, it represents and purely reflects a kind of association between the sound sequence and the notion/concept it perceives, is a mechanism people chose to objectivize the thought into meaningful and concrete instruments. The characteristic features of the languages we have analyzed have naturally arisen from the laws of thinking shared by all member of this language speaking community. Exploiting the power of compound words we became aware of the fact that the signifying words used or the selection of different linguistic elements to nominate one and the same objective reality's component was not at all neither identical nor similar and this data gave us the immense possibility to advance arguments that a native language speakers perceive, understand, interpret and shape the real world in different distinct, original ways and that the devices people choose to cut up their reality apparently differ a lot from languages to languages. Humboldt's concept and perception that "the inner form of a language has a triple content; the way the categories of the conscious mind are reflected in the language system, the reflection of peoples' spiritual world, the language itself" gain special value and significance in this contrastive analysis.